



Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Buletini Shkencor

Buletini shkencor Nr.6 Vol.4 - 2023



Buletini shkencor

NR.6, VOL.4 - 2023

ISSN: 2310-6719

ISSN online: 3005-8473

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

Buletini shkencor

Numër 6, Vëllimi 4, 2023

ISSN 2310-6719
ISSN online 3005-8473

BULETINI SHKENCOR
Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë

Numër 6, Vëllimi 4, 2023

ISSN 2310-6719
ISSN online 3005-8473

Fjala hyrëse

Nga Prof. Dr. Roland Zisi, Rektor i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë

Është detyrim dhe kënaqësi për mua që si kryeredaktor i Buletinit Shkencor të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, që të përcjell për lexuesit një rezymë shpjegues në çelje të volumit të ri të tij, (Numër 6, Vëllimi 4, 2023). Ky numër i ri i Buletinit tonë shkencor përmban 19 artikuj studimorë nga fusha të ndryshme si drejtësia, shkencat politike, shëndetësia, gjuhësia etj.

Buletini Shkencor i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë drejtohet nga një Bord Editorial dhe redaksitë përkatëse. Pjesë e Bordit Editorial janë akademikë të njohur në fusha të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Buletini Shkencor ka si qëllim të udhëtojë nëpër mjediset e universiteteve kombëtare dhe ndërkombëtare për promovimin e rezultateve të kërkimit shkencor të ndërmarrë nga profesorati i Universitetit “Ismail Qemali”, dhe jo vetëm.

Pjesa më e madhe e materialeve të botuara në Buletinin Shkencor të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë janë fryt i punës kërkimore-shkencore që kryejnë pedagogët e Universitetit të Vlores, por prej kohësh janë afruar edhe studiues të universiteteve të tjera të vendit. Paralelisht, Buletini Shkencor u jep mundësinë edhe studentëve të UV të publikojnë punimet e tyre shkencor në bashkëpunim me profesorët e tyre edhe/ose me studentë të tjerë.

Në nëntor të këtij viti, pas aplikimit në Qendrën Ndërkombëtare për Regjistrimin e Publikimeve Seriale (CIEPS – ISSN International Qendra), me vendndodhje në Paris, Buletini Shkencor është pajisur me numër ISSN për publikime online (ISSN: 3005-8473).

Jam i sigurt se ky volum i ri i Buletinit Shkencor do të shërbejë jo vetëm gjatë mësimdhënies me të dhëna shkencore të reja por edhe si shëmbull për brezat e reja të kërkuesve shkencor.

Duke respektuar planin strategjik të UV-s për rritjen e kërkimit shkencor, unë si Rektor i UV-s si dhe të gjitha autoritetet drejtuese do të vazhdojmë të mbështesim studime sa më cilësore e bashkohore të cilat i përshtaten dhe i përgjigjen nevojave lokale, rajonale e më gjerë.

Vlorë, Dhjetor 2023

Bordi editorial:

1. Prof. Dr. Roland ZISI (Kryetar)
2. Prof. As. Dr. Frosina Londo
3. Prof. As. Dr. Aurela Saliaj
4. Prof. Dr. Albert Qarri
5. Prof. As. Dr. Armela Panajoti
6. Prof. As. Dr. Hajdar Kiçaj
7. Prof. As. Dr. Enkelejd Mehilli

Bordi Shkencor:

1. Prof. Dr. Roland ZISI (Kryetar)

Fakulteti i Shkencave Humane

2. Prof. Dr. Bardhosh Gaçe
3. Prof. Dr. Nexhip Merkuri
4. Prof. As. Monika Hasani
5. Prof. As. Veneranda Hajrulla
6. PhD Erion Hitaj

Fakulteti i Ekonomisë

7. Prof. As. Dr. Xhiliola Agaraj (Shehu)
8. Prof. As. Dr. Klaudia Guga
9. Prof. As. Dr. Ilirian Lipi
10. Prof. As. Dr. Evelina Bazini
11. Prof. As. Dr. Fjoralba Velaj
12. Prof. As. Dr. Elenica Piero
13. Prof. As. Dr. Filloreta Madani

Fakulteti i Shendetit Publik

14. Prof. Dr. Yllka Bilushi

Fakulteti i Shkencave Teknike

15. Prof. As. Dr. Kristofor Lapa
16. Prof. As. Dr. Flora Qarri
17. Prof. As. Dr. Ermal Feleqi
18. Prof. As. Dr. Denada Kasëmi
19. Prof. As. Dr. Diana Ilia
20. Prof. As. Dr. Luljeta Gushe
21. Prof. As. Dr. Llambrini Sota

Të jashtëm

22. Prof. Dr. Genuario Belmonte
23. Prof. Dr. Triantaphyllos Almpanis
24. Prof. Dr. Francesko Altimari
25. Prof. Dr. Jorgo Kaçani
26. Prof. Dr. Muzafer Korkuti
27. Prof. Dr. Shaban Sinani
28. Prof. Dr. Dhori Kule

INFORMACION

Buletini Shkencor boton punime origjinale që sjellin njohuri të reja dhe të rëndësishme për avancimin e shkencës.

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të gjetjeve shkencore të akademikëve shqiptarë brenda dhe jashtë mjedisit universitar shqiptar. Rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për të gjithë kërkuesit akademik dhe jo vetëm të bëjnë të njohura gjetjet më të reja në fushat përkatëse të tyre si dhe në përditësimin në kohë të gjetjeve të mëparshme.

Dërgimi i dorëshkrimit nënkupton që punimi i paraqitur në të nuk është botuar më parë (përveçse në formën e një përmbledhjeje, leksioni apo tezave akademike), nuk është në shqyrtim për t'u botuar gjetkë dhe se botimi është aprovuar nga të gjithë autorët, si dhe autoritetet përgjegjëse ku hulumtimi është kryer. Autorëve do t'ju kërkohet që të paraqesin, nëse ka ndonjë konflikt interesash, si dhe ndonjë burim financiar të veçantë të përdorur për kryerjen e kërkimit. Nëse dorëshkrimi pranohet për botim ai nuk mund të botohet në të njëjtën formë diku tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga Bordi i Buletinit Shkencor.

Plagjiatura nuk lejohet dhe do t'u raportohet si autorit, ashtu edhe autoriteteve përkatëse. Konkluzionet duhet të justifikohen nga skema eksperimentale dhe të dhënat e paraqitura. Informacioni duhet të jetë i detajuar në mënyrë që të lejojë përsëritjen e punës nga shkencëtarë të tjerë të së njëjtës fushë. Autorët duhet t'i ruajnë të dhënat eksperimentale dhe t'ia paraqesin Këshillit Botues, nëse u kërkohen. Shkrimi duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm, konçiz dhe korrekt nga ana gramatikore. Autorët mbajnë përgjegjësi për anën shkencore dhe formale të materialeve që paraqesin, si dhe për çdo korrespondencë me redaktorët.

Të interesuarit të paraqiten me arritjet më të reja nga fushat e angazhimeve të tyre profesionale – shkencore.

Artikujt duhet të jenë origjinale (të pakumtuara në ndonjë aktivitet tjetër), të pabotuara dhe jo në proces vlerësimi ose botimi (në ndonjë redaksi tjetër).

Autorët janë përgjegjës për redaktimin gjuhësor të tekstit të përmbledhjeve të tyre, qoftë në shqip, qoftë në anglisht.

Të gjithë autorët e interesuar për të botuar në Buletinin Shkencor të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë mund të na kontaktojnë në adresën email: publikime@univlora.edu.al

Përmbajtja

SHKENCAT MJEKËSORE DHE SHËNDETËSORE

PREVALENCA E BURNOUT-IT AKADEMIK TEK STUDENTËT E FAKULTETIT TË SHËNDETIT, VLORE	
<i>Erlini Kokalla, Brunilda Subashi, Lejdi Fetahu, Marjola Muhaj, Majlinda Rakipaj.....</i>	<i>9</i>
IMPAKTI I COVID-19 NË GJENDJEN PSIKOLOGJIKE TË INFERMIERËVE	
<i>Evis Allushi, Adela Lame, Vasilika Prifti, Sonila Nika.....</i>	<i>16</i>
VLERËSIMI I NJOHURIVE TË STUDENTËVE TË INFERMIERISË PËR ROLIN E USHQYERJES SË SHËNDETSHME NË PARANDALIMIN E KANCEREVE TË LIDHURA ME DIETËN	
<i>Xhesika Dine.....</i>	<i>24</i>

SHKENCAT HUMANE, POLITIKE-JURIDIKE DHE EKONOMIKE

MBI NATYRËN E KONFLIKTEVE NË SHOQËRI DHE MENAXHIMI I TYRE	
<i>Ferit Baça.....</i>	<i>31</i>
KONGRESI I MANASTIRIT	
<i>Blerina Xhelaj.....</i>	<i>37</i>
TIK TOKU, SFIDA E RE E MEDIAVE KLASIKE	
<i>Deniz Çupi (Xhoga).....</i>	<i>43</i>
DREJTËSI ME NDËRMJETËSIM	
<i>Drita Avdyli, Enkeledi Hajro.....</i>	<i>50</i>
ROLI I PROKURORIT NË GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE FAMILJARE	
<i>Erida Visoçi.....</i>	<i>55</i>

GJUHËSI-ALBANOLOGJI

THE BENEFITS OF A DUAL DEGREE PROGRAM IN UNIVERSITY	
<i>Frosina Londo, Kozeta Hyso, Zamira Alimemaj.....</i>	<i>67</i>
FOREIGN LANGUAGES AS A KEY CRUCIAL ELEMENT IN UNDERSTANDING BUSINESS - CULTURAL DIFFERENCES	
<i>Kozeta Hyso, Frosina Londo.....</i>	<i>70</i>
“TANUSHA E KRAJLIT” SI SIMBOL I BUKURISË FEMËRORE NË EPOSIN SHQIPTAR	
<i>Alta Haluci, Çerkezi Edlira.....</i>	<i>74</i>
ASPEKTE TË PËRKTHIMIT TË EMRAVE TË PËRVEÇËM NË LETËRSINË PËR FËMIJË	
<i>Viola Adhami.....</i>	<i>81</i>

SHPIRTI I JASHTËM NË PËRRALLA <i>Çerkezi Edlira, Alta Haluci</i>	85
MENAXHIMI I KLASËS DHE MATERIALET AUTENTIKE GJATË MËSIMIT TË GJUHËS SË HUAJ.RASTI I GJUHËS ITALIANE <i>Eliona Naqo</i>	90
MOMENTE TË NDIKIMIT RECIPROK DHE TË IDENTIFIKIMIT TË FILOZOFISË ME PEDAGOGJINË <i>Jak Simoni</i>	96
NDIKIMI I ARTIT TE TË FOLURIT NË ORË MËSIMORE PROJEKTESH E PËRSHTATUR ME GJUHËN STANDARDE SHQIPE <i>Joana Lapa</i>	103
SHKENCAT INXHINIERIKE DHE MATEMATIKORE	
VLERËSIMI I KARAKTERISTIKAVE TË LËVIZSHMËRISË TË NJË ANIJEJE PESHKIMI NËPËRMJET PËRDORIMIT TË SOFTUERIT “FUQI ANIJE V 1.0” <i>Blenard Xhaferaj</i>	108
SISTEMI I TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE PREZANTIMI I MBROJTJES FDIR <i>Mateo Selfo, Aldi Tabaku, Enio Selfo</i>	114
RRJETI RRUGOR DHE NEVOJA PËR TRANSPORT TË QËNDRUESHËM NË QYTETIN E VLORËS <i>Pëllumb Cacaj, Shpëtim Cami</i>	123

SHKENCAT MJEKËSORE DHE SHËNDETËSORE

Prevalenca e burnout-it akademik tek studentët e Fakultetit të Shëndetit, Vlorë

Msc. Erlini Kokalla*

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit

erlini.kokalla@univlora.edu.al

PhDC. Brunilda Subashi

Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik
brunilda.subashi@univlora.edu.al

Msc. Lejdi Fetahu

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit

lejdi.fetahu@univlora.edu.al

Msc. Marjola Muhaj

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit

marjola.muhaj@univlora.edu.al

Msc. Majlinda Rakipaj

Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit
majlinda.rakipaj@univlora.edu.al

Abstrakt

Hyrje: Dinamizmi i jetës studentore bën që studentët të ekspozohen ndaj një sërë faktorësh stresues, të cilët mund të derivojnë në të ashtuquajturin burnout-i akademik. Ky fenomen përkufizohet si një reagim negativ emocional, fizik dhe mendor, për shkak të studimit të zgjatur që rezulton në rraskapitje, zhgënjim, mungesë motivimi dhe reduktim të aftësive të studentëve.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i prevalencës së burnout-it akademik tek studentët e fakultetit të Shëndetit (infirmieri dhe infirmieri-mami), në qytetin e Vlorës.

Metodologjia: Studimi është kros-seksional dhe përfshin 281 studentë të anketuar gjatë muajve mars-qershor 2023.

Rezultate: Shumica e pjesëmarrësve ishin femra (85.8%) dhe mosha mesatare ishte 20 (± 2) vjeç. Sindromi i burnout-it akademik u evidentua në 27.8% të studentëve të përfshirë në studim. Përsa i përket 3 dimensioneve të burnout-it, 60.9% e studentëve rezultuan me nivele të larta të rraskapitjes emocionale, 63.3% me nivele të larta të cinizmit dhe 58% e studentëve me nivele të ulëta të efikasitetit akademik.

Konkluzione: Dimensionet e sindromit të burnout-it akademik evidentohen ndjeshëm tek

Results: The majority of participants were female (85.8%) and the mean age of the study

studentët e infermierisë dhe infirmieri-mamisë në Fakultetin e Shëndetit, prandaj është i rëndësishëm krijimi i një sistemi universitar bashkëpunues për të nxitur motivimin dhe reduktuar faktorët e mundshëm të burnout-it.

Fjalë kyçe: Burnout-i akademik, studentët e infermierisë, studentët e mamisë, rraskapitje, cinizëm, efikasiteti akademik.

Abstract

Background: The dynamism of student life exposes students to several stressful factors, which can lead to so-called academic burnout. This phenomenon can be defined as a negative emotional, physical and mental reaction to prolonged study that results in exhaustion, frustration, lack of motivation and reduced of students' abilities.

Purpose: The purpose of this study is to assess the prevalence of academic burnout syndrome in nursing and midwifery students at the Faculty of Health.

Methodology: The study is cross-sectional and includes 281 students surveyed during March-June 2023.

participants was 20 (± 2) years old. The results showed that the prevalence of academic burnout

syndrome was 27.8% among the surveyed. Regarding the 3 dimensions of burnout, about 60.9% of students had high level of emotional exhaustion, 63.3% of students had high level of cynicism, and 58% of students suffered from low levels of academic efficacy.

Conclusions: Considering that the presence of the academic burnout dimensions is significantly encountered among nursing and midwifery students in the Faculty of Health, the university should establish a cooperative system to motivate students and to reduce the factors of burnout.

Keywords: *Academic Burnout, nursing students, midwifery students, exhaustion, cynicism, academic efficacy, score.*

1. Hyrje

Burnout-i është një sindromë e konceptuar si rezultat i stresit kronik në vendin e punës dhe karakterizohet nga tre dimensione; rraskapitja apo humbja e energjisë, cinizmi dhe reduktimi i efikasitetit.[1] Rraskapitja përfshin ndjenjën e tendosjes dhe lodhjes kronike, cinizmi konsiston në një qëndrim indiferent, humbjen e interesit apo mospërfilljen ndaj punës; dhe mungesa e efikasitetit profesional i referohet ndjenjave të reduktuara të kompetencës, arritjeve dhe përmbushjes profesionale.[2] Pra burnout-i është një fenomen, i cili i atribuohet vendit të punës[3], por në ditët e sotme ky koncept është zgjeruar duke përfshirë edhe fushën akademike.[4]

Ashtu si në mjedisin e punës, studentët, gjatë shkollimit të tyre universitar, përballen me kërkesa akademike - teste, punë teorike dhe praktike në kurs, aktivitete kërkimore dhe aspekte të praktikës profesionale, të tilla si kontakti me profesionistët e shëndetësisë dhe pacientët, si dhe çështjet praktike të ofrimit të shërbimeve shëndetësore; të cilat mund të vlerësohen si stresorë. [5]

Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj këtyre stresorëve, kombinuar edhe me tiparet e karakterit të tyre, bën që studentët të preken nga sindromi i burnout-it.

Burnout-i akademik cilësohet si një reagim negativ emocional, fizik dhe mendor, si rezultat i studimit të zgjatur që rezulton në rraskapitje,

zhgënjim, mungesë motivimi dhe reduktim të aftësive në mjedisin akademik. [6]

Ky sindrom mund të derivojë gjithashtu në shqetësime mendore në formën e ankthit, stresit të zgjatur, depresionit, armiqësisë ose frikës, moral dhe në vetëvlerësim të ulët. [7]

Por pasojat e burnout-it tek studentët e shëndetësisë duhen vlerësuar në perspektivë dhe jo vetëm përgjatë periudhës akademike.

Është evidentuar se burnout-i i hershëm tek profesionistët e ardhshëm të shëndetësisë mund të influencojë zhvillimin shëndetësor dhe profesional të tyre, të ndikojë në cilësinë e kujdesit shëndetësor dhe të ekspozojë pacientët ndaj rreziqeve të lidhura me kujdesin[8]. Pra efektet e burnout-it, përveç studentëve të prekur, shihet të afektojnë edhe aktorë të tjerë vulnerabël të shoqërisë, prandaj studimi i këtij fenomeni tek studentët e infermierisë/ mamisë shihet si thelbësor.

Në vendin tonë nuk ka evidenca mbi burnout-in akademik, prandaj synimi i këtij studimi është vlerësimi i nivelit të këtij sindromi tek studentët e Fakultetit të Shëndetit, duke krijuar kështu një pasqyrë të situatës aktuale dhe shënimin e pikënisjes për studime të mëtejshme.

2. Materiali dhe metoda

Ky është një studim transversal (kros-seksional), me fokus vlerësimin e fenomenit të burnout-it tek studentët e 'Fakultetit të Shëndetit'. Studimi është kryer gjatë periudhës mars-qershor 2023.

2.1. Karakteristikat e kampionit

Në studim u përfshinë 281 studentë të 'Fakultetit të Shëndetit'. Pjesëmarrja ishte vullnerare pas mirë-informimit të tyre në lidhje me qëllimin e studimit. Kriteri i përfshirjes në studim ishte ndjekja e njëres prej degëve pranë Fakultetit të Shëndetit. Ndërsa kriteri i përjashtimit ishte refuzimi i pjesëmarrjes dhe plotësimi jo i plotë i pyetësorit.

2.2. Procesi i anketimit

Pyetësori i përdorur në këtë studim është i strukturuar, me vetëraportim, anonim, duke ruajtur plotësisht konfidencialitetin e pjesëmarrësve. Pyetësori përbëhet nga dy pjesë, si më poshtë vijon:

-Pjesa e parë përfshin të dhënat socio-demografike të popullatës së marrë në studim (gjinia, mosha, vendbanimi, statusi civil, niveli ekonomik dhe statusi i punësimit, dega, viti dhe cikli i studimit).

-Pjesa e dytë e pyetësorit synon vlerësimin e burnout-it dhe korrespondon me Shkallën e burnout-it akademik të Bresos (Breso's academic burnout scale). Pyetësi është përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe, pas marrjes së lejes etike nga autori.

Pyetësi i përdorur për të vlerësuar burnout-in tek studentët është hartuar nga Bresó, Salanova, and Schaufeli [9]. Pyetësi përbëhet nga 15 konstatime mbi 3 dimensionet e burnout-it akademik; rraskapitja, cinizmi, dhe efikasiteti akademik, për të cilat pjesëmarrësit përgjigjen në një shkallë të vlerësimit të frekuencës me 7 pikë që varion nga 0(kurrë), 1(disë herë në vit), 2(një herë në muaj), 3(një herë në javë), 4(një herë në ditë), 5(disë herë në ditë) dhe 6(gjithmonë).[10].

Cut-off i përdorur për kategorizimin e rezultateve është;

	EX	CY	EF
E ulët	≤2	≤1.24	≤4.5
E lartë	>2	>1.24	>4.5

Tabela nr.1: Cut-off-et e përdorura në studim për 3 dimensionet e burnout-it; EX (rraskapitja), CY(cinizmi), EF (efikasiteti akademik).

Shpërndarja e pyetësorit u realizua përmes Google-forms.

2.3. Analiza statistikore e të dhënave

Analiza statistikore e të dhënave të grumbulluara u realizua në SPSS (Statistical Package for Social, Sciences) version 22. Variablat kategorikë janë paraqitur në frekuencë dhe përqindje. Variablat e metrikë janë paraqitur si mesatare dhe deviacion standard. Për vlerësimin e lidhjeve mes variablave u aplikua testi Chi-Square dhe testi Ekzakt i Fisherit. Të dhënat u pasqyruan në tabela dhe grafikë.

3. Rezultatet

Ndër 281 studentë të përfshirë në studim rezultoi se 241 (85.8%) prej tyre i përkasin gjinisë femërore dhe 40 (14.2%) i përkasin gjinisë mashkullore.

Mosha e pjesëmarrësve varion nga 18 vjeç deri në 37 vjeç, me një mesatare ($\pm$ SD) që arrin vlerën 20 ($\pm$ 2)vjeç. Pjesa më e madhe e studentëve i korrespondon moshës 19 vjeç, konkretisht në 45.6% (128) prej tyre.

Shumica e studentëve të përfshirë në studim, 203 (72.2%), janë banues në zonat urbane, ndërsa 78 (27.8%) prej tyre banojnë në zonat rurale.

Bazuar në nivelin ekonomik, studentët kategorizohen në nivel të ulët 13(4.6%) e tyre, nivel mesatar 254(90.4%) dhe nivel të lartë në 14(5%) prej tyre.

Të pyetur mbi statusin civil, rezultoi se 15(5.3%) e studentëve janë të martuar, ndërsa 266(94.7%) janë beqarë.

Përsa i përket angazhimit të tyre në punë, rezultoi se 65 (23.1%) e studentëve janë të punësuar, ndërsa 216 (76.9%) nuk kanë angazhim tjetër përveç studimeve.

Të dhënat e sipërpërmendura janë pasqyruar të përmbledhura edhe në tabelën nr.2.

Të dhëna socio-demografike		Frekuencë (%) / Mesatare ($\pm$ SD)	
Gjinia	Femër	241	85.8%
	Mashkull	40	14.2%
Mosha		20 ($\pm$ 2)	
Vendbanimi	Zona urbane	203	72.2%
	Zona rurale	78	27.8%
Statusi civil	Beqar/e	266	94.7%
	I/e martuar	15	5.3%
Niveli ekonomik	I ulët	13	4.6%
	I mesëm	254	90.4%
	I lartë	14	5.0%
Statusi i punësimit	I punësuar	65	23.1%
	I papunë	216	76.9%
Dega e studimit	Inf.i e pergjithshme	232	82.6%
	Inf.-mami	49	17.4%
Viti studimit	Vit I	179	63.7%
	Vit II	87	31.0%
	Vit III	15	5.3%

Tabela nr.2: Të dhëna socio-demografike, shprehur në frekuencë dhe përqindje (të dhënat kategorike), mesatare dhe deviacion standard (mosha).

Përsa i përket profilit akademik, të gjithë pjesëmarrësit rezultojnë të jenë ndjekës të ciklit


të parë të studimeve (Bachelor), ndër të cilët 232(82.6%) studiojnë infermieri të përgjithshme dhe 49 (17.4%) infermieri-mami; ndërsa përsa i përket vitit të studimit 179 (63.7%) janë në vit të parë, 87(31%) në vit të dytë dhe 15 (5.3%) në vit të tretë.

Vlerësimi i burnout-it akademik është realizuar përmes 15 pyetjeve, ku 5 i përkasin EX(rraskapitjes emocionale), 4 CY(cinizmit) dhe 6 EF (efikasiteti akademik); bazuar në pikëzimin e secilës prej tyre. Pikët e grumbulluara për secilin dimension janë pasqyruar në tabelën nr. 3, ku vihet re se EX arrin një mesatare ($\pm$ SD) 2.7($\pm$ 1.6)pikë, EF 3.9($\pm$ 1.8) pikë dhe CY shënon një vlerë mesatare 1.9($\pm$ 1.5) pikë.

	Mesatare	SD
Pikët e EX	2.7	1.6
Pikët e EF	3.9	1.8
Pikët e CY	1.9	1.5

Tabela nr. 3: Mesataret dhe deviacioni standard i pikëve të grumbulluara për dimensionet e burnout

Diferencimi i studentëve sipas niveleve të burnoutit akademik (bazuar në 3 dimensionet) u bë përmes kategorizimit të pikëve të grumbulluara nga pyetësi, duke pasur parasysh cut-off-in e vendosur në fillim të studimit. U konsideruan me prani të burnout-it akademik studentët që paraqitën rezultate të larta në rraskapitjen emocionale (>2 pikë mesatare) dhe cinizëm (>1.24 pikë mesatare) dhe rezultate të ulëta në efikasitetin akademik (≤ 4.5 pikë mesatare). [11, 12] Variablat e sipërpërmendur janë pasqyruar në grafikun nr.1, 2, 3 dhe 4.




Grafiku nr.1: Shpërndarja e studentëve bazuar në nivelin e EX.

Siç evidentohet në grafikun nr.1 rreth 60.9% e studentëve të anketuar, kanë rezultuar me nivel


të lartë të rraskapitjes emocionale (EX), ndërsa 39.1% e tyre me nivel të ulët.

Shumica e studentëve të përfshirë në studim shfaqin nivele të larta të cinizmit, konkretisht 63.3%, ndërsa 36.7% e tyre nivel të ulët të cinizmit. (grafiku nr.2)




Grafiku nr. 2: Shpërndarja e studentëve bazuar në nivelin e CY.

Gjithashtu edhe nivelet e efikasitetit akademik rezultojnë të ulëta në pjesën më të madhe të studentëve, 58% e tyre. Ndërsa 42% e tyre shfaqin nivele optimale të efikasitetit. (grafiku nr.3)



Grafiku nr.3: Shpërndarja e studentëve bazuar në nivelin e EF.

Përmes vlerësimit të 3 dimensioneve të burnout-it, u përcaktua prania ose jo e sindromit tek studentët. Pra studentët që përfshinin nivele të larta të rraskapitjes emocionale, të cinizmit dhe nivele të ulëta të efikasitetit akademik, u identifikuan me prani të burnout-it.



Grafiku nr.4: Prania e burnout-it akademik (AB) tek studentët

Pas kategorizimit përkatës, burnout-i akademik (AB) rezultoi i pranishëm në 27.8% të studentëve të përfshirë në studim.

Nivelet e burnout-it u vlerësuan sipas të dhënave socio-demografike. Shpërndarja e tyre sipas të dhënave socio-demografike (gjinia, vendbanimi, niveli ekonomik, dega e studimit, statusi i punësimit) është pasqyruar në grafikun nr. 5.

Nga grafiku evidentohet se sindromi i burnout-it akademik shprehet më tepër tek femrat (89.7%) se tek meshkujt (10.3%), tek studentët e që janë banues në zonat urbane (73.1%) dhe me nivel ekonomik të mesëm (87.2%). Përsa i përket degës së studimit, studentët e infermierisë së përgjithshme kanë një frekuencë më të lartë të


burnout-it (85.8%), krahasuar me ata që ndjekin programin infermieri-mami. Ndërsa studentët, të cilët përveç studimeve janë edhe të punësuar, rezultojnë me një hasje më të ulët të burnout-it se sa ata që nuk janë të punësuar.

	Gjinia	Vendbanimi	Niveli ekonomik	Statusi civil	Dega e studimit	Punësuar
Vlera e testit	1.4	.038	4.815	.009	.834	.924
vlera p (Chi-Square)	.24	.846	.09		.361	.336
vlera p (Fisher)				0.92		

Tabela nr. 4: Rezultatet e testit Chi-Square dhe T. Ekzakt të Fisherit (Vlerësimi lidhjes Burnout akademik - të dhëna socio-demografike)

Diferencat mes grupeve u vlerësuan përmes testit Chi-Square dhe testit Ekzakt të Fisherit, rezultatet e të cilëve janë pasqyruar në tabelën nr.4.

Nga aplikimi i testeve rezultojnë se nuk ka ndonjë lidhje mes variablave të sipërpërmendur, çka do të thotë se ndryshimi mes grupeve është derivim i hendeikut numerik të pjesëmarrësve për secilën kategori.



Grafiku nr. 5: Shpërndarja e studentëve me nivel të lartë të burnout-it akademik, sipas të dhënave socio-demografike.

4.Diskutimi

Në këtë studim u trajtua sindromi i burnout-it akademik dhe u bë vlerësimi i nivelit të tij (përmes 3 dimensioneve; rraskapitja emocionale, cinizmi, dhe efikasiteti akademik) tek 281 studentë të 'Fakultetit të Shëndetit', matja e të cilit u realizua përmes shkallës së burnout-it akademik të Bresos (Breso's academic burnout scale).

Pas analizimit dhe kategorizimit të pikëve të grumbulluara përmes 15 pyetjeve të pyetësorit, rezultoi se 60.9% e studentëve shfaqën nivele të larta të rraskapitjes emocionale, 63.3% nivele të larta të cinizmit dhe 58% e studentëve shfaqën nivele të ulëta të efikasitetit akademik.

Niveli i lartë i cinizmit dhe nivelet e ulëta të efikasitetit akademik, në këtë studim, shihen të jenë më të shprehura tek studentët krahasuar me 2 studime të tjera të ngjashme të aplikuara tek studentët e infermierisë, konkretisht në Etiopi (2021) ku në një kampion prej 151 studentësh 47.9% shënuan nivel të lartë të CY; 59.7% nivel të ulët të EF; dhe në Brazil (2020) ku nga 114 studentë 31.6% shfaqën CY të lartë dhe 21.1% EF të ulët. Ndërsa rraskapitja emocionale rezulton të jetë më e ulët se në studimet e sipërpërmendura, e cila shënon vlerën 61.8% për studimin e parë dhe 76.3% për studimin e dytë. [13, 14]

Prevalenca totale e burnout-it akademik tek studentët e Fakultetit të Shëndetit rezulton të jetë 27.8%. Kjo vlerë shihet të jetë e lartë krahasuar me studimin e kryer në Brazil (2020) ku prevalenca e burnout-it është 10.5%. Por krahasuar me studimin e Etiopisë (2021) me 34.0% dhe me një studim të realizuar në Serbi (2015), ku burnout-i akademik arrin vlerën 84.4%, prevalenca e evidentuar tek studentët e qytetit të Vlorës rezulton të jetë e ulët. [13, 14, 15]

Pavarësisht rezultateve krahasimore me studimet në shtetet e tjera, niveli i burnout-it akademik cilësohet i konsiderueshëm, duke pasur parasysh edhe rezultatet e arritura specifikisht për 3 dimensionet, të cilët janë tregues të pranisë së 'symptomave' që mund të derivojnë në burnout.

Nga analizimi i të dhënave të përgjithshme të përfshira në këtë studim, nuk u arrit të evidentoheshin lidhje sinjifikante, për të përcaktuar faktorë të mundshëm të burnout-it, pavarësisht se në shumë studime gjinia, viti i studimit dhe statusi civil, përbëjnë faktorë të

rëndësishëm për nxitjen e sindromit të burnout-it. [15, 16, 17, 18]

Duhet pasur parasysh se limitimi i rezultateve të studimit vjen si pasojë e kampionit të vogël të marrë në studim gjë që kufizon diversitetin e tij. Por pavarësisht kësaj, duke qënë se ky është studimi i parë që vlerëson nivelin e burnout-it tek studentët në vendin tonë, mund të shërbejë si referencë për studime të ardhshme, më të zgjeruara të lidhura me këtë tematikë dhe kryesisht me fokus evidentimin e faktorëve të riskut.

5. Konkluzione

Nga ky studim u konkludua se studentët e infermierisë dhe infermieri-mamisë në 'Fakultetin e Shëndetit', Vlorë shfaqin nivele të konsiderueshme të burnout-it. Bazuar në 3 dimensionet e vlerësuara të këtij fenomeni, evidentohet ndjeshën numri i rasteve që riskohen për t'u prekur nga burnout. Duke pasur parasysh këto gjetje, rekomandohet kryerja e një studimi në nivel më madhor, si dhe krijimi i një sistemi universitar bashkëpunues për të nxitur motivimin dhe reduktuar faktorët e mundshëm të burnout-it.

6. Referenca

1. Maslach C, Jackson SE. *The measurement of experienced burnout.* J Occup Behav. 1981; 2:99113
2. Vera Walburg, *Burnout among high school students: A literature review.* Children and Youth Services Review 42 (2014) 28–33
3. Kim B, Jee S, Lee J, An S, Lee SM. *Relationships between social support and student burnout: a meta-analytic approach.* Stress Health. 2018; 34(1):127–134. doi: 10.1002/smi.2771
4. Bresó E, Salanova M, Schaufeli WB. *In search of the 'third dimension' of burnout.* Appl Psychol. 2007; 56:460–78.
5. Costa ALS. *Stress in nursing students: construction of determining factors.* REME Rev Min Enferm. 2007; 11:414–419
6. Stevenson, Danica, *Academic burnout in nursing school.* Nursing 52(3):p 60-61, March2022. DOI: 10.1097/01.NURSE.0000820056.95100.26
7. Cordes, C. L., & Dougherty, T. W. (1993). *A review and an integration of research on job*

burnout. *Academy of management review*, 18(4), 621-656

8. Rudman A, Gustavsson JP. Burnout during nursing education predicts lower occupational preparedness and future clinical performance: a longitudinal study. *Int. J. Nurs. Stud.* 2012;49:988–1001.

9. Yaghoobi, A., Mokhtaran, M., & Mohammadzadeh, S. (2017). Predicting Academic Burnout (Exhaustion) based on Cognitive Styles and Psychological Resilience. *Iranian Evolutionary Educational Psychology Journal*, 1, 1, 7-13.

10. Mohsen Khosravi, Burnout among Iranian medical students: Prevalence and its relationship to personality dimensions and physical activity *Eur J Transl Myol* 2021; 31 (1): 9411. doi: 10.4081/ejtm.2021.941

11. Maslach C, Jackson SE. The measurement of experienced burnout. *J Organ Behav.* 1981;2(2):99–113. doi: 10.1002/job.4030020205.

12. Schaufeli WB, Martinez IM, Pinto AM, Salanova M, Bakker AB. Burnout and engagement in university students: a cross-national study. *J. Cross Cult. Psychol.* 2002;33(5):464–481

13. Yohannes Gebreegziabhere Haile, 1 Amanuel Lemma Senkute, 2 et al. (2019) Prevalence and associated factors of burnout among Debre Berhan University medical students: a cross-sectional study, *BCM Medical Education.* 19: 413. doi: 10.1186/s12909-019-1864-8

14. Maria José Quina Galdino,¹ Laio Preslis Brando Matos de Almeida,² et al (2020) Burnout among nursing students: a mixed method study *Invest Educ Enferm.* doi: 10.17533/udea.iee.v38n1e0

15. Sreten Vičentić, Milan Latas, Jasmina Bariš (2015) Burnout in medical students in Serbia: Preclinical and clinical differences. *Engrami* vol. 37 januar-mart 2015. br. 1

16. Ann Rudman 1, J Petter Gustavsson (2012) Burnout during nursing education predicts lower occupational preparedness and future clinical performance: a longitudinal study *Int J Nurs Stud* 2012 Aug; 49 (8): 988-1001. doi:10.1016/j.ijnurstu.2012.03.010.

17. Mohsen Khosravi (2021) Burnout among Iranian medical students: Prevalence and its

relationship to personality dimensions and physical activity *Eur J Transl Myol* doi: 10.4081/ejtm.2021.9411

18. Zheng Liu¹, Yujin Xie², Zhuhong Sun et al. (2023) Factors associated with academic burnout and its prevalence among university students: a cross-sectional study. *BMC Medical Education* 23:317

19. Eunhee Hwang, Jeonghyun Kim (2022) Factors affecting academic burnout of nursing students according to clinical practice experience *BMC Medical Education* 22: 346. doi: 10.1186/s12909-022-03422-7

Impakti i Covid-19 në gjendjen psikologjike të infermierëve

Dr. Evis Allushi

Adela Lame

Phd candidate Vasilika Prifti

Phd candidate Sonila Nika

evis.allushi@univlora.edu.al

Studimi i përvojave dhe mirëqenies së infermierëve gjatë krizës së Covid-19, është mjaft i rëndësishëm për shkak të ekspozimit të tyre ndaj kushteve që kërcënonin shëndetin, mirëqenien dhe aftësinë e tyre për të punuar, duke identifikuar grupet e rrezikut dhe burimet e mundshme të ndërhyrjes organizative.

Evidentimi i nivelit të problemeve psikologjike tek infermierët dhe faktorët që ndikuan në të gjatë periudhës së pandemisë, është qëllimi i këtij studimi. Ky studim krosesksional u krye duke plotësuar një pyetësor me 64 infermierë nga tre pavione të Spitalit Rajonal Vlorë, patologji, kirurgji dhe urgjencë gjatë periudhës Maj-Qershor 2021, me pyetje mbi të dhënat demografike si moshë, pavioni, eksperiencë në punë dhe pyetje mbi mënyrën sesi ata janë ndjerë gjatë punës me pacientë COVID-19 dhe ndikimi i tyre. Infermierët jo të gjithë kanë njohuri të mira. Vitet e punës ndikonë në rritjen e njohurive. Edhe pse shumica e infermierëve janë trajnuar ata mendojnë se kanë akoma nevojë për trajnim. Shumica e infermierëve kanë frikë nga ekspozimi. Infermierët nuk janë të kënaqur me nivelin e pagave, shprehin se kanë shumë ankth dhe stres. Infermierët nuk ndihen të sigurt në vendin e punës duke u varur kjo nga grupmosha.

Fjalë kyçe: *stres, pandemi, frikë, ankth, siguri në punë.*

The impact of Covid-19 on the psychological state of nurses during Covid-19

Studying the experiences and well-being of nurses during Covid-19, which is very important because of their exposure to conditions that threaten their health, well-being and ability to

work, identifying risk groups and possible sources of intervention.

Evidence of the level of psychological problems among nurses and the factors that influenced it during the pandemic period, is the purpose of this study. This cross-sectional study was conducted by completing an questionnaire with 64 nurses from three wards of the Vlorë Regional Hospital, pathology, surgery and emergency during the period May-June 2021, with questions on demographic data such as age, ward, work experience and questions on how they felt while working with COVID-19 patients and their impact. Not all nurses are knowledgeable. Years of work affect the growth of knowledge. Although most nurses are trained, but they still need training. Nurses are not satisfied with the salary level, they say that they have a lot of anxiety and stress. Nurses do not feel safe in the workplace depending on the age group.

Key words: *stress, pandemic, fear, anxiety, safety at work.*

Hyrje

Pandemia e sëmundjes së re, COVID-19, solli një sfidë të paparë për sistemet e kujdesit shëndetësor në të gjithë globin [1] e njohur gjithashtu si pandemia e koronavirusit, një pandemi globale e vazhdueshme e sëmundjes koronavirus 2019 (COVID-19) e shkaktuar nga sindroma e rëndë akute e frymëmarrjes koronavirus (SARS-CoV-2). Shpërthimi i parë filloi në Ëuhan, Hubei, Kinë në fund të vitit 2019. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) shpalli një Emergjencë të Shëndetit Publik të Shqetësimit Ndërkombëtar në lidhje me COVID-

19 në 30 Janar 2020 dhe më vonë deklaroi një pandemi në 11 Mars 2020.

Virusi COVID-19 përhapet kryesisht përmes pikave të pështymës ose shkarkimit nga hunda kur një person i infektuar kollitet ose teshtin. Komplikacionet që çojnë në vdekje mund të përfshijnë insuficiencën e frymëmarrjes, sindromën akute të distresit të frymëmarrjes (ARDS), sepsin dhe shokun septik, tromboembolizmin dhe / ose dëmtim multiorganor, duke përfshirë dëmtimin e zembrës, heparit ose veshkave.[3]

Të jetosh me një virus potencialisht vdekjeprurës nuk është e vetmja gjë që ka efekte psikologjike. Kufizimet për kontakt dhe dalje pasuan virusin. Shkollat, qendrat e kujdesit ditor, klubet sportive, terrenet e lojërave, restorantet dhe dyqanet janë mbyllur. Jeta gati sa nuk erdhi në një ngërç.

Kriza shëndetësore sulmoi atë që ishte njerëzore. Jeta është e gjitha: shkëmbimi i larmishëm njerëzor për të cilin të gjithë kanë nevojë çdo ditë qëndro i shëndetshëm mendërisht.

Sidoqoftë, pandemia e korona virus përballët me fuqitë njerëzore të vetëshërimit me një të jashtëzakonshme, sfida deri më sot pandemia e Covid-19 nuk ka fund. Pasiguria e madhe që sjell virusi me vete vazhdon. Kërkimi i psikoterapisë është i njohur mirë: krizat më të gjata, konfliktet dhe kërcënimet për jetën [4].

Efektet psikologjike zakonisht janë të ndryshme nga ato të një pandemie njëmuje të kombinuar me vështirësi ekzistenciale ekonomike.

Virusi goditi pothuajse të gjitha shoqëritë në botë me shpejtësi dhe intensitet të paparë. Gjithashtu sepse njerëzimi si kurrë më parë është në kontakt me njëri-tjetrin përmes tregtisë dhe flukseve të udhëtimit. Anasjelltas, masat e mbrojtjes shëndetësore godasin të gjitha sistemet ekonomike pothuajse njëkohësisht.[5]

Qoftë në rutinën e përditshme apo katastrofat, infermierët janë në vijën e parë dhe janë përgjegjës për sigurimin e kujdesit holistik për të gjitha llojet e pacientëve. Duke marrë parasysh faktin që infermierët përbëjnë shumicën e ofruesve të kujdesit shëndetësor, ata kanë një funksion kritik në sistemet e kujdesit shëndetësor [6] Rolet e tyre në trajtimin e pacientëve me COVID-19 përfshijnë triaging pacientë dhe zbulimin e rasteve të dyshuara me infeksione; sigurimi i trajtimit thelbësor në rast urgjence dhe trajtimi i pacientëve të dyshuar me masa paraprake; duke ndihmuar në dekontaminimin dhe koordinimin me ofruesit e tjerë të kujdesit shëndetësor; sigurimi i praktikave holistike të infermierisë në menaxhimin e infeksioneve të shumta në të njëjtën kohë; duke luajtur role kritike në zgjerimin e shërbimeve të kujdesit; dhe marrëdhëniet me të afërmit [7]

Ndikimi psikologjik i pandemisë Covid-19 mbi punonjësit e kujdesit shëndetësor që janë në vijën e frontit është vlerësuar në të gjithë botën përmes studimeve të shumta të botuara në literaturë. Në Itali, një studim ndër-sektorial i 1,379 punonjësve të kujdesit shëndetësor tregoi se moshë më e re dhe seksi femër janë më të lidhura me reagimet anësore, me simptoma të stresit post-traumatik në 49.3% të të intervistuarve, depresion të rëndë në 24.7%, ankth në 8.2%, pagjumësia në 19.8% dhe stresi i lartë i perceptuar në 21.9% [8]

Në Spanjë, u krye një sondazh në internet me 1,422 punëtorë të kujdesit shëndetësor (nga të cilët 1,228 ishin gra), duke demonstruar se si lodhja emocionale dhe depersonalizimi (perceptimi i ndryshuar i vetvetes dhe mjedisit) kontribuojnë në shqetësimin psikologjik, ndërsa qëndrueshmëria dhe përmbushja personale mund të jenë faktorë mbrojtës, me simptoma të çrregullimit të stresit post-traumatik në 56.6% të të anketuarve [9].

Në Shtetet e Bashkuara, 657 mjekëve dhe infermierëve iu dha një sondazh në internet gjatë një rritje të pranimeve në spital, i cili tregoi se infermierët dhe profesionistët e përparuar të kujdesit shëndetësor në veçanti po përjetonin shqetësim psikologjik, me 57% të tyre duke përjetuar shqetësim psikologjik. Ata kishin rezultate përfaqësuese për stres akut, 48% për simptoma depresive dhe 33% për simptoma ankthi [10].

Një rishikim sistematik dhe meta-analizë që synon të ekzaminojë prevalencën e depresionit, ankthit dhe pagjumësisë midis 33,062 profesionistëve të kujdesit shëndetësor që morën pjesë në 13 studime ndër-sektoriale të kryera kryesisht në Kinë, tregoi se gratë dhe infermierët tregojnë nivele më të larta të simptomave. Afektive se burrat dhe mjekë, me një prevalencë të simptomave të ankthit dhe depresionit mbi 20% dhe një prevalencë të çrregullimeve të gjumit prej 38.9% [11].

Materiali dhe metoda:

Qëllimi i studimit: Evidentimi i nivelit të problemeve psikologjike tek infermierët dhe faktorët që ndikuan në të gjatë periudhës së pandemisë, në mënyrë që të ofrohet ndihmë për këtë popullatë.

Objektivat specifik:

Identifikimi i gjendjes psikologjike të infermierëve në Spitalin Rajonal Vlorë, si pasojë e Covid-19.

Identifikimi i faktorëve që kanë ndikuar në psikologjinë e tyre.

Popullata në studim dhe koha e studimit: Në studim morën pjesë 64 infermierë të cilët u

përzgjedhën në mënyrë të rastësishme, që punonin në pavione dhe turne të ndryshme në spitalin rajonal Vlorë. Ky është një studim deskriptiv cross-seksional i cili u realizua në Spitalin Rajonal, Vlorë. Studimi u krye gjatë periudhës 20 Prill-12 Maj 2022.

Zgjedhja e instrumentit

U formuluan pyetësorë të realizuar vecanërisht për këtë studim, të bazuar në raportimet paraprake të literaturës përkatëse. U panë disa studime mbi ceshtjen në studim dhe u përzgjedh një prej tyre prej të cilit u përshtat një pyetësor i vetadmindruar.

Janë përdorur përgjithësisht pyetje të mbyllura, të cilat kërkonin një përgjigje të paracaktuar (alternativat e sugjeruara). Këto ishin më të lehta për t'u administruar dhe analizuar, dhe kërkonin më pak kohë për t'u përgjigjur prej subjekteve në studim.

Mbledhja e të dhënave u realizua nëpërmjet yetësorëve të vetadmindruar, ku infermierët e reparteve të përfshirë në studim i plotësuan në mënyrë të pavarur.

Testimi u krye në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe infermierët patën kohën e nevojshme për t'u përgjigjur pyetjeve.

Pasi u mor leja prej drejtuesve të pavioneve respektive, u dha prej tyre edhe një informacion i cili na udhëzoi për momentin më të përshtatshëm për realizimin e studimit të infermierët. Kjo metodë u përdor për të përfshirë në studim ata individë të cilët ishin të gatshëm dhe që ndodheshin në detyrë në ato momente (infermierët). Kjo ishte metoda më e përshtatshme për vetë natyrën e studimit, (deskriptive, quantitative) e cila kërkonte një pjesëmarrje vullnetare.

Rezultate:

Prezantimi i strukturës së mostrës:

Në këtë studim pjesëmarrës ishin infermierët, të cilët u përzgjedhën në mënyrë rastësore në repartin e patologjisë, kirurgjisë dhe urgjencës. Në total ishin 64 infermierë, 32 ishin nga moshë 23-30 vjeç, 24 prej tyre 31-40 vjeç, 7 ishin 41-50 vjeç, dhe 1 mbi moshën 50 vjeç.

Tabela Nr.1 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infermiereve sipas nivelit të edukimit.

Niveli I edukimit	Nr	%
Ka përfunduar Ciklin e I-rë të studimeve	14	21.9%
Ka përfunduar Ciklin e II-Të të studimeve (Master professional)	31	48.4%

Ka përfunduar Ciklin e II-Të të studimeve (Master Shkencor)	19	29.7%
--	----	-------

Nga të dhënat e mësipërme shohim se: 21.9% e infermierëve të marrë pjesë në studim kanë përfunduar vetëm Ciklin e I-rë të studimeve, 48.4% e tyre kanë përfunduar Ciklin e II-të të studimeve (Master professional) dhe 29.7% kanë përfunduar Ciklin e II-të të studimeve (Master Shkencor).

Tabela Nr.2 Paraqitja tabelare e infermierëve sipas pavionit.

Pavioni	Nr	%
Patologji/Infektiv	23	35.9%
Urgjencë	15	23.4%
Kirurgji	26	40.6%

Nga të dhënat e mësipërme shohim se: 35.9% e infermierëve që kanë plotësuar pyetësorin punojnë në Patologji/Infektiv, 23.4 % e tyre në Pavionin e Urgjencës dhe pjesa më e madhe e tyre pra 40.60% në Pavionin e Kirurgjisë.

Tabela Nr.3 Paraqitja tabelare e infermierëve sipas eksperiencës në punë.

Eksperienca në Punë	Nr	%
0-10 vite	46	71.9%
Mbi 10 vite	18	28.1%

Tabela Nr.4 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infermiereve sipas njohurive mbi Sars Cov 2.

Sa e vlerësoni veten me njohuritë që ju dini për Sars cov 2 ?	Nr	%
Mirë	33	52.4%

Shumë mirë **31** **47.6%**

Nga të dhënat e mësipërme shikojmë se nga infermierët e përfshirë në studim, kësaj pyetje i kanë dhënë përgjigje 63 infermierë të cilët (52.4%) pohuan se kishin njohuri shumë të mira në lidhje me klinikën, komplikacionet prandërlikimet, trajtimin dhe prognozën e tij dhe vetëm 47.60 % pohuan se kishin njohuri shumë të mira mbi Covid-19.

Tabela 5: Shpërndarja e infermierëve sipas ekperiencës në punë dhe njohurive mbi SARS-COVID2

Sa e Mirë Shumë Total vleresoni veten me njohurit që ju dini për Sars cov 2 ?			
Nën 10 vjet	28	18	46
Mbi 10 vjet	5	13	18
Total	33	31	64

Tabela Nr.6 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infermierëve sipas mendimit që ata kanë rreth nevojës për trajnim mbi Covid-19.

Nevoja për trajnim mbi Covid-19	Nr	%
Po	40	62.5%
Jo	19	29.7%
Nuk e di	5	7.8%

Nga sa shohim më lartë duket qartë se : 62.5% e infermierëve mendojnë se ende kanë nevojë për trajnim mbi Covid-19, 29.7% mendojnë se nuk kanë nevojë për trajnim mbi Covid-19, dhe vetëm 7.8 % I janë përgjigjur pyetjes nuk e di.

Tabela Nr.7 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infermierëve sipas trajnimit që kanë marrë mbi Covid-19.

A keni marrë trajnim mbi Covid-19	Nr	%
Po	50	79.4%

Jo **14** **20.6%**

Nga të dhënat e mësipërme shohim se nga infermierët e përfshirë në studim: 64 infermierë të përgjigjur pyetjes së drejtuar 79% e tyre kanë marrë trajnime mbi Covid-19 dhe pjesa tjetër 21% nuk kanë marrë trajnim.

Tabela Nr.8 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infermierëve sipas mendimit që ata kanë rreth frikës së infektimit nga ekspozimi i tyre ndaj rasteve të konfirmuara.

Frika e infektimit nga ekspozimi me rastet e konfirmuara.	Nr	%
Po	42	65.6%
Jo	22	34.4%

Të dhënat e mësipërme tregojnë se 66% e stafit infermior kanë shprehur frikë nga infektimi për shkak të ekspozimit me rastet e konfirmuara dhe 34% e tyre nuk kanë shprehur frikë nga infektimi.

Tabela Nr.9 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infermierëve sipas mendimit që ata kanë rreth frikës së infektimit nga ekspozimi i tyre ndaj rasteve të konfirmuara e lidhur me trajnimin që kanë marrë për SARS COVID

Frika e infektimit nga ekspozimi me rastet e konfirmuara.	Po, kanë frikë	Jo, nuk kanë frikë
Të trajnuar	5	37
Të patrajnuar	13	9
Total	18	48

Nga tabela shohim se janë 42 infermierë të trajnuar mbi SARS COVID dhe prej tyre 5 ose 12% kanë frikë prej kësaj sëmundje kurse 37 ose 88 % nuk kanë frikë, ndërsa nga infermierët e patrajnuar 13 ose 59% kanë frikë dhe 9 ose 41 % nuk kanë frikë.

Tabela Nr.10 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infermierëve sipas frikës nga transmetimi i Covid-19 e cila con në izolim dhe pakësim të kohës së kaluar me familjarët e tyre.

Izolim ose pakësim i kohës së kaluar me	Nr	%
---	----	---

**familjen si pasojë e
frikës së transmetimit
të Covid-19**

Po 42 65.6%

Jo 22 34.4%

Të dhënat e mësipërme tregojnë se 66% e infermierëve janë izoluar ose kanë zvogëluar kohën që kalonin me familjarët dhe të afermit e tyre kjo e cila është një ndër shkaqet kryesore në ndikimin psikologjik të stafit infermior, dhe 34% e infermierëve të pyetur kanë shprehur JO nuk janë izoluar ose të kalonin më pak kohë me ta.

Tabela Nr.10 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infermierëve sipas stresit, ankthit apo lodhjeve tepër të mëdha që ata kanë përjetuar gjatë periudhës së pandemis nga Covid-19.

	Ankth	Stres
Nr	5	27
%	7.8%	42.2%

Referuar të dhënave dhe tabela e mësipërme, duke parë në total vihet re se; 8% e infermierëve kanë shprehur se kanë përjetuar vetëm ankth gjatë periudhës së pandemisë, 42% e infermierëve pra pjesa më e madhe e tyre shprehin se stresi ka qenë përjetimi i tyre i vetëm, 37% e tyre kanë konstatuar se kanë përjetuar lodhje shumë të madhe për shkak të orareve të tejzgjatura, mbingarkesës me pacientë. Dhe 13% e infermierëve kanë shprehur se s'kanë përjetuar asnjë prej tyre pra ankth, stres apo lodhje shumë të madhe.

Tabela Nr.11: Paraqitja grafike e shpërndarjes së infermierëve sipas stresit, ankthit apo lodhjeve tepër të mëdha që ata kanë përjetuar gjatë periudhës së pandemis nga Covid-19 lidhur kjo me pavionin në të cilin ata punojnë

Pavioni/simptomat	Ankth	Stres	Lodhje shumë të madhe	Asnjë prej tyre	Total
-------------------	-------	-------	-----------------------	-----------------	-------

Patologji-infektiv	2	17	3	1	23
Urgjencë	2	7	4	2	15
Kirurgji	1	3	17	5	26
Total	5	27	24	8	64

Duke u përpjekur të shpjegojmë faktorët që kanë ndikuar në stresin dhe lodhjen e infermierëve I kemi vëzhguar sipas pavionit që ata punojnë. Sipas përgjigjeve shohim se shumë stres kanë përjetuar infermierët e patologjisë/infektivit më 17 individë ose 27%, po gjithashtu lodhje ka patur në kirurgji me po 27%, në urgjencë stresi 11%. Pra ka nivele të ndryshme të indikatorëve në lidhje me pavionet e punës.

Tabela Nr.12 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infermierëve sipas mungesës ose jo të PPE

Munges PPE	Nr	%
Po	23	37.1%
Jo	39	62.9%

Duke u bazuar tek paraqitja grafike dhe ajo tabelare shohim se 63% e infermierëve kanë pohuar se kanë mungesë PPE të cilat e veshitësojnë akoma më shumë punën në kohë pandemie, ndërsa pjesa tjetër 37% kanë shprehur se nuk kanë mungesë të tyre në vendin e punës.

Tabela Nr.13 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infermierëve sipas mendimit se sa të ndjeshëm janë ata ndaj infektimit me Covid-19.

Sa të ndjeshëm ndaj infektimit	Nr	%
Aspak	13	20.3%
Pak	36	56.3%
Shumë	15	23.4%

Nga të dhënat e mësipërme shohim se nga infermierët e përfshirë në studim 23.4% e tyre janë shumë të ndjeshëm nga infektimi me Covid-19, 56.3% e infermierëve janë pak të ndjeshëm nga infektimi. Gjithashtu shohim se 20.3% e

infirmierëve të përfshirë në studim janë *asapak* te ndjeshëm ndaj infektimit me Covid-19.

Tabela Nr.14 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infirmierëve sipas infektimit me Covid-19.

	Nr	%
Po	32	50%
Jo	19	29.7%
Nuk e di	13	20.3%

Nga të dhënat e mësipërme shohim se nga infirmierët e përfshirë në studim 50% e tyre e kanë kaluar Covid-19, 30% e infirmierëve nuk e kanë kaluar Covid-19 dhe 20% e këtyre infirmierëve të marrë në studim nuk e dinë nese e kanë kaluar ose jo Covid-19.

Tabela Nr.15 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infirmierëve sipas infektimit me Covid-19 dhe pavionit që ata punojnë

	Po, janë infektuar	Jo, nuk janë infektuar	Nu k e di në	Tot al
Patologji/infektiv	20	3	0	23
Urgjencë	6	2	7	15
Kirurgji	6	14	6	26
Total	32	19	13	64

Sipas pavioneve dhe numrit të infektimeve vëhet re se më shumë të infektuar ka në repartin e patologjisë me 20 ose 31%, në kirurgji 14 ose 22% nuk janë infektuar dhe në urgjencë 7 ose 11% nuk e dinë.

Tabela Nr.16 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infirmierëve sipas sigurisë në vendin e punës dhe grupmoshës.

Mosha dhe siguria në punë	23-30 vjec	31-40 vjec	41-50 vjec	Mbi 50 vjec	Total
Shumë i sigurt	1	0	1	1	3
Disi i sigurt	31	8	6	0	45
Aspak i sigurt	0	16	0	0	16
Total	32	24	7	1	64

Sipas tabelës shohim se grupmosha 23-30 vjec ndihet disi i sigurtë në punë me 48%, grupmosha 31-40 vjec aspak i sigurtë të gjithë me 25% dhe 41-50 vjec me 9% disi të sigurtë. Pra shumë pak infirmierë ndihen shumë të sigurtë në punë, shumica disi dhe pothuajse ¼ aspak të sigurtë.

Tabela Nr.17 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infirmierëve sipas punës me orare të zgjatura gjatë periudhës së Covid-19.

A jeni detyruar të punoni me orare të zgjatura gjatë pandemisë	Nr	%
Po	41	64.1%
Jo	23	35.9%

Nga sa shohim më sipër duket qartë se: Pjesa më e madhe e infirmierëve të përfshirë në studim 64.1% janë detyruar të punojnë me orare të zgjatura gjatë periudhës së pandemisë nga Covid-19 e cila është një ndër faktorët që ndikon negativisht në psikologjinë, lodhjen, mbingarkesën e tyre. Ndërsa 35.9% e këtyre infirmierëve kanë deklaruar se nuk janë detyruar të punojnë me orare të zgjatura.

Tabela Nr.18 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së infirmierëve sipas mendimit për tu larguar nga spitali ose jo.

A keni menduar të largoheni nga spitali.	Nr	%
Po	9	14.1%
Jo	55	85.9%

Nga të dhënat e mësipërme shohim se nga infirmierët e përfshirë në studim: 85.90% kanë deklaruar se nuk kanë menduar për t'u larguar nga spitali, dhe 14.10% e tyre kanë deklaruar se PO kanë menduar për t'u larguar nga spitali.

Përfundime

Shumica e infirmierëve pjesëmarrës në studim janë në moshën nën 30 vjec. Pothuajse gjysma e tyre kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve dhe pothuajse 3/4 janë me nën 10 vjet eksperiencë pune. Për sa i përket pavioneve janë pothuaj njësoj numri i pjesëmarrësve. Për sa i përket njohurive gjysma kanë njohuri të mira dhe gjysma kanë njohuri shumë të mira.

Vitet e punës ndikonë në rritjen e njohurive mbi SARS Covid.

Shumica e infermierëve janë të trajnuar mbi Covid-19 dhe ata që janë të trajnuar kanë më shumë njohuri dhe më pak frikë nga infektimi.

Edhe pse shumica e infermierëve janë trajnuar ata mendojnë se kanë akoma nevojë për trajnim. Shumica e infermierëve kanë frikë nga ekspozimi me Covid-19 dhe shumica e tyre janë infektuar me këtë sëmundje, sidomos infermierët e infektivit.

Pothuajse të gjithë infermierët kanë frikë nga transmetimi në familje i infeksionit.

Infermierët nuk janë të kënaqur me nivelin e pagave, shprehin se kanë shumë ankth dhe stres, lodhja është shumë e madhe dhe kjo varet edhe nga pavioni ku ata punojnë sidomos ata në pavionin e patologjisë/infektivit. 1/3 mendojnë se kanë mungesa të mjeteve mbrojtëse.

Shumica e infermierëve ndihen disi të sigurt në vendin e punës duke u varur kjo nga grupmosha. Pjesa më e madhe e infermierëve të përfshirë në studim janë detyruar të punojnë me orare të zgjatura gjatë periudhës së pandemis nga Covid-19 e cila është një ndër faktorët që ndikon negativisht në psikologjinë, lodhjen dhe mbingarkesën e tyre.

Shumica e infermierëve kanë deklaruar se nuk janë penduar që janë infermier/e nisur nga mbingarkesa, lodhjet shumë të mëdha, streset, oraret e zgjatura dhe shumë pak infermierë mendojnë të ikin nga puna në spital.

Referenca:

1. IBIS World Effects of COVID-19 on Global (Healthcare Systems. [(accessed on 16 May 2021)]; Available online: <https://www.ibisworld.com/industry-insider/coronavirus-insights/effects-of-covid-19-on-global-healthcare-systems/>)
2. Neto M.L.R., Almeida H.G., Esmeraldo J.D., Nobre C.B., Pinheiro W.R., De Oliveira C.R., Sousa I.D., Lima O.M.M., Lima N.N.R., Moriera M.M., et al. (2020) When health professionals look death in the eye: The mental health of professionals who deal daily with the 2019 coronavirus outbreak. *Psychiatry Res.* 2020;**288**:112972. doi: 10.1016/j.psychres.112972. [PMC free article] [PubMed] [CrossRef] [Google Scholar]
3. Jervis R. (2020) Death Is Our Greeter: Doctors, Nurses Struggle with Mental Health as Coronavirus Cases Grow. [(accessed on 22 July 2020)]; Available online: <https://www.usatoday.com/story/news/nation/2020/05/03/coronavirus-death-count-has-00doctors-struggling-mental-health/3063081001/>
4. Arnetz, J. E., Goetz, C. M., Arnetz, B. B., & Arble, E. (2020). Nurse Reports of Stressful Situations during the COVID-19 Pandemic: Qualitative Analysis of Survey Responses. *International journal of environmental research and public health*, 17(21), 8126. <https://doi.org/10.3390/ijerph17218126>
5. Colombini S. (2020) Florida Health Care Workers Feeling Strain of Coronavirus Surge. [(accessed on 23 June 2021)]; Available online: <https://health.wusf.usf.edu/post/florida-health-care-workers-feeling-strain-coronavirus-surge#stream/0>.
6. Worringer B., Genrich M., Müller A., Gündel H., (2020), Contributors of the SEEGEN Consortium. Angerer P. Hospital medical and nursing managers' perspective on the mental stressors of employees. *Int. J. Environ. Res. Public Health*.**17**:5041. doi: 10.3390/ijerph17145041. [PMC free article] [PubMed] [CrossRef] [Google Scholar]
7. Liu Z., Han B., Jiang R., Huang Y., Ma C., Wen J., Zhang T., Wang Y., Chen H., Yongchun M. (2020), Mental health status of doctors and nurses during COVID-19 epidemic in China. *SSRN J.* doi: 10.2139/ssrn.3551329. [CrossRef] [Google Scholar]
8. Mo Y., Deng L., Zhang L., Lang Q., Liao C., Wang N., Qin M., Huang H. (2020) Work stress among Chinese nurses to support Wuhan in fighting against COVID-19 epidemic. *J. Nurs. Manag.*; **28**:1002–1009. doi: 10.1111/jonm.13014. [PMC free article] [PubMed] [CrossRef] [Google Scholar]
9. Hernández-Díaz, Yazmín; Genis-Mendoza, Alma D.; Fresán, Ana; González-Castro, Thelma B.; Tovilla-Zárate, Carlos A.; Juárez-Rojop, Isela E.; López-Narváez, María L.; Martínez-Magaña, José J.; Nicolini, Humberto. (2021). "Knowledge, Emotions and Stressors in Front-Line Healthcare Workers during the COVID-19 Outbreak in Mexico" *Int. J. Environ. Res. Public Health* 18, no. 11: 5622. <https://doi.org/10.3390/ijerph18115622>

10. Sampaio F.M.C., Da Cruz Sequeira C.A., Da Costa Teixeira L. (2020) Nurses' mental health during the COVID-19 outbreak: A cross-sectional study. *J. Occup. Environ. Med.*;62:783-787. doi: 10.1097/JOM.0000000000001987. [PubMed] [CrossRef] [Google Scholar]
11. Lai J, Ma S, Wang Y, et al. (2020) Factors Associated With Mental Health Outcomes Among Health Care Workers Exposed to Coronavirus Disease 2019. *JAMA Netw Open.*;3(3):e203976. doi:10.1001/jamanetworkopen.2020.3976

Vlerësimi i njohurive të studentëve të infermierisë për rolin e ushqyerjes së shëndetshme në parandalimin e kancereve të lidhura me dietën.

Xhesika Dine

*Master Shkencor në Shkenca Infermierore
Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
xhesikadine@gmail.com*

ABSTRAKT

Hyrje: Kanceri parashikohet të jetë shkaku kryesor i vdekjeve në çdo vend të botës deri në fund të këtij shekulli. Si infermierë të ardhshëm dhe anëtarë të besuar të ekipit shëndetësor, studentët e infermierisë kanë rol unik si këshillues dhe propagandues të adaptimit të sjelljeve të shëndetshme te pacientët apo tek çdo person që riskon mirëqenien për shkak të ushqyerjes jo të shëndetshme. **Qëllimi:** Vlerësimi i nivelit të njohurive të studentëve të infermierisë në lidhje me ushqyerjen e shëndetshme për parandalimin e kancereve të lidhura me dietën. **Metodologjia:** Ky është një studim ndërseksional, i kryer në Fakultetin e Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë. Studentët pjesëmarrës aprovuan pjesëmarrjen në studim me ruajtjen e anonimitetit. Ata u pyetën përmes një pyetësori për rolin që ka ushqyerja e shëndetshme në parandalimin e kancerit. **Rezultatet:** Në studim morën pjesë 202 studentë. Studentët ishin të moshës 19-45 vjec. 70.3% e studenteve ishin femra dhe 29.7% meshkuj. 65% e studentëve u përgjigjën saktë pyetjeve të pyetësorit. U konstatua një lidhje sinjifikative mes gjinisë dhe njohurive që studentët kishin në lidhje me temën e studimit. **Konkluzionet:** Njohuritë e studentëve ishin përgjithësisht të mira përsa i përket ushqyerjes së shëndetshme dhe rolit të saj në parandalimin e kancereve të lidhura me dietën. Studentet femra kishin më tepër njohuri sesa meshkujt për rolin e ushqyerjes së shëndetshme në parandalimin e kancerit.

Fjalët kyç: ushqyerje e shëndetshme, njohuri, parandalimi i kancerit, studentë.

ABSTRACT

Background: Cancer is predicted to be the leading cause of death in every country in the world by the end of this century. As future nurses and trusted members of the health team, nursing students have a unique role as advisors and promoters of adapting healthy behaviors to patients or to any person who risks well-being due to unhealthy nutrition.

Aim: Assessment of the level of knowledge of nursing students regarding healthy nutrition for the prevention of diet-related cancers. **Methodology:** This is a cross-sectional analytical study, conducted at the Faculty of Health, "Ismail Qemali" University of Vlorë. Participating students agreed to participate in the study with the preservation of the anonymity of their data. They were asked through a questionnaire, about the role of healthy nutrition in cancer prevention. **Results:** 202 students participated in the study. The students were aged 19-45. 70.3% of students were female and 29.7% male. 65% of students answered the questionnaire questions correctly. A significant relationship was found between gender and the knowledge that students had about the subject of the study.

Conclusions: From this study it was concluded that students' knowledge was generally good regarding healthy nutrition and its role in the prevention of diet-related cancers. Female students had more knowledge than males about the role of nutrition in cancer prevention.

Key words: healthy eating, knowledge, prevention of cancer, students.

HYRJE

Kanceri parashikohet të jetë shkaku kryesor i vdekjeve në çdo vend të botës deri në fund të këtij shekulli. Në vitin 2020 kishte 19.3 milionë raste të kancerit në mbarë botën dhe 10.0 milionë vdekje nga kanceri [1]. Parandalimi i kancerit është i rëndësishëm për reduktimin e shifrave në rritje. Si anëtarë të besuar të ekipit shëndetësor, infermierët kanë një rol unik për të edukuar pacientët dhe anëtarët e familjes së tyre mbi parandalimin e kancerit dhe strategjitë e reduktimit të rrezikut. Sipas raportit të *Infermierisë në Botë 2020*, infermierët përbëjnë afërsisht 59% të fuqisë punëtore shëndetësore në nivel global. Një fuqi punëtore efektive infermirore është thelbësore për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, të fokusuar në reduktimin e barrës së sëmundjeve duke përfshirë kancerin, dhe arritjen e mbulimit shëndetësor universal [2]. Infermierët si ofrues të kujdesit shëndetësor tek pacienti mund të kryejnë ekzaminimet e gjendjes nutricionalë të të ushqyerit dhe kryerjen e vlerësimit dhe ndërhyrjeve për ushqyerjen deri te ofrimi i ndihmës gjatë vaktit, mbështetje për ushqimin ose terapi dietike.

Roli dhe përgjegjësia po ashtu janë prezente dhe tek studentët e infermierisë, si ofrues të ardhshëm të kujdesit shëndetësor dhe praktikues aktual të disa prej principeve dhe teknikave kryesore infermirore. Ata duhet të jenë këshillues dhe propagandues të fortë të adaptimit të sjelljeve të shëndetshme të pacientët e tyre, pasi njohuritë mbi ushqyerjen e shëndetshme përbëjnë një faktor kritik që i motivon individët të parandalojnë sjelljen të dëmshme për shëndetin, duke marrë parasysh që ushqyerja dhe disa zakone jo të shëndetshme të stilit të jetesës janë kontribues të zhvillimit të kancerit.

Studimet e mëparshme kanë zbuluar se studentët e universitetit kanë praktika jo të shëndetshme ushqimore; pasi konsumojnë më shumë ushqime të shpejta, zakonisht të pasura me yndyrë, sheqer dhe kripë, konsum të ulët të frutave dhe perimeve, anashkalonojnë vaktet dhe angazhohen në pak aktivitet fizik [3]. Studentët janë në një periudhë zhvillimi në jetë, në të cilën fillojnë të formohen sjellje të lidhura me shëndetin.

Rezultatet e këtij studimi do të na ndihmojnë të pasqyrojmë njohuritë e studentëve në lidhje me ushqyerjen e shëndetshme për parandalimin e kancereve të lidhura me dietën, duke qenë se studimet me fokus këtë temë tek grup-popullata e studentëve, pas kërkimeve të bëra të bëra në internet, rezultojnë se mungojnë në vendin tonë.

Metodologjia

Tipi i studimit

Studim analitik, ndërseksional i realizuar në periudhën Janar- Maj 2023.

Popullata finale e studimit

Nga popullata totale e studentëve të *Fakultetit të Shëndetit* në Universitetin "Ismail Qemali" në studim mori pjesë një mostër prej 202 studentësh. Studentët që morën pjesë në studim i përkisnin të dy cikleve të studimit (Bachelor, Master Profesional dhe Master Shkencor) dhe të tre viteve të studimit sipas ciklit përkatës së studimit.

Kriteret e përzgjedhjes

- Studentë të të dy cikleve të studimit Bachelor dhe Master Profesional e Shkencor
- Studentë aktual të këtij viti akademik, jo ish-studentë apo studentë që kanë ndërprerë studimet e tyre përkohësisht.

Fusha e studimit:

Ky studim fokusohet në fushën e vlerësimit të njohurive të studentëve të infermierisë për ushqyerjen e shëndetshme në funksion të parandalimit të kancereve . Si studentë aktual dhe punonjës të ardhshëm në fushën e shëndetësisë, vlerësimi i njohurive tek ata ka një rëndësi të madhe, për një çështje emergjente shëndetësore siç është kanceri dhe ushqyerjen si faktor për zhvillimin/ parandalimin e tij.

Ndryshorët e matur

U mbledhën të dhëna në lidhje me variablat universale si dhe të dhëna në lidhje me variablat që ishin të krijuara për vlerësimin e njohurive të studentëve për ushqyerjen e shëndetshme dhe ndikimit të saj në parandalimin e kancereve të lidhura me dietën.

Instrumenti i përdorur

Për mbledhjen e të dhënave u administrua një pyetësor i përbërë nga pyetje të mbyllura, i cili u shpërnda online nëpërmjet *Google Forms*. Pyetësori kishte akses të hapur në një studim me fokus temën e studimit tonë, dhe ishte i disponueshëm për studiuesit[4]. Pyetësori ishte i hartuar në bazë të literaturës bashkëkohore dhe në bazë të udhëzimeve të *WCRF/AICR*. Ai u testua në një studim pilot, në të cilin morën pjesë 20 studentë, që u përzgjodhën në mënyrë të rastësishme. Ata studentë nuk u përfshinë në mostrën finale, që mori pjesë në studim. Pas

studimit pilot u bënë korrigjime dhe përshtatje për versionin final të pyetësorit. Pyetësi kishte një besueshmëri të brendshme dhe u arrit një vlerë e koeficientit *cronbach alpha* 0,908.

Pyetësi kishte të formuluar në krye të tij të gjithë informacionin e nevojshëm për pjesëmarrësit, përpara se ata të fillonin plotësimin e tij. Ky informacion përfshinte: titullin e studimit, qëllimin e tij, ruajtjen e anonimitetit të pjesëmarrësve. Pyetësi ishte i përbërë nga 16 pyetje, 3 prej të cilave siguruan të dhëna në lidhje me moshën, gjininë, dhe vitin e studimit, ndërsa 13 pyetjet e tjera siguruan të dhëna për njohuritë që zotërojnë studentët mbi ushqyerjen e shëndetshme për parandalimin e kancereve të lidhura me dietën.

Lloji i të dhënave

Të dhënat në këtë punim janë parësore dhe dytësore, cilësore dhe sasiore. Të dhënat e përdorura si burim për pjesën teorike të studimit janë të natyrës dytësore, ndërsa të dhënat e përfutuara nga përgjigjet e studentëve pas shpërndarjes së pyetësorëve janë të dhëna parësore, cilësore dhe sasiore. Variablat cilësore ishin të tilla si: gjinia, dhe variablat që vlerësonin njohuritë e studentëve. Variablat sasiore ishin: mosha, viti i studimit. Materiale të ndryshme u grumbulluan përmes navigimit në internet për të siguruar të dhënat dytësore. Mbledhja e të dhënave parësore u arrit pas shpërndarjes dhe mbledhjes së pyetësorëve, të dhënat janë koduar dhe përpunuar statistikisht.

Analiza statistikore

Përpunimi statistikor i të dhënave u realizua duke përdorur paketën statistikore SPSS versioni 29.0.1. Testet e përdorura janë në varësi të llojit të variablave. Për përpunimin e këtyre të dhënave është përdorur analiza descriptive. Për variablat e vazhduar u paraqitën madhësitë si mesatarja aritmetike, vlera maksimale dhe ajo minimale. Të dhënat janë paraqitur në tabelë. Për pyetësin e administruar, u krijua një sistem pikësh vlerësimi të njohurive në bazë të përgjigjeve që studentët dhanë. Konkretisht me 0 pikë u vlerësuan përgjigjet *Jo* dhe *Nuk e di*, ndërsa për përgjigjet *PO* vlerësimi ishte 1 pikë. Vlera e sinjifikancës statistikore është $p < 0.05$. Për të vlerësuar vlerën e sinjifikancës dhe korrelacionin midis variablave cilësore (nominale) është realizuar *chi-square test*.

Leja etike: U kërkuar konsensusi etik nga drejtuesit e Fakultetit të Shëndetit dhe po ashtu u kërkuar konsensusi nga vetë studentët për pjesëmarrjen në studim

Kufizimet e studimit

Studimi është realizuar në një numër relativisht të ulët studentësh. Po ashtu në studim mungon pjesëmarrja e studentëve nga fakultete tjera të Universitetit, përpos studentëve nga Fakulteti i Shëndetit. Nisur nga kjo lind nevoja që studime të ardhshme të kryhen dhe të zgjerohen dhe në grupe të tjera studentësh.

Rezultatet

KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË STUDENTËVE:

Prej 202 studentëve pjesëmarrës në studim:

- 70,3% e tyre ishin femra, ndërsa 29.7% ishin meshkuj.
- 25,2% janë të moshës 20 vjeç, ndërsa një pakicë prej 1,5% dhe 1% i takojnë moshave 42 dhe 45 vjeç. Mosha minimale e pjesëmarrësve në studim ishte 19 vjeç, ndërsa mosha maksimale 45 vjeç. Mosha mesatare ishte 21.50 vjeç
- 33.2% ishin në Ciklin e parë të studimeve Bachelor, në vitin e parë, ndjekur nga studentë në vitin e dytë 24.3%, në vitin e tretë 19.8%. Pjesa tjetër ishin studentë që ndiqnin ciklin e dytë të studimeve Master, përkatësisht 8.9% e tyre ishin studentë në Master Profesional, viti i parë; 5.9% në Master Shkencor, viti i parë dhe 7.9% studentë në Master Shkencor, viti i dytë.

VLERËSIMI I NIVELIT TË NJOHURIVE TË STUDENTËVE

U krijua një sistem pikësh vlerësimi për përgjigjet e dhëna të studentëve në lidhje me pyetjet e bëra, Me 0 pikë u vlerësuan përgjigjet *Jo* dhe *Nuk e di*, ndërsa për përgjigjet *PO* vlerësimi ishte 1 pikë. Mesatarja e totalit të pikëve ishte 7. Pikët e marra mbi këtë vlerë (7) identifikonin një Nivel të Mirë të Njohurive, ndërsa pikët e marra nën këtë vlerë të mesatare identifikonin një Nivel të Ulët të Njohurive. Nga përlogaritja e bërë rezultoi se 65% e studentëve kishin njohuri të mira për ushqyerjen e shëndetshme dhe rolin të saj për parandalimin e kancereve të lidhura me dietën.

Tabela 1. Mesatarja, minimumi, maksimumi i pikëve

Mesatarja	7.0099
Minimumi	0
Maksimumi	13

Tabela 2. Rezultatet e pikëve për vlerësimin e njohurive

Piket	Frekuenca	Perqindja
0	9	4.5
1	2	1.0
2	3	1.5
3	6	3.0
4	9	4.5
5	22	10.9
6	19	9.4
7	36	17.8
8	34	16.8
9	27	13.4
10	27	13.4
11	5	2.5
12	1	0.5
13	2	1.0
Totali	202	100

Për të vlerësuar nëse ekziston një lidhje midis gjinisë së studentëve pjesëmarrës në studim dhe variablave që vlerësojnë njohuritë e tyre është aplikuar testi Chi Square. Vlera e sinjifikancës statistikore është përcaktuar $p < 0.05$. Rezulton se ekziston një lidhje sinjifikative mes gjinisë dhe variablave të mëposhtëm:

- A mundet dikush që duke reduktuar pijet me përmbajtje sheqeri të reduktoi rrezikun për zhvillimin e kancerit?
- Konsumi i ushqimeve të pasura me fibra është një faktor mbrojtës ndaj kancerit
- A është e rëndësishme të shmanget konsumi i varietetve të frutave dhe perimeve cdo ditë
- Frutat dhe perimet duhet të zënë të paktën gjysmën e pjatës së një adulti
- Ushqimi me origjinë bimore nuk luan rol në mbrojtjen ndaj zhvillimit të kancerit
- Konsumi i peshkut krahasuar me mishin rekomandohet për mbrojtjen ndaj zhvillimit të kancerit
- Shmangia e pirjes së duhanit apo kontaktit me duhanpërsit mbron ndaj zhvillimit të kancerit

Tabela 3. Chi square test për korrelacionin mes gjinisë dhe njohurive të studentëve

PYETJET			Vlera p
	χ^2	df	
A mundet dikush që duke reduktuar pijet me përmbajtje sheqeri të reduktoi rrezikun për zhvillimin e kancerit	19.303	2	.001
Konsumi i ushqimeve të pasura me fibra është një faktor mbrojtës ndaj kancerit	9.574	2	.008
A është e rëndësishme të shmanget konsumi i varietetve të frutave dhe perimeve cdo ditë	11.703	2	.003
Frutat dhe perimet duhet të zënë të paktën gjysmën e pjatës së një adulti	30.401	2	.001
Ushqimi me origjinë bimore nuk luan rol në mbrojtjen ndaj zhvillimit të kancerit	6.793	2	.033
Konsumi i peshkut krahasuar me mishin rekomandohet për mbrojtjen ndaj zhvillimit të kancerit	9.679	2	.008
Shmangia e pirjes së duhanit apo kontaktit me duhanpërsit mbron ndaj zhvillimit të kancerit	6.449	2	.040

Diskutimi

Studimi vlerësoi njohuritë e studentëve të Fakultetit të Shëndetit në "Universitetin Ismail Qemali", Vlorë në lidhje me parandalimin e kancereve të lidhura me dietën përmes zakoneve të të ushqyerit shëndetshëm. Nevoja për të qenë

të informuar për sëmundje kërcënuese si kanceri dhe adaptimi i një mënyre të shëndetshme të të ushqyerit janë pjesë thelbësore e parandalimit të tij. Përgjegjësia e studentët e infermierisë është e madhe, pasi ata duhet të jenë këshillues dhe propagandues të fortë të adaptimit të sjelljeve të shëndetshme të pacientët gjatë kryerjes së praktikave klinike apo dhe të çdo person tjetër që riskon mirëqenien e tij për shkak të ushqyerjes jo të shëndetshme. Ata si ofrues të ardhshëm të kujdesit shëndetësor dhe praktikues aktual të disa prej principeve dhe teknikave kryesore infermiore, duhet të sigurojnë bazën e njohurive të nevojshme, për të ofruar një kujdes shëndetësor me karakter multidisiplinar dhe kjo përfshin edhe këshillimin, informimin e pacientëve mbi ushqyerjen e shëndetshme. Njohuritë mbi ushqyerjen e shëndetshme përbëjnë një faktor kritik që i motivon individët të parandalojnë sjellje të dëmshme për shëndetin, duke marrë parasysh që ushqyerja dhe disa zakone jo të shëndetshme të stilit të jetesës janë kontribues të zhvillimit të kancerit. Nisur nga rezultatet e studimit, studentët kishin njohuri përgjithësisht të mira përsa i përket rolit të ushqyerjes së shëndetshme në parandalimin e kancereve të lidhura me dietën. Nga studimi rezultoi se duhanpirja, konsumi i alkoolit kishin përqindjen më të lartë (mbi 70%) të aprovimit nga ana e studentëve si faktor rreziku për zhvillimin e kancerit. Ndërsa pyetjet që kishin të bënin me konsumin e ushqimeve me origjinë bimore, kishin përqindjen më të lartë të përgjigjeve (mbi 70%) duke evidentuar ushqimin me origjinë bimore si faktor për mbrojtjen ndaj zhvillimit të kancerit. Ato pyetje që patën një përqindje të ulët të përgjigjeve të sakta nën 50% , janë pyetjet për konsumin e mishit të kuq dhe kripës si faktor rreziku për zhvillimin e kancerit. Vetëm 42.6% dhe 47.5% e studentëve u përgjigjën saktë për këto pyetje. Në mungesë të gjetjes së studimeve të kryera në Shqipëri për vlerësimin e njohurive në lidhje me temën e studiuar, u gjet një studim i cili vlerësonte modelet dietike të 289 studentëve në vendin tonë. Ky studim raportoi se respektimi i modeleve dietike të shëndetshme dhe të qëndrueshme është jo-optimal për të rinjtë në Shqipëri [5]. Pra nisur nga përfundimi i këtij studimi, mund të themi se pavarësisht njohurive të mira që studentët kanë në lidhje me ushqyerjen e shëndetshme, praktikat dhe modelet e tyre të të ushqyerjes nuk janë brenda nivelit optimal. Ndryshe nga rezultati i studimit aktual, në një studim tjetër të kryer në Itali tek të rinjtë e moshës 13-20 vjeç, rezultoi se vetëm 26.1% e tyre kishin nivel të mirë njohurish për shumicën e faktorëve të rrezikut të kancerit [6]. Ajo çfarë vihet re si pikë e përbashkët mes

studimit të realizuar në Itali dhe studimit tonë është se në këto dy studime pyetjet që lidheshin me faktorët e rrezikut si: duhanpirja, konsumi i alkoolit, konsumi i pijeve me sheqer dhe vlera energjike të larta, mbanin vlerën më të lartë të përqindjes së përgjigjeve të zgjedhura si faktorë rreziku për kancerin. Një tjetër studim i realizuar në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2011, tek të rinjtë rezultoi se me përjashtim të pirjes së duhanit, ndërgjegjësimi i tyre për faktorët e rrezikut të kancerit ishte i ulët [7]. Në studimin aktual të kryer, përgjithësisht njohuritë e studentëve ishin të mira, kjo lidhet dhe me faktin që ata janë studentë të *Fakultetit të Shëndetit* dhe si infermierë të ardhshëm janë të pajisur me njohuritë bazike dhe të domosdoshme të marra gjatë viteve të studimit akademik për t'i shërbyer vetes dhe pacientëve në funksion të mirëqenies dhe shëndetit optimal. Po ashtu një nivel i lartë njohurish rezultoi edhe në një studim të kryer në mesin e studentëve të mjekësisë, në të cilin u arrit një rezultat mesatar njohurish prej 64% [8]. Në këtë studim rezultati ishte i kënaqshëm, por vlen të theksohet se studentët treguan disa boshllëqe në njohuri dhe gjithashtu ndiheshin të pamjaftueshëm në besimin e tyre për të ofruar kujdes ushqimor në të ardhmen. Në studimin tonë rezultoi se femrat kishin më shumë njohuri se meshkujt në lidhje me disa prej faktorëve të rrezikut të kancerit. Po ashtu në një studim të kryer në Oman, në Arabinë Saudite në të cilin merrnin pjesë 481 të rinj u konstatua një lidhje sinjifikative mes gjinisë dhe njohurive. Faktorët e rrezikut të kancerit dhe simptomat njihen dukshëm më shumë tek vajzat krahasuar me djemtë ($p = 0,001$) [9].

Pikat e forta dhe pikat e dobëta të studimit

Ky studim është i llojit analitik dhe pas kërkimeve të bëra , është ndër të vetmet studime i kryer vitet e fundit në Shqipëri për vlerësimin e njohurive të popullata e studentëve, i orientuar specifikisht në njohuritë e tyre për ushqyerjen e shëndetshme dhe rolin që ka ushqyerja në parandalimin e kancerit. Ky studim ka pika të dobëta, pasi popullata e studimit përfshin vetëm studentë të Fakultetit të Shëndetit dhe jo studentë të fakulteteve të tjera të Universitetit, sepse synohej që të vlerësohej niveli i njohurive të studentëve në fushën e shëndetësisë lidhur me një çështje shëndetësore emergjente, siç është kanceri dhe roli që ka ushqyerja në parandalimin e tij, por kjo ka sjellë mungesë të diversitetit të popullatës në studim. Po ashtu studimi është realizuar në një numër relativisht të ulët studentësh. Studimi indikon kryerjen e studimeve të tjera të ardhshme në vendin tonë në

këtë fushë, duke u zgjeruar me mostra më të mëdha të popullatës target (studentëve), duke

përfshirë dhe fakultete të tjera të Universitetit, pasi studime të tilla jo vetëm vlerësojnë njohuritë, por edhe lënë hapësirën e nevojshme për ndërgjegjësim dhe informim të vazhdueshëm.

Konkluzione

Në përfundim të këtij studimi u arrit në konkluzionet se:

- 65% e studenteve kishin njohuri të mira për ushqyerjen e shëndetshme dhe rolin e saj për parandalimin e kancereve të lidhura me dietën, duke konkluduar se njohuritë e studentëve të Fakultetit të Shëndetit ishin përgjithësisht të mira në fushën e studiuar
- Ekziston një lidhje sinjifikative mes gjinisë dhe njohurive që studentët zotërojnë në lidhje me parandalimin e kancereve përmes ushqyerjes së shëndetshme, ku në bazë të testit statistikor të kryer (chi square) rezultoi se femrat kishin më tepër njohuri sesa meshkujt për temën e studiuar.

Referencat

1. Latest global cancer data: Cancer burden rises to 19.3 million new cases and 10.0 million cancer deaths in 2020 – IARC J. www.iarc.who.int. Available from: <https://www.iarc.who.int/news-events/latest-global-cancer-data-cancer-burden-rises-to-19-3-million-new-cases-and-10-0-million-cancer-deaths-in-2020/>
2. Rosa WE, Parekh de Campos A, Abedini NC, Gray TF, Huijter HAS, Bhadelia A, et al. Optimizing the Global Nursing Workforce to Ensure Universal Palliative Care Access and Alleviate Serious Health-Related Suffering Worldwide. *Journal of Pain and Symptom Management*. 2021 Jul;63(2). Available from <https://doi.org/10.1016/j.jpainsymman.2021.07.014>
3. Try to prevent cancer through diet, not supplements [Internet]. World Cancer Research Fund. Available from: [https://www.wcrf-uk.org/preventing-cancer/our-cancer-prevention-](https://www.wcrf-uk.org/preventing-cancer/our-cancer-prevention-recommendations/dont-use-supplements-for-cancer-prevention/)

[recommendations/dont-use-supplements-for-cancer-prevention/](https://www.wcrf-uk.org/preventing-cancer/our-cancer-prevention-recommendations/dont-use-supplements-for-cancer-prevention/)

4. Folasire OF, Folasire AM, Chikezie S. Nutrition-related cancer prevention knowledge of undergraduate students at the University of Ibadan, Nigeria. *South African Journal of Clinical Nutrition*. 2016 Sep 27;29(4):165–71.
5. Llanaj E, Hanley-Cook GT. Adherence to healthy and sustainable diets is not differentiated by cost, but rather source of foods among young adults in Albania. *The British Journal of Nutrition [Internet]*. 2021 Aug 28 ;126(4):591–9. Available from: <https://pubmed.ncbi.nlm.nih.gov/33143757/>
6. Di Giuseppe G, Pelullo C, Mitidieri M, Lioi G, Pavia M. Cancer Prevention: Knowledge, Attitudes and Lifestyle Cancer-Related Behaviors among Adolescents in Italy. *International Journal of Environmental Research and Public Health*. 2020 Nov 10;17(22):8294. Available from <https://doi.org/10.3390/ijerph17228294>
7. Kyle RG, Nicoll A, Forbat L, Hubbard G. Adolescents' awareness of cancer risk factors and associations with health-related behaviours. *Health Education Research*. 2013 May 6;28(5):816–27. Available from <https://doi.org/10.1093/her/cyt055>
8. Mogre V, Aryee PA, Stevens FCJ, Scherpbier AJA. Future Doctors' Nutrition-Related Knowledge, Attitudes and Self-Efficacy Regarding Nutrition Care in the General Practice Setting: A Cross-Sectional Survey. *Medical Science Educator*. 2017 May 11;27(3):481–8. Available from <https://doi.org/10.1007/s40670-017-0413-5>
9. Al-Azri M, Al-Saadi WI, Al-Harrasi A, Murthi Panchatcharam S. Knowledge of Cancer Risk Factors, Symptoms, and Barriers to Seeking Medical Help among Omani Adolescents. *Asian Pacific Journal*

*of Cancer Prevention. 2019 Dec
1;20(12):3655-66. Available from
<https://doi.org/10.31557/APJCP.2019.20.12.3655>*

**SHKENCAT HUMANE, POLITIKE-JURIDIKE DHE
EKONOMIKE**

Mbi natyrën e konflikteve në shoqëri dhe menaxhimi i tyre

Ferit Baça

Departamenti i Filozofisë

Fakulteti i Shkencave Sociale

Universiteti i Tiranës

ABSTRAKT

Vetë natyra dhe shoqëria njerëzore kanë lindur nga përplasjet e vazhdueshme dhe konfliktet që i ushqejnë ato parreshtur. Nda, konfliktet janë konceptuar dhe pranuar si pjesë e jetës. E thënë ndryshe, nuk mund të ketë ditë pa natë dhe anasjelltas. Mjaft filozofë e shtrijnë lindjen e konfliktit para lindjes së shoqërisë njerëzore duke argumentuar se ai derivon nga jeta e natyrës, e karakterizuar nga një konflikt i ashpër dhe i pandërprerë, prej nga buron edhe vetë jeta e njeriut dhe e shoqërisë njerëzore. Kështu përshembull, Immanuel Kanti, do të thellohej edhe më shumë mbi kompleksitetin e natyrës njerëzore dhe veçanërisht, mbi kontradiktat që e shoqërojnë atë. Koncepti i tij teorik mbi konfliktin trajtohet dhe vlerësohet si një instrument i natyrës nëpërmjet të cilit ajo realizon qëllimin e saj, vendosjen e drejtësisë dhe triumfin e lirisë. Konfliktet kanë karakter universal, me lidhje dhe rrënjë të thella; shkak-pasojë. Përgjithësisht ato paraqiten si dy anë të një "medaljeje". Nga kjo veçori e konfliktit mund të vërehet se jo çdo konflikt shpie domosdoshmërisht drejt dhunës dhe luftës, sepse në mjaft fusha të jetës shoqërore, konkurrenca dhe triumfi i ideve të përparuara ndaj ideve konservatore apo të prapambetura i hap rrugën zhvillimit të mëtejshëm të saj dhe progresit. Shoqëria njerëzore i ka shfrytëzuar konfliktet në formën e konkurrencës apo garave në gjirin e saj për zhvillimin e anëve të ndryshme të jetës duke çliruar energji të reja krijuese.

Tema e mëposhtme synon të ndikojë në formimin e bindjeve dhe të qëndrimit dialektik mbi njohjen, kuptimin dhe trajtimin e konfliktit.

Fjalët kyçe: *Konflikti, lufta, pabarazia, barazia, menaxhimi dhe trajtimi.*

ON THE NATURE OF CONFLICTS IN SOCIETY AND THEIR MANAGEMENT

ABSTRACT

Nature itself and human society are born out of the constant collisions and conflicts that feed them endlessly. On the other hand, conflicts are conceived and accepted as a part of life. In other words, there can be neither day nor night without the other. Many philosophers extend the birth of conflict before the birth of human society, arguing that it derives from the life of nature, characterized by fierce and incessant conflict, from which the very life of man and human society originates. Thus, Immanuel Kant, for example, would delve even deeper into the complexities of human nature, particularly the contradictions that accompany it. His theoretical concept of conflict is treated and evaluated as an instrument of nature through which it realizes its purpose, the establishment of justice, and the triumph of freedom. Conflicts have a universal character, with deep roots and connections; cause and effect. In general, they are presented as two sides of a "medal." From this feature of the conflict, we can observe that not every conflict necessarily leads to violence and war, because in many areas of social life, the competition and triumph of advanced ideas over conservative or backward ideas paves the way for their further development and progress. Human society has used conflicts in the form of competition in its bosom for the development of different aspects of life, releasing new creative energies.

The following paper aims to influence the formation of beliefs and a dialectical attitude on the recognition, understanding and handling of conflict.

Keywords: *conflict, war, inequality, equality, management, and treatment.*

Hyrje

Duke qenë në thelb një fenomen social, konflikti mbetet bashkëudhëtarë i të gjitha fazave të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Jeta dhe historia mijërvjeçare e njerëzimit na imponon një qasje dialektike ndaj konfliktit; njësoj si ndaj vdekjes, si një ligj objektiv, ndaj të cilit jemi pajisur me arsye për ta kuptuar natyrën e tij të përrjetshme, me një gjykim dhe një forcë për ta trajtuar atë si bashkëudhëtarë të jetës tonë dhe për ta menaxhuar me kujdes në dobi të ekzistencës dhe zhvillimit të jetës njerëzore. Ndonëse konfliktet shfaqen në jetë kundër dëshirës së popujve, pesha dhe roli i tyre ka përcaktuar kurdoherë rrjedhën e historisë dhe ka dominuar fatin e tyre. Dy luftërat e fundit botërore, përveç humbjeve të pasurisë materiale i shkaktuan njerëzimit një humbje prej 34 milion njerëz. Por problemi i luftimeve shfaqet edhe më i mprehtë në rethanat e përdorimit të energjisë atomike. Rreziku i një konflikti nuklear i qëndron mbi kokë njerëzimit si shpata e demokleut dhe i jep konfliktit përmasat e një tragjedie botërore.

Fenomeni i konflikteve vlerësohet si një prej dukurive më thelbësore të qenies njerëzore dhe pjesë integrale e ekzistencës së tij. Tek ky fenomen mund të kundrohen edhe paqja edhe lufta, me një lidhje kauzale, sikurse nata mbars ditën dhe anasjelltas. Në horizontin e shekujve ka momente kur në këto mendime spikat qëndrimi biblik: "Konfliktet janë një e keqe e pashërueshme e jetës njerëzore; kështu ka qenë dhe kështu do të mbetet në jetë të jetëve!" Mjaft studiues, filozofë, shkrimtarë, gjeneralë e diplomatë i kanë kushtuar jetën zgjidhjes së këtij raporti të ndërlikuar të shoqërisë njerëzore. Lufta dhe paqja kanë qenë dhe mbeten burime të pashtershme për vepra të mirëfillta historike dhe filozofike. Në disa prej ideve dhe pikëpamjeve të këtyre mendimtarëve vihet në dukje dëshpërimisht se konflikti nuk është gjë tjetër veçse një shpërdorim dhe humbje e aftësive dhe energji të individit dhe e shoqërisë njerëzore.

Në këtë studim jemi përpjekur të sjellim pikpamje të ndryshme mbi konfliktin dhe vendosjen e paqes në shoqëri, ide dhe pikëpamje që kanë luajtur një rol të veçantë në kohëra të ndryshme, por me një rëndësi që i kalon caqet kohorë. Ndaj dhe shpresoj që ai t'u shërbejë sadopak studiuesve të rinj të kësaj teme, jo vetëm për pasurimin e mëtejshëm të njohurive e thellimin e debatit, por edhe për rritjen e vetëdijes së tyre se, në rrugën e vështirë që kanë përzgjedhur, kanë me vete

aleatë të mëdhenj dhe të sprovuar, autorë, mbi idetë dhe veprat filozofike të cilëve do të ndalemi në mënyrë të veçantë.

Metodologjia e studimit

Në të gjitha rastet e përgatitjes së një studimi, sigurimi i burimeve me përmbajtje filozofike e shkencore dhe shqyrtimi i saj i kujdesshëm, janë "drita" që e ndricon hap pas hapi e rresht pas rreshti trajtimin e saj. Ato mundësuan formulimin dhe shpalosjen sa më të mirë të mendimeve rreth çështjeve të natyrës së konflikteve dhe zgjidhjes së tyre, për të dhënë një pasqyrë sa më e qartë nëpërmjet ballafaqimit dhe krahasimeve të ideve e teorieve të ndryshme. Në përgatitjen e kesaj teme janë përdorur metoda të nevojshme shkencore, si metoda përshkruese, argumentuese, ballafaquese dhe krahasuese. Kërkimi është mbështetur në konsultimin e kuadrit ligjor, historik, akademik në periudha të ndryshme të historisë. Pjesë e literaturës së shfrytëzuar kanë qenë gjithashtu punimet e akademikëve të huaj, apo studimet e pavarura të studentëve në shkollat ndërkombëtare etj. Një mbështetje e vlefshme për realizimin e këtij punimi kanë qenë rishikimi i botimeve të autorëve shqiptarë dhe të huaj, të njohur për kontributin e tyre akademik në këtë fushë, të artikujve shkencorë, referuar në konferenca të ndryshme shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe ato të artikujve të botuar në revista shkencore në formë të printuar apo online.

Origjina e konflikteve

Në thelb historia e shoqërisë njerëzore nuk është gjë tjetër veçse histori konfliktesh të njëpasnjëshme, të mëdha, që kanë shënuar ndryshime epokale si dhe të vogla, si grumbullime sasiore, të cilat kanë përgatitur sërish ndryshimet cilësore. Shoqërisë njerëzore i është dashur të përballojë në vazhdimësi pasojat e luftës. Dihet se, luftat dhe konfliktet janë e kundërta e dëshirës së popujve; prandaj së konflikteve midis njerëzve, grupeve njerëzore dhe midis shteteve apo kombeve me kultura të ndryshme, politike, ideologjike dhe besime të ndryshme fetare. Sipas studiuesit dhe filozofit amerikan K.J.Holsti: "*Konflikti është një dukuri që shpie në dhunë të organizuar të shkaktuar nga përfshirja e palëve, që kanë pozicione të papërputhshme për çështje të ndryshme, kanë qëndrim armiqësor dhe forma të caktuara veprimi diplomatik dhe ushtarak*" (Holsti, K. J. 1994, F. 328). Konflikt do të thotë mospajtim me një ide, problem apo çështje të

caktuar. Në një konflikt vihet re përplasja e dy ose më shumë forcave, grupimeve apo palëve për zgjidhjen e tij duke përdorur mjetet e dhunës dhe të luftës. Shfaqja e një konflikti dëshmon njëkohësisht edhe për dështimin e përpjekjeve dhe mjeteve paqësore, përplasjen e dhunshme të palëve pjesëmarrëse ku mbizotëron "parimi": E drejta është në anën e më të fortit.

Konfliktet kanë ekzistuar që në fillimet e shoqërisë njerëzore dhe janë po aq të vjetra sa dhe njerëzimi. Konfliktet ndeshen në të gjitha rrafshet e jetës; në familje, në punë, në politikë, në besimet fetare, etj. Një fenomen i tillë jetik që i jep kuptim dhe zhvillim jetës shoqërore, në situata të caktuara shoqërohet me lindjen e rreziqeve të një konflikt midis palëve në përpjekje për vendosjen e drejtimit të shoqërisë. Individit paraqitet i ndryshëm dhe me veçansitë e tij në shoqëri. Kështu, shpesh herë interesat tona na çojnë drejt një konflikti të mundshëm me individë dhe grupe të ndryshme të shoqërisë. Nisur nga dëshirat, synimet dhe qëllimet tona ndeshemi edhe me konflikte të pashmangshme të cilat kërkojnë zgjidhje.

Në të gjitha sistemet politike që ka njohur shoqëria njerëzore, veçanërisht në Demokraci, përjetojmë konflikte të ndryshme të cilat prekin interesat tona vetjake dhe ato të komunitetit ku jetojmë. Konfliktet ndodhin për shkak të palëve të cilat kanë qëllime, interesa dhe botkuptim të ndryshëm, të cilat paraqesin një përceptim subjektiv të tyre si dhe të shkaqeve strukturale, si padrejtësia, varfëria, pabarazia dhe subjektiviteti në raport me qëndrimin objektiv. Filozofi romak, Seneka duke shprehur gjykimin e tij për konfliktet dhe luftërat në mes të shteteve, ka vënë në dukje: *"Njerëzit gjithmonë pyesin për rezultatet e luftërave dhe jo për shkaqet e tyre". (Baça Ferit, 2017. F. 17).* Ide e cila pasqyron në të vërtetë prirjen ekzistencialiste të shoqërisë njerëzore, si dhe nënvizon idenë se, shkaqet që shërbejnë për nxitjen dhe shpërthimin e luftës janë të shumëllojshme dhe gjithmonë të pranishme. Gjykimi i filozofit romak është një kritikë e hershme ndaj fokusimit të studiuesve mbi pasojat dhe shfaqjen e jashtme të fenomenit të konflikteve dhe luftërave. Sipas tij, nuk duhen anashkaluar shqyrtimi me kujdes i natyrës dhe shkaqeve të konflikteve dhe luftërave. Gjithësesi, Lufta dhe Paqja", qëndrojnë përballë njëra - tjetrës, sikundër nata dhe dita, apo si dy drejtëza paralele, që iluzivisht duket sikur priten në një pikë, por që njëherësh, janë në një unitet të habitshëm dialektik.

Esenca e pikëpamjeve të Rusoit fokusohet rreth fazave të zhvillimit të shoqërisë

njerëzore, ku spikat pikëpamja, sipas së cilës thelbi dhe burimi kryesor i konfliktit në shoqëri mbetet pabarazia e lindur. *"E tillë që, ose duhej të ishte zanafilla e shoqërisë dhe e ligjeve, që i dhanë shtrëngesa të reja të dobët dhe fuqi të reja të pasurit (shek XVIII), rrënuan njëherë e përgjithmonë lirinë natyrore, ngulitën në mënyrë të përhershme ligjin e pronësisë dhe të pabarazisë, prej një përvetësimi të dhunshëm dhe të guximshëm, nxorën një të drejtë të pakthyeshme, dhe për hir të përfitimit të ndonjë ambiciozi, ja nënshtruan më në fund të gjithë gjininë njerëzore punës, robërisë dhe mjerimit."* (Rusoi, Zh, Zh. 2008. F.109-110).

Në këtë mënyrë, ai ia kishte dalë mbanë të zgjonte dhe argumentonte përpara shoqërisë së kohës vetëdijen mbi të drejtën natyrore të njeriut për të jetuar i barabartë dhe i lirë, gjë që nuk mund të sigurohej në një monarki që ngrihej mbi idenë e absolutizmit dhe të drejtave të pakufizuara të monarkut, ku çdo gjë, çdo pasuri dhe e drejtë, qoftë edhe jeta njerëzore i përkiste atij. Argumentet e mësipërme e nxitën atë t'i thellonte pikëpamjet dhe idetë me të cilat doli hapur kundër formës së regjimit në Francë, mbretërisë, duke u shndërruar në një ithtar të zjarrtë të vendosjes së sistemit republikan, pikëpamje dhe ide të cilat luajtën dhe luajnë edhe sot në mbarë botën e civilizuar një ndikim të fuqishëm.

Nuk ka asgjë më të vështirë se sa ta pranosh tjetrin si të barabartë me veten, veçanërisht nëse midis palëve në konflikt arrihet të vendosen ura mirëkuptimi. Zhvillimet e kohëve të fundit po shtrojnë gjithmonë dhe më shpejt shinat drejt së ardhmes së një bote të bashkuar, me shtete e grup shtetesh që kanë probleme dhe sfida të njëjta të ekzistencës njerëzore, por edhe grup-shtetesh që bartin nga e kaluara probleme të veçanta të zhvillimit të tyre social-ekonomik. Nisur nga pasojat dhe efektet e dukshme shkatërrimtare që sjellin disa lloj konfliktesh, veçanërisht ato që zhvillohen midis palëve të armatosura, me të drejtë, ekziston një opinion negativ ndaj konflikteve në tërësi, sepse përmbajtja e konflikteve që shoqërohen me përdorimin e dhunës dhe të armëve, shkakton humbje jetësh njerëzore, dëme dhe shkatërime të natyrës, të pasurisë dhe të pronës.

Parandalimi dhe Menaxhimi konflikteve

Nevoja e njohjes dhe zgjidhjes së konfliktit shtrojnë përpara shoqërisë njerëzore nevojën e komunikimit midis palëve në konflikt. Një komunikim eficient shndërrohet edhe në një "çelës magjik" për menaxhimin dhe zgjidhjen e

një konflikt. Komunikimi dhe menaxhimit i konfliktit lidhet ngushtë me hapat e pare, në dukje të vegjël dhe në dukje, të parëndësishëm, por edhe "një marshim i gjatë fillon kurdoherë me një hap". Mjaft herë pjesëmarrësit në një konflikt komunikojnë në mënyrë jo efektive me palën tjetër dhe në vend që "ta shuajnë" zjarrin, i hedhin më shumë benzinë atij. Palët në konflikt priren të keqinterpretojnë fjalët dhe argumentet e kundërshtarëve të tyre. Në situata të tensionuara, shpesh herë komunikimi shfrytëzohet për të nënvlerësuar palën tjetër, për t'i prekur ata në sedër apo për t'i akuzuar para të pranishmëve. Në konfliktet me pasojë të rënda, veçanërisht në luftëra, thashethemet "vrapojnë" më shpejt se sa faktet. Këto prirje i nxisin palët për një reagim të egër ndaj kundërshtarëve. Në mungesë të komunikimit midis tyre, informacioni zotëruar mbi kundërshtarin është fakti se ai është i pamoralshëm dhe i paarsyeshëm se sa ai është në të vërtetë. Edhe në situatat kur njerëzit udhëhiqen nga synime të mira, në saj të komunikimit të dobët, edhe një situatë në përmirësim e sipër mund të pësojë hapa prapa dhe drejt një konflikti shkatërrues. Nuk ka komunikim pa respekt ndaj tjetrit. Së pari duhet zotëruar aftësi për të thyer barrierën te vetvetja mbi drejtësinë e kauzës tënde.

"Shumë njerëz mendojnë se vetë OKB-ja shërben si parandalues konfliktesh. Njihet roli i kësaj organizate për nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit midis popujve dhe shteteve të botës. Për më tepër ajo jep ndihmesë në zhvillimin e rregullave ndërkombëtare të trafikut, nëpërmjet zgjerimit dhe mbrojtjes të të drejtës ndërkombëtare. Gjithashtu puna e organizatës për zhvillimin e shteteve të varfra të botës, është masa më efektive për parandalimin afatgjatë të konflikteve. Varfëria jep terren për dëshpërim dhe mungesë stabiliteti dhe krijon konflikte me pasojë për një sërë shtetesh. Mungesa e gjërave më të rëndësishme për të mbajtur veten dhe familjen gjallë, kërkesa për ushqim, për të mira materiale, për siguri dhe shpresë për të ardhmen bëjnë, që në qoftë se mendon se ke pak për të humbur dhe shumë për të fituar, të hysh në konflikt për t'i arritur këto objektiva. Ky mund të jetë këndi i duhur i rënies, për shumë konflikte të përgjakshme në Afrikë, në dhjetëvjeçarët e fundit" (Mellbye Kval. 2006. F. 155). Të tjerë thonë se globalizmi dhe demokracia nxisin paqen afatgjatë në bashkësinë ndërkombëtare.

Një ndër filozofët që trajtuan në mënyrë të veçantë temën e konfliktit është Zhan Zhak Rusoi. Duke qenë njohës i mirë i teorive dhe pikëpamjeve të filozofëve të lashtësisë dhe atyre bashkëkohorë, Rusoi formoi një koncept të

përparuar për kohën mbi origjinën dhe natyrën e konfliktit. Puna e tij hulumtuese u pasqyrua gjerësisht në veprën "Origjina e pabarazisë në mes të njerëzve", nëpërmjet të cilës ai hodhi dritë mbi origjinën dhe natyrën e konflikteve. Në këtë vepër zënë vend të dukshëm abstragimet dhe argumentimet e tij mbi natyrën dhe tipologjinë e konflikteve; fetare, politike, etnike, sociale dhe ekonomike, etj. Tejqyra e tij prej studiuesi u ndal në mënyrë të veçantë në njërën prej shkaqeve dhe origjinës së konfliktit midis njerëzve në shoqërinë njerëzore; atë mbi pronën, nga lindi pabarazia, shfrytëzimi, robëria dhe varfëria, etj. *"I pari që, pasi i kishte vënë kufijtë një trualli, tha: Kjo është e imja!" (Rusoi, 2008. F. 89). Radioskopia e tij kalon si në një ekran mjaft anë të moralit njerëzor, të atij morali që gëlon nga veset e këqija, produkt i shoqërisë së qytetëruar. Rusoi nënvizon: "Fryma e shoqërisë dhe barazia që përfitohet prej saj janë ato që ndryshojnë dhe tjetërsojnë në këtë mënyrë të gjitha prirjet tona natyrore." (Rusoi. Zh. Zh, 2008. F. 132). Ndaj dhe marrëdhëniet dhe konfliktet midis individëve në gjirin e shoqërisë zgjidhen duke u mbështetur në kërkesat morale, produkt i zhvillimit ekonomik e shoqëror, që karakterizohet nga respekti reciprok midis njëri - tjetrit.*

Rusoi thekson se edhe lumturia natyrore prishet kur njerëzit fitojnë shkathtësi dhe kur zhvillojnë shkencën, të cilat krijojnë hapat e kalimit drejt gjendjes sociale qytetare, gjendje, në të cilën, disa jetojnë në luks, kurse disa të tjerë, në një mjerim e poshtërim të paduruar. Të mbarsura me pezëm e kritika, të veshura plot hijeshi artistike, por edhe ironi therëse, shumë shpejt, idetë demokratike të filozofisë sociale të Rusoit do të përvetësoheshin nga shoqëria e kohës dhe do të nxitnin nevojën për ndryshimin e shoqërisë franceze duke u shndërruar në promotor të revolucionit borgjez francez të vitit 1789 me parullën: "Liri, barazi, vëllazëri!". Pikëpamjet e Zhan Zhak Rusoit do të shërbenin si një inspirim nxitës për shumë filozofë të shekullit të XIX, deri edhe në formulimin e teorisë së zhvillimit të Luftës së Klasave, "si motor i zhvillimit të shoqërisë njerëzore" për të përshpejtuar konfliktet dhe luftat në gjirin e saj. Vepra "Kontrata Sociale" e Rusoit fitoi vlerësime të panumërta nga personalitete të fushave të ndryshme të jetës, të cilat zbulojnë anë të veçanta dhe të rëndësishme të përmbajtjes së saj.

Në këtë kuptim, teoritë e lindjes dhe të zhvillimit të shoqërisë njerëzore deri në ditët tona; fazat nëpërmjet të cilave ka kaluar ajo, nga individ, tek fiset, në komunitet, deri në organizimin e një shkallë më të lartë të saj, si

unitete njerëzore; sipas gjuhës, dokeve, zakoneve, duke jetuar në një hapësirë të përbashkët, si dhe duke përzgjedhur formën e ndërtimit të shtetit, duken se mbeten probleme të cilat kërkojnë një ndriçim edhe më të hollësishëm dhe objektiv. Historia e ideve, e atyre që u dhanë zjarr impulseve të para të zhvillimit të shkencave dhe arteve, dëshmon se njeriu ia doli të formojë vetëdijen për vendin që zë në natyrë.

Meqenëse rrethanat e lindjes së konfliktit kanë një pafundësi shkaqesh edhe mënyrat e menaxhimi dhe zgjidhjes së tij janë të ndryshme dhe të pafundme, ndonëse në jetën e përditshme statusin e preferencial e kanë fituar ato zgjidhje që, duke patur një kosto të vogël, arrijnë të sigurojnë avantazhe dhe përfitime më të mira për palët e përfshira në konflikt. Kështu, për probleme të ndryshme kemi dhe reagime të ndryshme. Çdo pjesë e procesit të menaxhimit të një konflikti vlersohet si pjesë e një organizmi të gjallë, në të cilin bën majë komunikimi. Ai u jep palëve mundësi të tregohen të hapur, të sqartë dhe të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin. Por komunikimi nuk është i vetmi "faktor magjik" në menaxhimin e konfliktit. Ai duhet të shoqërohet hap pas hapi dhe të kombinohet me krijimin e një klime të besueshme të cilat përgatisin kushtet dhe letësojnë në tërësinë e tyre arritjen e marrëveshjeve dhe mirëkuptimit midis palëve konfliktuale. Çelësi i suksesit në zgjidhjen e një konflikti e ka burimin në parimin: "Mos lejo që një mospajtim ose mosmarrëveshje sado i vogël në fillim, të përshkallëzohet si ai orteku i dëborës."

Duke ndjekur ecurinë e një konflikti, ashtu sikundër zhvillimin e një sëmundje në trupin e një njeriu, menaxhuesit që kanë marrë përsipër zgjidhjen e konfliktit duhet ta shohin atë nga të dy krahët, edhe aspektet kontradiktore, duke njohur me detaje si faktorët pozitivë dhe ata negativë të një situatë apo procesi konfliktual. Mbajtja e një qëndrimi të njëanshëm, ta zemë negativ ndaj një konflikti do të na shpjerë drejt zgjidhjeve të gabuara. Zgjidhja e konfliktit kërkon mbajtjen parasysh të gjendjes ekzistuese si dhe përshtatjen me nevojat e reja që imponojnë kushtet. Faktin që, jo gjithmonë këto situata që evoluojnë gjatë dinamikës së zgjidhjes së një konflikti përputhen me realitetin e krijuar. Në përfundim të konfliktit për të dy "kundërshtarët" shpesh herë mbeten edhe pikëpyetje e probleme të pa zgjidhura, të cilat në një periudhë jo të largët do të bëhen përsëri objekt i lindjes së konflikteve të reja. Nga sa parashtruar duhet të kuptojmë se menaxhimi i konfliktit ka të bëjë me identifikimin e këtyre pikëpyetjeve, pengesave

dhe evitimin e mekanizmave destruktive, me të cilët mund të arrihet një zgjidhje e kënaqëshme.

Palët e përfshira në konflikt gjithmonë besojnë se kanë arsye për zhvillimin e konfliktit dhe mbetet detyrë e menaxhuesve të tij që t'ua bëjnë të qartë metë gjitha mënyrat e mundëshme palëve në konflikt se, kostua e zhvillimit të tij është kurdoherë më e lartë se sa një zgjidhje paqësore. Ky përfundim kërkon të punohet ndaj koncepteve mbizotëruese si, bie fjala: "Tërheqja dhe shkëputja nga konflikti, janë dobësi, paaftësi ose mungesë besimi në fitore". Marrëveshja midis palëve është më e dobishme se fatura e konfliktit. Një punë e tillë duhet t'i bindë palët konfliktuale në nevojën dhe domosdoshmërinë për pranimin e marrëveshjeve dhe zgjidhjeve paqësore me leverdi reciproke.

Gjatë procesit të menaxhimit për zgjidhjen e një konflikti është jetike vazhdimi i komunikimit dhe i dialogut midis palëve në konflikt, qëndrimi i kundërt, ndërprerja e komunikimit midis tyre do të përkeqësonte dhe përshkallëzonte marrëdhëniet midis tyre. Për të kuptuar rrezikun e ndërprerjes së komunikimit dhe rolin e besimit në komunikim, mund të marrim rastet kur fëmijët adoleshentë humbasin besimin e prindërve, për shkak se ata gjithnjë u kundërvihen dëshirave dhe mendimeve të tyre. Për këtë dhe për shkaqe të tjera ndërpritet komunikimi i vërtetë dhe adoleshenti, mungesën e besimit tek prindërit e zëvendëson me besimin të shoqëria e cila jo rrallë mund ta shpjerë atë në një rrugë të gabuar. Është e dobishme që prindërit t'u japin hapësirë fëmijëve të tyre për t'u shprehur, t'i mirëkuptojnë dhe në asnjë mënyrë të mos e ndërpresin me ata komunikimin.

Në menaxhimin e konfliktit me sukses ose jo sukses, ndikon edhe mënyra se si komunikojnë palët, mënyra si ia shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre njëri-tjetrit. Kur kundërshtarët sqarojnë pozitën e tyre dhe marrin parasysh pikëpamjet e ndryshme, arrijnë të merren vesh dhe ta kuptojnë më shpejt njëri-tjetrin. Si rregull çiftet që bisedojnë hapur dhe drejtpërdrejt rreth shqetësimeve të tyre sigurojnë një martesë të lumtur dhe jetëgjatë. Për nga moria dhe natyra e pafund e problemeve që përmban, një konflikt ai duket se përbën në vetvete bërthamën e një shoqërie njerëzore në minaturë. Mbi të gjitha mbeten probleme të diskutueshme çështjet e karakterit të drejtësisë; barazisë dhe pabarazisë, të cilat përbëjnë edhe tezat më të rëndësishme të shkencës politike, pra dhe të faktit se kush mund ta zgjidhë konfliktin.

Përfundime

Në epokën e realizmit të marrëdhënieve shoqërore njeriu realizoi edhe ndarjen e punës që përshpejtoi ardhjen e epokave të reja. Duke qenë se, qeniet njerëzore mbeten objekt dhe subjekt i konflikteve, perceptimi i fenomenit të konfliktit në shoqërinë njerëzore, roli dhe natyra e njeriut, mbeten esenciale në njohjen, trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit. Natyra komplekse e konfliktit na ofron mundësinë e komunikimit midis palëve konfliktuese si dhe realizimin e synimeve tona gjatë menaxhimit të këtij procesi. Përpjekjet për trajtimin e problemit të konfliktit mishërohen në mjaft prej teorive të filozofëve që u japin përgjigje pyetjeve: Nga lindin dhe çfarë përfaqësojnë konfliktet në shoqërinë njerëzore? Mund të qartësohen faktorët që ndikojnë në rrezikun e konfliktit e dhunës?

Çështja e konfliktit në shoqërisë njerëzore përbën një temë të diskutueshme si në aspektin moral ashtu edhe atë shkencor. Duke qenë një bashkëudhëtare e jetës, shoqëria njerëzore nuk mund të imitojë qëndrimin e strurit i cili për të shpëtuar nga rreziqet kërcënuese fsheh kokën në rërë. Përkundrazi, shoqëria njerëzore dhe shkenca të veçanta të saj, si bie fjala, filozofia, etj., i kanë në qendër të studimeve të tyre. Historia e zhvillimit të konflikteve është një mësuese e ashpër, por objektive e cila e ka mësuar shoqërinë njerëzore se, gjatë zhvillimit të konflikteve pasojat për të

- ".2008.

gjitha palët pjesëmarëse shoqërohem me humbje jetësh dhe shkatërtime të vlerave historike, kulturore dhe materiale. Përvoja mijërvjeçare dëshmohej mjaft koprace në fushën e zgjidhjes dhe menaxhimit të konfliktit duke ofruar vetëm metodën e zgjidhjes paqësore e cila u jep mundësi të barabarta dhe përfitime reciproke palëve. Nga ana tjetër, rruga me efikase për parandalimin e konflikteve mbetet, respektimi i parimeve të demokracisë, i ndarjes së pushteve dhe i mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut.

BIBLIOGRAFIA

- Baça Ferit. (2017). *"Teori konflikti: Trajtesë filozofike"*. Shtw pia botuese "Edlora". Tiranë.
- Holsti, K. J. (1994). *"International Politics: A Framework for Analysis"* (7th Edition) 7th Edition: Pearson College Div.
- Mellbye Kval. (2006). *"Politika dhe demokracia"* perk Ermir Pulha. Tiranë: Shtëpia Botuese "Onufri"
- Ruso, Zhan Zhak. *Kontrata Sociale*. Botimi i IV. Përk. Lazan Koldashi. Tiranë: Luarasi University Press. 2007.
- Ruso, Zhan Zhak. *Origjina e Pabarazisë Sociale mes Njerëzve*. Përk. Qemal Velia. Tiranë: Botimet "Almera"

Kongresi i Manastirit

Dr. Blerina XHELAJ

Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë

Departamenti i Edukimit

blerina.xhelaj@univlora.edu.al

Abstrakt

Midis datave 14 dhe 22 nëntor 1908 u mbledh Kongresi i Manastirit për zgjidhjen e çështjes së alfabetit të gjuhës shqipe, njësimi i së cilës ishte bërë një problem i mprehtë politik, arsimor e kulturor dhe një kërkesë urgjente e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Për të plotësuar këtë kërkesë, patriotët shqiptarë shfrytëzuan shpejt situatën e krijuar pas shpalljes së Kushtetutës në Perandorinë Osmane. Kongresi i Manastirit u mbajt në Përmet, në shtëpinë e Fehim Zavalanit. Ai ishte një nga organizatorët kryesorë të thirrjes së Kongresit të Manastirit për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Në Kongres morën pjesë 50 delegatë të shoqërive, klubeve dhe organeve kombëtare nga shumica e trevave shqiptare, si dhe nga kolonitë shqiptare nga vende të ndryshme, shkrimtarë e gazetarë, mësues të gjuhës dhe mësues shqiptarë, veprimtarë të njohur të kulturës dhe politikës kombëtare. lëvizjes. Kongresi shqyrtoi edhe dy alfabetet të tjera, alfabetin grek të përhapur për përdorimin e shqipes nga studiuesi i gjuhës shqipe, veprimtaria e Rilindjes Kombëtare në fushën e arsimit dhe kulturës, Kostandin Kristoforidhi, dhe alfabetin arab, që një numër i caktuar muslimanët, veçanërisht në Maqedoni dhe Kosovë vazhduan ta shohin atë, si zgjidhjen e vetme edhe për një kohë të caktuar pas kongresit. Si kryetar i klubit "Bashkimi" të Manastirit, Fehim Zavalani koordinoi veprimtarinë e të gjitha klubeve shqiptare për mbrojtjen e alfabetit, kulturës dhe të drejtave kombëtare të shqiptarëve kundër reaksionit Xhonturk. Në Kongresin e Dibrës më 1909, u

kundërshtuan përpjekjet e mbështetësve të xhonturqve për t'iu imponuar shqiptarëve alfabetin arab. Kongresi i Manastirit pati një rëndësi të madhe jo vetëm për alfabetin, gjuhën letrare kombëtare, arsimin dhe kulturën, por edhe për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në përgjithësi. Gjatë ditëve të kongresit u organizuan takime të veçanta dhe takime të mbyllura me delegatë, ku u diskutuan çështje të mprehta politike. Diskutimet e zhvilluara shërbyen për afrimin e pikëpamjeve, përcaktimin e platformës së përbashkët politike të organizatave kombëtare dhe koordinimin më të mirë të aktiviteteve të tyre. Çështja e alfabetit ishte një temë politike e diskutuar gjatë Rilindjes dhe do të mbetej e tillë edhe për disa vite në vijim, përkatësisht deri në vitin 1908. Duke vendosur të mbështeste një zgjidhje kompromisi, Kongresi hapi rrugën për një kalim gradual nga alfabeti i Stambollit në alfabetin aktual të shqipes, bazuar në shkronjat latine, dhe arriti të shmangë shumë polemika dhe kundërshtime në vitet e mëvonshme. Alfabeti që u vendos në Kongresin e Manastirit vazhdoi të shërbente për themelimin e gjuhës shqipe, e cila do të përdorej gjerësisht në shumë libra, gazeta e revista, e deri më sot.

Fjalë kyçe: *alfabet, kongres, delegatë, konferencë ndërkombëtare, lëvizje kombëtare, platformë politike.*

Congress of Manastir

Abstract

Between November 14 and 22, 1908, the Congress of Manastir was convened to resolve the issue of the alphabet of the albanian language, the unification of which had become an acute political, educational and cultural problem and an urgent demand of the National Movement Albanian. In order to fulfill this request, the albanian patriots quickly took advantage of the situation created after the proclamation of the Constitution in the Ottoman Empire. The Manastir Congress was held in Permet, in the house of Fehim Zavalani. He was one of the main organizers of the call of the Congress of Manastir for the unification of the alphabet of the albanian language. The Congress was attended by 50 delegates of societies, clubs and national bodies from most of the albanian territories, as well as from albanian colonies in various countries, writers and journalists, language teachers and albanian teachers, well-known activists of national cultural and political movement. The Congress also examined two other alphabets, the greek alphabet, spread for the use of albanian by the albanian language researcher, activity of the National Renaissance in the field of education and culture, Kostandin Kristoforidhi, and the arabic alphabet, which a certain number of muslims, especially in Macedonia and Kosovo, continued to see it, as the only solution even for a certain time after the congress. As chairman of the club "Bashkimi" of Manastir, Fehim Zavalani coordinated the activity of all albanian clubs for the protection of the albanian alphabet, culture

and the national rights of albanians against the Xhon Turk reaction. In the Congress of Dibra in 1909, the efforts of supporters of the Xhon Turks to impose the arabic alphabet on the albanians were opposed. The Congress of Manastir was of great importance not only for the alphabet, the national literary language, education and culture, but also for the Albanian National Movement in general. During the days of the congress, special meetings and closed meetings with delegates were organized, where sharp political issues were discussed. The discussions that took place, served to bring the views closer, to define the common political platform of the national organizations and to better coordinate their activities. The issue of the alphabet was a political topic discussed during the Renaissance, and would remain so for several years to come, namely until 1908. By deciding to support a compromise solution, Congress paved the way for a gradual transition from the Istanbul alphabet to the current albanian alphabet, based on latin letters, and managed to avoid many controversies and objections in later years. The alphabet that was decided at the Congress of Manastir, continued to serve for the establishment of the albanian language, which would be widely used in many books, newspapers and magazines, and textbooks until today.

Keywords: *alphabet, congress, delegates, international conference, national movement, political platform.*

1.1 The beginnings of the Monastery Congress

The Congress of Manastir consisted in the unification of an alphabet of the albanian language, attended by dozens of albanian representatives from different provinces and religious affiliations. The Alphabet Congress, as it is otherwise known, began its work from November 14 to November 22, 1908 in Manastir. Until this period, different alphabets existed in Albania. One of the most recent was the one created in Istanbul and was called the Istanbul Alphabet. Most scholars claimed that the alphabet used with non-latin letters was not suitable for the well-being of albanian and the national linguistic union. For this reason, the well-known "Union" society in Manastir called the First General Congress to discuss a unified

alphabet. A unified alphabet would be the beginning of albanian literature. 160 delegates were present at the congress, coming from all parts of Albania, as well as from the albanian communities in Romania, Italy, Greece, Turkey, Egypt, America, etc.

Gjergj Fishta was elected chairman of the commission, while Mithat Frasheri was elected chairman of the congress. While, Fehim Zavalani delivered the opening speech at the congress.

Parashqevi Qiriazi, a teacher at the girls' school in Korça, was elected secretary of the commission. Grigor Cilka from Korça was elected vice president, as well as 11 other members.

Albanians of the muslim, catholic, orthodox, and protestant religions participated in the Congress. The message held by the catholic priest Gjergj Fishta, from Shkodra, touched all the participants, so much so that a priest hugged him in front of everyone. The request of the albanian patriots was that the albanian language should not be written with arabic or greek letters, but with the Latin alphabet, which would mean non-submission, either to the ottomans or to the greeks. The Congress decided by a unanimous vote to put aside the Istanbul alphabet, and to write the albanian language only with the latin alphabet with 36 letters which is used to this day. Also, it was decided that after two years, a second Congress would be held in Ioannina, to examine spelling and literary problems, as well as to make efforts to merge the Gege and Toska dialects into a unified albanian language. Since before the Congress of Manastir, the albanian language was written in arabic, greek, slavic letters, or their adaptations, the determination of the delegates to turn their eyes to the west was clearly a cultural declaration of independence, which did not go unnoticed. Noticed neither by the turkish government nor by the greek orthodox church and their slavic allies.

A printing press was also opened in Manastir, which was financed by a group of patriotic albanianmuslim merchants. The printing house of Manastir soon became known throughout Albania for the distribution of books, newspapers and magazines in the albanian language. It was said that 17 people worked in this printing house, where, by means of a new electric machine, it was set in motion by hand, to print the weekly newspaper "Bashkimi i Kombit", albanian primers and school textbooks. Meanwhile, the issue of the albanian language became quarrel over the outbreak of violence by people who furiously attacked the progress of the albanian language, mainly they were paid by neighboring authorities such as greek, serbian, and turkish. A high number of albanian patriots have worked in Albania, such as: Babë Dudë Karbunara (1842-1917) born in Berat, who collaborated closely with Kostandin Kristoforidhin. Baba Karbunara was the first to read the gospel in the albanian language. He began to receive the first threats from the orthodox clerical superiors and in 1895, the fanatics burned down his entire house. Orthodox priest Stathi Melani was another high personality who made a special contribution in the villages of South Albania for the spread of the albanian school and the albanian church. Father Stath Melani's activity caught the attention of the turkish authorities. Three times,

the turkish authorities burned his house and his albanian books, but he continued his activity until December 24, 1917, when Father Stathi was ambushed and killed.

1.2 Congress of Elbasan

Petro Nini Luarasi (1865-1911) is one of the outstanding patriots who worked for the spread of the albanian language in the district of Korça. He was the director of the boys' school in Korça. Petro Nini Luarasi went from village to village to spread the albanian language. On September 20, 1892, the bishop of Kosturi, Fillateri, issued an announcement entitled "The Curse of Albanian Letters". In 1909, the turkish government closed all albanian schools and gave a firm order to burn all albanian books, documents and literature. The political situation in the country at that time was critical to catch fire from moment to moment. During this period, the mission of the albanian patriots to open schools in the albanian language, to publish newspapers and magazines, etc., increased. For the albanian patriots, the fact became clear that they would never be able to realize their lofty goals without first opening albanian schools, for the education of the young albanian generation, who should be kneaded with love for their homeland and to be educated in the albanian language, since until that time they had been the object of foreign propaganda in the schools opened by the turkish government and the greek church, where they learned turkish and greek and the mother tongue, which was albanian. However, during the work to open albanian schools, the albanian patriots encountered three major problems. Firstly, the obstacles from the turkish and greek authorities, secondly from the lack of finance and thirdly from the lack of educated teachers. Small amounts of money, but quite useful, had been collected within the country, while the larger ones had come from albanian societies and clubs in other countries, that is, from patriotic societies that operated outside albanian borders. But the problem was the fact that there were few educated teachers of the albanian language. To resolve this issue, the Thessaloniki Club called the Congress of Elbasan, from August 20 to 27, 1909. In this 8-day Congress, which aimed to develop the educational movement throughout the country, delegates from 28 albanian societies and clubs came. At the Congress, it was decided to establish the "Normal School in Elbasan", a six-year school for the preparation of new teachers. People learned in foreign european universities were found and appointed to form the teaching staff. While the first director of this school was Luigj Gurakuaqi.

The club of Manastir was designated as the center for the creation of a Federation of Albanian Clubs in Albania and in emigration. The purpose of the clubs was to spread the albanian language and education, without interfering with political influence. The "Progress" club was designated as the financial center, which would administer the grants and the addition of day and night schools. The main responsibility and biggest concern was maintaining the Elbasan Normal School. The Congress of Elbasan urged all albanians to introduce the albanian language in foreign schools, spread throughout Albania. On November 18, 1909, the call was made openly, "The maintenance of the Elbasan Normal School needs money, and more money." It is not difficult to imagine the low standard of living of the people who were made such a proposal! However, with or without the appropriate means, the Elbasan Normal School continued to prepare the pioneers of education for the reborn Albania. Years later this school was baptized with his name. The Normal School, which officially opened in December 1909, with 143 students.

The explosion of albanianism exceeded all the predictions of the enemies of the albanian language. At that time, about 90 albanian, newspapers and magazines were published in Albania and in albanian colonies abroad. Many patriotic societies and organizations were created that operated abroad such as in Bucharest, Sofia, Boston, Buffalo, Calabria and even Egypt. The young turks with their leader Ferit Pasha, scared by this rapid explosion of albanian education, reacted harshly, banning associations, schools and publications in albanian. In Vlora, honest patriots were arrested and exiled, the Vlora school was closed, and its director Loni Naçi left Albania, for fear of murder. In Gjirokastra, the pioneer of albanian national education, Koto Hoxhi, was interned in the Bosphorus castle. Pandeli Sotiri, founder of the first albanian school in Korça, was exiled to Thessaloniki. The Xhonturks had set themselves the task of annihilating all the honest albanians who worked for the spread of the albanian language. Things were going from bad to worse. The emergence of the albanian language, with latin letters, provoked conservative muslims. They protested that albanian, like turkish, should be written only in arabic letters and that the albanian patriots' preference for western latin letters was a contempt and submission to the muslim religion. Uninformed and ignorant people, with the support of the Young Turks' Government in Istanbul, formed the "Mahfeti society" with the aim of dividing the albanians

and inhibiting education in Albanian. At the end of 1909, the turkish government banned the use of the albanian language with national letters in all schools across the country. He also issued a decree according to which the albanian language will be written only in arabic letters. The reactionary society "Mahfeti" with the support of the turkish government, printed and distributed the first primers in arabic letters. For this reason, in February 1910, a protest rally was held in Elbasan, where 7,000 protesters raised their voices against the use of arabic letters for the albanian language. That same month, the protests continued in Korça, Berat, where over 15,000 people burned albanian primers with arabic letters, sent from Istanbul, in the center of the city.

Numerous telegrams from the albanian societies of Thessaloniki, Skopje and Manastir expressed themselves in defense of the albanian alphabet. In Shkodra, a group of Muslims got ready to organize a demonstration in support of arabic letters. But, they changed their minds, when 60,000 honest albanian catholics and muslims, from "Malësia e Madhe", organized a grand demonstration in support of latin letters a few days ago. Similar protests were organized in Permet, Kolonja, Tepelena, Frashër, Konica etc. But, the turks did not want to know. Then in March 1910, the second Congress of Manastir was called. There, it was decided to continue the use of the national alphabet with latin letters and the protests against the unjust decision of the turkish government.

The national newspaper "Shreptima" of Cairo published a memorandum drawn up by the insurgents fighting in the mountains of Albania. It stated that: *"their goal was not to loot or kill, but to fight for the freedom of education in the albanian language and with the national alphabet, the freedom to open all albanian schools closed by the turkish government and the commissioning of printing presses, as well as the publication of banned newspapers, the release of political prisoners. And it ended with the message: "Let the whole civilized world and especially the government of the Ottoman Empire know well that all albanians, Gega and Toska, christian and muslim, will not stop fighting for these three demands, until the government gives us guarantee them with certainty".*

Even in this war, the albanian school was victorious. With few means and teachers, but with the desire in the soul for albanian scholastic knowledge, among obstacles, from close and distant enemies, the albanian school won from the north to the south of Albania and prepared new generations of patriots and future albanian teachers. Although, this cultural

development was envisioned as non-violent, it soon turned into an armed conflict. Albanian patriots and brave men like Isa Boletini and the distinguished diplomat Ismail BejQemalVlora, at the same time the albanian deputy in the ottoman parliament, would speed up the steps to declare Albania's independence on November 28, 1912 in Vlora. Ismail Qemali followed an active diplomatic path, meeting with some of the most important representatives of the european chancelleries, such as the italian and austrian ones, which would also recognize Albania's independence. After the act of independence, a few months later the Balkan War began in Skopje and Monastery, two cities historically inhabited by the majority albanian population, were occupied by the slavs. All the albanian shops and books were burned and most of the albanian patriots were slaughtered by the serbs and some were imprisoned. The albanianmuslim population was forced to leave the city of Skopje and Manastir, Those albanian orthodox families that remained there, over the years and by force were subjected by being assimilated by their albanian historical and cultural dignity.

Conclusion

"The Congress had two national goals, the opening of schools and the teaching of the albanian language, as well as the development of the alphabet, as a fundamental component of national identity. The Congress took a wide reach from all albanian provinces and from all social strata. The albanian language was seen as a means of social development in all fields of activity. The fact that the albanian schools and the alphabet of the albanian language did not operate only in intellectual circles, but also in different social strata and groups, prove a social and linguistic complex of patriotic activity related to the issue of the alphabet of the albanian language. It was labeled not only as a scientific matter, but also as a matter of national civilization, social, educational, historical-cultural, but also political development. Sami Frashëri saw very correctly the aspect of the inseparable connection of language with society and sociolinguistic aspect. "Not learning the mother tongue, of course, has favored the process of assimilation of a part of the albanians..." he writes. Sami Frashëri defended the correct thesis that the albanian alphabet was based on the latin alphabet to add that Albania is "a european country and the albanian people are a european people".

Even Kostandin Kristoforidhi, in 1888, wrote: "If the albanian language is not written even today, after this day, not many years will pass and there will be no more Albania on the face of the earth..."

Kristoforidhi rightly sees the albanian language and its alphabet as indicators of being, of education and of national development.

In the invitations that the albanian club "Bashkimi" of Manastir had sent to cultural clubs and societies inside and outside Albania to participate in the Congress of Manastir, it was pointed out the great national, historical and developmental value that the drafting of an alphabet of the albanian language had. There, among other things, he wrote: "The national interest calls for the unification of the alphabet of our language for the progress and happiness of our people." The alphabet "enforces the most brilliant pages of our national history; the alphabet of the language which is the key to meeting our civil needs and industrial progress, for us today is one of the first important needs"

Reference

1. *Universiteti i Tiranes, "Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit, Tiranë, 1972*
2. *Akte të RKSH 1878- 1912, Tiranë, 1978*
3. *Nano, Mustafa "Një javë në Manastir, UETPRESS,*
4. *Duka, Valentina "Çështje të Historisë bashkëkohore të shqiptarëve" shblu, Tiranë, 2003*
5. *Frashëri, Kristo, Rilindja Kombëtare Shqiptare, Tiranë, 1962*
6. *Hysi, Shyqyri, " Histori e popullit shqiptar", botimet Milosao*
7. *Koliqi, Hajrulla "Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar, Prishtinë 2002*
8. *Skendi Stavro, " Zgjimi Kombëtar Shqiptar, PHOENIX, Tiranë, 2000*
9. *Swire, Joseph, "Shqipëria ngritja e një mbreterie", Dituria, 2005*
10. *Konference Kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe kulturës së tij, Tiranë, 1988*
11. *Hysni Myzyri "Shkolla e parë kombëtare shqipe" Tiranë 1973*
12. *Trushaj Aleks, "Historia e popullit shqiptar nga prehistoria te pavarësia"*
13. *Trushaj Aleks, "Historia e popullit shqiptar nga pavarësia te demokracia", Botimet EUROPRINT, Vlorë, 2009*

14. <https://www.radiokosovaelire.com/kongresi-manastirit-vitit-1908-ishte-kongresi-unifikimit-te-nje-alfabeti-te-gjuhes-shqipe/>
15. https://sq.wikipedia.org/wiki/Kongresi_i_Manastirit
16. <https://prointegra.ch/historiku-i-kongresit-te-manastirit-114-vite-nga-unifikimi-i-alfabetit-te-gjuhes-shqipe/>
17. <http://libratonline.blogspot.com/2014/12/r-oli-historik-i-kongresi-te-manastirit.html>
18. <https://telegraf.al/speciale/asije-hoxha-meshume-se-kurre-ripohojme-rendesine-e-kongresit-te-manastirit/>
19. <https://www.kultplus.com/lajme/delegatet-qe-moren-pjese-ne-kongresin-e-dyte-te-manastirit/>
20. <https://www.epokaere.com/kongresi-i-manastirit-veper-elitare-e-historise-kombetare/>

Tik Toku, sfida e re e mediave klasike

Dr. Deniz Çupi (Xhoga)

Adresa: Universiti "Ismail Qemali" Vlorë
Faculteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë
dxhoga@yahoo.com

Abstrakt

Mediat klasike po përballen më një sfidë të re TikTok-un. Logot kryesore të mediave kombëtare dhe ndërkombëtare kanë tashmë llogari në TikTok. Moshat e reja gjithnjë e më pak informohen nga edicionet e lajmeve, ata përditësohen me lajmet e fundit nga TikTok. Sfidat e mediave klasike është se si t'i përshtasin lajmet e tyre me stilin e kësaj platforme, video të shpejta, plot humor, meme, muzik. Ndër mediat sociale TikTok është platforma me rritjen më të lartë në botë dhe mediat klasike nuk mund të qëndrojnë indiferente ndaj këtij trendi, përkundrazi përpiqen çdo ditë të marrin audiencë nga kjo platformë.

Fjalë kyç: media, postime, video, audiencë, pandemi, platform

Abstract

Classic media faces a new challenge, TikTok. Major national and international media logos already have TikTok accounts. The young age is less and less informed by news editions, they are updated with the latest news from TikTok. The challenge for traditional media is how to adapt their news to the style of this platform, fast videos, and full of humor, memes, and music. Among social media, TikTok is the platform with the highest growth in the world, and classic media cannot remain indifferent to this trend, on the contrary, they try every day to get audience from this platform.

Keywords: media, posts, video, audience, pandemic, platform

TikTok është aktualisht një nga rrjetet sociale me rritjen më të shpejtë në botë. Algoritmet e tij tentojnë të shfaqin video të pa numërta të

shkurtëra dhe argëtuese. Deri kohët e fundit, rrjeti kishte një reputacion të ndërtuar pothuajse ekskluzivisht në meme me lëvizje të shpejta, gjithë humor, apo muzikë. Po ngjarje të tilla si, pandemia Covid-19 (**Fletcher et.al 2020**), vrasja e njeriut me ngjyre nga polici në SHBA apo lufta në Ukrainë kanë bërë që lajme të tilla të hyjnë në çdo rrjet social përfshirë dhe TikTok. Ndryshimet në platformë, duke mundësuar video pak më të gjata dhe promovimin e transmetimeve të drejtpërdrejta, e kanë bërë gjithashtu TikTok më tërheqës për publikuesit e lajmeve, të cilët janë në kërkim të audiencave të reja dhe çelësi i suksesit të tyre janë zgjerimi i fashës së moshës, që i ndjekim lajmet e tyre.

Pavarësisht kësaj, hulumtimet tregojnë lajmet mbi TikTok gjenerohen ende kryesisht nga ndikues, influencers të mediave sociale, aktivistë ose njerëz të zakonshëm dhe rrallë nga gazetarë.

1. Studimet mbi fashat e reja të audiencave tregojnë se megjithëse TikTok është i dashur për humorin dhe prezantim angazhues, ka shumë dyshime mbi besueshmërinë e informacionit që preantohet atje, duke u rradhitur si media potenciale për keqinformim dhe dezinformim.

2. Të kuptuarit e natyrës së lajmeve në çdo platformë sociale është përpjekja e mediave klasike duke pasur parasysh natyrën shumë të personalizuar të përvojës dhe disponueshmërinë e kufizuar të të dhënave publike. Pjesërisht për këto arsye, në këtë raport ne fokusohemi kryesisht në prodhimin e përmbajtjes për TikTok nga publikuesit e

informacioneve, si dhe nga disa krijues të pavarur lajmesh.

Ndërsa kjo platformë me lëvizje të shpejtë maturohet dhe rritet, ky studim identifikon fusha në të cilat vetë TikTok mund të duhet të fokusohet më shumë si shqetësimet e ekspertëve të medias në lidhje me cilësinë dhe gamën e përmbajtjes së lajmeve të ofruara dhe zbatimi i normave të etikës. Duke pasur parasysh numrin e mediave tashmë të përfshira dhe shpejtësinë e ndryshimit, ky studim del i nevojshëm, pasi dhe mediat shqiptare po i përshtaten këtyre ndryshimeve.

Gjetjet kryesore

- Rreth gjysma e mediave kryesore po publikojnë rregullisht përmbajtje në TikTok. Një pjesë e madhe e tyre i janë bashkuar TikTok në vitin 2021.
- Newsroom-et tërhiqen nga audienca me rritje të shpejtë dhe demografia më e re, por ato janë gjithashtu të prirura për të ofruar lajme të besueshme, rrjedhimisht janë të detyruara të hulumtojnë para publikimit, në mënyrë që të mos keqinformojnë publikun.
- Ndërkohë shumë media po qëndrojnë larg ose po angazhohen me kujdes. Disa shqetësohen për pronësinë kineze të platformës dhe implikimet e mundshme për fjalën e lirë; të tjerë kanë frikë se 'TikTok-ifikimi i lajmeve' rrezikon të banalizojë histori të rëndësishme si dhe të minojë modelet e biznesit që ju referohen mediave të tjera sociale.
- Procesi për marrjen e statusit të 'verifikuar' në TikTok duket se është i vështirë dhe jo gjithnjë zbatohet. Shumë media me lajme të forta dhe përmbajtje të besueshme, ku përfshihet verifikimi i fakteve, nuk i kanë dhënë ende dritën jeshile gjenerimit të lajmeve të tyre në TikTok, apo përdorimit të TikTokut si burim, veçanërisht jashtë SHBA-së dhe Evropës Perëndimore. Më saktë, gati të gjitha mediat e mëdha BBC, Rojter, SkyTv, etj kanë llogari në TikTok, ku hedhin lajme që përshtaten me filozofinë e kësaj platforme, por rrallë e përdorin si burim për lajmet e tyre TikTok-un.

2. Metodologjia

Për të kuptuar shtrirjen dhe përfshirjen e medias klasike në platformën TikTok, u

identifikuan mediat kryesore ndërkombëtare, ku janë përjashtuar India, ku TikTok është i ndaluar dhe Hong Kongun, ku nuk është i disponueshëm. Në të gjitha rastet, u vu re se numrat e ndjekësve për çdo media dhe, në rastin e më të suksesshmeve, duke llogaritur mesatarja e shikimeve në 50 postimet e fundit në platform, konkretisht në fillim të vitit 2022.

Duhet të theksohet se përmbajtja e postimeve në TikTok ndryshonte jashtëzakonisht shumë, duke nisur nga lajmet e vështira deri te ato argëtuese, ato që tregojnë stilin e jetës, apo të showbizit. U kontrollua secila media klasike në platformën TikTok për të verifikuar se në ç'raport ishte e lidhur përmbajtja e lajmeve të mediave klasike me ato që ata kishin hedhur në këtë platformë.

Ndër mediat e analizuara janë përfshirë logo si: Washington Post, Sky News, Guardian dhe Le Monde si dhe janë marrë për bazë të dhënat e Raportit i lajmeve Dixhital 2021 dhe 2022 (Reuters Institut 2021/2022).

3. TikTok dhe lufta e Ukrainës

TikTok është një aplikacion i mediave sociale që u lançua në vitin 2018 nga kompania kineze Bytedance. Kjo platformë përmbante një miksim videosh të shkurtra shpesh të shoqëruara me këngë apo muzikë virale të kohës. Tashmë kjo platformë ka më shumë se një miliard përdorues aktivë të përditshëm (CNBC 2021). Ka qenë aplikacioni celular më i shkarkuar në botë që nga fillimi i vitit 2020 dhe është veçanërisht i popullarizuar nga audienca më e re, shumë prej të cilëve janë larguar tashmë nga rrjetet më tradicionale si Facebook.

Një pikë kthese për platformën duket se ka qenë "bllokimi në shtëpi", ndërprerja e rutinës së jetës së përditshme nga Covid-19 (Skynews 2022). Shumë të rinj, të mbyllur në shtëpi, eksperimentuan me aplikacionin e videos, ku kishin mundësinë edhe të redaktimit apo punimit të saj, duke ndarë përvojat e tyre më një audiencë të gjerë. Pa mbaruar mire Covid19 nisi pushtimi rus i Ukrainës, ngjarje që rriti më tej reputacionin e platformës për lajmet, me të rinjtë ukrainas që ndanë histori të dëshmitarëve okularë të jetës nën bombardime në kohë reale. Nga ky moment disa logo të medive ndërkombëtare apo me emër iu bashkuan platformës për herë të parë.

Kur u lançua TikTok, bëhej fjalë vetëm për kërcim dhe muzik. Por jo sot. Me video të shpejta, të rinj nga e gjithë bota sjellin informacion të menjëhershëm, gati në kohë reale, por që duhet verifikuar.

Shumë përdorues të moshave të reja i ndjekin lajmet, kryesisht ato mbi situatën në Ukrainë dhe Rusi nëpërmjet mediave klasike që kanë llogari në TikTok. *"Kujdes Huw Edwards, TikTokers po vijnë. Platforma e videove sociale është burimi i lajmeve me rritje më të shpejtë për të rinjtë në Mbretërinë e Bashkuar. Sipas një sondazhi, gati gjysma e njerëzve që e përdorin atë për çështjet aktuale u drejtohen shokëve TikTokers dhe jo mediave konvencionale të lajmeve për t'u përditësuar me lajmet e reja"* (The Guardian 2022). TikTok përdoret për lajme nga 7% e të rriturve, sipas observatorëve të komunikimit në Mbretërinë e Bashkuar, nga 1% që ishte në vitin 2020. Rritja është nxitur kryesisht nga përdoruesit e rinj, ku gjysma e ndjekësve të lajmeve në TikTok janë nga 16 deri në 24 vjeç.

Figura 1: Lufta në Ukrainë rriti mbulimin e ngjarjes me lajme, veçanërisht nga moshat më të reja



Burimi: (Instituti Reuters 2022)

Sipas studimeve të kryera rritja më e shpejtë e përdoruesëve të platformës TikTok ka ndodhur në vendet e Amerikës Latine, si Brazili, të cilat tradicionalisht kanë parë një adoptim të lartë të rrjeteve të reja sociale (Digital News Report

2022). Megjithatë studiet kanë gjetur përdorim edhe më të lartë në shumë shtete të Azisë dhe Afrikës. Në disa prej këtyre vendeve, rritja e TikTok është nxitur nga përdorimi falas ose i lirë si pjesë e paketave të dhënave nga kompanitë celulare.

Adoptimi i njerëzve me këtë platforme është një pikë e fortë e TikTokut krahasuar me platformat e tjera të rrjeteve sociale, pasi nuk varet nga konfigurimi fillestar. Me anë të një algoritmi të thjeshtë aplikacioni mëson se çfarë lloj përmbajtjeje i pëlqen një shikuesi dhe e rafinon atë me kalimin e kohës. Në studimet cilësore për Raportimin e Lajmeve Dixhitale, përdoruesit folën për natyrën magjike të këtij algoritmi dhe përvojën argëtuese shpesh dhe bindëse:

Krijon kaq shumë varësi, por në TikTok dhe aty ku lajmit i mungon besueshmëria, ai shkëlqen në prezantim, thotë një përdorues 22 vjeçar në UK për Institutin Rojter (Instituti Reuters 2022a).

4. Mediat klasike me llogari në TikTok

Në këtë sfond, nuk është për t'u habitur që prodhuesit dhe shpërndarësit kryesor të lajmeve kanë filluar ta marrin seriozisht TikTok. Studimi i bërë nga Instituti i Studimeve të Rojter (Reuters Institut 2022 a, b) tregon se në 44 vende rreth gjysma (49%) e mediave gjeneraliste po përditësojnë rregullisht llogaritë e TikTok-ut me përmbajtje të lidhura me lajmet, që ato kanë transmetuar në edicionet e lajmeve apo web-et e tyre. Miratimi më i shpejtë i administratorëve të mediave ka qenë në disa vende më të mëdha të Evropës Perëndimore, duke përfshirë Francën, Spanjën, në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe Azinë Juglindore, Australi, SHBA dhe Amerikën Latine. Ka pasur më pak entuziazëm në vendet nordike, në Japoni dhe në Evropën Lindore dhe Qendrore.

Studimi që Rojter ka bërë rreth përshtatjes së lajmeve në TikTok tregon se:

Përshtatja më e lartë e lajmeve në TikTok: Indonezia 90%, Australia 89%, Franca 86%, Spanja 86%, Mbretëria e Bashkuar 81%, Shtetet e Bashkuara 77%.

Adoptimi më i ulët: Tajvani 0%, Bullgaria 7%, Belgjika 16%, Greqia 23%, Danimarka 26%, Korea 27% Itali 29%, Japoni 31. Këto të dhëna janë mbledhur më 7-28 nëntor 2022.

Shohim se lista e llogarive të lajmeve më të ndjekura në TikTok dominohet nga prodhues dhe publikues lajmesh nga vende me popullsi të madhe, si SHBA, Indonezia, Japonia, Filipinet dhe Brazili, por dhe organizata tradicionale të lajmeve si nga Mbretëria e Bashkuar, Tajlanda, Gjermania, Franca dhe Spanja, janë gjithashtu të përfaqësuara fuqishëm në TikTok.

Në vazhdim të këtij hulumtimi vërehet se performojnë në një nivel të kënaqshëm disa llogari rinore të drejuara nga shoqëria civile si në Evropë ashtu edhe në SHBA.

"NowThis" ka më shumë se 8.5 milionë ndjekës për llogaritë e saj të lajmeve dhe politikës, ndërsa startup-i spanjoll Ac2ality, i cili ka një mision të 'tregojë lajmet në një minutë', ka grumbulluar 3,9 milionë ndjekës që nga viti 2019. Marka mediatike franceze Brut ka më shumë se 2.7 milionë përmbajtje të synuara për nën 35 vjeç. Fanpage (850,000) ka sjellë një përzierje lajmesh investiguese dhe argëtuese në TikTok dhe Vice World News ka krijuar 2.6 milionë ndjekës në më pak se një vit, duke zënë një vend kryesor në këtë proces.

5. Përse të rinjtë zgjedhin TikTok

Sipas filozofes **Adriana Cavarero (2000)**, "dëshira për të kallëzuar" është nevojë bazë e qënies njerëzore, jo dhe aq ngase ne kemi një vetvete autentike të nënshtretëzuar për të shprehur se sa për shkak të dëshirës së veçantë të mishëruar në ndërgjegjen e secilit prej nesh "për të këqyrur për unitetin e identitetit të vet" në një ngjarje.

Ndërkohë në mediat klasike moshat e reja kanë qenë të përjashtuara nga "dëshira për të kallëzuar", mediat klasike, si shtypi i shkruar, radio dhe television gjithnjë i kanë përkur moshave të mesme, të moshuarëve dhe më pak të rinjve.

Por, kohët kanë ndryshuar. Tashmë moshat e reja kanë mediat e reja, ju takon "të vjetrave" të pëpiqen për të zënë vend mes preferencave mediatike të moshave të reja.

"Mediat klasike e kanë gjithnjë e më të vështirë të kontrollojnë audiencat e tyre dhe janë gjithnjë në sfidë me vetvetes për të plotësuar kërkesat e audincave të tyre. "Interneti dhe teknologjitë e reja iu kanë dhënë individëve pushtetin që të zgjedhin se kur, ku dhe si ata do

t'i kërkojnë lajmet për argëtim". (**Domonick R.J. 2010**).

Tabelë 1: Përdorimi i TikTok sipas grupmoshave

Përdorimi i TikTok		
Mosha (vjeç)	Për lajme në %	Për qëllime të tjera në %
18-24	15	40
25-34	10	28
35-44	7	23
45-54	6	19
55+	3	11

Tabelë e përgatitur nga autorja D.Ç

Sidoqoftë, prej kohësh është menduar se llogaritjet e ndjekësve në TikTok kanë më pak ndikim në popullaritetin e mundshëm të ngritjes së një çështje të caktuar në ndonjë postimi të veçantë në krahasim me platformat e tjera. Përfshirja e lartë e të rinjve në mediat sociale, në rastin tonë në TikTok vjen si pasojë e përfshirjes së ulët e moshave të reja në mediat klasike.

Mbi këtë bazë, NBC News kryeson listat me më shumë se një milion shikime për postim, mesatarisht. Markat braziliane kryesojnë në TikTok. Ndërkohë si kanali G1 i Globo ashtu edhe Metropoles përmbanin video të shumta individuale me mbi 5 milionë shikime secila. Yahoo! News US gjithashtu shënoi rezultate të larta me një numër mesatar shikimesh prej 653,480, ndërsa ABC News, CBS News, Daily Mail dhe TV Asahi ranë poshtë listës. Angazhimi me përmbajtje priret të jetë shumë më i ulët në vende si Indonezia dhe Tajlanda, pavarësisht numrit të lartë të ndjekësve për shumë logo të lajmeve televizive. Një prej arsyeve është se publikojnë video me pak përpjekje për t'i rивersionuar ato të përshtatshme për TikTok. Përkundrajt kësaj mediat që e kryesojnë këtë liste, duke përfshirë mediat si NowThis, Ac2ality, Brut dhe Vice World News, bëjnë përpjekje të konsiderueshme që videot e lajmeve të tyre t'i përshtatin në përputhje me përmbajtjen specifike të platformës, dhe kjo është reflektuar në rezultate shumë më të larta të angazhimit të audiencës së moshave të reja.

Tabelë 1: Përdorimi i TikTok sipas vendeve

Rritja e përdorimit të TikTok		
Vendet	2019	2022
US	3%	16%
Kanada	5%	22%
Brazil	1%	29%
Spanj	4%	24%

Tabelë e përgatitur nga autorja D.Ç

6. Pse disa media po shkojnë drejt TikTok dhe të tjerët ngurrojnë

Rritja e TikTok ka përkuar me shqetësimet shpesh ekzistenciale si nga mediat gjeneraliste të cilat kryesisht i bëjnë publike financimet e tyre ashtu edhe nga ato komerciale. Të dyja palët kanë për qëllim se si të tërheqin dhe të angazhojnë më shumë audiencë më të re, me qëllim rritjen e të ardhurave të tyre.

Në veçanti, nën 25 vjeç, po shpenzojnë më shumë kohë duke lunduar nëpër aplikacione si TikTok – rreth 57 minuta në ditë në Mbretërinë e Bashkuar. Shifër e dhënë nga rregullatori i medias Ofcom (**Dailymail 2022**). Gjithnjë e më pak ka të rinj që shikojnë edicione lajmesh, ata marrin vesh se çfarë ndodh nëpër faqet e internetit dhe aplikacionet që përdorin. Ka ikur koha e hierarkisë së koncepteve, me krijimin e radios dhe televizionit krijohet dhe kultura mozaik. “Kjo hierarki konceptesh të përgjithëshme dhe integruese të propozuara nga kultura humaniste zëvendësohet pak nga pak nga informimi i pandërprerë, i tejskajshëm, i cregullt dhe gjysmë rastësor i kulturës mozaik”. (**Balle, F. 2011**) Sot kjo kulturë mozaik është “sunduese” te të rinjt. Inforamcioni “rrjedh” nga të gjitha anët duke jua hequr “monopolin” e mesazhit medjave klasike, rrjetet sociale po kthehen në konkurente të forta.

Pothuajse të gjithë administratorët e mediave e kanë kuptuar se duhet ta çojnë përmbajtjen e prodhuar tek këto audiencë kudo që ato janë. “Është një platformë në të cilën ka shumë lexues të rinj, shikues të rinj,” thotë Fabrizio Barbato, administrator i Ciaopeople, e cila zotëron Fanpage dhe të tjera media sociale më të vogla. “Ne menduam se duhet të jemi të pranishëm në

të, edhe nëse nuk ka asnjë model të drejtpërdrejtë biznesi për momentin”. (**Instituti Roiters 2022,a, b,c**)

Administratorët e tjerë të tjerë theksojnë se ndryshimet e fundit në platformë, të tilla si transmetimi i drejtpërdrejtë i informacionit dhe minutazhi i ulët i videove, e kanë bërë TikTok-un më të favorshëm për administratorët e lajmeve: ‘Ka një shtrirje të madhe. Ka një angazhim të madh’, thotë Alan Strange, redaktor për përmbajtjen sipas kërkesës në Sky News. (**Instituti Roiters 2022a,b, c, d**). Sky kohët e fundit shënoi 16 milionë shikime për një transmetim të drejtpërdrejtë të funeralit të Mbretëreshës dhe dhjetëra miliona shikime për një video korrespondente nga Ukraina. Tani e shoh TikTok si një nga platformat e tij më të rëndësishme së bashku me YouTube.

“TikTok tani është burimi i vetëm më i favorshëm i lajmeve për adoleshentët në Mbretërinë e Bashkuar, tregon hulumtimi. Gjithashtu, TikTok tani është burimi i vetëm i preferuar i lajmeve mes 12 deri në 15-vjeçarëve, i ndjekur nga YouTube dhe Instagram së bashku, thotë Ofcom”. (**Indipendent 2023**)

Botuesi gjerman ARD ishte një nga botuesit e parë që krijoi një llogari, në nëntor 2019. “Ne kemi detyrë të transformojmë markën tonë me audiencë më të re dhe të informojmë shoqërinë në tërësi,” thotë Patrick Weinhold, Drejtues i Mediave Sociale për Tagesschau. (**Tagesschau 2022**), i cili zbatoi një strategji me dy nivele lajmesh dhe argëtimi, e cila shpesh përfshinte krijimin e videove ‘prapa skene’: ‘Ne donim ta bënim markën tonë më të natyrshme, më ndërvepruese dhe më të këndshme në nivelin e aspektit personal (sy për sy). Imazhi i markës sonë vjen nga një ambient televiziv tradicional, i bazuar në studio. Ne donim ta lehtësojmë këtë.’

Por TikTok nuk është një zgjedhje e qartë për të gjithë. Disa transmetues publikë si **BBC News (2022)** kanë qenë ambivalent, fillimisht duke qëndruar jashtë platformës për t’u fokusuar në rrjete të tjera si Instagram. Transmetuesit e tjerë publikë, duke përfshirë NRK (Norvegji), NHK (Japoni), DR (Danimarkë) dhe Yle (Finlandë) kanë qenë të ngadalshëm në angazhim, pjesërisht për shkak të shqetësimeve se stili i përdorur në TikTok mund të mos jetë i favorshëm për lajme serioze ose për shkak të shqetësimeve që lidhen me pronësinë kineze të

platformës. Shumë botues të bazuar në abonim, si New York Times, kanë qëndruar gjithashtu larg, duke mos e konsideruar si një faktorë shtesë të mundshëm për rritje të të ardhurave të tyre, duke e konceptuar si një prespektivë të kufizuar.

Por administratorët e tjerë të mediave janë të interesuar për TikTok sepse ofron mundësinë për të ndërtuar një marrëdhënie me audiencën më të re dhe ata shpresojnë se do të shpërblehen më vonë. "Ne kemi bërë një punë të mirë duke zhvilluar një audiencë vërtet të madhe në Instagram dhe qëllimi është ta përsërisim atë në TikTok," vëren Liv Moloney, Shef i Mediave Sociale në The Economist. "Gjithashtu, me tendencën për më shumë video vertikale në Instagram dhe YouTube, ne menduam e përsë të mos hyjmë dhe në TikTok." Ashtu si shumë të tjerë, The Economist nuk do të hyjë "me gjithëçka" në TikTok, duke bërë përzgjedhje lajmesh, disa duke dhe i modifikuar për t'i përshtatur në stilin e TikTok. "**The Economist**" (2022) ka postuar më pak se 50 video që nga fillimi në korrik 2022, i ka tejkualuar 20 milionë shikime dhe është i zënë duke eksperimentuar me qasje të ndryshme për të parë se çfarë funksionon më mirë.

Në Suedi, një numër botuesish me bazë abonimesh i janë bashkuar platformës në vitin 2022, duke përfshirë gazetën rekord të Suedis Dagens Nyheter dhe tabloidin Aftonbladet. Prania e TikTok në Aftonbladet ishte pjesë e një nisme specifike për të zhvilluar marrëdhënie me audiencën e gjeneratës së ardhshme. Redaktorja Nathalie Mark ka marrë për detyrë të identifikojë platformat dhe formatet që krijojnë besnikëri dhe shtrirje. Sipas saj TikTok është shumë i rëndësishëm për të fituar një audiencë të re dhe sidomos që fashat e reja të audiencës të mos tërhiqen nga kundërshtarët.

Por veç anës së mirë duhet të shojmë dhe anën negative të çështjes. Një arsye tjetër e rëndësishme e përmendur nga drejtuesit e mediave dhe gazetarët lidhet me shqetësimin për përhapjen e lajmeve të reme në platformë. Jan Žabka, një gazetar çek, i cili punon në uebsajtin me interes publik HlídacíPes.org, shikonte vëllain e tij më të vogël duke lundruar nëpër faqen e tij të platformës "Për ty" deri në shtatë orë në ditë dhe shqetësohej për besueshmërinë e lajmeve që ai po shihte. "Ishte

e trishtueshme që nuk kishte faqe lajmesh në atë kohë nga Republika Çeke – kështu që doja të isha atje", thotë ai **për Rojter Institut (2022)**. Žabka siguroi rreth 20,000 euro nga fondet dhe fondacionet e inovacionit në BE dhe Mbretërinë e Bashkuar dhe i ka përdorur paratë për të bërë video në TikTok për të ndihmuar në përmirësimin e shkrim-leximin e lajmeve për tema të tilla si ruajtja e privatësisë në internet, identifikimi i llojeve të ndryshme të lajmeve të reme dhe mënyra e përdorimit të burimeve të hapura të informacionit. "Kur kam një temë, bëj tre-pesë video pastaj publikoj", thotë ai.

Konkluzione

Mediat sociale janë duke u vetpërmirësuar dhe së bashku me TikTok-un ato po ecin në një valë rritjeje, të nxitur nga kreativiteti dhe energjia e të rinjve. Siç ka treguar ky hulumtim administratorët e mediave kudo në botë po përfshihen në këtë platformë, pjesërisht duke u angazhuar duke ndërtuar marrëdhënie me këtë dritare të re audience dhe demografie, por edhe për të eksperimentuar me formatet vertikale të videove në dhënien e informacioneve, të cilat po gjenden gjithnjë e më shumë në platformat e mediave sociale.

Miratimi i TikTok-ut nga administratorët e mediave shpërndahet në mënyrë të pabarabartë mes vendeve. Entuziazëm më të madh kanë vendet e Evropës Perëndimore, Azisë Juglindore, Amerikës Latine dhe SHBA-së, dhe më pak interes Evropa Qëndrore dhe Lindore dhe vendet nordike. Disa administrator mbeten të shqetësuar për pronësinë kineze të platformës dhe rreziqet e saj të mundshme; të tjerë kanë frikë se formati shumë i shkurtër i videos rrezikon të banalizojë lajmet e rëndësishme.

Për ata që po eksperimentojnë në platformë, nuk ka asnjë recetë për sukses. Shumë administrator përdorin një strategji të bazuar në punësimin e krijuesve të rinj të cilët janë të familjarizuar me platformën dhe gjuhën e saj popullore. Kjo qasje është lidhur fort me audiencën dhe është vlerësuar pozitivisht nga studiuesit, por ka një kosto të konsiderueshme dhe në platforma të tjera e njëjta përmbajtje, i njëjti informacion kërkon tjetër qasje të përmbajtjes sipas, pasi çdo rrjet social ka specifikat e veta. Media të tjera kanë përdorur tjetër strategji. Ato kanë përfshirë gjithë gazetarët dhe drejtuesit më me përvojë, jo

vetëm duke ju dhënë mundësinë por dhe duke ju kërkuar që të shfaqin gjithë talentet dhe energjitë e tyre për përshtatjen e informacioneve në stilin e platformës TikTok, duke ofruar fleksibilitet të lartë.

Referenca:

Balle. F., (2011) *Mediat dhe Shoqëritë*, Botimi i 15, Papirus, fq. 751

Të rinjtë dhe zakonet e tyre të lajmeve, si mund të arrijnë kompanitë mediatike dhe të angazhojnë audiencë më të re. BBC, 2022, <https://www.bbc.co.uk/academy/events/young-people-news-habits/>

Cavarero, A, *Lidhja e rrëfimeve: Tregimi dhe vetvetja, Relating Narratives: Storytelling and Selfhood*, Psychology Press, 2000, fq 88

TikTok thotë se 1 miliard njerëz përdorin aplikacionin çdo muaj, CNBS, 2021, 27 September, <https://www.cnb.com/2021/09/27/tiktok-reaches-1-billion-monthly-users.html>

Të rinjtë shikojnë më shumë TikTok sesa TV. 15 - 24-vjeç shpenzojnë mesatarisht 57 minuta në ditë në faqen e videove, zbulon raporti i Ofcom, DailyMail, 2022, 17 August, <https://www.dailymail.co.uk/news/article-11119265/Young-people-watch-TikTok-broadcast-TV.html>

Dominick R.J. *Dinamika e komunikimit masiv, Media në periudhën dixhitale*, UET Press, 2010, fq. 518

Fletcher, R., Kalogeropoulos, A., Simon, F., & Nielsen, R. *Information inequality in the UK coronavirus communications crisis. (Pabarazia e informacionit në krizën e komunikimit të koronavirusit në Mbretërinë e Bashkuar)*, Reuters Institute for the Study of Journalism, 2020, fq 5.

Si publikuesit po mësojnë të krijojnë dhe shërndajnë lajme në TikTok. Instituti Reuters, 2022, 8 Dhjetor <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/how-publishers-are-learning-create-and-distribute-news-tiktok>.

Përmbledhje dhe gjetjet kycc në raportin 2021, Instituti Reuters, 2021, 23 Jun,

<https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/digital-news-report/2021/dnr-executive-summary>

Prezantimi i Fondit TikTok të Krijuesve prej 200 milionë dollarësh, Newsroom TikTok, 2020, 22 Jul, <https://newsroom.tiktok.com/en-us/introducing-the-200-million-tiktok-creator-fund>

TikTok në bllokadë, Tageschau, 2022, 23 March, <https://www.tagesschau.de/investigativ/tiktok-begriffe-blockade-101.html>

Si shpërtheu TikTok mediat sociale, The Economist, 2023, 21 March, <https://www.economist.com/business/2023/03/21/how-tiktok-broke-social-media>

TikTok është burimi i lajmeve me rritjen më të shpejtë për të rriturit në Mbretërinë e Bashkuar, zbulon Ofcom, The Guardian 2022, 21 Jul, <https://www.theguardian.com/technology/2022/jul/21/tiktok-is-fastest-growing-news-source-for-uk-adults-ofcom-finds>

TikTok tani është burimi i vetëm më i favorshëm i lajmeve për adoleshentët në Mbretërinë e Bashkuar, tregon hulumtimi, The Independent, 2023, 20 Jul, <https://www.independent.co.uk/tech/tiktok-teenagers-favourite-news-source-b2378563.html>

TikTok, burimi i lajmeve më i popullarizuar mes adoleshentëve, zbulon hulumtimi i Ofcom, Sky News, 2023, 14 Jun, <https://news.sky.com/story/tiktok-most-popular-source-for-news-among-teenagers-ofcom-research-finds-12923950>

Washington Post thellon investimin në tregimin në TikTok, duke shpallur dy pozicione të reja, Washington Post, 2021, 24 August, <https://www.washingtonpost.com/pr/2021/08/24/washington-post-deepens-investment-storytelling-tiktok-announcing-two-new-positions/>

Drejtësi me Ndërmjetësim

Dr. Drita AVDYLI¹ Mag. Enkeledi HAJRO²

¹ *University Mediterranean of Albania*

ORCID: <https://orcid.org/0009-0003-8086879X>

² *Faculty of Justice/University of Tirana*

Abstrakt

Ndërhyrja e avokatit në zgjidhjen e konfliktit në çdo formë të saj është puna e avokatit. Puna e avokatit nuk kufizohet vetëm në këshillim dhe dosje procese gjyqësore por edhe për aktivitete shumë më të gjera, të cilat, natyrisht, përfshijnë studimi i të gjitha zgjidhjeve të mundshme për të zgjidhur çdo konflikt në mënyrën më të dobishme mënyrë për klientin e tij/saj, pa përjashtuar asnjë prej tyre. Dhe kjo përfshin të vlerësoni, propozoni dhe, kur është e mundur, kryeni një proces ndërmjetësimi si zgjidhja më e mirë e konfliktit. Bashkimi Evropian, i vetëdijshëm për këtë, përmes Direktivës 2008/52/CE, kërkon që shtetet anëtare të harmonizojnë legjislacionin e tyre dhe të përfshijnë në legjislacionin e brendshëm duke marrë këto hapa:

- Legjislacioni për ndërmjetësimin.
- Trajnim i nevojshëm për ndërmjetësuesit.
- Përcaktimi nëse ndërmjetësimi është i detyrueshëm para gjykatës.
- Njohja gjyqësore e ndërmjetësimit.
- Fushat e veprimit të ndërmjetësimit
- Kërkesat për marrjen e licencës së ndërmjetësit
- Dhomat e avokatëve/ ndërmjetësve nga çdo vend dhe, sipas rastit.

Direktiva Evropiane për Ndërmjetësimin 2008/52/CE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 21 majit 2008, për disa aspekte të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe tregtare, parashikon se trajnimi fillestar duhet të përfshijë:

- Njohuri mbi bazat e ndërmjetësimit si dhe kushtet e procesit dhe kornizës.
- Teknikat e negociimit dhe komunikimit,
- Kompetenca e konfliktit,

- Njohuri mbi ligjin që rregullon ndërmjetësimin.
- Ushtrime praktike, lojë me role dhe mbikëqyrje

Fjalet Kyce: *Drejtësi, Ndërmjetësim, ndërgjegjësim, gjykata, konflikt, titull ekzekutiv*

Sipas ligjit, ndërmjetësimi është një proces konfidencial dhe i strukturuar në të cilin palët përpiqen, mbi baza vullnetare dhe në mënyrë autonome, për të arritur një zgjidhje miqësore të konfliktit të tyre me ndihmën e një ose më shumë ndërmjetësuesve, të licensuar nga Ministria e Drejtësisë dhe anëtar i Dhomes Kombetare e Ndërmjetësve. Palët mund të zgjedhin vetë këtë person asgjnjës, ndërpresin ndërmjetësimin në çdo kohë ose mund të shkojnë në ndërmjetësim si para, gjatë apo pas vendimeve të gjykatës.

Ligji inkurajon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me pëlqimin e ndërsjellë të palëve të përfshira. Ai përfshin disa amendime në kodet procedurale që nxitin ndërmjetësimin. P.sh

Palët para se të fillojnë procedurën civile në gjykatë, duhet të tregojnë nëse janë përpjekur ta zgjidhin çështjen jashtë gjykatës, p.sh. përmes procedurës së ndërmjetësimit dhe nëse ka arsye specifike që e dekurajojnë këtë lloj procedure. Gjykata gjithashtu mund të sugjerojë që palët të përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjen mendërmjetësim; nëse palët vendosin të ndjekin këtë opsion, gjykata do të urdhërojë pezullimin e procedimeve deri në plotësimin e afatit të caktuar nga gjykata që mund të mos jetë më i gjatë se 3 muaj.

Gjatë procedurës së ndërmjetësimit, afatet e parashkrimit pezullohen.

Fushat e veprimit

Në përgjithësi, ndërmjetësimi pranohet gjithmonë kur legjislacioni nuk e bën zyrtarisht të përshkruajë zgjidhjen gjyqësore të një të caktuar të mosmarrëveshjeve ose çështjeve. Ndërmjetësimi është më i shpeshtë në fushat që vijojnë :

- E drejta familjare, e drejta e pronës dhe e drejta tregtare.
- Çështjet familjare, janë veçanërisht në lidhje me ndarjen ose divorcin, rastet e caktimit të kujdestarisë dhe të drejtat e prindit për takim me fëmijën.
- Mosmarrëveshjet në lidhje me trashëgiminë.
- Çështje lidhur me të drejtat ekonomike ndërmjet personave fizik dhe juridikë
- E drejta civile (konflikte në komunitetin e lagjes, leasing, të drejtat e konsumatorit)
- Të drejtat e ndërtimit.
- Administrata publike (e fokusuar në ndërmjetësimin mjedisor).
- Kodi i punës.
- Konfliktet mes mjekut dhe pacientit.
- E drejta penale, për ndërmjetësimin e viktimës/kundërvajtësit.
- Shkollat (ndërmjetësimi shkollor).

Ligji për ndërmjetësimin- koncepti kryesor

Ndërmjetësimi është një proces konfidencial, i strukturuar ku palët përpiqen , që me vullnetin e tyre dhe në mënyrë autonome, të arrijnë një zgjidhje miqësore të konfliktit ndërmjet tyre me ndihmën e një ose më shumë ndërmjetësve.

Ndërmjetësi është një person i pavarur, i panashëm, pa fuqi vendimmarrjeje i cili udhëheq palët në ndërmjetësim.

Llojet e ndërmjetësimit

- Ndërmjetësimi jashtë gjykatës(i pavarur nga ndonjë procedurë gjyqësore)
- Ndërmjetësim që realizohet gjatë pezullimit të procedurave gjyqësore , por jashtë gjykatës

Ndërmjetësimi është miratuar në Shqipëri për herë të parë në vitin 2011.

Qëllimi kryesor i Direktivës së BE-së:

- Të sigurojë ekzekutimin e marrëveshjes së arritur nëpërmjet ndërmjetësimit;
- Të sigurojë konfidencialitetin e ndërmjetësimit;
- Pezullimi i afateve ligjore gjatë kohëzgjatjes së ndërmjetësimit.

Shtetet anëtare duhet të miratojnë rregullat dhe parashikimet administrative të nevojshme për implementimin e Direktivës.

Promovimi i ndërmjetësimit nëpërmjet amendimit të kuadrit ligjor që mundëson referimin në ndërmjetësim dhe shmang pengesat që dalin nga ligji apo parashikime të tjera që e dekurajojnë palën ti referohet ndërmjetësimit. Prandaj, duhet të përshtaten ligji për ndërmjetësimin me ndryshimet në kodet përkatëse të procedurës civile, administrative, kodin e Punës, Kodin e Familjes, Ligji për shoqëritë tregtare.

Fazat e ndërmjetësimit

- Hapja,
- Mbledhja e çështjeve për ndërmjetësim,
- Punohet me konfliktin,
- Zgjidhja e konfliktit,
- Marrëveshja.

a) Faza e hapjes së seancës për ndërmjetësim

- Krijohet një atmosferë e ngrohtë, transparente dhe tolerante- bisedime të shkurtra me palët,
- Sqarohen pritshmëritë,
- Sqarohen rregullat e procedurës, negociohet dhe dakordësohen (vullneti i palëve, konfidencialiteti, vet-përgjegjshmëria, ndarja institucionale e ndërmjetësimit nga gjykata dhe procedura të tjera),
- Vizibiliteti (flete informimi, banner, udhërrëfyes etj):
- Aspekte të veçanta të çështjes nuk duhet të harrohen,
- Palët kanë pikat e tyre në vëmendje,
- Mund të trajtohen situata komplekse,
- Palët fokusohen në udhërrëfyesin për hapat dhe jo në konfrontimin ndërmjet tyre,
- Krijohet konfidenca në ndërmjetësim dhe progresi është i dukshëm.

b) Mbledhja/identifikimi i çështjeve

- Vendoset agjenda,
- Ndahet informacioni bazë,
- Mblidhen pikat /çështjet që duhet të negociohen,
- Vendosen prioritetet.
- E njëjta kohë në dispozicion të palëve

c) Të punohet me konfliktin

- Faza e eksplorimit : duhet të aftësohet secila palë që të kuptojë interesat e saj dhe të palës tjetër,

- Është një fazë kyç në procesin e ndërmjetësimit e cila lejon shfryrjen e emocioneve, explorimin e interesave dhe nevojave themelore,
- Lejon hapësirën për të marrë dijeni dhe njohjen ndërmjet palëve,
- Progresi dhe suksesi i fazës së eksplorimit varet nga ndërmjetësi i cili udhëheq bisedën në mënyrë të sjellshme, duke përdorur aftësitë e tij të larta të komunikimit dhe të ndërhyrjes në momente kyçe për zhvillimin e ndërmjetësimit.

d) Zgjidhja e konfliktit

- Identifikohet variante të ndryshme në një kohë të shkurtër; shikohet për alternativa/ thyhen bllokada qëndrimet bllokuese të palëve/ kreativitet dhe fantazi,
- Vlerësimi - analizohen pikat e forta, dobësitë, mundësitë, dhe rreziqet.
- Fokusohet tek interesat dhe jo pozicionet ligjore,
- Kërkohen kritere objektive,
- Krijimi i opsioneve të reja: mbi cilat baza mendohet/ imagjinohet arritje e një marrëveshje? Çfarë do të ishte një zgjidhje e drejtë për palët?
- Fokusohet tek zgjidhjet dhe jo tek problemet,
- Negocimi.

e) Akt-Marrëveshja

- Qëllimi është që të arrihet një marrëveshje ekonomike, por edhe nga pikëpamja sociale dhe psikologjike e pranueshme,
- Mundësia e suksesit: të jetë e drejtë, efiçente, e arsyeshme dhe zgjidhje e qëndrueshme,
- Fitojnë të dyja palët.

Ndërmjetësimi në Shqipëri, sfidat dhe arritjet

Ligji Nr.10 385, datë 24.2.2011" Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" ka pësuar shtesa dhe ndryshime me Ligjin Nr. nr. 81/2013 dhe Ligjin Nr. 26/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" duke përafuar këtë ligj me direktivën 2008/52/EC "Mbi disa aspekte të

ndërmjetësimit në çështjet civile dhe tregtare", me nr. CELEX 32008l0052.

Ndërmjetësimi si mjet alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve nuk ka gjetur akoma deri më sot një zbatim të gjerë, çka i dedikohet mungesës së mjaftueshme të ndërgjegjësimit të publikut për njohjen e këtij ligji, mungesës së njohjes nga ana e organeve ligjzbatuese të përmbajtjes së këtij ligji, procedurës dhe avantazheve që sjell, mungesës së vullnetit nga ana e gjyqësorit për ta referuar ndërmjetësimin tek palët ndërgjyqëse si një mjet efektiv për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet tyre i cili merr fuqi me anë të urdhrit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv që lëshon gjykata, parashikim ky i Nenit 23 të Ligjit Nr. 10 385, datë 24.2.2011" Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" , i ndryshuar dhe Neneve 510 gërma "e" dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile.

Në këto kushte është gjykata ajo që mund të deklarojë pavlefshmërinë e ndërmjetësimit në bazë të Nenit 24 të ligjit sipas të cilit:

1. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, në kuptim të këtij ligji, është e pavlefshme kur:

- a) realizohet nga persona që nuk janë ndërmjetës të licencuar dhe të regjistruar sipas këtij ligji;
- b) mosmarrëveshja, sipas ligjit, duhet zgjidhur vetëm në rrugë gjyqësore;
- c) përmban detyrime të vlerësueshme në të holla dhe nuk formulohet me shkrim;
- ç) përmban detyrime për subjekte që nuk kanë marrë pjesë në ndërmjetësim;
- d) ka simulim dhe, për konfliktin real, ka shkaqe pavlefshmërie.

2. Gjykata, përveç rasteve të parashikuara në Kodin Civil për pavlefshmërinë e veprimeve juridike, mund ta konstatojë marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim të pavlefshme edhe kur arrin në përfundimin se ajo nuk respekton rendin publik në Republikën e Shqipërisë.

Prandaj një fushatë ndërgjegjësimi dhe njohje e publikut për përdorimin e ndërmjetësimit si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve /konflikteve ndërmjet palëve është e domosdoshme me qëllim që palët të kenë njohurinë dhe sigurinë mbi zbatimin e marrëveshjes dhe se është gjykata ajo që në një seancë të vetme verifikon në fund me një seancë të vetme plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të marrëveshjes së ndërmjetësimit me praninë e ndërmjetësit.

Nga ana tjetër ligji parashikon procedurat disiplinore kundrejt ndërmjetësit nëse verifikohet se nga ana e tij janë shkelur rregullat ligjore në fuqi. Një procedurë e tillë disiplinore mund të fillojë me sinjalizimin e gjykatës ose të palës së interesuar se ndërmjetësi ka vepruar në kundërshtim me detyrimet e tij që parashikohen në ligj.

Ndërmjetësimi nxit dialogun ndërmjet palëve, i afron ata në njohjen më të mirë të aspekteve të ndryshme të mosmarrëveshjes së tyre, i detyron që të njohin ligjin dhe sigurisht të përfitojnë edhe edukim ligjor. Kështu ata do të ofrojnë vetë zgjidhjen e tyre që kënaq në përpjesëtim të drejtë edhe kërkesat e tyre. Por e gjitha kjo kërkon një kohë të caktuar, sepse palët duhet të arrijnë pjekurinë në njohjen dhe diskutimet e tyre duke dialoguar nën drejtimin e ndërmjetësit si lehtësues. Këtë detyrim ligjor që Kodi i Procedurës Civile ia ka njohur gjyqtarit me zhvillimin e veprimeve të pajtimit, ky i fundit nuk ka asnjë mundësi ta përmbushë për shkak të mbingarkesës, kohës dhe infrastrukturës së papërshtatshme. Prandaj është e nevojshme ndërhyrja ligjore në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin e Familjes ku është përsëri gjyqtari ai që zhvillon seancën e pajtimit, që duhet të zhvillohet paraprakisht para një ndërmjetësi, para se çështja të shkojë gjykatë.

Aktualisht ka një stok të lartë të dosjeve gjyqësore të prapambetuara të pashqyrtuara që përkthehen në mos efience të sistemit gjyqësor dhe mohim të drejtësisë për qytetarët. Harta gjyqësore e miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, e bën imediate ndërhyrjen ligjore për të orientuar palët drejt ndërmjetësimit të çështjeve të tyre gjyqësore, sepse ul kostot e shqyrtimit të një mosmarrëveshje, shkurton në maksimum kohën për gjetjen e një zgjidhje përfundimtare që përbashkon palët dhe për më tepër ka një ndikim të madh në uljen e konfliktualitetit në shoqërinë shqiptare.

Ligji për ndërmjetësimin është pothuajse i plotë por që nuk është shoqëruar me amendimet e nevojshme të kodeve respektive që lehtësojnë referimin e çështjeve për ndërmjetësim. Mentaliteti i shoqërisë shqiptare kërkon që ndërmjetësimi duhet të parashikohet i detyrueshëm, para se çështja të shkojë në gjykatë. Ndërmjetësimi duhet të jetë i detyrueshëm për ato çështje për të cilat Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar praktikën gjyqësore, e kanë njehsuar atë dhe nuk do të cetojnë në raste të ngjashme.

Por këto raste të unifikimit të praktikës gjyqësore nuk njihen nga palët dhe jo gjithmonë janë të informuar nga avokatët lidhur me këto qëndrime.

Njëkohësisht as noteri nuk ka dijeni për qëndrimet e unifikuara të Gjykatës Lartë, prandaj detyra e atyre që do të informojnë për ndërmjetësimin është kjo - njohja e palëve me praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë për çështje të caktuar dhe pse palët duhet ti drejtohen ndërmjetësit. Prandaj do të përpigemi të japim disa nga këto raste që përfshijnë konfliktet ndërmjet personave privatë dhe jo me shtetin.

P.sh

Pjesëtimi i pasurisë,- kur nuk ka dakordësi ndërmjet palëve, duhet ti shpjegohet praktika e ndjekur dhe se si ka vendosur gjykata. Faza e parë e pjesëtimit është e njëjtë dhe formale për caktimin e pjesëve ideale dhe pronës që do të pjesëtohet, ama faza e dytë se kujt i mbetet prona për ta përdorur fizikisht apo se si mund të ndahet, duhet të negociohet pranë ndërmjetësit dhe marrëveshja përfundimtare mund të noterizohet.

Shpërblimi i dëmit për largim të padrejtë nga puna - Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (KAGJL) ka vendosur që shpërblimi duhet të jetë i plotë dhe të bëhet mbi bazën e pagës bruto. Ky është një rast që mund të përdoret nga punëdhënësit privat të cilët duan të minimizojnë dëmet e pësuar nga largimet. Nuk ka akoma një qasje nga punëdhënësi publik.

Shpërblimi i dëmit nga vonesa e përmbushjes së detyrimit kontraktor - KALGJ vlerëson se sanksioni i vendosur në kontratën e furnizimit për vonesat në ekzekutimin e detyrimeve, përbën një kusht penal vlerësues, që nuk mund të kërkohej së bashku me ekzekutimin e detyrimit. Pas shlyerjes së detyrimit, nuk mund të vijojë gjykimi për kushtin penal vlerësues.

Shpërblimi i dëmit pasuror dhe jopasuror nga aksidentet - Rastet e shpërblimit të dëmit me Byronë e Sigurimeve. Autori është gjithmonë i interesuar që të ndërmjetësojë masën e shpërblimit, dhe kur është rasti edhe ankimin, gjithmonë kur nuk ka një çështje penale.

Përmbushja e detyrimeve monetare që rrjedhin nga kontratat - Ka një numër të lartë të padive nga kompanitë celulare për mospërmbushje të detyrimeve kontraktore, ku individët janë dakord të paguajnë detyrimin por jo kamatat dhe interesat.

Çështjet familjare mbi caktimin e kujdestarisë, të drejtën e takimit apo të drejtën e lëvizjes së fëmijëve jashtë shtetit me njërin prind janë çështje që mund të zgjidhen me ndërmjetësim, sepse kërkohej që të negociohet

me palët, të orientohen dhe të afrojnë pozicionet e tyre.

Çështjet tregtare janë më të predispozuara për ndërmjetësim meqenëse biznesi vlerëson humbjen dhe rrisqet në një mënyrë tjetër qasjeje, ku të dyja palët shmangin gjykatën dhe ofrojnë alternativat e zgjidhjes.

Çështjet e sipërmarrjeve në ndërtim përbëjnë një numër shumë të lartë të çështjeve gjyqësore civile sot, çka bën të domosdoshme ndërhyrjen ligjore për referim e detyrueshëm në ndërmjetësim. Ka raste ku i gjithë gjykimi i çështjes varet nga raporti i ekspertit kontabël apo vlerësues i pasurisë, i cili përbën një provë shkencore dhe merret në konsideratë nga gjykata si prova bazë.

Bibliografia

- Fjalori Drejtesise, botimi dyte 2011, Njazi Uka;
- Kanun of Lekë Dukagjini.
- Ismet Elezi; Konferenca Kombetare e Ndermjetesimit; Tradita dhe Praktika e Ndermjetesimin ne Ceshtjet penale, April 2005;
- Ligji nr 10385 date 24.02.2011, ndryshuar datë 17.95.2018
- Kodi European I Ndermjetesve
- Kodi Shqiptar I Etikes se Ndermjetesve
- Statuti I DHKN, Shqiperi
- The Statute of NCM , Albania;
- CEPEJ(2007)14European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ);
- COUNCIL OF EUROPE COMMITTEE OF MINISTERS Recommendation No. R (99) 19 of the Committee of Ministers to member States concerning mediation in penal matters (Adopted by the Committee of Ministers on 15 September 1999 at the 679th meeting of the Ministers' Deputies);
- COUNCIL OF EUROPE COMMITTEE OF MINISTERS Recommendation Rec(2001)9 of the Committee of Ministers to member states on alternatives to litigation between administrative authorities and private parties (Adopted by the Committee of Ministers on 5 September 2001 at the 762nd meeting of the Ministers' Deputies);
- CEPEJ(2007)14 European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ) Guidelines for a better implementation of the existing recommendation concerning family mediation and mediation in civil matters, Strasbourg, 7

December 2007; • DIRECTIVE 2008/52/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 21 May 2008 on certain aspects of mediation in civil and commercial matters;

- Convention on the Recognition of Divorces and Legal Separations adopted by Law No. 109/2012 for the accession of the Republic of Albania;
- Güler İslamoğlu, Deniz Börü, Melek Birsal, Boğaziçi Journal Vol. 22, no. 1-2 (2008);
- Ivan Pupolizio, The ideologies of mediation between theory and practice."

Roli i prokurorit në gjykimin e çështjeve familjare

Erida VISOÇI

Prokurore

*Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë
të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë*

Hyrje

E drejta familjare përfaqëson një ndër fushat më të rëndësishme të së drejtës dhe të shoqërisë për vetë ndjeshmërinë që ka si dhe për pasojat e drejtëpërdrejta që shfaq në jetën e përditshme. Megjithatë një sferë tërësisht private, Kodi i Familjes ka parashikuar shprehimisht mundësinë e ndërhyrjes së prokurorit në raste të veçanta ku përveç interesave privatë ka mundësi të cënohet edhe interesi publik. Referuar kuadrit ligjor, prokurorit i është krijuar mjedis i përshtatshëm për të ndërhyrë në mbrojtje të martesës, fëmijëve dhe familjes në tërësi. Në përpjekje për të kuptuar zbatimin e të së drejtës së prokurorit për të ndërhyrë në këto procese me natyrë civile, lind nevoja për t'iu referuar praktikës gjyqësore. Rezulton që përfshirja e prokurorit në të tilla çështje është pothuajse inekzistente. Për këtë arsye përveç problematikave të praktikës jo shumë të pasur vendase, në këtë punim janë paraqitur edhe disa nga praktikat më të mira ndërkombëtare. Më shumë sesa një trajtim teorik dhe rrëfyues mbi rolin e prokurorit, kjo temë është një përpjekje për përballje me detyrimeve e të drejtave ligjore dhe zbatueshmërisë së tyre.

1. Nevoja e përfshirjes së prokurorit në gjykimin e çështjeve familjare

Figura e prokurorit është parë gjithmonë e lidhur ngushtësisht me procesin penal. Kjo përveç perceptimit të shoqërisë lidhet edhe me

përshtetues të funksioneve të prokurorisë si ushtruese e ndjekjes penale, si dhe përfaqësuese e akuzës në gjyq në emër të shtetit.¹ Natyrshëm shtrohet pyetja a është e nevojshme përfshirja e prokurorit në gjykimin e çështjeve familjare dhe nëse po deri në ç'masë. Përgjigja është pozitive dhe justifikohet nga natyra e të drejtës familjare. Një e drejtë që përveç karakterit privat, mbart në vetvete edhe interesin publik. Do të ishte i pajustificueshëm një qëndrim plotësisht pasiv i shtetit duke marrë parasysh angazhimin përballë qytetarëve² për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre. Më poshtë trajtohen rastet kur prokurori legjitimohet të ndërhyjë në rregullimin e çështjeve që në pamje të parë duken se i përkasin plotësisht sferës së të drejtës private, por që në thelb të tyre ndërthuren interesa publikë. Në këtë përballje, një rëndësi e veçantë i duhet kushtuar këtij të fundit për vetë efektin dhe pasojat që sjell ndaj shoqërisë si e një e tërë. Duke e përcaktuar si një subjekt të legjitimuar, ligjvënësi ka synuar që të parandalojë problematikat faktike dhe të mbrojtje familjen. Kështu, në rastin e kundërshtimit të lidhjes së martesës, qëllimi i legjislatorit është që të parandalohet, përpara lidhjes, pavlefshmëria e martesës në të ardhmen, pra të mbrohet martesa nga rastet e

¹ Neni 148 i Kushtetutës.

² Në bazë të Kushtetutës dhe instrumentave ndërkombëtarë.

pavlefshmërisë.³ Ndërkohë që në rastet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet prindërore, prokurori ka detyrimin të mbrojë interesin më të lartë të të miturit. Parim ky që në proceset ku përfshihen të miturit, shndërrohet në një detyrim për shtetin ta garantojë atë praktikisht përmes organeve të tij, qofshin këto gjykatat apo prokuroritë. Parë në këtë këndvështrim, më shumë sesa një mundësi për të marrë pjesë në këto gjykime është një detyrim për prokurorin, që në çdo moment që bie në dijeni të rrethanave të cilat rrezikojnë martesën, jetën familjare apo interesin më të lartë të fëmijës, t'i drejtohet gjykatës për të parandaluar pasojat në të ardhmen.

1.1. Historiku i rolit të prokurorit në çështjet familjare

E drejta familjare në vendin tonë është rregulluar nëpërmjet një sërë aktesh që kanë pësuar ndryshime në mënyrë që t'i përshtaten zhvillimeve shoqërore. Kodifikimi i mirëfilltë i rregullimit të marrëdhënieve familjare filloi me miratimin e Ligjit "Mbi Kodin e Familjes të Republikës Popullore të Shqipërisë".⁴ Sipas këtij Kodi prokurori legjitimohej të kërkonte pavlefshmërinë e martesës⁵ në rastet kur martesa ishte lidhur :

- pa hirin e bashkëshortëve të ardhshëm;⁶
- nga një person që nuk ka mbushur moshën e parashikuar⁷ (burri që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe gruaja që nuk ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç);
- gjatë vazhdimin të një martese të mëparshme të njerit prej bashkëshortëve;⁸
- nga një person që vuan nga një sëmundje psikike ose ka zhvillim mendor të metë

që e bën të paaftë të kuptojë qëllimin e martesës;⁹

- midis personave që kanë lidhje gjaku, krushqie apo birësimi;¹⁰
- pa patur qëllim që bashkëshortët të jetojnë si burrë e grua.¹¹

Në lidhje me marrëdhëniet prindërore, prokurori mund të kundërshtonte njohjen e amësisë,¹² si dhe mund të kërkonte heqjen e të drejtës prindërore¹³ kur vlerësohej se prindi shpërdoronte të drejtën prindërore ose tregonte pakujdesi të rëndë në ushtrimin e detyrave të tij. Gjithashtu, prokurorit i njihej e drejta e kërimit të pushimit të adoptimit për shkaqe të rëndësishme¹⁴ si dhe e paraqitjes së protestës ndaj vendimit të gjykatës për adoptimin.¹⁵

Ky rregullim ishte në fuqi deri në miratimin e Kodit të ri në vitin 1982,¹⁶ i cili ka qenë i aplikueshëm deri në hyrjen në fuqi të Kodit aktual të Familjes në vitin 2003. Kodi i 1982 e përmend vetëm në dy dispozita të tij prokurorin. Neni 21 i këtij kodi parashikon mundësinë e prokurorit për të kërkuar pavlefshmërinë e martesës në rastet kur bashkëshortët nuk kanë mbushur moshën e parashikuar në ligj,¹⁷ kur ekziston një martesë e mëparshme, kur ekziston lidhja e gjakut, krushqisë, birësimi apo në rast se njëri nga bashkëshortët ndodhet në gjendje të tillë mendore që nuk e lejon të kuptojë qëllimin e martesës.¹⁸ Nuk mund të lihej pa parashikuar edhe kërkesa për heqjen e të drejtës prindërore,

³ Arta Mandro, Çështjet familjare e martesore dhe barazia gjinore, Roli i gjykatës, fq. 71.

⁴ Ligj Nr.4020, datë 23.6.1965. Më parë këto marrëdhënie rregulloheshin me anë të ligjeve të ndryshme si Ligji "Mbi Martesën", Ligji " Mbi raportet në mes prindërve dhe fëmijëve", Ligji " Mbi Adoptimin" dhe Ligji "Mbi Kujdestarinë".

⁵ Neni 35 Kodi i Familjes 1965.

⁶ Neni 26 po aty.

⁷ Neni 27 po aty.

⁸ Neni 28 po aty.

⁹ Neni 29 po aty.

¹⁰ Neni 30 po aty.

¹¹ Neni 31 po aty.

¹² Neni 69 po aty.

¹³ Neni 112 po aty.

¹⁴ Neni 98 po aty.

¹⁵ Neni 93 po aty.

¹⁶ Ligj Nr.6599, datë 29.6.1982 Kodi i Familjes i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

¹⁷ Gruaja 16 vjeç dhe burri 18 vjeç.

¹⁸ Neni 15 Kodi i Familjes 1982.

e cila mund të ushtrohej nga prokurori në rastet kur prindi :

- shpërdoron të drejtën prindërore;
- tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj;
- me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve.¹⁹

Rezulton se historikisht roli i prokurorit ka qenë i lidhur me pavlefshmërinë e martesës dhe heqjen e të drejtës prindërore. E njehta qasje është ruajtur edhe në legjislacionin aktual, i cili ka në fokus të tij martesën dhe interesin më të lartë të fëmijës.

1.2. Rastet e legjitimitetit të prokurorit sipas Kodit aktual të Familjes

Kodi i Familjes parashikon shprehimisht në dispozitat e tij mundësinë e ndërhyrjes së prokurorit. Kjo mundësi shtrihet në momente të ndryshme të jetës familjare duke filluar që nga lidhja e martesës, e deri te heqja e përgjegjësisë prindërore. Rastet e legjitimitetit të prokurorit në gjykimin e çështjeve familjare mund t'i ndajmë në dy kategori kryesore :

- Rastet që lidhen me martesën
- Raste që lidhen me marrëdhënien prindërore

Legjitimimi në rastet që lidhen me martesën vjen si rrjedhojë e faktit se martesa është institucioni ku plekset dhe gjen mishërim përputhja e interesit publik me intersin dhe autonominë e privatëve.²⁰

Ligjvënësi i ka njohur të drejtën prokurorit që të mund të kundërshtojë lidhjen e martesës, por në mënyrë të kushtëzuar vetëm në rastet kur ai legjitimohet të kërkojë pavlefshmërinë e martesës.²¹ Martesa nënkupton një deklaram vullneti që ka për qëllim krijimin e marrëdhënies martesore, në të njëjtën kohë përbën edhe një nga burimet e lindjes së marrëdhënies familjare.²² Lidhja e martesës kërkon ekzistencën e nevojshme të disa kushteve thelbësore.²³ Në

kundërshtimin për lidhje martesë prokurorit i duhet të përcaktojë ekzistencën e rrethanave faktike apo juridike që bien në kundërshtim me këto kushte. Këtu përmendim rastin kur martesa nuk është lidhur publikisht²⁴; martesa është lidhur pa pasur qëllim për jetë të përbashkët si burrë e grua²⁵; martesa e lidhur nga personi që nuk ka mbushur moshën²⁶; martesa e lidhur gjatë vazhdimin të një martesë të mëparshme²⁷; martesa e lidhur mes personave që kanë lidhje gjaku, krushqie, kujdestarie apo birësimi.²⁸

Njësoj siç mund të kundërshtojë, prokurori mund edhe të ndihmojë në lidhjen e martesës. Një mundësi e tillë parashikohet në nenin 29 të Kodit, i cili parashikon se lidhja e martesës mund të bëhet edhe pa shpallje kur ekzistojnë shkaqe me rëndësi. Të drejtën për të kërkuar diçka të tillë para gjykatës e ka në mënyrë ekskluzive prokurori i vendit ku do lidhet martesa.

Në cilësinë e mbrojtësit të interesit publik, prokurori njihet si subjekt që mund të kërkojë pavlefshmërinë absolute të martesës.²⁹ Për legjitimimin e prokurorit nuk kërkohet që ky të vërtetojë ekzistencën e një interesi për ngritjen e kësaj padie,³⁰ duke qenë se është përfaqësues i interesit publik dhe ai mund të vihet në dijeni për shkakun e pavlefshmërisë nga subjekte të tjerë që nuk legjitimohen personalisht për të kërkuar pavlefshmërinë.

Rast tjetër i legjitimitetit të prokurorit është edhe kundërshtimi i njohjes vullnetare të amësisë apo atësisë në rast se, nga të dhënat që figurojnë në aktet e gjendjes civile, rezulton pavërtetësia e amësisë dhe atësisë së deklaruar.³¹

Rëndësi të veçantë paraqet edhe përfshirja në listën e subjekteve që legjitimohen për të kërkuar heqjen e përgjegjësisë prindërore.³² Në këtë kërkesë duket sikur prokurori rikthehet në habitatin e tij duke qenë se humbja e përgjegjësisë prindërore parashikohet tashmë si një dënim plotësues nga Kodi ynë Penal.³³ Duhet

¹⁹ Neni 76 po aty.

²⁰ Arta Mandro, E drejta familjare, fq.198.

²¹ Neni 20, prg.3 Kodi i Familjes.

²² Sonila Omari, E drejta familjare, fq. 45.

²³ Nenet 7-15 të Kodit të Familjes.

²⁴ Neni 42 Kodi i Familjes.

²⁵ Neni 36 Kodi i Familjes.

²⁶ Neni 39 Kodi i Familjes.

²⁷ Neni 41 Kodi i Familjes.

²⁸ Neni 40 Kodi i Familjes.

²⁹ Neni 45 Kodi i Familjes.

³⁰ Sonila Omari, op.cit. fq. 149.

³¹ Neni 173 Kodi i Familjes.

³² Neni 228 Kodi i Familjes.

³³ Neni 30, prg.1, pika 10 Kodi Penal.

përmendur se pavararësisht ngjashmërive, heqja dhe humbja e përgjegjësisë prindërore janë dy masa të ndryshme. Humbja e përgjegjësisë prindërore renditet ndër sanksionet më të rënda të parashikuara nga Kodi për prindin që gjatë ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, dëmton interesin e fëmijës.³⁴

Tjetërsimi i pasurisë së të miturit përbën një tjetër moment ku legjitimohet ndërhyrja e prokurorit, por vetëm kur ai merr dijeni që veprimi juridik është kryer pa u marrë autorizimi i gjykatës.³⁵

Gjithashtu, kërkesa për vendosjen në kujdestari mund paraqitet në gjykatë edhe nga prokurori.³⁶ Ky legjitimim vjen si rrjedhojë e angazhimit të shtetit për të garantuar mbrojtje të veçantë për fëmijët.³⁷ Mendoj se më shumë se një e drejtë, kjo duhet kuptuar si një detyrim i prokurorit, në momentin që ai merr dijeni se ndodhemi në një nga rastet e përcaktuara në nenin 263 të Kodit të Familjes për vendosjen në kujdestari.³⁸

Së fundi, mund të themi që prokurori legjitimohet të ndërhyjë sa herë që ndodhemi para rasteve kur përfshihen interesa publikë. Si të tillë mund të konsiderojmë mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit, mbrojtjen e familjes si dhe të martesës, detyrime këto që rrjedhin nga ligji themelor i shtetit.

1.3. Kufijtë e veprimtarisë së prokurorit në gjykimin e çështjeve familjare

Pasi trajtimit të rasteve kur legjitimohet prokurori të ndërhyjë në gjykimin e çështjeve familjare është e nevojshme të trajtohen edhe se cilët janë kufijtë e kësaj veprimtarie. Duke mbajtur gjithmonë në konsideratë faktin se ndërhyrja e prokurorit justifikohet nga interesi publik edhe kufijtë e veprimtarisë së tij duhet të

jenë në përputhje me këtë qëllim. Ndërhyrja e prokurorit nuk duhet konsideruar si një ndërhyrje e shtetit (organit shtetëror) në jetën private të individëve. Në një vend si Shqipëria, e cila ka vuajtur për vite me rradhë ndërhyrjen e shtetit në jetë private, pa u garantuar as standardet minimale për një jetë private dhe familjare të qetë, vendosja e kufijve paraqitet sa e rëndësishme aq edhe problematike.

Siç do trajtohet dhe më poshtë, në praktikë nuk ndeshemi me abuzim të prokurorit në masën e ndërhyrjes. Në përcaktimin e kufijve, prokurori duhet gjithmonë të vlerësojë interesat në konflikt. Në mënyrë që të arrijë në zgjedhjen më të mirë të mundshme, atij i duhet të peshojë dhe të vlerësojë faktorë të ndryshëm, duke filluar që nga nevojat e shoqërisë e deri te ato të individëve.

2. Vështrim krahasues mbi rolin e prokurorit në të drejtën familjare

Për shumë kohë roli i prokurorit në mjedisin e çështjeve civile është konsideruar si një ndërhyrje në thelb formale, dhe e pa shoqëruar nga një qëllim i veçantë me natyrë substanciale. Ndërkohë që me kalimin e kohës, roli i prokurorit i është nënshtruar një procesi evolutiv duke u konsideruar tashmë si një bartës i interesave socialë, që ka kryesisht detyrimin për të mbrojtur interesat e të miturit në proces.³⁹ Në një vështrim të përgjithshëm të legjislacioneve të ndryshme europiane, vihet re që pothuajse të gjitha e pranojnë përfshirjen e prokurorit në çështje të së drejtës familjare.

Mundësia për të ndërmarrë veprime ligjore për të kërkuar pavlefshmërinë e martesës nga ana e prokurorit njihet në vende si: Austria, Franca, Hungaria, Luksemburgu, Polonia, San Marino, Sllovenia, Spanja dhe Turqia.⁴⁰ Gjithashtu, ai mund të kundërshtojë atësinë apo birësimin në Çeki, Hungari, Lihtenshtein, Luksemburg, Poloni,

³⁴ Sonila Omari, op.cit. fq. 399.

³⁵ Neni 234, prg.2 Kodi i Familjes.

³⁶ Neni 264/ç Kodi i Familjes.

³⁷ Neni 54, prg.1 i Kushtetutës.

³⁸ Prindërit janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore; prindërit kanë vdekur, nuk njihen, janë shpallur si të pagjetur; u është hequr përgjegjësia prindërore; u është hequr zotësia për të vepruar apo çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata.

³⁹ Valentina Sellaroli, Il ruolo del PM nelle procedure civili minorili, Associazione Italiana Magistrati per i Minorenni e la Famiglia, fq.2.

⁴⁰ Report by András Zs. VARGA, Role of the public prosecution service outside the field of criminal justice, fq. 6, https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/ccpe/conferences/2008/4rev_2008_CCPEBu_reportV_argas_en.pdf.

Portugali, Rusi, Sllovakia dhe Slloveni.⁴¹ Rol tjetër i tij është ai i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve që njësor si në vendin tonë parashikohet edhe në legjislacionin e Çekisë, Hungarisë, Luksemburgut, Portugalisë, Rosisë, Sllovakisë, Spanjës dhe Turqisë.⁴²

Pra, njihet dhe aplikohet gjërësisht ndërhyrja e prokurorit në çështjet civile, kryesisht ato familjare, dhe për të kuptuar më mirë funksionimin e saj duhet të referojmë në praktikën gjyqësore.

2.1. Standardet ndërkombëtare të përfshirjes së prokurorit

Nevoja e përfshirjes së prokurorit në të drejtën familjare është trajtuar me shumë kujdes edhe nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në raste të lidhura me nenin 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.⁴³ Në të tilla raste prokurori vepron në emër të interesit publik apo interesit më të lartë të fëmijës.⁴⁴ Rastet më të shpeshta kanë të bëjnë me investimin e prokurorit për të kundërshtuar atësinë pas kalimit të afatit kohor gjatë të cilit ati mund të fillojë vetë këtë procedurë. Në këto procedime, prokurori ka detyrimin të gjejë një balancë të drejtë mes interesit të atit të prezumuar dhe interesave të shoqërisë, duke marrë parasysh rrethanat të tilla si mosha, situata personale apo sjellja e palëve të përfshira.⁴⁵

Më poshtë do trajtojmë disa nga rastet e trajtuara nga GjEDNj dhe standardet e vendosura prej saj. Në rastin *Yildirim kundër Austrisë*⁴⁶, Gjykata u shpreh se refuzimi i prokurorit për të kundërshtuar atësinë e fëmijës nuk përbën shkelje të nenit 8 të Konventës kur identiteti i atit biologjik të fëmijës mbetet i paqartë. Aplikanti, shtetas turk ishte martuar me një shtetase austriake duke e ditur që ajo ishte shtatzënë dhe fëmija nuk ishte i tij. Pak kohë më vonë ata ndahen faktikisht, por duke qënë se ligjërisht

ishin akoma të martuar ai prezumohet at i vajzës dhe regjistrohet si i tillë në regjistrin e lindjeve. Duke mos u treguar i kujdesshëm të kundërshtojë prezumimin brenda afatit 1-vjeçar nga lindja⁴⁷, ai i drejtohet prokurorit duke qënë se ai legjitimohet të kërkojë kundërshtimin në çdo kohë. Prokurori i drejtohet nënës së vajzës dhe ajo pranon që ati biologjik i vajzës së saj është një shtetas gjerman. Me anë të letërporosisë pyetet edhe shtetasi gjerman i cili mohon të jetë ati i vajzës në fjalë. Ndodhur në këto kushte prokurori refuzon të bëjë kundërshtimin e atësisë duke qënë se rrezikon që atësia e vajzës të mbetet e papërcaktuar dhe ajo të mos përfitojë nga të drejtat e saj për kujdesin prindëror.⁴⁸ Aplikanti pretendon shkelje të neneve 6 dhe 8 të Konventës.⁴⁹ Në përgjigje të këtyre pretendimeve GjEDNj u përgjigj se është e drejtë balanca e vendosur nga ligji vendas. Është e justifikueshme që pas kalimit të afatit të përcaktuar për kundërshtimin e atësisë së prezumuar të prevalojë interesi i fëmijës mbi atë të aplikantit. Megjithatë prokurori ishte në dijeni të faktit që aplikanti nuk ishte ati biologjik i fëmijës, kundërshtimi i atësisë së prezumuar binte ndesh me interesin më të lartë të fëmijës, për aq kohë sa atësia biologjike ishte e paqartë.

Ky standard i vendosur nga GjEDNj sqaron më së miri se interesi më i lartë i fëmijës është një parim mbizotërues në gjykimin e çështjeve që përfshijnë të miturit. Në vendimin e saj gjykata lejoi një kufizim (nëse mund ta trajtojmë si të tillë) të së drejtës së aplikantit për jetë private dhe familjare. Megjithatë dy prindërit ligjorë konfirmojnë që ati i regjistruar nuk është at biologjik i fëmijës, prokurori në përmbushje të detyrimit të tij për t'i ofruar dhe garantuar mbrojtje interesit të fëmijës vendos të mos veprojë. Ky qëndrim mendoj se është një shembull i mirë që duhet ndjekur në praktikë pasi shfaq prokurorin si një vlerësues substancial

⁴¹ Po aty.

⁴² Po aty.

⁴³ E drejta për jetë private dhe familjare.

⁴⁴ Research Division, The role of public prosecutor outside the criminal law field in the case law of the European Court of Human Rights, fq.12.

⁴⁵ Po aty

⁴⁶ *Yildirim v. Austria* (dec.), no. 34308/96, 19 Oct 1999,

http://www.menschenrechte.at/orig/99_6/Yildirim.pdf

⁴⁷ Siç parashikohej në legjislacionin austriak.

⁴⁸ Përsa i përket detyrimeve të atit.

⁴⁹ E drejta për akses dhe E drejta për jetë private dhe familjare.

të rrethanave duke hequr dorë nga roli formal që zakonisht përshfaq.

Ndryshe nga çfarë vendosi në *Yildirim kundër Austrisë*, GjEDNj bën një tjetër interpretim në rastin kur ndodhemi në kushte të ndryshme. Kështu, në *Paulik kundër Sllovakisë*⁵⁰, gjykata u shpreh se refuzimi i prokurorit për të kundërshtuar atësinë përbënte cënim të të drejtës për jetë private dhe familjare të aplikantit, pasi vajza e tij ishte pothuajse 40 vjeç, ishte e pavarur prej tij dhe nuk kishte kundërshtime në lidhje këtë çështje. Në këtë çështje aplikanti kërkonte kundërshtimin e atësisë së deklaruar në 1970 duke qenë se tashmë kishte një provë të re që ishte analiza e ADN-së. Prokurori refuzoi diçka të tillë duke qenë se atësisë ishte deklaruar më parë me një vendim gjyqësor dhe sipas tij nuk mund të kërkonte rishikimin e këtij vendimi. GjEDNj unanimisht vendosi se kemi shkelje të neneve 8 dhe 14 të Konventës, pasi ndryshe nga rastet e atësisë së përcaktuar me vendim gjyqësor, në rastin e prezumimit të atësisë prindërit kishin mundësi të ndërmerrnin hapa ligjore për kundërshtim. Sipas gjykatës ky trajtim i diferencuar nuk ishte i arsyeshëm dhe proporcional me qëllimin e legjislacionit.

Ndonëse në pamje të parë duket sikur GjEDNj ndryshoi qëndrim në këtë çështje, edhe në këtë rast gjykata i është përmbajtur dhe ka theksuar më tej qëndrimin që prokurori duhet të bëjë një vlerësim në thelb të rrethanave dhe pasojave që mund të sjellë kundërshtimi i atësisë. Kur kemi të bëjmë me fëmijë madhorë ndryshon balanca e interesave dhe kemi një "përballje" mes të barabartëve.

Një tjetër rast ku kërkohej ndërhyrja e prokurorit për kundërshtimin e atësisë është *Darmon kundër Polonisë*.⁵¹ Rasti në fjalë ka të bëjë me kërkesën për kundërshtimin e atësisë së prezumuar. *Darmon*-it pas zgjidhjes së martesës, i caktohet nga gjykata detyrimi për të paguar për mbajtjen e fëmijëve. Pas kësaj aplikanti ngre

dyshime lidhur me atësinë e tij dhe i drejtohet prokurorit për të kërkuar kundërshtimin e atësisë. Duke qenë se pretendimi i tij bazohej thjesht në një bindje të brendshme dhe nuk u paraqit asnjë provë përballë prokurorit, ky refuzoi të kërkojë kundërshtimin e atësisë. Çështja u paraqit para GjEDNj për shkelje të nenit 6 dhe 8 të Konventës. Gjykata e vlerësoi këtë kërkesë të papranueshme. Në arsyetimin e saj ajo u shpreh se për aq kohë sa aplikanti nuk e bazoi kërkesën e tij në substancë, refuzimi i prokurorit për të kërkuar kundërshtimin e atësisë nuk mund të konsiderohet një ndërhyrje në të drejtat e aplikantit. Vajza e aplikantit e konsideronte veten vajzë biologjike të tij, duke refuzuar t'i nënshtrohet testit të ADN-së apo testeve të tjera gjenetike. Sipas gjykatës janë pikërisht refuzimi i saj dhe i nënës së vajzës që pengojnë aplikantin të ligjërojë realitetin biologjik.

Në këtë rast, megjithëse trajtohet atësia e një fëmije madhor, gjykata e vlerësoi të rregullt refuzimin e prokurorit për kundërshtimin e atësisë. Kjo qasje justifikohet së pari me faktin se nuk mundet që prokurori të paraqesë kërkesa për kundërshtim atësie të cilat bazohen thjesht në dyshime të kërkuësve. Në të tilla kushte prokurori do të shndërrohej në një urë përcjellëse të kërkesave të aplikantit, ndërkohë që roli i tij është në funksion të interesave publikë e të mbrojtjes së familjes. Së dyti, as prokurori e as gjykata nuk mund të urdhërojnë që fëmija t'i nënshtrohet testit të ADN-së për të provuar pretendimet e aplikantit. Marrja e një prove të tillë duhet lënë tërësisht në vullnetin e personit, për aq kohë sa marrja e saj eventualisht mund të përkeqësojë gjendjen psikologjike dhe ligjore të fëmijës. Shteti përmes organeve të tij, pra prokurorisë, nuk mund të investohet për të provuar fakte që sjellin humbjen e atësisë ligjore si dhe vendosjen e fëmijës përballë një realiteti të ndryshëm nga ai çka fëmija beson. Prokurori duhet të luajë rolin e garantuesit dhe jo të hetuesit të marrëdhënieve familjare të krijuara.

⁵⁰ *Paulik v. Slovakia*, no. 10699/05, ECHR 2006-XI, [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"fulltext":\["paulik"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER"\],"chamber":\["CLIN"\],"itemid":\["001-77327"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{).

⁵¹ *Darmon v. Poland* (dec.), no. 7802/05, 17 Nov 2009, <http://caselaw.echr.globe24h.com/0/0/poland/2009/11/17/darmon-v-poland-96055-7802-05.shtml>.

Ka sisteme në të cilat prokurori mund të veprojë për njohjen e atësisë në emër të atit.⁵² Në të tilla raste prokurorit i duhet të bëjë një vlerësim paraprak të balancës mes interesit të atit biologjik, interesave të fëmijës dhe të familjes.

Një çështje e tillë është paraqitur para GjEDNj kundër Polonisë. Në çështjen *Rózański kundër Polonisë*⁵³ fëmija megjithëse kishte lindur ndërkohë që nëna bashkëjetonte me aplikantin, u njoh me vonë dhe u regjistrua si fëmijë i partnerit të ri të nënës. Ndodhur në këto kushte aplikanti në bazë të ligjit vendas nuk mund të kërkonte njohjen e atësisë pa bashkëpunimin e prokurorit, i cili refuzoi të ndërmarrë veprime për këtë rast. Në qëndrimin e saj GjEDNj u shpreh se në refuzimin e kërkesës së aplikantit, prokurori duhet të merrte në konsideratë interesin e atit biologjik, të fëmijës dhe familjes së krijuar. Autoritetet në vendimarrjen e tyre nuk kanë dashur të trazojnë marrëdhënien ligjore mes fëmijës dhe partnerit të ri të nënës. Ky qëndrim është i kritikueshëm pasi nuk ka një ekzaminim të interesave të përfshira, si dhe nuk është sqaruar ndikimi i njohjes së atësisë së aplikantit në interesat e fëmijës. Gjykata vendosi se ka shkelje të nenit 8 të Konventës, edhe duke patur parasysh marzhin e vlerësimit që i njihet shtetit, ky i fundit kishte dështuar në detyrimin për t'i siguruar respektimin e jetës familjare aplikantit.

Ky vendim i GjEDNj tregon se nuk mund të flasim për kriteret e paracaktuara në çështjet familjare. Vlerësimi i rasteve kur prokurori ka detyrim të veprojë e kur jo përcaktohet nga rrethanat konkrete të çështjes dhe interesat e përfshirë në të. Në rastin e mësipërm, vlerësimi vetëm i raporteve të ligjore e faktike të krijuara mes fëmijës dhe partnerit të ri të nënës nuk është i plotë. GjEDNj është shprehur në praktikën e saj se Konventa me anë të nenit 8 detyron që çdo shtet të ketë për qëllim ribashkimin e prindërve

natyrorë me fëmijët e tyre.⁵⁴ Është e kuptueshme që vetëm lidhja e gjakut nuk është e mjaftueshme për të mundësuar këtë ribashkim, por në çdo rast duhet bërë një vlerësim dhe baraspeshim i plotë i të gjithë interesave të përfshirë.

2.2. *Problematikat e praktikës gjyqësore vendase*

Gjatë kërimit për të gjetur praktikë gjyqësore dhe për të shtruar problematika në lidhje me rolin e prokurorit në gjykimin e çështjeve familjare vërehet një mungesë e theksuar e ndërhyrjes së prokurorit.

Më sipër u përmendën rastet kur prokurori legjitimohet të ndërhyjë në proceset familjare, të cilat rrallë herë përdoren nga prokurori. Një mungesë e tillë vjen edhe për shkak të orientimit thellësisht penal të prokurorit, duke i mohuar vetes pjesëmarrjen në procese me natyrë civile.

Në praktikën gjyqësore vendase rasti tipik i ndërhyrjes së prokurorit lidhet me shpalljen e martesës. Në bazë të nenit 29 të Kodit të Familjes⁵⁵ prokurorit i njihet e drejta që të kërkojë në gjykatë lidhjen e martesës pa u shpallur. Prokurori që të vërë në lëvizje gjykatën për lidhjen e martesës pa shpallje, duhet të marrë dijeni e të bëhet kërkesë nga bashkëshortët e ardhshëm.⁵⁶ Doktrina ka trajtuar si shkaqe me rëndësi për lidhjen e martesës pa shpallje rastet që kanë të bëjnë me lidhjen e martesës së dëshmitarëve apo bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe shkaqe të tjera që vlerësohen si të rrezikshme nëse realizohet lidhja e martesës me shpallje.⁵⁷ Ndërkohë që në praktikë prokurori ndërhyr dhe kërkon lidhjen e martesës pa shpallje për shkaqe të cilat nuk përputhen me trajtimin dhe kuptimin që i jep doktrina kësaj dispozite.

⁵² Research Division, The role of public prosecutor outside the criminal law field in the case law of the European Court of Human Rights, fq.12.

⁵³ *Rózański v. Poland*, no. 55339/00, 18 May 2006, [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{\"itemid\":\"001-75423\"}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{\).

⁵⁴ *Görgülü v. Germany* no.74969/01, 26 Februar 2004,

[http://hudoc.echr.coe.int/eng#{\"fulltext\":\"gorgulu\",\"documentcollectionid2\":\"GRANDCHAMBER\",\"CHAMBER\"},\"itemid\":\"001-61646\"}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{\).

⁵⁵ Me kërkesë të prokurorit të vendit ku lidhet martesa e bashkëshortëve të ardhshëm, gjykata, për shkaqe me rëndësi, mund të vendosë që martesa të lidhet edhe pa u shpallur.

⁵⁶ Arta Mandro, Çështjet familjare e martesore dhe barazia gjinore, Roli i gjykatës, fq. 72.

⁵⁷ Po aty.

Kështu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka lejuar lidhjen e martesës pa shpallje duke arsyetuar : *"Meqënëse së shpejti pritët që ajo të fillojë një punë të re në kompaninë "Steward HealthCare", me detyrë analiste klinike (e konfirmuar në e-mailin e saj oferta për punën e re), e ka të pamundur qëndrimin e saj të metejshëm në Shqipëri, për këtë arsye ka prenotuar edhe biletën pranë një agjensie ajrore."*⁵⁸

Duke mos u mjaftuar me kaq Gjykata shprehet se qëllimi i kësaj martese është edhe përshpejtimi i dokumenteve për bashkim familjar në Amerikë. Qëllimi i martesës i përshkruar në këtë mënyrë, bie ndesh me trajtimin e gjithëpranuar se martesa mbart në vetvete synimin për një jetesë të përbashkët si dhe realizimin e interesave të përbashkët personale. Mendoj se gjykata nuk mund dhe nuk duhet të pranojë një argument të tillë si shkak për lidhjen e martesës pa shpallje. Po në këtë vendim në përpjekje për të arsyetuar vendimmarrjen, Gjykata shprehet se : *"... meqënëse edhe gjendja shëndetësore e nënës së shtetasit E.T., shtetasja B.T. është rëndë për shkak të diagnostikimit të sëmundjes së saj "kancer në gjirin e djathtë", dhe së shpejti ajo do i nenshtrohet një trajtimi kurues në spitalin amerikan në Boston..."*.

Duket se një praktikë e tillë ndiqet në mënyrë konstante nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër pasi në një tjetër rast të mëparshëm kjo gjykatë ka vendosur të lejojë lidhjen e martesës pa shpallje për arsyen e vetme se : *"Personi i interesuar, A.B., jeton dhe punon prej vitesh në Amerikë. Me datë 15/02/2013 ai do të largohet nga Shqipëria për në Amerikë dhe për këtë arsye, ka blerë biletën me datë kthimi 15.02.2013, e cila u paraqit si provë gjatë gjyqimit."*⁵⁹

Të njejtin qëndrim e gjejmë në një sërë vendimesh. Për gjykatën konsiderohet e mjaftueshme që : *"shtetasi E.P. punon dhe jeton në Michigan SHBA. Për këtë arsye ai nuk mund të qëndrojë për 10 ditë, afat ky për shpalljen e martesës, për shkak se shtetasi E.P., kohën që ka në dispozicion e ka shumë të shkurter, si rezultat i*

*vazhdimet të marrëdhënies së punës që ka, ka prenotuar dhe largimin e tij me linjë ajrore."*⁶⁰

Në një rast kur kemi të bëjmë me lidhjen e martesës me shtetas të huaj gjykata arsyetoi lejin e lidhjes së martesës pa shpallje pasi : *"kërkuesi J.L. është me banim në Australi dhe për arsye të ngutshme pune ai nuk mund të qëndrojë në Shqipëri deri në plotësimin e afatit 10 ditor për shpalljen e kërkesës për lidhjen e martesës."*⁶¹

Pavarësisht faktit se inkurajohet ndërhyrja e prokurorit në gjykimin e çështjeve familjare, kjo ndërhyrje duhet të jetë në funksion të mbrojtjes së familjes, martesës dhe fëmijëve dhe jo të përdoret si një mekanizëm për të shmangur afatet e zakonshme ligjore.

Duket sikur gjykata vihet në funksion të korrigjimit të neglizhencës së treguar nga bashkëshortët e ardhshëm duke pranuar kërkesën e prokurorit pa kërkuar justifikim dhe arsyetim të shkakut të rëndësishëm. Ky praktikë nuk ka evoluar aspak, pasi të njejtin qëndrim mban gjykata edhe në një vendim më të vonshëm në kohë.⁶²

Ndonëse në pamje të parë duket sikur shpallja përbën një element formal që nuk ndikon në vetë marrëdhënie, duhet përmendur fakti se mungesa e shpalljes sjell edhe pasoja. Qëllimi i shpalljes është që duke bërë publike lidhjen e martesës të mundësojë mbikqyrjen e rregullsisë së saj, goditjen e saj nga të tretët, nga ata që legjitimohen si kundërshtues të lidhjes së martesës sipas Kodit të Familjes.⁶³ Në momentin kur lejohet lidhja e martesës pa shpallje, kufizohet kjo e drejtë e subjekteve të legjitimuara për kundërshtimin e lidhjes së martesës.

Nga vendimet gjyqësore, vërehet se as prokurori e as gjykata nuk i kushtojnë vëmendje elementit *shkak i rëndësishëm* të përcaktuar nga dispozita ligjore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër që ka praktikë më të pasur lidhur me këtë çështje në vendimin e saj lejon lidhjen e martesës pa shpallje me arsyetimin si më poshtë : *"Martesën*

⁵⁸ Vendim nr. 51-2014-1393 datë 22.4.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁵⁹ Vendim nr. 51-2013-637 datë 21.2.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁶⁰ Vendim nr. 51-2012-7861, datë 26.10.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

⁶¹ Vendim nr. 51-2012-6942 datë 19.9.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁶² Vendim nr. 51-2014-441, datë 15.2.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁶³ Arta Mandro, Çështjet familjare e martesore dhe barazia gjinore, Roli i gjykatës, fq. 75.

të dy bashkëshortët e ardhshëm kërkojnë ta lidhin para nëpunësit të gjendjes civile. Por duke qenë se kjo e fundit nuk mund të realizohet, pasi nuk është bërë nga ana e tyre kërkesa për shpalljen e martesës 10 ditë para, ata bazuar në nenin 29 të Kodit të Familjes i janë drejtuar Prokurorisë së Rrethit Shkodër, ku dhe kanë depozituar dokumentacionin provues.”⁶⁴ I njeiti arsyetim gjendet edhe në vendimin nr. 6994 të vitit 2012, ku gjykata pranon se : “... duke qenë se kërkuessit A.B. dhe S.L., me datë 26/09/2012 do të largohen nga Shqipëria, martesa nuk mund të realizohet pasi nuk është bërë nga ana e tyre kërkesa për shpalljen e martesës 10 ditë para. ... Në rastin konkret kërkuessit A.B. dhe S.L. kanë prerë biletën për në shtetin italian dhe për këtë arsye nuk mund të qëndrojnë në Shqipëri deri në plotësimin e afatit 10 ditor për shpalljen e kërkesës për lidhjen e martesës.”⁶⁵

Një tregues i mëtejshëm i rolit tërësisht formal të prokurorit, i cili shfaqet thjesht si përcjellës i kërimit të bashkëshortëve të ardhshëm është edhe fakti se në praktikën gjyqësore gjenden raste ku prokurori heq dorë duke kërkuar pushimin e çështjes.⁶⁶ Heqja dorë tregon që prokurori nuk ka bërë vlerësimin e duhur të situatës ose vetë bashkëshortët e ardhshëm kanë kërkuar të mos vazhdojnë më me këtë kërkesë.

Moment tjetër i rëndësishëm është edhe pavlefshmëria e martesës. Në një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶⁷ trajtohet kërkesa e prokurorit për pavlefshmëri të martesës. Në këtë vendim gjykata shprehet lidhur me legjitimitimin e prokurorit si më poshtë :

“ paditësi ka legjitimitet pasiv për të mbrojtur një interes të drejtëpërdrejtë të ligjshëm për të rivendosur një të drejtë publike të shkelur referuar natyrës së posaçme që ka martesa si bashkëjetesë ligjore dhe pasojave shoqërore që ka.”

Prokurori në këtë çështje kërkoj pavlefshmërinë si martesë fiktive, të martesës së një shtetasi shqiptar me një shtetase italiane megjithëse kjo martesë kishte përfunduar me vdekjen e

shtetasit shqiptar. Arsyetimi i gjykatës në këtë vendim paraqet shumë probleme. Ajo e pranon kërkesën e prokurorit për pavlefshmërinë e martesës me këtë arsyetim :

- së pari, “ fiktiviteti konstatohet nga diferenca e madhe e moshës...”;
- së dyti, “ të pyetur me cilësinë e dëshmitarëve në lidhje me praninë e tyre gjatë lidhjes së martesës dëshmitarët nuk u shprehën të sigurt nëse kanë qenë të pranishëm dhe së nënshkrimet i përkisnit atyre apo jo për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.”
- së treti, “ në bazë të aktit të ekspertimitpër nënshkrimin e përfaqësuesit të pushtetit vendor nuk është dhënë një konkluzion definitive nëse është apo jo nënshkrim i tij.”
-

Ky vendim edhe njëherë tregon që investimi i prokurorit në çështjet familjare bëhet për realizimin e interesave ngushtësisht personale të palëve në proces apo të personave që nuk legjitimohen për të ngritur të tilla kërtime. Një praktikë e tillë bie ndesh me qëllimin e legjitimit të prokurorit në këto çështje si garant i interesit publik.

Gjatë kërimit të praktikës gjyqësore vendase⁶⁸ rezulton vetëm një rast i ndërhyrjes së prokurorit në çështje familjare lidhur me marrëdhëniet prindërore në Gjykatën e Pogradecit. Me kërkesë të prokurorit kjo gjykatë ka vendosur : “Heqjen e përgjegjësisë prindërore të të paditurve F.C. e L.S., për rritjen dhe edukimin e fëmijës së tyre A.C.”⁶⁹ Duke qenë se rezulton i publikuar vetëm dispozitivi dhe jo pjesa arsyetuese e vendimit është i pamundur vlerësimi i rolit të prokurorit në këtë çështje. Ajo çka vihet re është se gjykata në vendimin e saj i ka hequr përgjegjësinë prindërore të dy prindërve, por nuk ka rregulluar situatën e mëtejshme të fëmijës.

⁶⁴Vendim nr. 51-2012-6425, datë 30.7.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁶⁵Vendim nr. 51-2012-6994, datë 26.9.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁶⁶Vendim nr. 53-2011-1054, datë 7.5.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁶⁷Vendim nr. 277, datë 09.2.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁶⁸ Në <http://gjykata.gov.al>.

⁶⁹ Vendim nr. 43-2013-666, datë 24.6.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Në rastet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet prindërore roli i prokurorit duhet të ishte shumë aktiv duke marrë parasysh faktin se në të tilla marrëdhënie është prezent interesi më i lartë i fëmijës.

3. Përfundime

Problematika kryesore që ndeshet në trajtimin e kësaj çështje është praktika gjyqësore vendase. Mungesa e praktikës e bën të pamundur zhvillimin dhe zgjidhjen e shumë problematikave të shtruara para nesh.

Ndërkohë që për kuadrin ligjor mund të themi që është i plotë dhe i ofron prokurorit lehtësitë e nevojshme për të vepruar sa herë që e shih të nevojshme se duhet mbrojtur interesi publik apo interesi më i lartë i të miturit.

Ajo çka vihet re është se prokurori është pasiv dhe nuk i kushton vëmendjen e duhur gjykimit të çështjeve familjare. Nga hulumtimi i praktikës gjyqësore nuk rezultojnë të ketë ndonjë rast që prokurori të ketë kundërshtuar lidhjen e martesës.

Pjesëmarrja e tij është e kufizuar vetëm në rastet e kërkesave për lidhjen e martesave pa shpallje. Në këto kërkesa ai vihet në lëvizje me kërkesën e bashkëshortëve të cilët kërkojnë lidhjen e martesës në mënyrë të menjëhershme pa iu nënshtruar procedurës së shpalljes e cila është e lidhur me afatin 10 ditor. Në këto raste prokurori nuk i kushton rëndësi vlerësimit të rrethanave dhe shndërrohet në një përcjellës të kërkesës së bashkëshortëve të ardhshëm. Por, problematik paraqitet fakti se edhe gjykata tregohet indiferente dhe nuk bën dallimin mes rëndësisë së shkaqeve. Duke pranuar çdo shkak si të rëndësishëm, duket sikur lidhja e martesës pa shpallje ka thjesht kërkesa procedurale e jo substanciale.

Do të ishte shumë e vlefshme përgatitja e udhëzuesve për prokurorët, gjyqtarët dhe zbatuesit e tjerë të së drejtës në lidhje me kuptimin dhe aplikimin sa më të drejtë të kësaj dispozite duke dhënë referenca për përcaktimin e shkaqeve me rëndësi. Si masë e fundit, ndoshta

do të shërbente edhe ndërhyrja e ligjvënësist në këtë dispozitë për të vënë theksin të rëndësia e shkaqeve dhe aplikimi i kësaj dispozite vetëm nëse ndodhemi para disa rrethanave dhe kushteve të veçanta. Kjo do ndikonte që si prokurori ashtu edhe gjyqtari të thellohen në rëndësinë që paraqet rasti.

Në lidhje me rolin e prokurorit në marrëdhëniet prindërore vihet re një qëndrim pasiv i prokurorit. Siç u trajtua dhe më lart, rezultojnë vetëm një vendim gjyqësor që ka vendosur heqjen e përgjegjësisë prindërore me kërkesë të prokurorit. Gjatë kërkimit edhe në vendimet penale, nuk rezultojnë të jetë kërkuar nga prokurori e të jetë dhënë nga gjykata si dënim plotësues humbja e përgjegjësisë prindërore. Nuk është e qartë nëse kjo vjen se ky dënim plotësues është parashikuar relativisht vonë⁷⁰ dhe kërkon kohën e nevojshme për t'u kuptuar dhe aplikuar apo sepse nuk konsiderohet i përshtatshëm për rastet në fjalë.

Mendoj se prokurori duhet t'i kushtojë një vëmendje të veçantë çështjeve familjare, pasi familja përbën organizimin më të rëndësishëm të shoqërisë. Pavarësisht se Kodi i Familjes në të shumtën e rasteve nuk parashikon detyrueshmërinë e prokurorit për ndërhyrje, mendoj se do ishte shumë i vlefshëm një rol më aktiv i prokurorit. Duke iu referuar standardeve më të mira europiane dhe praktikës së GjEDNjroli i prokurorit nuk duhet kufizuar vetëm në ndjekjen penale por ai duhet të vendosë veten edhe në pozita sociale në mbrojtje të marrëdhënieve më të mira shoqërore e familjare.

Në përfundim, mendoj se sugjerimet për ndryshime apo përmirësime konkrete të legjislacionit do të jenë të nevojshme në momentin kur praktika gjyqësore të fillojë të lëvrojë në këtë fushë dhe të shfaqë problematikat e para.

BIBLIOGRAFIA

▪ Literatura

⁷⁰Shtuar pika 10 me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012 Humbja e përgjegjësisë prindërore.

MANDRO Arta, E drejta familjare, Shtëpia botuese Emal, Tiranë 2009

MANDRO Arta, Çështjet familjare e martesore dhe barazia gjinore, Roli i gjykatës, Botimet Morava, Tiranë 2015

OMARI Sonila, E drejta familjare, Botimet Morave, Tiranë 2010

SELLAROLI Valentina, Il ruolo del PM nelle procedure civili minorili, Associazione Italiana Magistrati per i Minorenni e la Famiglia, maggio 2004

Research Division, The role of public prosecutor outside the criminal law field in the case law of the European Court of Human Rights, Council of Europe, March 2011

VARGA András Zs., Report, Role of the public prosecution service outside the field of criminal justice, Bureau of the Consultative Council of European Prosecutors, Strasbourg, 5 May 2008

- **Ligje**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë (2003)

Kodi i Familjes i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (1982)

Kodi i Familjes i Republikës Popullore të Shqipërisë (1965)

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

- **Vendime gjyqësore**

Yildirim vs. Austria (dec.), no. 34308/96, 19 Oct 1999.

Paulik vs. Slovakia no. 10699/05, ECHR 2006-XI.

Görgülü vs. Germany no.74969/01, 26 Feb 2004.

Rozanski vs. Poland no. 55339/00, 18 May 2006.

Darmon vs. Poland (dec.), no. 7802/05, 17 Nov 2009.

Vendim nr. 277, datë 09.2.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vendim nr. 53-2011-1054, datë 7.5.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Vendim nr. 51-2012-6425, datë 30.7.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Vendim nr. 51-2012-6942 datë 19.9.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Vendim nr. 51-2012-6994, datë 26.9.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Vendim nr. 51-2012-7861, datë 26.10.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Vendim nr. 51-2013-637, datë 21.2.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Vendim nr. 43-2013-666, datë 24.6.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Vendim nr. 51-2014-441, datë 15.2.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Vendim nr. 51-2014-1393, datë 22.4.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

GJUHËSI-ALBANOLOGJI

The Benefits of a Dual Degree Program in University

Prof. As. Dr Frosina Londo

Prof. As. Dr Kozeta Hyso

Prof. As. Dr Zamira Alimemaj

Department of Foreign Language

Faculty of Humanities

University of Vlora.

frosinalondo@yahoo.it

kozetahyso1@gmail.com

zamiraalimema@gmail.com

Abstract

Today, many universities and schools offer their students the chance to undertake a dual degree program and the specialist explore how students are given the opportunity to earn dual degrees at a number of respected institutions.

Studying for two separate degrees, dual degree programs are usually hosted at two different universities or schools. This is hugely beneficial not only from an academic perspective, but the chance to study at a different institution and in a different country is an invaluable opportunity for participants to immerse themselves into a new culture – something which is particularly useful if they then want to work abroad.

Double degrees offer broad education and involve a high level of demand, organization and commitment. All this is highly appreciated even by companies which see a double degree eases the access to the labor market. The teaching load will be higher and the duration will be longer than in standard degrees.

Key words: *Concept of double degree, professional career, benefits in studying in dual programs.*

Concentration capacity, creative thinking and broad multidisciplinary knowledge

When studying a double degree students will gain concentration capacity, creative thinking

and broad and multidisciplinary knowledge of the area you choose. To this we add the encouragement of entrepreneurship in many of these degrees including training in marketing and business. Double degrees revalue degrees that at first have no optimal employment opportunities as they complement them with a practical education oriented to results.

They also offer the option of avoiding to make the decision between two areas of your interest and although they last longer, they will always demand less time than studying two consecutive degrees. Moreover if you choose this last option you shall bear in mind that there are subjects from different degrees that overlap and therefore opting for a double degree is the most intelligent choice.

Taking two programs means you have a deeper understanding of your chosen subjects. You can also gain richer points of view of subjects that seem different but are actually related. Examples are a double degree in business management and finance or computer science and business. It means the deeper Understanding of Specific Subjects

Our case study

While being aware that having a double degree increases our values, meaning better employment opportunities we launched a double degree program in tourism and management in

University of Vlora when we know that many companies demand employees to have more generalist skills without abandoning specific competencies. For the last year that we applied it in our own audiences we see that students specifically had such kind of beneficiary sources such as:

Wider Networks Studying two programs gives you a wider network, from fellow students to lecturers, experts, researchers. Networking skill is important in the professional world, and it will give added benefits in the future

Getting Multiple Soft Skills While studying and finishing dual degrees requires you to develop various soft skills, such as time management, reading comprehension, analytical skill, and discipline. They are as useful as practical or specialist skills to thrive in workplaces.

As a dual degree student, they express that the opportunity to get involved in twice as many projects and initiatives at university, and to meet people from across the two different programs is very rewarding. With experience and connections from two disciplines, dual degree students can benefit from more job opportunities, higher salaries and more specialized roles. While asked them for benefits they say that the degree has made them a more versatile candidate who can adapt to the needs of a demanding and changing job market, through the different approaches that my two subjects offer. The students become more open-minded to take new directions when it comes to the professional choices. They can create an interesting career across a variety of roles that complement each other.

If students are unsure what subject they want to study at university and want to keep their options open so they don't have to make a choice, a dual degree might not be right for them. It will open up more opportunities, but it can overwhelm if they have doubts about your choices.

Advantages of Dual degree

A dual degree education brings in several advantages. It provides more career options than a single degree would have provided. It could also provide the students with a broader base of competencies than a single course and therefore prepare them better for taking on jobs or for starting up on their own.

Further, many of the innovations happen within the boundaries of individual disciplines and dual degree education is, therefore, likely to facilitate research and innovation. It is hoped that universities will implement this policy at speed and scale for the policy to achieve its intended goals.

The policy carries several implications when it comes to students' readiness for jobs. The starting point of this discourse is to understand why many educated youths are unable to meet employers' expectations or requirements. Is it because they have only one degree with the knowledge they have acquired covering limited areas/ subjects/ disciplines?

If this is the case, the dual-degree policy is the solution. But if the reason for several of the youth not finding jobs has to do with the need for proficiency in the application of knowledge or the need for complementary soft skills, then we might have to look for solutions elsewhere

We will also need to see how employers perceive students who have undertaken two courses simultaneously versus those who have undertaken them sequentially or those who have only undertaken one course. It may take some time before a few dual-degree batches have graduated when we are able to evaluate the impact of this policy initiative comprehensively. Of course, a lot would depend on implementation.

Conclusion

Dual degrees can be a real advantage to those who want to pursue a degree where international experience is key, such as foreign languages, business, political science, economics, finance or sciences.

Taking into consideration a job market that's constantly evolving and increasingly tough, especially for graduates, a dual degree can help you stand out among the crowd.

An alternative to the dual degree structure, which may also help achieve similar goals related to flexibility and multi-disciplinarily could be to widen the scope of multi-disciplinary electives and credit courses within the degree programs themselves. This is an established practice across several international universities and may be an option to be considered going forward.

References

1. Knight, J. (2008). *Joint and double degree programmes: Vexing questions and issues*. Observatory on Borderless Higher Education.
2. Knight, J. (2011). Doubts and dilemmas with double degree programs. *International Journal of Educational Technology in Higher Education*, 8(2), 297-312.
3. Kuder, M., & Obst, D. (2009). Joint and double degree programs in the transatlantic context: A survey report. *Institute of International Education and Freie Universität*.
4. Obst, D., & Kuder, M. (Eds.). (2009). Joint and double degree programs: An emerging model for transatlantic exchange. Institute of International Education. [This book is not available in Biola library].
5. Nickel, S., Zdebel, T., & Westerheijden, D. F. (2009). Joint Degrees in European Higher Education. Obstacles and opportunities for transnational programme partnerships based on the example of the German-Dutch EUREGIO. *Centre for Higher Education Policy Studies (CHEPS)*.

Foreign Languages as a key crucial element in understanding business - cultural differences

Prof. As. Dr Kozeta Hyso

Department of Foreign Language
Faculty of Humanities
University of Vlora.
kozetahyso1@gmail.com

Prof. As. Dr Frosina Londo

Department of Foreign Language
Faculty of Humanities
University of Vlora.
frosinalondo@yahoo.it

Abstract

Foreign Languages in the global economy

Good business communication helps get the job done well, on time and on budget. These communicators are highly valued in today's complex and competitive business world, and are often earmarked for promotion and increased responsibility.

Nowadays global economy and businesses cannot ignore the importance of foreign languages communication. Businesses are finding that it is in their best interest to learn about national, cultural and ethnic groups they need to communicate with to grow their businesses. Knowledge of language nuances and local customs are important to that growth as a misstep can cause a lost sale or a delayed project.

It must be simple and easily understood, a rule often overlooked by managers and team members. This is especially important when preparing a document, speech or presentation that is a game-changer for the company. Simple and concise language wins over language that is obtuse and hard to understand.

Key words: *Foreign languages, keys of communication, business knowledge, business deal.*

English and Italian as business communication.

Numerous companies use English and Italian languages within the workplace, despite being franchises into different countries but even because of a bulk of their business / services or productions is conducted in the international market where English is dominance and Italian languages is specific for spreading and shipping in world market.

English and Italian entered the workplace along with the global hi-tech boom in Albania and specifically in Vlora .

English for international communication will be simple, plain, and regular in their linguistic forms and structures, socio- culturally neutral in their interactional strategies. Suggest them to use such English, avoiding two-word verbs and difficult structures in doing business with non-native people, its purpose being to get the speaker's meaning across to the interlocutor.

Italian also would accommodate any varieties as far as they are comprehensible to the educated users of any varieties, native or not. It will contribute to create, maintain, and develop the international standards of both of them in response to the growing demand for a means of international communication.

First of all, the communicative competence of the EIL users would presuppose two kinds of knowledge-knowledge of the world in general and specialized knowledge in their professional or academic fields that are acquired through education and professional or academic development. They will upgrade EIL users' linguistic, discourse, sociolinguistic and strategic competencies. EIL users are assumed to have sufficient knowledge of the structure of the language and profession-related vocabulary items; they are expected to have good knowledge of organization of discourse in terms of cohesion and coherence; they should have enough strategic knowledge to enhance communication; and they need to have broad and denominator-like basic commonsense assumptions (universal or pan-human socio-cultural knowledge) to be shared with other people. These assumptions are acquired through education and experience, but education and experience of individuals are varied and so is the knowledge. What makes it difficult is the fact that these assumptions are heterogeneous, inconsistent, and even contradictory. Nevertheless we need and do communicate internationally as well as intranationally.

The use of EIL among professionals and scholars presupposes the users' knowledge of the chosen field of specialization for successful communication. This professional and/or academic knowledge is by nature international and crosses the boundary between native speakers and non-native speakers. These people learn both languages to use them for specific purposes, not for general purposes nor for mere socialization. While the unfair reality of having native speakers and non-native speakers of English for international communication may be reduced in these global communities of professionals and specialists, it may create the similar distinction of specialists and laymen, thus not helping increase more general intelligibility.

An overview of function of both languages in local business in Vlora city.

During these last decades the need for learning both English and Italian languages is remarkably increased but beside it there is a special need for them in specific purposes mostly for business. Nowadays in Albania there is a rapid development of the different professional qualification courses. Training ensures participants improving communication skills, professional reading and writing, expanding vocabulary and perceiving specific professional skills in both languages. Each training is detailed

and built specially for the Albanian professionals. English and Italian for business will be defined as ancillary to entrepreneurs and business people in the proficiency of both language skills which they need for their business and in everyday life. They've been developed into an international languages, been taught and learnt everywhere around for many years. Today's businesses and management are quite complex due to the globalization and to the fact that in a company there might be several people from several different backgrounds and variety cultures. But still, I would say that the most important thing in order to manage well is to Communicate and have the need for communicate well to each other and most importantly have an effective intercultural communication between co-workers. This is why the management today must ensure that they are understanding and being understood across cultural boundaries. Multiculturality and worldwide contacts are a possibility for learning together and working together globally.

A lot of our students find themselves in business enterprises using professionally and fully flexible both languages while maintain their own local business but not only them but also the employed students in variety of tourism and call centered local enterprises.

Considering the great number of language learners with various objectives in their using language and difference among them, determination and consideration of true attitudes in teaching and learning English and Italian for Specific Purposes gain vital importance. Thus this lead a more restricted area of language teaching in general concept of English as an International Language, namely English for Specific Purposes, which enables the learner to focus on necessary input which is needed for his/her vocation or job. "As English gathers momentum as the main language of international communication, it is perceived as the language of career opportunity, so the pressure grows for teaching to be more directly employment-related."

At the same importance is also Italian language due to the true fact that Italian business and enterprises are spreaded all over the world.

Moreover, along with the increasing focus on learners needs, both languages for Specific Purposes is classified under two categories as English for Academic Purposes and English for Occupational Purposes, Italian for Academic Purposes and Italian for Occupational Purposes.

Simple case study.

Our students working for an Italian company which located in our city with their productions and shipping all over the regions and overseas countries coped several problems in communication and concepts unless having a good knowledge in English and Italian languages for specific business purposes.

The Intercultural management problem: When thinking about all the cultural differences mentioned above and acknowledge the situation; The Albanian Company ordered some stuffs from Italy in their strict deadlines, ordering dates and expectations that the goods will be delivered on time. The manager told to two of our employees to make sure that the orders are done and delivered. The employees contacted the persons in Italy made example were order and agreed on the deadlines, due dates of the payments and delivery dates. Everything seems well. But when the delivery date came, no goods were delivered or even sent from Italy yet, even we in Albania already had promised the goods to be in the boutique for customers. The manager in Italy blamed the two employees for not doing their task well and contacted the people in Italy. getting the same chain of events happened often always something fast late from the deadline, phone meetings were late, and if there was a meeting organized in Italy or Albania, it didn't go well. All of such kinds of misconception are pointed out clearly in learning specific programs of languages for specific purposes.

Multiculturality and worldwide contacts are a possibility for learning together and working together globally." This is why the first solution would be for a company is doing business abroad and or with intercultural staff, the priority would be for the management to decide to give intercultural training for the employees in order to understand the differences and similarities and most of all the Business etiquettes from the other countries. I am sure that the role of the intercultural manager is not an easy one, but it does offer many a different challenge that must be met in order for the human elements of organizations to succeed. I would say after the intercultural training for the employees and managers the next step would be to learn how to show respect and courtesy and also tolerance towards the other culture. Trying to understand the different ways of working and not to think that "My way is the right way". In my intercultural management problem, our manager should have realized that the concept of time is

different in Italy and maybe tell the employees to order the good 3 weeks in advance in order not to be late then just to make the same mistake every time and blame the Italians. Identifying the problem: If the meetings do not go well when being face-to-face. Maybe meeting through email or through other persons with intercultural knowledge would have been a proper idea. The manager and the employees should always make sure they understand each other. In my case, our manager should let the employees know that please repeat the task I told you and please try to inform the Italians in advance that we really need our goods to be in our country due to the deadline. Confirming the deal written by email, for example, would be a good backup too. Communicating at all levels was bad in our company until we got a new manager who acknowledged the intercultural problems and did what was necessary to make the cooperation better.

Conclusion:

The management of the company suffers and also the business partners etc. In fact after discussing and having some theoretical background to the topic I would say that the main reason for the problem when thinking about the theory part Hofstede's and Halls theories for example were the misunderstanding of concepts like time, space and even business etiquette and the differences. The point that the manager didn't have enough knowledge of managing a company with international partners was most crucial part.

The Intercultural management problem which I discussed above was really common I think nowadays but also very harmful for the company, employees and managers.. As a solution mentioned above in the text I would recommend Intercultural training and flexibility in cultural differences for the whole company from employees to managers. My message concerning the intercultural problem here is that nowadays in our globalizing world it is the most important factor when doing international business to be aware of the countries and cultures around you.

References :

- **Cross-cultural Communication in Business Negotiations.** Liangguang Huang. English Department, Zhenjiang Watercraft College of PLA. Zhenjiang 212003

- Cross – cultural Communication in Business Negotiation 26sht- Pdf (On May 16, 2014) Amit kumar Singh and others published **Cross Cultural Communications in Negotiations** https://www.researchgate.net/.../294085528_Cross_Cultural_Communication_in_Business_Negotiation
- **The Significance of Cross-cultural. Communication in International Business Negotiation.** Tingqin Zhang & Hui Zhou. Daqing Petroleum Institute at Qinhuangdao Cross Negotiations - Theseus <https://www.theseus.fi/.../Deepak%20and%20Sabita%20Thesis%202021>
- While conventional or traditional practices related to **communication** and nego- ... International**business, Cross-cultural negotiation, Culture, Negotiation.**

"Tanusha e Krajlit" si simbol i bukurisë femërore në eposin shqiptar

Dr Alta Haluci

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë

Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë

Phd Çerkezi Edlira

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë

Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë

Abstract

In Albanian aesthetics, one of the well-known models of female beauty is considered Tanusha, one of the female characters in the Kreshnik Cycle, in the earliest popular creation, which was written about by early Albanian researchers and esthetologists, especially on the aesthetic notion of beautiful, and by foreign researchers. In the Kreshnik cycle, the character of Tanusha is seen in a broad view and in relation to people, circumstances and time in one of the most beautiful songs of the cycle, known as "Martesa e Halil". The Kreshnik cycle, being one of the oldest creations in Albanian folklore, through its complexity, has brought us the two best images of the female world, which stand out and have penetrated the world of Albanian female images from time to time, Akjuna and Tanusha. Interpretations on this figure has been numerous, debating and many references, because in most cases it has been seen in all the Kreshnik complexity, which resembles an encyclopedia for culture, history, ethnopsychology, tradition, because it has in its origin a clear plexus of syncretism and animism. The more time passes, the more reports and options, dilemmas, interpretations, doubts and conventionality are added to the characters, approaches, phenomena and phenomena that the song conjures up in itself, due to the

representative nature and ethnopsychological features, social cuts that the song has Christmas. The songs of the cycle of the Kreshniks, apart from being creations with great evidential values of the poetic and aesthetic spirit of the Albanian people, they have in many cases been important and referential for other fields of his, even history, so the approach to " Martesa e Halili" as well as for the other songs, resumes a wider relationship, which could not be avoided and the aesthetics

Hyrje

Në estetikën shqiptare,¹ njëra nga modelet e njohura të bukurisë femërore është konsideruar Tanusha, njëra prej personazhet femra në Ciklin e Kreshnikëve, në krijimin popullorë më të hershëm për të cilën është shkruar nga studiuesit dhe estetologët shqiptarë të hershëm, posaçërisht mbi nocionin estetik të së bukurës², dhe nga studiues të huaj. Në Ciklin e Kreshnikëve, personazhi i Tanushës shihet në një pamje të gjerë dhe në marrëdhënie me njerëzit, rrethanat dhe kohën në njërin nga këngët më të bukura të ciklit, e njohur si "Martesa e Halilit". Sikli i kreshnikëve, duke qenë një nga krijimet më të vjetër në folklorin shqiptarë, përmes kompleksitetit të vet, na ka

¹ Alfred Uçi, "Estetika e folklorit", botoi Akademi e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2007, f.58,

² Frang Bardhi, 1935, Nikollë Filja 1737 etj

sjellë dhe dy imazhet më të mira të botës femrore, të cilat bien në sy dhe kanë depërtuar në botën e imazheve femërore shqiptare kohë pas kohe, Akjunën dhe Tanushën.

Tanusha është një nga prerjet më idilike dhe mjeshtërore të imazhit femërorë, të bukurisë femërore, e cila bie në sy në rrethanat në të cilat ajo jeton, ku dhe personaliteti dhe imazhi i saj zhvillohet. Ajo është vizatuar dhe mishëruar emblematikisht nga rapsodi popullorë, që, edhe pse ka kaluar kohë dhe pse kënga legjendare ka kaluar gojë mbas goje dhe brez pas brezi, ajo ka mbetur si një perlë që shkelqen sado që t'i largohesh. Tanusha është një figurë komplekse, e cila duke qenë e mishëruar në bukuri, cilësi dhe në tipare, për të iu përgjigjur kreshnikut të Jutbinës, Halilit, në gjithë tiparet dhe cilësitë e tij, ajo i ka kapërcyer kohët, pengesat, dukuritë dhe perceptimet e ndryshme estetike, dhe ka mbetur një nga simbolet e bukurisë femrore në traditën shqiptare.

Interpretimet mbi këtë figurë kanë qenë të shumta, debatuese dhe shumë referente, për shkakun se ajo në të shumtën e rasteve është parë në gjithë kompleksitetin kreshnik, i cili ngjan me një enciklopedi për kulturën, historinë, etnopsikologjinë, traditën, sepse ai në origjinën e vet ka një pleksje të qartë sinkretizmi dhe animizmi. Lidhur me këtë çështje, ndoshta do të duhej të reflektonim dhe mendimin e akademik Alfred Uçi, i cili në njërin nga studimet më të gjera mbi folklorin, në veprën me titull "Estetika e folklorit", kur duhet të ndajë mitologjinë në arkaike, klasike dhe mitologjemë (mitologjinë bashkëkohore), lidhur me Tanushëm dhe Ajkunën dhe ndonjë tjetër, të cilat vijnë nga krijimet e lashta, argumenton t'i trajtojmë si "heronjtë e legjendës", por me tipare njerëzore.³ Ky trajtim e bën më angazhues trajtimin e figurës së Tanushës, qoftë si bukuri femërore, por dhe si dimension njerëzorë, të cilën e afron drejt nesh, heqja e "mantelit" të mitologjisë dhe të legjendës.

Sa më shumë kalon koha, po aq më shumë shtohen raportet dhe opsionet, dilemat, interpretimet, dyshimet dhe konvencionaliteti me personazhet, qasjet, dukuritë dhe fenomenet që kënga qerthullon në vetvete, për shkakun e natyrës përfaqësuese dhe tipareve etnopsikologjike, prerjeve sociale që ka kënga

kreshnike. Këngët e ciklit të kreshnikëve përveçse janë krijime me vlera të mëdha evidentuese të shpirtit poetik dhe estetik të popullit shqiptar, ato në shumë raste kanë qenë të rëndësishme dhe referencial dhe për fusha të tjera të tijes, qoftë dhe të historisë, kështu që qasja për "Martesa e Halilit" si dhe për këngët e tjera, rimerr një marrëdhënie më të gjerësuar, të cilat nuk iu është shmangur dot dhe estetika.⁴

Kënga "Martesa e Halilit" është njëra nga këngët më të gjata të Ciklit. Ajo ka rreth 700 vargje dhe ka një kumt vertikal të qëndrueshëm linear. Po ashtu, kënga ka dhe një informacion social⁵, të traditës⁶, të mjedisit⁷, të lidhjeve familjare dhe miqësisë⁸, të besës dhe mikpritjes tradicionale⁹ apo dhe të sjelljes së njerëzve me njëri-tjetrin¹⁰. Qoftë dhe në qasjet studimore estetiko-artistike, ato etnopsikologjike- folklorike, kënga "Martesa e Halilit" rikthen në vëmendje pyetje të shumta, rikonformuese apo me arsyetimin për të zbuluar akoma çështje etnologjike, që tejkalojnë dhe qëllimin e parë të qasjes. Duke qenë një nga epikat specifike shqiptare, marrëdhënia fundamentale e gjithë këngëve reflekton bazën e konfliktit, bazën e "forcave njerëzore- kreshnike", që zbulojnë dhe figurat e kreshnikëve, që me gjasë është "konflikti" i njohur dhe i hapur me sllavët, të ardhur vonë në Ballkan, që me kalimin e kohës u "indeksua" me etnitetin e serbëve, të njohur me emrin "shkau", emër që e hasim në jo pak krijime dhe këngë të epikës legjendare shqiptare.

Në kushtet e një mbijetese të gjatë të kreshnikëve me kundërshtarin e tyre, në

⁴ Alfred Uçi, burim i cituar, fq.143,

⁵ Kahreman Ulqini "Elementë të së drejtës zakonore të epikës heroike legjendare" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987), fq.247-256,

⁶ Xhemal Meçi "Kuvendi si traditë në eposin tonë" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987), fq.257-259,

⁷ Pirro Thomo, "Mjedisi dhe elementët arkitektonikë të epikës legjendare" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987), fq.220-228,

⁸ Yllka Selimi, "Lidhjet familjare dhe miqësore në epikën heroike legjendare shqiptare" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987),

⁹ Selami Tabaku, "Besa dhe mikpritja si dëshmi e lashtësisë dhe origjinalitetit të epikës legjendare" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987),fq.272-276,

¹⁰ Bardhul Prifti, "Përshëndetjet, urimet dhe mallkimet në epikën historike" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987), fq.283-291,

³ Alfred Uçi, burim i cituar, f. 57-58,

konflikt për kullota dhe rrethanash të tjera, që në këngët e Ciklit dalin në mënyrë anësore¹¹, të cilët përbëjnë dhe bazën e studimeve të kohëve tona mbi këtë pasuri të çmuar shqiptare, me të drejtë çështjes së armiqësisë me këta kundërstarë nuk mund t'i shmangesh dot. Në këtë kontekst, ka një pyetje të vazhdueshme, se

"-A kanë jetuar *"n'mni t'njani-tjetrit"* gjithnjë përgjatë shekujve shqiptartë dhe sllavët?

Shmangia në këtë rast e emërtesës "shkau" e bën

më të hapur mundësinë për të komunikuar dhe

për ta bërë më të shtruar reflektimin emocional

për një sqarim të tillë.

Kënga "Martesa e Halilit" është ndër më të hapurat në komunikimin, që lexuesi mund të marrë njoftime të rëndësishme për problemet etike që përgjithësisht në këtë cikël kërkohet përmes elementëve të etnopsikologjisë. E pikërisht për të elementuar besueshëm një çështje të tillë ne kemi marrë një kampion të pranueshëm nga studiuesit e folklorit si më të mirin të këtyre këngëve atë të Nikaj- Mërturit, që titullohet "Martesa e Halilit". Përgjithësisht epika legjendare e vjelur në këtë trevë të veriut të vendit është menduar si më e mira, për shkak dhe të mos- asimilimit të pjesës më të madhe të popullsisë në mysliman. Në pjesën më thelbësore të vetin, Cikli i "Këngëve Kreshnike" ka një substrat të besimit katolik.¹²

Kënga "Martesa e Halilit" ka një epizëm të dukshëm. Ajo nis me refrenin e njohur: "**Lum për ty, o i lumi Zot!**", por dhe rapsodi popullore ka qenë mjaft racional dhe referent për të krijuar një lidhje mirfilli komunikuese me të gjithë dekorin natyrorë, psikologjik, tradicional dhe ruajtjen e këtij niveli komunikimi dhe njoftues. Përgjithësisht në Epikën Legjendare shqiptare ka një koncept kronike, që lidhet me mundësinë e identifikimit të kohës si nocion kohe, të vendit dhe të "temës" për të cilën flitet, në rast se mund ta emërtonim të tillë. Rrëfimi në këngën "Martesa e Halilit" fillon në një zonë të lartë ku banon kryekreshniku Mujë, në një mot të ftohtë dhe me borë të madhe. Në shtëpinë e Mujit, ku nuk mungon as të ngrohti, as vera, as mishi dhe as bujaria, miqtë e tij kanë një

shqetësim, thënë në vargje mjaft sintetikisht: "*Pash një Zot, Mujë, qi t'ka dhanë,/ qysh Halilin s'e martove?/ Janë martue krejt moca (mosha, moshatarët) e tij...*"¹³, me ç'rast njoftohet dhe pika e lidhjes, siç veprohet në të shumtën e rasteve në këto këngë.

Në çdo "syzhe", d.m.th situatë që kapërcen në kohë apo momente të caktuara, këngët kanë një raport të dukshëm me Zotin, herë të kushtrueshëm "*Lum për ty, o i Lumi Zot*", por dhe "*T'kjosim falë, o i Madhi Zot*", ku bien në sy një lloj difference, në një rast "*i Lumi Zot*" dhe në rastin tjetër "*i Madhi Zot*", siç duket kemi të bëjmë dhe me shtresime kohore, që kanë lënë gjurmët e veta dhe në variantin më të besueshëm të Ciklit. Siç dihet, pjesa më e madhe e studiuesëve të ciklit të kreshnikëve, kanë një përafrim mendimi dhe të gjithë shquajnë në vjetërsinë e tij me besimin, një bazë substrative, një sinkretizëm veprues dhe të pranishëm në të gjithë gjerësinë e tij.

Pavarësisht detajeve interesante që zakonisht kanë këngët e kësaj natyre (në "Martesa e Halilit" këto janë të shumtë, pasi kënga ka një subjekt linear të detyrueshëm, ka dhe një lloj njoftimi për marrëdhëniet në një kontekst të gjerë, veçmas me kundërshtarin. Tradita e kuvendit,¹⁴ që në Këngët Kreshnike vjen përmes komunikimit të krye-kreshnikut Mujë apo kuvendi me Tredhet' Agët (tridhjet burrat e mençur, që zakonisht marrin pjesë në kuvendet kreshnike, për të marrë vendime të rëndësishme, *shën. im A.H*), shoqëron të gjithë epikën legjendare, por në këngën "Martesa e Halilit" ajo qendërzon një komunikim vertikal dhe horizontal, pasi kënga shpërshfaq një mjedis tradicional kuvendi, në të cilin flitet për çështje thelbësore, se si është ndërtuar kodi martesorë dhe ai etik në Jutbinë.

Halilin, i cili është dhe protagonist i kësaj kënge, njëri nga kreshnikët e njohur të legjendës, për të cilin ka interpretime të ndryshme, pse ai quhet Halil dhe nuk quhet ndryshe, duke qenë vëllai i Mujit, është i pranishëm në çdo kuvend. Në kuvend flitet hapur dhe cilido ka të drejtë të thotë atë që mendon. Siç dhe shihet në këngën "Martesa e Halilit" në traditën e kreshnikëve martesa ka një rëndësi të madhe. Ajo përbën një

¹¹ Kahreman Ulqini, burim i cituar

¹² Selami Pulaha, "Fshatarësia e lirë e Shqipërisë së Veriut gjatë shek. XV-të-XVIII-të dhe Cikli i Kreshnikëve" ("Çështje të folklorit", vëll. 3), Tiranë 1987, fq.174-189,

¹³ Kënga "Martesa e Halilit", varianti Nikaj Mërtur, fq.69,

¹⁴ Xhemal Meçi, burim i cituar, fq.258,

nevojë për t'u shtuar familja, veçmas me meshkuj, zgjatime të kësaj psikologjie ka dhe sot në trevën e Veriut dhe të Kosovës, është një kod krenarie dhe lidhet mbi kode të forta burrërie dhe zakoni, është nderi i burrit dhe i shtëpisë. Mbi një traditë të tillë është ngritur thuajse dhe kodi i familjes veriore lidhur me martesën, i kodifikuar që herët.¹⁵

Kuvendi që lidhet me çështjen e martesës së Halilit, zbulon thelbin e marrëdhënies që kreshnikët kanë me fundamente të tillë. Në pak vargje, sa tregues, burrërorë, komunikues dhe të thukët, Halili, si protagonist i kuvendit zbulon marrëdhëniet dhe raportet që kreshnikët kanë me martesën, kodin zakonorë dhe etik, por dhe marrëdhëniet më problematike për të cilat është folur dhe shkruar gjatë gjithë kohës. Përpara "furtunës" që miqtë e Mujit i shtrojnë në odën e kuvendit për martesën e Halilit, Halili, një zot i vetes, një nga shtyllat e kullës dhe të fuqisë kreshnike flet vetë. Ai thotë: "*Kah kam vlla e kah kam motër, deksha para, n'u martosha! / Se gjithë gratë e Krahinës ku janë, / e gjithë vashat e Jutbinës ku janë, / bash si motra,*¹⁶ *qi po m'duken. Dheu m'ka mlue e fat s'i qita vedit, / po s'e mora Tanushën e Krajlit. / E un Tanushën vetë e ko' pa, / kur kem' pasë besë me Krajli...*"¹⁷

Kënga sjell një informim jashtëzakonisht të rëndësishëm për të kuptuar jo vetëm rregullin, kodin e qëndrueshëm të kreshnikëve të Jutbinës për martesën dhe miqësinë, por dhe marrëdhëniet historike me krajinë.

Në këngën kreshnike gjendet një informacion i madh, i cili zbulohet situatë pas situatë, ngjarje pas ngjarje, në mënyrën më korrekte, pavarësisht shtresimeve kohore. Vargu "*kur kem pasë besë me Krajli*"¹⁸, është një qëndrim konstant dhe çuditërisht i qëndrueshëm në rrjedhën e zhvillimeve të mëvonëshme historike mes shqiptarëve dhe sllavëve në Ballkan. Kreshniku Halil, na njofton se më herët, se kur nuk bëhet e ditur, kreshnikët me njerëzit e

krajlit kanë pasë besë me njëri-tjetrin. Kur Halili vendos të marrë fjalën në kuvendin e burrave të Jutbinës, të cilët nuk përmenden si "*tredhet ag't*" e Jutbinës, informacioni për një marrëdhënie dhe fundament të tillë shtohet. Halili nuk përmend asnjë armiqësi, as ndonjë hakmarrje, se do të ia rrëmbente Tanushën Krajlit, por kur flet për Tanushën, ai e veçon atë për cilësitë dhe bukurinë e saj, të cilën rapsodi ka arritur ta skalitë me një fuqi magjike, gati hyjnore.

Po të shohim si e përshkruan Halili vajzën e bukur të krajlisë, ka shumë pak vend për t'u marrë me armiqësinë e kreshnikëve me krajinë. Ja si e përshkruan kreshniku Tanushën: "*Gja më t'mirë s'shef njeri nën ket diell! / Vetulla e saj ndrejt si fiskaja, / shteku i ballit, si shteku i malit, / kur merr hana me pranue, / syni i saj si kokrra e qershisë, / e ka qerpikun si krahi i dallndyshës, / ftyra e saj si kuqet molla n'degë, / hunda ndrejt si kalemi i Tushës, / goja e vogël si lulja qi shpërthen, / dhamët e bardhë si gurzit e lumit, / fill mbas shiut kur po i shndritë dielli, / qafa e saj si qafa e pllumbit, / shtati i saj si 'i shtat çetinet, / mish i dorës porsi rremi i shemshirit...*"¹⁹, përmes të cilit nuk gjendet një përshkrim autentik i bukuri së femrore në asnjë nga krijimet popullore shqiptare. Karakterisimi dhe vizatimi i Tanushës nga Halili, është i vetmi në këtë traditë, në këtë mënyrë dhe në gojën e vetë kreshnikut, që nuk gjendet në asnjë traditë të folur dhe të shkruar shqiptare. Vizatimi i Tanushës është autentik, i shtrirë në të gjithë cilësitë, tiparet dhe dukjen e saj. Ajo nuk është një Ajkunë, nuk vizatohet si një kreshnike, por si një femër me tiparet e një njeriu real.²⁰

Nga njëra anë, vetë Halili na njofton se dikurë me krajinë kishin besë, që do të thotë, ata i besonin njëri-tjetrit. Në traditën e Veriut, sanksionuar dhe në librin më të rëndësishëm të jetesës në komunitet, siç është "Kanuni i Maleve"²¹, ka një rregull themeltar dhe shumë funksional deri në kohët e vona, që emërtohet "besa" (*kush jep dhe kush kërkon besë*), me ç'rast, hidhet dritë dhe mbi marrëdhëniet mes kreshnikëve dhe Krajlisë. Ka dhe një fakt tjetër, i cili lidhet me thelbin e martesës së Halilit, që në studimet dhe interpretimet folklorike dhe të

¹⁵ Shih. "Kanuni i Lekë Dukagjinit", kapitulli i miqësisë dhe martesa,

¹⁶ Në Kanunin e Maleve, ka një rregull të ashpër, gjaku rrespektohet për katërqind vjet. Nuk lejojet me dhënë e me marrë. Halili i quan me lidhje gjaku të gjithë gratë dhe vajzat e Jutbinës.

¹⁷ Kënga "Martesa e Halilit", varianti i Nikal Merturit, fq.70,

¹⁸ Prof.dr. Shaban Sinani, "Mitologji në Eposin e Kreshnikëve", botoi Argeta LMG, Tiranë 2006,

¹⁹ Kënga "Martesa e Halilit", burim i cituar, fq.70-71,

²⁰ Alfred Uçi, burim i cituar, fq.58,

²¹ "Kanuni i Maleve", kapitulli "Besa",

natyrave të tjera është trajtuar si rrëmbimi i Tanushës nga Halili. Në këtë kontekst, perceptimi i Tanushës si çikë Kralisë është vetëm konvencional dhe element i nevojshëm për të zhvilluar subjektin. Pas "rrëmbimit" të saj, Tanusha e Kralisë trajtohet sipas kodit të familjes kreshnike, e cila ushqen jetën dhe të ardhmen e Jutbinës.

Kënga "Martesa e Halilit" sjell një qasje dhe na informon se dy të rinjtë kanë një lidhje të fortë me njëri-tjetrin, se ata e kanë pranuar njëri-tjetrin, ajo e jashtëzakonshme dhe ai ma i bukuri i kreshnikëve. Ja ç'shënon kënga: "*Kur ka pa ftyrën e djalit: / -Po ket ftyrë, zot, ku e kam pa, / qi po m'giet me t'Halilit?! / Tjetër djali s'asht durue: / -Zoti t'vraftë, Tanushës po i thotë, / po a je nieri qi ke besë? / -T'hashin krahët, more djalë i ri, / se fort fell qi paske hi, / treqind shpirtna n'trup me i pasë, / kurrnja drita s't'a ka xanë. / Hajde mbrendë, kopil, po i thotë, / se ja desim t'dy përnjiherë, / ja kem' pshtue t'dy përnjiherë...*"²²

Pra, siç shihet, kënga tregon një "rrëmbim" për shkak të bukurisë²³ dhe mrekullisë mitike-njerëzore të njëri-tjetrit, dy krijesa të hershme që nuk mund të qëndrojnë jashtë njëri-tjetrit. "Martesa e Halilit" në të gjithë kompleksin e saj është ndërtuar e tillë.

Në një dekor kreshnikësh, në një dekor kompleks të natyrës, orëve, zanave, kuajve fluturues, dhive të egra, parathënieve, shenjave të natyrës, largësisë së Kralisë, shatorret, kullat e sarajet, treqind vajzave të bukura të Kralisë që i rrinë përreth Tanushës, spikat Halil kreshniku, i cili shpaloset në të gjithë këngën kreshnike. Ai e vazhdon gjithë udhëtimin, deri në Krali si një kreshnik nën praninë e qenieve mitologjike, me ç'rast na lejon të interpretohen dhe ndonjë "vacuum" për shkak të llojit letrarë folklorik.

Pra, siç shihet, duke parë, gjithë atë që ka ndodhur në ciklin e kreshnikëve, "Martesa e Halilit" është një kurorëzim i qartë, edhe pse konfliktet mes kreshnikëve dhe Kralisë janë përcjellë me luftëra, martesë e Tanushës në Jutbinë,²⁴ lindja e fëmijëve dhe ripërtitja e jetës, nuk e kalçifikon mosmarrëdhënien mes kundërshtarëve. Thënë ndryshe, krushqitë kanë

ndodhur, jeta është ripërtrirë me marrje dhe dhënie mes njëri-tjetrit. Siç dhe njoftohet që në krye të herës, në vargun "*kur kishim besë me krali*" e deri në fundin e këngës, ku tregohet për Tanushën e lumtur, nuse në Jutbinë, kuptohet se as kreshnikët nuk i kanë mohuar njerëzit e Kralisë dhe as Kralia nuk i ka mohuar kreshnikët.²⁵

Ndërsa shkrimtari Ismail Kadare, gjatë fundshekullit të kaluar ka botuar librin "*Krushqit janë të ngrirë*", një libër që është ndërtuar mbi një subjekt konfliktuar, në të cilin mëtohet një gjendje e nderë, një lloj arome të këngës kreshnike, por duke qenë një roman, kjo nuk absolutizon një mungesë totale të marrëdhënies mes shqiptarëve (si pasardhës të kreshnikëve) dhe serbëve (si pasardhës së njerëzve të Kralisë). Janë dy çështje që trajtohen ndryshe nga folklori, letërsia dhe historia.

Përfundime

Tanusha është një nga prerjet më idilike dhe mjeshtërore të imazhit femërorë, të bukurisë femërore, e cila bie në sy në rrethanat në të cilat ajo jeton, ku dhe personaliteti dhe imazhi i saj zhvillohet. Ajo është vizatuar dhe mishëruar emblematisht nga rapsodi popullorë, që, edhe pse ka kaluar kohë dhe pse kënga legjendare ka kaluar gojë mbas goje dhe brez pas brezi, ajo ka mbetur si një perlë që shkelqen sado që t'i largohesh. Tanusha është një figurë komplekse, e cila duke qenë e mishëruar në bukuri, cilësi dhe në tipare, për të iu përgjigjur kreshnikut të Jutbinës, Halilit, në gjithë tiparet dhe cilësitë e tij, ajo i ka kapërcyer kohët, pengesat, dukuritë dhe perceptimet e ndryshme estetike, dhe ka mbetur një nga simbolet e bukurisë femërore në traditën shqiptare.

Interpretimet mbi këtë figurë kanë qenë të shumta, debatuese dhe shumë referente, për shkakun se ajo në të shumtën e rasteve është parë në gjithë kompleksitetin kreshnik, i cili ngjan me një enciklopedi për kulturën, historinë, etnopsikologjinë, traditën, sepse ai në origjinën e vet ka një pleksje të qartë sinkretizmi dhe animizmi.

²² "Martesa e Halilit", variant i Nikaj Merturit, fq.76,

²³ Alfred Uçi, burim i cituar, fq.108,

²⁴ Qemal Haxhihasani, "Tema e martesave në këngët tona kreshnike" (Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike), Tiranë, 1977, fq.181-183,

²⁵ Qemal Haxhihasani, "Mendësi zotëruese në Ciklin eKreshnikëve", (Kultura Popullore), Tiranë 1991, nr. 1, fq.17- 36,

Kënga "Martesa e Halilit" është njëra nga këngët më të gjata të Ciklit. Ajo ka rreth 700 vargje dhe ka një kumt vertikal të qëndrueshëm linear. Po ashtu, kënga ka dhe një informacion social²⁶, të traditës²⁷, të mjedisit²⁸, të lidhjeve familjare dhe miqësisë²⁹, të besës dhe mikpritjes tradicionale³⁰ apo dhe të sjelljes së njerëzve me njëri-tjetrin³¹.

Qoftë dhe në qasjet studimore estetiko-artistike, ato etnopsikologjike-folklorike, kënga "Martesa e Halilit" rikthen në vëmendje pyetje të shumta, rikonformuese apo me arsyetimin për të zbuluar akoma çështje etnologjike, që tejkalojnë dhe qëllimin e parë të qasjes. Duke qenë një nga epikat specifike shqiptare, marrëdhënia fundamentale e gjithë këngëve reflekton bazën e konfliktit, bazën e "forcave njerëzore-kreshnike", që zbulojnë dhe figurat e kreshnikëve, që me gjasë është "konflikti" i njohur dhe i hapur me sllavët, të ardhur vonë në Ballkan, që me kalimin e kohës u "indeksua" me etnitetin e serbëve, të njohur me emrin "shkau", emër që e hasim në jo pak krijime dhe këngë të epikës legjendare shqiptare.

Kënga "Martesa e Halilit" ka një epizëm të dukshëm. Ajo nis me refrenin e njohur: "*Lum për ty, o i lumi Zot!*", por dhe rapsodi popullore ka qenë mjaft racional dhe referent për të krijuar një lidhje mirfilli komunikuese me të gjithë dekorin natyrorë, psikologjik, tradicional dhe ruajtjen e këtij niveli komunikimi dhe njoftues. Përgjithësisht në Epikën Legjendare shqiptare ka një koncept kronike, që lidhet me mundësinë e identifikimit të kohës si nocion kohe, të vendit

dhe të "temës" për të cilën flitet, në rast se mund ta emërtonim të tillë.

Kënga sjell një informim jashtëzakonisht të rëndësishëm për të kuptuar jo vetëm rregullin, kodin e qëndrueshëm të kreshnikëve të Jutbinës për martesën dhe miqësinë, por dhe marrëdhëniet historike me krajinë. Në këngën kreshnike gjendet një informacion i madh, i cili zbulohet situatë pas situatë, ngjarje pas ngjarje, në mënyrën më korrekte, pavarësisht shtresimeve kohore

Karakterisimi dhe vizatimi i Tanushës nga Halili, është i vetmi në këtë traditë, në këtë mënyrë dhe në gojën e vetë kreshnikut, që nuk gjendet në asnjë traditë të folur dhe të shkruar shqiptare. Vizatimi i Tanushës është autentik, i shtrirë në të gjithë cilësitë, tiparet dhe dukjen e saj. Ajo nuk është një Ajkunë, nuk vizatohet si një kreshnike, por si një femër me tiparet e një njeriu real

Në një dekor kreshnikësh, në një dekor kompleks të natyrës, orëve, zanave, kuajve fluturues, dhive të egra, parathënieve, shenjave të natyrës, largësisë së krajlisë, shatorret, kullat e sarajet, treqind vajzave të bukura të krajlisë që i rrinë përreth Tanushës, spikat Halil kreshniku, i cili shpaloset në të gjithë këngën kreshnike. Ai e vazhdon gjithë udhëtimin, deri në krajlë si një kreshnik nën praninë e qenieve mitologjike, me ç'rast na lejon të interpretohen dhe ndonjë "vacuum" për shkak të llojit letrarë folklorik.

Literaturë

Alfred Uçi, "Estetika e folklorit", botoi Akademi e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2007, Frang Bardhi, 1935, Nikollë Filja 1737 etj

¹ Kahreman Ulqini "Elementë të së drejtës zakonore të epikës heroike legjendare" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987),

¹ Xhemal Meçi "Kuvendi si traditë në eposin tonë" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987),

¹ Pirro Thomo, "Mjedisi dhe elementët arkitektonikë të epikës legjendare" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987),

Yllka Selimi, "Lidhjet familjare dhe miqësore në epikën heroike legjendare shqiptare" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987,

Selami Tabaku, "Besa dhe mikpritja si dëshmi e lashtësisë dhe origjinalitetit të epikës legjendare" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987),

²⁶ Kahreman Ulqini "Elementë të së drejtës zakonore të epikës heroike legjendare" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987), fq.247-256,

²⁷ Xhemal Meçi "Kuvendi si traditë në eposin tonë" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987), fq.257-259,

²⁸ Pirro Thomo, "Mjedisi dhe elementët arkitektonikë të epikës legjendare" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987), fq.220-228,

²⁹ Yllka Selimi, "Lidhjet familjare dhe miqësore në epikën heroike legjendare shqiptare" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987,

³⁰ Selami Tabaku, "Besa dhe mikpritja si dëshmi e lashtësisë dhe origjinalitetit të epikës legjendare" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987),fq.272-276,

³¹ Bardhul Prifti, "Përshëndetjet, urimet dhe mallkimet në epikën historike" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987), fq.283-291,

Bardhul Prifti, "Përshëndetjet, urimet dhe mallkimet në epikën historike" ("Çështje të Folklorit", nr.3, Tiranë 1987),

Selami Pulaha, "Fshatarësia e lirë e Shqipërisë së Veriut gjatë shek. XV-të-XVIII-të dhe Cikli i Kreshnikëve" ("Çështje të folklorit", vëll. 3), Tiranë 1987,

¹ Kënga "Martesa e Halilit", varianti Nikaj Mertur,

¹ Shih. "Kanuni i Lekë Dukagjinit", kapitulli i miqësisë dhe martesë,

¹ Kënga "Martesa e Halilit", varianti i Nikaj Merturit,

¹ Prof.dr. Shaban Sinani, "Mitologji në Eposin e Kreshnikëve", botoi Argeta LMG, Tiranë 2006,

¹ Qemal Haxhihasani, "Tema e martesave në këngët tona kreshnike" (Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike), Tiranë, 1977,

Qemal Haxhihasani, "Mendësi zotëruese në Ciklin e Kreshnikëve", (Kultura Popullore), Tiranë 1991, nr. 1, fq.17- 36,

Aspekte të përkthimit të emrave të përveçëm në letërsinë për fëmijë

Dr. Viola Adhami

Departamenti i Gjuhës Italiane

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

viola.adhami@unitir.edu.al

Abstrakt

Përkthimi i librave për fëmijë ka qenë dhe mbetet një sfidë tepër komplekse. Vështirësitë me të cilat përballen përkthyesit janë të shumta. Në këtë artikull do të ndalemi në disa aspekte të përkthimit që kanë të bëjnë me emrat e përveçëm. Shembujt janë marrë nga përkthimet e dy klasikëve të letërsisë italiane për fëmijë, para dhe pas vitete 90, siç janë *Aventurat e Cipolinës* së Gianni Rodarit dhe *Pinoku* i Carlo Colodit. Si janë trajtuar edhe raste të veçanta të përkthimit ku kultura luan një rol kryesor. Pra, do të analizojmë rëndësinë e kontekstit kulturor të gjuhës burimore dhe si është përcjellë ai në gjuhën mbërritëse dhe sa nga kultura 'tjetër' ruhet ose mund të ruhet në librat e përkthyer për fëmijë.

Fjalët çelës: *përkthim, letërsi për fëmijë, kulturë, emra të përveçëm*

Abstract

Translation of children's books has been and remains an extremely complex challenge. The difficulties faced by translators are many. In this article we will dwell on some aspects of translation that have to do with proper nouns. The examples are taken from translations of two classics of Italian children's literature, before and after the 90s, such as Gianni Rodari's *Adventures of Cipollino* and Carlo Colodi's *Pinocchio*. How special cases of translation where culture plays a major role are handled. So we will analyze the importance of the cultural context of the source language and how it has been carried over into the target language and how much of the 'other' culture is preserved or can be preserved in translated children's books.

Key words: *translation, children's literature, culture, proper names.*

Hyrje

Sot, ne preferojmë të flasim për përkthimin si komunikim ndërkulturor [...]. Me këtë qasje të re, përkthimi përkufizohet si një akt komunikimi që ndodh ndërmjet kulturave. (Nergaard 1995: 14)

Pra përkthyesi jo vetëm duhet të ndryshojë qasjen e përdorur zakonisht ndaj një teksti, por duhet të ndryshojë tërësisht mentalitetin e tij. Nuk mjafton të mendosh për fëmijën, duhet të mendosh si fëmijë. Shumë herë teksti duhet që të interpretohet në mënyrë krijuese, duke u përpjekur gjithmonë të ruajë besnikërinë maksimale ndaj asaj që autori ka dashur të thotë dhe të arrijë të përkthejë jo vetëm fjalët, por edhe emocionet. Prandaj është thelbësore të hysh në botën e lexuesve të vegjël duke folur gjuhën e tyre. Sipas Oittinen-it "Duke përkthyer, ne gjithmonë i përshtatim tekstet tona për qëllime të caktuara dhe për lexues të caktuar, fëmijë dhe të rritur. [...] Domestikimi është pjesë e përkthimit" (Oittinen 2000: 83). Ta bësh tekstin të shfrytëzueshëm nga lexuesit e ardhshëm, ta përshtasësh, do të thotë t'u japësh mundësinë që të «përfshihen emocionalisht që të mësojnë të kuptojnë ndjenjat e njerëzve të tjerë në situata të ndryshme» (Oittinen 2000: 90).

Përkthimi dhe kultura

Vështirësia rritet kur përkthyesi dhe lexuesi i përkasin një mjedisi kulturor të ndryshëm nga autori. Por sigurisht që problemet në përkthim shtohen kur kemi të bëjmë me fëmijët, pasi ndryshon shkalla e përshtatjes (p.sh. përkthimi bëhet më i vështirë për t'u lexuar), kur konteksti kulturor i mjedisit të huaj përkthehet pa përshtatje. Klingbergu sqaron "Prandaj, përkthyesit priren drejt asaj që unë shkurtimisht do të doja ta quaja përshtatje konteksti që do të thotë përshtatje e kontekstit kulturor të gjuhës burimore me kontekstin kulturor të gjuhës mbërritëse". Klingberg (1978: 86). Ai paraqet një listë të kategorive në të cilat gjendet kjo

përshtatje e kontekstit: emrat e përveçëm, pseudonimet, emrat e vendeve, emrat e kafshëve, referenca letrare, referenca ndaj kontekstit social dhe politik, vaktet dhe ushqimet, tradita dhe zakonet. Këto kategori i shohim më të qarta dhe më të dukshme në përkthimin për fëmijë. Zgjedhjet e përkthimit janë jashtëzakonisht të lidhura me funksionin e një përkthimi në kulturën mbërritëse, që do të thotë se një përkthim që është për fëmijët shpesh përshtatet sipas asaj që të rriturit mendojnë se janë aftësitë dhe preferencat e këtij publiku. Mënyra në të cilën përkthyesi mund të përshtatë ose afrojë tekstin me kulturën mbërritëse mund të jetë e shkallëve të ndryshme: nga zëvendësimi i një termi me një lloj të barasvlershëm me shkallë të ndryshme parafrazimi, heqesh, ose shtesash shpjeguese dhe lloje të tjera kompensimesh, dhe mund të arrijmë edhe në një përshtatje radikale, e cila ndikon në lokalizimin e të gjithë tekstit (Klingberg 1986: 18), pra një lloj domestikimi të tekstit. Kjo sepse emrat e personazheve shpesh kanë kuptim të qartë: këto kuptime nënkuptojnë natyrën e personazhit ose pamjen e tij. Metodat e tëhuajëzimit, nga ana tjetër, e bëjnë lexuesin të ndjejë dallimet kulturore dhe gjuhësore. Është më pak miqësor për lexuesin, por ruan tiparet karakteristike të tekstit burimor dhe ndjesinë e diçkaje të huaj. "E huaja, e çuditshmja apo edhe ekzotikja e ruajtur në tekst pritet të jetë një nxitje për leximin" (Mazi-Leskovar 2003:252). Tëhuajëzimi në letërsinë për fëmijë mund të përdoret si mjet edukimi. Nëpërmjet ruajtjes së veçorive të tekstit burimor, fëmijët mund të mësojnë për kulturat e huaja dhe mënyrat e ndryshme të jetesës. Gjatë përkthimit të emrave të personazheve, mënyra më e zakonshme e tëhuajëzimit është ruajtja e emrave në formën e tyre origjinale. Por çdo përkthyes duhet të zgjedhë strategjinë e duhur. Ky vendim ndikohet nga faktorë të ndryshëm. Për të përmbushur kërkesat e lexuesve të tij, përkthyesi duhet të gjejë "përzierjen e duhur të tëhuajëzimit dhe domestikimit" (Mazi-Leskovar 2003:254). Sipas Venutit, "strategjitë e përkthimit përfshijnë detyrat themelore të zgjedhjes së tekstit që do të përkthehet dhe zhvillimin e një metode për përkthimin e tij" (Venuti 2018:240). Mënyrat sipas tij ndahen kryesisht në dy grupe: strategjitë e domestikimit dhe strategjitë e tëhuajëzimit. Nëse do t'i referohemi Schleiermacher-it mundësitë e përkthyesit të "vërtetë", janë vetëm dy: "Ose përkthyesi e lë shkrimtarin vetëm sa më shumë që të jetë e mundur dhe e shtyn lexuesin drejt shkrimtarit, ose ai e lë lexuesin vetëm sa më shumë që të jetë e mundur dhe e shtyn shkrimtarin drejt lexuesit". Për përkthimet e emrave të personazheve në letërsinë për fëmijë shpesh përdoren teknika të domestikimit. Kjo

ndodh sepse emrat e përveçëm kryejnë një numër të madh funksionesh komunikuese: ata janë tregues semantikë, socialë, etnikë, retorikë dhe stilistikorë. Nga studimet e shumta del se roli i tyre është tepër i rëndësishëm. Nëse flasim për një tekst letrar fuqia e tyre shprehëse na i paraqet personazhet në nivele të ndryshme. (Debus 2001: 230).

Përkthimi emrave të përveçëm në letërsinë për fëmijë

"Një fjalë – shkruan te *Gramatika e fantazisë* Rodari - e hedhur ashtu rastësisht në mendje, prodhon dallgë në sipërfaqe dhe në thellësi, nxit një varg të pafundëm reaksionesh zinxhir, duke përfshirë tinguj dhe imazhe, analogji dhe kujtime, kuptime dhe ëndrra, në një lëvizje që i intereson përvojës dhe kujtesës, fantazisë dhe pavetëdijes dhe që është e ndërlikuar nga fakti që e njëjta mendje nuk qëndron pasive, por ndërhyr vazhdimisht, për të pranuar dhe refuzuar, për të lidhur, censuruar, ndërtuar dhe shkatërruar." (Boero 2016: 273)

Në tekstet letrare emrat e përveçëm rrallë kanë një kuptim neutral dhe në përkthim gjithmonë krijojnë probleme ndërgjuhësore dhe ndërkulturore. Dhe nëse i referohemi pikërisht letërsisë për fëmijë, kjo gjë është edhe më e dukshme. Në krijimet për fëmijë personazhet janë shumë herë të shpikur dhe emrat janë të shpikur. Studimet në fushën e teorisë së përkthimit dhe në atë të onomastikës janë shtuar shumë vitet e fundit, por situatat me të cilat përballen studiuesit janë aq të shumëllojshme sa bëhet e vështirë të arrihet në përfundime teorike të strategjive të përdorura. Do të marrim disa shembuj për të parë sesi kanë ardhur në shqip disa emra të përveçëm, strategjitë që kanë përdorur përkthyesit dhe nëse ja kanë dalë të përcjellin informacionin që këto emra mbartin në vete.

Jemi ndalur në romanin "Aventurat e Çipolinos". Personazhet e romanit për fëmijë janë frutat, perimet dhe kafshët që që kthehen në antroponime. Emra të përgjithshëm që me shkronjë të madhe kthehen në të përveçëm, apo pësojnë ndryshime me anë të prapashtesave përmirësuese apo përqësuese, për të ndarë personazhet në pozitivë dhe negativë. Në kapitullin e parë njihemi me protagonistin së bashku me gjithë familjen e tij: Cipollino ishte djali i Cipollone-s dhe kishte shtatë vëllezër: *Cipolletto*, *Cipollotto*, *Cipolluccio* e kështu me radhë, të gjithë emra të përshtatshëm për një familje qepësh. Në shqip në përkthimin e emrave të familjes së Çipolinos përkthyesit parapëlqejnë t'i lënë emrat në original (transliterim) me një

shënim në fund të faqes për kuptimin e emrit në shqip. Kjo mbase për ta bërë lexuesin të kuptojë se kemi të bëjmë me ngjarje dhe personazhe që i përkasin një realiteti tjetër. Përdoren mbasesat e shqipes dhe prapashtesa të origjinalit, të shqipes ose të krijuara. Çipolone, *Çipoleto*, *Çipoloto*, *Çipoloça* *Çipoluça*. Por duke i lënë emrat në origjinal menjëherë humbet pak forca që ka skena e parë, loja që krijon autori për lexuesin e vogël, kemi të bëjmë me një familje qepësh dhe qepët nuk kanë erë të këndshme, është familje e varfër dhe në shtëpinë e tyre mban erë dhe jo më kot kur vjen princ Limoni, ushtarët Limonuthat (Limoncini) spërkasin me livando. Dhe mos harrojmë që libri lexohet edhe nga të rriturit dhe lexuesi italian i kulturuar mund ta lidhë me figurën e Frate Cipolla (Dekameroni të Boccaccio-s), ku emri aluziv ka brenda humorin dhe njohje të menjëhershme të karakterit dhe funksionit të personazhit (Zaccarello 2004: 68). Një shembull tjetër interesant për t'u përmendur është emri i kopshtarit Pirro Porro. Në shqip është përkthyer me Prasi në përkthimin e parë dhe Pras Preshi në të dytin, ku te ky i fundit është ruajtur aliteracioni i origjinalit. Nuk e dimë nëse zgjedha e përkthyesve është e rastësishme apo jo por nëse i referohemi historisë do të ishte e pavend të përdorej një emër të parë që i përkiste mbretit të Epirit, ndërkohë që personazhi në fjalë i përket shtresës së ulët. Po të konsultojmë fjalorin pirro ka edhe kuptimin i kuq, që mbase autori e ka përdorur për të treguar llojin e preshit me origjinë nga Kina. Ashtu si përdor fjalën "melarancia", (il barone Melarancia - i përkthyer si baron Portokalli) ku kemi të bëjmë me "portokallin e ëmbël". Ky i fundit, i quajtur shkencërisht citrus sinensis, është me origjinë kineze dhe u importua në Eurora në shekullin e 14-të. Il cane Mastino (në përkthim qeni Mastino) përveçse tregon një racë specifike qeni që në shqip njihet me emrin Mastif, përdoret për të treguar një qen roje ose mbrojtës të fuqishëm dhe të egër, që del edhe nga kuptimi figurativ i shpjegimit të fjalës dhe i përshtatet më së mirë personazhit në libër. Qeni tjetër në roman është Segugio, qeni ndihmës i Mister Carotino-s (Mister Karotou dhe qeni Kape-Mbaje). Duke qenë se ky i fundit është agjent, nuk mund të mos ketë edhe një asistent të zotë. Kuptimi i fjalës është qen gjahu dhe shpjegimi figurativ është polic në gjuhën burimore. Në kapitullin e dhjetë, përmendet Attilio Regolo, në bisedën që bën Çipolino me zotin Urith. Në përkthim është hequr edhe pse si figurë historike mjaft e rëndësishme ka një vlerë simbolike në tekst. Meqënëse jemi në botën e kafshëve po sjellim edhe disa shembuj të emrave të kafshëve, sërish të qenve, por që i gjejmë në një klasik tjetër të letërsisë italiane për fëmijë, siç është pinoku i Carlo Colodit. Emrat e

qenve edhe në këtë rast krjojnë vështirsi për përkthyesin, pasi i referohen një 'kujteje' letrare, që mund të jetë e panjohur për lexuesin e zakonshëm shqiptar, por që paraqesin konotacione të njohura për lexuesin italian. Qeni leshatak i Zanës quhet Medoro, ashtu siç e kishte emrin edhe ushtari i shkretë tek Orlando Furioso (1532) i Ludovico Ariosto-s; një ushtar që ishte i gatshëm të vdiste për kapitenin e tij dhe që më pas fiton dhe martohet me heroinën Angelica. Kemi të bëjmë me një emër që ngjall ndjenja pozitive, emri Melampo është emri i qenit që kishte bërë një pakt me hajnat. Emri Melampo rrjedh nga fjala greke melampous që do të thotë 'këmbëzi'. Figurë e njohur edhe në mitologjinë greke. Më në fund kemi qenin, Alidoro, të cilin e shpëton Pinoku. Nërsa Alidori e shpëton nga shpella e Peshkatarit të Gjelbër. Emri Alidoro për lexuesin italian është i njohur nga opera italiane, përmendim "Hirushja" (1817) të Gioacchino Rossini-i. Nga shembujt e mësipërm shohim se në shqip nuk arrijnë të përcillen karakteristikat që mbartin emrat e personazheve. Ata nuk arrijnë të ngjallin ndjenjat pozitive apo negative që në leximin e parë. Por siç thotë Hahn, (2022:152) "Nëse përkthimet duan të funksionojnë – nëse duan të gjejnë një zë për rrëfimin, zërin që thur magjepsjen, ato nuk duhet të jenë vepër e një mendjeje mekanike, e një mendjeje që punon mekanikisht me një tekst – por e një mendjeje individuale dhe krijuese."

Përfundime

Në përfundim mund të themi se përkthimi i emrave nuk ka të bëjë vetëm me procesin e përkthimit që vazhdon të jetë një punë shumë impenjative për përkthyesit. Kalimi nga njera gjuhë dhe kulturë në tjetrën nuk mund të ndodhë pa pasoja. Përkthyesi duhet të marrë parasysh edhe elementet ekstratekstuale, sa e njeh publiku veprën origjinale, shijet e lexuesit, apo vendimet që marrin botuesit për arsye marketingu. Sot vëmendja e përkthyesit është gjithëpërfshirëse dhe përqendrohet në të gjitha aspektet që lidhen me tekstin. Pavarësisht nga rregullat e shumta që ekzistojnë sot për përkthimin e emrave të përveçëm nuk mund të dalin ende norma të percaktuara qartë. Edhe pse në përgjithësi emrat kanë funksion informues dhe sqarues, jo gjithmonë siç dhe e pamë nga shembujt e marrë, duhet që këto karakteristika të jenë të pranishme në përkthim. Dhe i mbetet përkthyesit nëse do ta lërë informacionin ta zbulojë lexuesi apo ta sqarojë vetë në fund të faqes apo të tekstit.

Bibliografia

- Abós, E.: *Translator: Trafficking between Cultures*, *The Horn Book Magazine* 93, no. 3, 2016. ff. 35–41.
- Boero P., De Luca C.: *La letteratura per l'infanzia*. Laterza; 2009
- Bukowski P. Sax Daniel J.: *Friedrich Schleiermacher's Pathways of Translation - Issues of Language and Communication*, V. 34, 2023
- Collodi C.: *Le avventure di Pinocchio. Storia di un burattino*, Einaudi Tascabili, Torino, 2002
- Collodi C.: *Le avventure di Pinocchio*, Giunti junior, 2008
- Collodi C. *Pinoku*,: përkthyes Simoni C., Naim Frashëri, 1959
- Collodi C. *Pinoku*,: përkthyes Simoni C., Mihal Duri, 1964
- Debus F.: *Funzioni dei nomi letterari. Il nome nel testo* 2001 ff. 227-240
- Dybiec-Gajer J., Oittinen R., Kodura M.: *Negotiating Translation and Transcreation of Children's Literature: From Alice to the Moomins (New Frontiers in Translation Studies)*, Edition, Kindle Edition Springer, 2020
- Ghesquiere R.: *Does Children's Literature Need Translation?* - *Children's Literature in Translation: Challenges and Strategies*, St. Jerome. 2006 f. 19-34
- Hahn D.: *Catching Fire: A Translation Diary* Charco Press, 2022
- Jakobson R. 1959,: *On Linguistic Aspects of Translation - In The Translation Studies Reader*, Venuti L., London/New York: Routledge. 2015
- Klingberg G.: *Children's Fiction in the Hands of the Translators*, CWK Gleerup, Malmø, 1986
- Lefevere A., Bassnett S.: *Translation, History and Culture*, Pinter Publisher, London and New York, 1990
- Nergaard S. (a cura di): *La traduzione come processo decisionale - Teorie contemporanee della traduzione*, Bompiani, Milano, 1995
- Oittinen R.: *Translating for Children*. New York/London: Garland, 2000
- Oittinen R. Ketola A., Garavine M.: *Translating Picturebooks: Revoicing the Verbal, the Visual and the Aural for a Child Audience*. London/New York: Routledge, 2017
- Rodari G.: *Le avventure di Cipollino*, Einaudi, 2010
- Rodari Xh., *Aventurat e Çipolinos: përkthyes Tafa T., Tafa E., Vëllezërit Tafa*; 2009
- Rodari Xh.: *Aventurat e Çipolinos: përkthyes Tafa T., Tafa E., Vëllezërit Tafa*; 2009
- Venuti L.: *The Translator's Invisibility: A History of Translation*, Routledge, London and New York, 2018
- Zaccarello M.: *Primi appunti tipologici sui nomi parlanti*. *Lingua e stile* 38, 2004

Shpirti i jashtëm në përralla

Phd Çerkezi Edlira

*Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
Fakulteti i Shkencave Humane,
Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë*

Dr Alta Haluci

*Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
Fakulteti i Shkencave Humane
Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë*

Abstrakt

Fairy tales, in which the mythical figures have carried the soul outside their being, are known among many peoples. The prominent English ethnologist and folklorist Frezeri in the book "The Golden Branch" dealt extensively with this issue. Based on his own knowledge, he connects this type of oral tale with the mind of the primitive world, according to which the soul for a time or even longer has the opportunity to separate from the body and man, yet to live.

The carrying of the soul from the body and its placement in various objects, living things and plants, according to this primitive opinion, is done in order to protect itself from the eventual danger that may appear in life. Our tales of this type, as well as the tales of other peoples, have support in totemistic prefigurations. In the tales of the South, the soul is carried outside of its own being by lubia, while in the tales of the North, the divi, the vampire and other mythical figures, mainly with destructive content.

The motif of the external soul can also be found in some folk tales with the figure of the diva and the vampire. Even in these tales, the spirit carried by the diva or the vampire, namely the secret of their strength, is found in many beings and things. The secret of strength, namely of the soul, in these different objects and beings is arranged from one to another. This mythical motif, integrated in the oral tale as an artistic structure, loses the independence it had at the beginning within mythology. In the concrete fairy tale, but also in general in fairy tales of the mythical type, the mythical motif, losing its connection with the specific mythological context, constantly

increases the artistic load, turns into the possibility of the aesthetic acquisition of a reality certain vital.

Hyrje

Përrallat, në të cilat figurat mitike e kanë të bartur shpirtin jashtë qenies së tyre, janë të njohura ndër shumë popuj. Etnologu dhe folkloristi i shquar anglez Frezeri në librin "Dega e artë" është marrë gjerësisht me këtë çështje. Në kapitullin "Shpirti i jashtëm në tregimet popullore" (Frezer: 789-823) ai sjell përralla të tilla nga popujt të ndryshëm të botës. Përveç në tregime gojore, Frezeri këtë çështje e ka studiuar edhe në zakonet e ndryshme popullore. Për ta sqaruar këtë besim të lashtë, autori ka bërë gjurmime konkrete tek fiset e ndryshme të Afrikës Jugore dhe të Amerikës, të cilat ndodhen në një shkallë të ulët të zhvillimit shoqëror. Frezeri, këtë zakon e ka studiuar dhe në praktikën rituale të jetës së këtyre fiseve.

Në bazë të gjurmimeve të veta, ai këtë tip të përrallës gojore e lidh me mendimin e botës primitive, sipas të cilit shpirti për një kohë ose edhe më gjatë ka mundësi të bartet nga trupi dhe njeriu, megjithëkëtë të jetojë. Bartja e shpirtit nga trupi dhe vendosja e tij në objekte, gjallesa dhe bimë të ndryshme, sipas këtij mendimi primitiv, bëhet me qëllim që të mbrohet nga rreziku eventual që mund t'i paraqitet në jetë. Përderisa objekti në të cilin ndodhet aspekti jetësor, të cilin njeriu primitiv e konsideronte si të vetin, mbetet i parrezikuar, njeriu mund të jetojë edhe në përrallat shqiptare me qëllim të ruajtjes së shpirtit nga rreziqet eventuale që mund t'i paraqiten.

Përrallat tona të këtij tipi, si dhe përrallat e popujve të tjerë, kanë mbështetje në parafytyrime totemistike. Në përrallat e Jugut shpirtin e bart jashtë qenies së vet lubia, kurse në përrallat e Veriut divi, vampiri dhe figurat e tjera mitike, kryesisht me përmbajtje destruktive. Kështu, në disa përralla, lubia ia robëron mbretit gruan. Djali i madh merr leje nga mbreti që ta gjejë të ëmën, por kot i harxhon lirat dhe kthehet pa kryer punë. Po kështu i ndodhë edhe djalit të mesëm, kurse më i vogli arrin që ta zbulojë vendin e shpirtit të bartur të Lubisë që është i fshehur përtej Detit të Zi, në barkun e një derri, në të cilin gjendet një arap i zi, në barkun e të cilit fshihet një (Mehmeti 1996: 88) lepur e në barkun e lepurit kutia që ka shtatë kokrra vezë. Djali më i vogël i mbretit, kur i zbulon dhe i asgjëson të gjitha këto, mposht Lubinë dhe liron të ëmën (Proza III: 117-182).

Motivin e shpirtit të jashtëm e gjejmë edhe në disa përralla popullore me figurën e divit e të vampirit. Edhe në këto përralla shpirti i bartur i divit apo i vampirit, gjegjësisht fshehtësia e forcës së tyre, ndodhet në shumë qenie e sende. Fshehtësia e forcës, përkatësisht e shpirtit, në këto objekte dhe qenie të ndryshme radhitet nga njëri në tjetrin (*Praza II*: 254-258, 259-263; Kurti I: 109-113; Mbledhës II: 566-571). Në këto përralla gruaja e robëruar zbulon fshehtësinë e forcës që e zotëron divi apo vampiri. Në të gjitha përrallat e këtij tipi, pas asgjësimit të objektit apo gjallesave që bartin shpirtin e transferuar, vdesin dhe figurat mitike siç: janë lubia, divi, vampiri apo gogoli në përrallat popullore arbëreshe.

Frezeri, duke folur për shpirtin e bartur në këtë lloj të përrallës, i qaset shqyrtimit të tij kryesisht nga aspekti etnologjik. Ai në këtë drejtim sjell rezultate të rëndësishme, sepse vërteton se në të gjitha këto raste kemi të bëjmë me një vetëdije primitive mitologjike, në bazë të së cilës, shpirti konsiderohej si një objekt lëndor, i cili mund të ndahet nga trupi. Përrallat me këtë motiv, sipas tij, shprehin mungesën e aftësisë të njeriut primitiv që ta kuptojë jetën në mënyrë abstrakte, si mundësi të vazhdueshme të ndjenjave apo si përshtatje të pandërprerë të rregullatorëve të brendshëm ndaj marrëdhënieve të jashtme (Frezer: 789).

Nga ana tjetër, është po ashtu meritë e këtij studiuesi që të ashtuquajturin shpirtin e jashtëm, përkatësisht shpirtin e bartur, e lidh me besime totemistike të cilat tshin të njohura ndër bashkësitë e hershme të fiseve gjuetare. Në këtë mënyrë, Frezeri, duke e shikuar këtë lloj të përrallës mitike nga aspekti etnologjik, lë anash karakterin artistik të saj (Mehmeti 1996: 89). Po ta shikojmë përrallën popullore

me motivin e shpirtit të bartur të figurave mitike si strukturë artistike, do të shohim se motivi dhe personazhet mitike në të, edhe pse lidhen me parafytyrime të hershme totemistike, siç e kishte konstatuar dhe Frezeri, në përbërjen e përrallës si krijim artistik kanë pësuar transformim.

Ky motiv mitik, i integruar në përrallën gojore si strukturë artistike, humb pavarësinë që ka pasur në fillim brenda mitologjisë. Në përrallën konkrete, por edhe përgjithësisht në përrallat e tipit mitik, motivi mitik, duke e humbur lidhjen me kontekstin e caktuar mitologjik, rrit vazhdimisht ngarkesën artistike, shndërrohet në mundësi të përvetësimit estetik të një realiteti të caktuar jetësor. Nga ana tjetër, siç e ka parë me të drejtë Alfred Uçi, shërben edhe "për të karakterizuar ngjarjet, që ndodhin në botën e huaj, në të cilën protagonistin njeri hyn për t' u përleshur me forcat armiqësore dhe për të arritur qëllimet" (Uçi 1982: 95-196). Prandaj, në tipin e përrallës mitike si strukturë artistike e folklorit gojor, përkatësisht si strukturë artistike e prozës popullore, rëndësi të posaçme ka i ashtuquajturin modeli i realitetit (Shkreb 1968: 39-49).

Përrallat që shtjellojnë shpirtin e jashtëm të figurave mitike dhe përrallat e tjera të llojit mitik, duke shfrytëzuar motive dhe personazhe mitike nga mitologjia, konstruktojnë modelin e realitetit që nuk është asgjë tjetër veçse një realitet i mundshëm, i cili i përgjigjet realitetit jetësor. Modeli i realitetit ose projekcioni i modelit të realitetit është një tipar fundamental i strukturës artistike të përrallës si krijim gojor. Pa këtë moment të rëndësishëm, përralla si formë e prozës gojore as që mund të mendohet. Modeli i realitetit, si element esencial i strukturës artistike të përrallës popullore, nuk është i njohur në format e tjera të folklorit gojor. Në këtë drejtim bëjnë përjashtim vetëm përrallat në vargje dhe disa nga këngët epike legjendare në strukturën e të cilave, po ashtu, është i integruar elementi mitik. Edhe në format e tilla mund të bëhet fjalë për modelin e realitetit, mirëpo, ky moment në format e epikës legjendare në vargje nuk del si në përrallat popullore të tipit mitik (Mehmeti 1996: 90).

Në kuadrin e përrallës mitike realiteti jetësor dhe modeli i realitetit, përkatësisht realiteti i dëshiruar, *gërshetohen me njëri-tjetrin*. Realitetin jetësor në këto përralla e paraqesin marrëdhënet e protagonistit me personazhet e tjera të botës njerëzore, kurse modelin e realitetit marrëdhëniet e protagonistit njeri me personazhet mitike. Po ta shikojmë nga ky drejtim, përrallën me motivin

e shpirtit të bartur të lubisë, realitetin jetësor në të do ta përbënin përpjekjet e tre djemve të mbretit për ta liruar të ëmën, marrëdhëniet sidomos të heroit kryesor të përrallës, djalit të vogël me nënën e robëruar, porositë që ai i jep nënës lidhur me zbulimin e forcës së Lubisë etj. Ndërkaq, modelin e realitetit në këtë përrallë e paraqesin marrëdhëniet e nënës me lubinë, të cilën ajo arrin ta mashtrojë dhe në këtë mënyrë zbulon vendin ku e ka të fshehur forcën. Modelit të realitetit në këtë përrallë i takojnë edhe marrëdhëniet e djalit të vogël me lubinë, i cili arrin që të shkojë në vendin ku gjendet forca e fshehur e saj, përkatësisht shpirti i bartur 1 lubisë. Djali i vogël, pasi i zbulon dhe i asgjëson të gjitha objektet dhe gjallesat në të cilat gjendet shpirti i lubisë, arrin ta lirojë nënën e robëruar.

Këto dy shtresa të këtij lloji të përrallës hetohen edhe në rastet e tjera, siç është p. sh. përralla "*Musa i vogël e divi*" (Kurti I: 109-113), në të cilën forca e divit gjendet në gjarprin e shpellës që ka dy pëllumba në bark.

Ndër tregimet karakteristike të këtij lloji, i cili lildhet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me këngët epike, është sidomos përralla "*Zanefaqekuqja dhe nusja*" (Kajtazi 1972: 20-21).

Në këtë përrallë zana i ngurosh krushqit, të cilët duke vallëzuar dhe kënduar ia prishin qetësinë në bjeshkë. Pas nguroshjes së krushqve, zana rrëmben nusen, të cilën e mban të robëruar në shpellë ku jeton edhe vetë. Pasi që krushqit nuk kthehen, i zoti i dasmës del për t'i kërkuar. Ai mëson se zana i ka ngurosur në mal, kurse nusen e ka robëruar në shpellë. Duke e kërkuar nusen në mal, e gjen më në fund në shpellën e zanës. E këshillon që të mësojë nga zana se ku e ka vdekjen. Posa kthehet zana nga gjuetia, nusja mëson me mjeshtri se shpirti i saj gjendet në barkun e një lepuri në Bjeshkë të Madhe, në të cilën është një shotë, kurse në barkun e shotës një kokërr ve. Kur zana del përsëri në gjueti, i zoti i dasmës takohet me nusen. Nusja i tregon se ku gjendet vdekja e zanës, përkatësisht shpirti i bartur i saj. Ai rrethon malin me gjuetarë, zë lepurin dhe nga barku i tij nxjerr shotën dhe vezën ku gjendet shpirti i bartur i zanës. Kërkon nga zana që t' i çngurosh krushqit. Zana menjëherë i çngurosh të gjithë krushqit. Në fund, zana vdes sepse asgjësohet dhe objekti i fundit në të cilin gjendej shpirti i bartur i saj. Pas ngadhënjimit të protagonistit njeri mbi pengesat iracionale, dasma vazhdon edhe shtatë ditë të plota (Mehmeti 1996: 91).

Edhe në këtë përrallë si dhe në përrallat e tjera, syzheu zhvillohet në rrafsh real jetësor dhe në atë fantastik. Rrafshi i parë

përbën realitetin jetësor, kurse i dyti modelin e realitetit ose projeksionin e realitetit në të cilin krijohen situata të përshtatshme, karakteristike për përrallat e tipit mitik, ku protagonistin njeri zbulon gjithë madhësinë dhe vitalitetin e vet. Fitorja e protagonistit njeri në këtë përrallë, por edhe në përrallat e tjera mitike mbi pengesat e ndryshme iracionale, si dhe dasma që vazhdon dhe shtatë ditë të tjera, paraqet të madhërishten solemne. Në këtë mënyrë, duke fituar protagonistin njeri mbi pengesat e botës mitike, e bën përrallën zhanër të vizionit të fitores, të ngadhënjimit të njeriut mbi të keqen, mbi të ligën.

Përrallat shqiptare me motivin e shpirtit të bartur të figurave mitike në shumë momente përputhen edhe me përrallat e popujve të tjerë. Këto ngjashmëri midis përrallave tona të këtij tipi dhe të përrallave të popujve të tjerë janë të dukshme sidomos në objektet në të cilat figurat mitike e kanë të vendosur forcën ose shpirtin e vet. Edhe në përrallat tona, sikurse në përrallat e popujve të tjerë, figurat mitike shpirtin e kanë të bartur në qenie të ndryshme zoomorfe. Aspekti jetësor i tyre, i vendosur në objekte dhe qenie zoomorfe si tek popujt e tjerë, gjendet larg dhe vështirë zbulohet.

Bartja e forcës së figurave mitike në gjallesa dhe në objekte të ndryshme, që gjenden të vendosur njëra në tjetrën, edhe në përrallat tona bëhet me qëllim të sigurisë së plotë të tij. Kështu, p.sh. në përrallat tona, siç është parë, lubia e ka shpirtin të vendosur përtej Detit të Zi, në barkun e një derri, në të cilin gjendet një arap i zi e në barkun e tij një lepur, kurse në barkun e lepurit shtatë kokrra vezë. Zana forcën e vet e ka të fshehur në Bjeshkë të Madhe në barkun e një lepuri, në të cilin gjendet një shotë, kurse në barkun e saj një ve. Ndërkaq, divi forcën e ka të bartur në një shpellë ku gjendet një gjarpër, e në barkun e gjarpërit janë dy pëllumba. Po kështu, edhe në përrallat popullore arbëreshe gogoli e ka forcën të vendosur në një pëllumbeshë, në barkun e së cilës ndodhen dy vezë (Mehmeti 1996: 92).

Edhe në përrallat nordike mbi xhindin, i cili nuk ka zemër në trupin e vet, xhindi e ka shpirtin të bartur në një ujëdhese të largët në mes të një liqeni, në të cilin ndodhet një kishë, në mes të kishës është një krua, kurse në të noton një patë në barkun e së cilës është një ve (Frezer: 794).

Në një përrallë induse, Punçkini, një figurë mitike e botës së përrallave, forcën e ka të bartur larg me qindra mila në një shkretëtirë në mesin e së cilës gjendet një pyll i dendur. Në mes

të këtij pylli ka palma, pranë një palme gjenden gjashtë enë të vendosura njëra mbi tjetrën, në enën e gjashtë është një kafaz i vogël ku ndodhet papagalli me ngjyrë të gjelbërt (Frazer: 793).

Në disa përralla greke forca e njeriut antropofag ndodhet në shpendë të ndryshëm (Frezer: 792). Si në përrallat tona, ashtu edhe në përrallat e popujve të tjerë, figura mitike e botës së përrallave që e ka shpirtin, gjegjësisht forcën e bartur jashtë qenies së vet, robëron princeshën. Në përrallat tona princesha është bija e krajlit, gruaja e mbretit ose e bukura në përrallat arbëreshe (Mehmeti 1996: 93). Edhe në përrallat tona, sikurse në përrallat e popujve të tjerë, femra e robëruar, përkatësisht princesha, me mjeshtri mbulon shpirtin e bartur të figurave mitike. Protagonisti njeri, gjegjësisht princesha, në përrallat botërore ose e bukura apo bija e krajlit në përrallat tona, gjithëherë e mashtron xhindin ose ndër ne divin, gogolin, lubinë, vampirin.

"Në të parën ditë e bija e krajlit po ia shtron odën divit me cohë të kuqe.

E shef divi e e pvet: - Po ti shka ke ba kështu moj grue?

- Kesh po i baj nderë forcës së atë - ia kthej ajo.

I bahet qefi - He - i thotë - Së kam forcën këtu; por e kam në kopsht.

Merr e bija e krajlit në nesre e e shtron kopshtin me cohë të kuqe. E shef divi e pvet: Po ti shka ke ba kështu, moj grue?

- Kesh po i baj nderë forcës së atë - ia kthen ajo.

I bahet qefi divit e i thotë: Së kam aty. Po ku e ke? - E pvet grueja.

- E kam, i thotë, në gjarpnin e shpellës me dy pllumba në bark. Me ba me mbi mbytë ata pllumba, mue më soset forca e des" (Kurti I: 112-113).

Edhe ndër ne, sikurse te popujt e tjerë, motivi i shpirtit të bartur të figurave mitike krahas në përralla, shtjelohet dhe në format në vargje të krijimtarisë gojore. Përderisa tek popujt e tjerë, siç dëshmon Frezeri, ky motiv përrallor në këngë është shumë më i ri! Përkundrazi ndër ne e gjejmë në një numër të konsiderueshëm këngësh tregimtare.

Përfundime

Përrallat, në të cilat figurat mitike e kanë të bartur shpirtin jashtë qenies së tyre, janë të njohura ndër shumë popuj. Etnologu dhe folkloristi i shquar anglez Frezeri në librin *"Dega e artë"* është marrë gjerësisht me këtë çështje. Përveç në tregime gojore, Frezeri këtë çështje e ka studiuar edhe në zakonet e ndryshme popullore. Për ta sqaruar këtë besim të lashtë,

autori ka bërë gjurmime konkrete tek fiset e ndryshme të Afrikës Jugore dhe të Amerikës, të cilat ndodhen në një shkallë të ulët të zhvillimit shoqëror. Frezeri, këtë zakon e ka studiuar dhe në praktikën rituale të jetës së këtyre fiseve. Motivin e shpirtit të jashtëm e gjejmë edhe në disa përralla popullore me figurën e divit e të vampirit. Në të gjitha përrallat e këtij tipi, pas asgjësimit të objektit apo gjallesave që bartin shpirtin e transferuar, vdesin dhe figurat mitike siç: janë lubia, divi, vampiri apo gogoli në përrallat popullore arbëreshe.

Në përrallën konkrete, por edhe përgjithësisht në përrallat e tipit mitik, motivi mitik, duke e humbur lidhjen me kontekstin e caktuar mitologjik, rrit vazhdimisht ngarkesën artistike, shndërrohet në mundësi të përvetësimit estetik të një realiteti të caktuar jetësor.

Përrallat që shtellojnë shpirtin e jashtëm të figurave mitike dhe përrallat e tjera të llojit mitik, duke shfytëzuar motive dhe personazhe mitike nga mitologjia, konstruktojnë modelin e realitetit që nuk është asgjë tjetër veçse një realitet i mundshëm, i cili i përgjigjet realitetit jetësor.

Përrallat shqiptare me motivin e shpirtit të bartur të figurave mitike në shumë momente përputhen edhe me përrallat e popujve të tjerë. Këto ngjashmëri midis përrallave tona të këtij tipi dhe të përrallave të popujve të tjerë janë të dukshme sidomos në objektet në të cilat figurat mitike e kanë të vendosur forcën ose shpirtin e vet. Edhe në përrallat tona, sikurse në përrallat e popujve të tjerë, figurat mitike shpirtin e kanë të bartur në qenie të ndryshme zoomorfe. Aspekti jetësor i tyre, i vendosur në objekte dhe qenie zoomorfe si tek popujt e tjerë, gjendet larg dhe vështirë zbulohet.

Bota e metamorfozës në letërsinë gojore shqiptare përbën një kompleks besimesh, ritesh, mitesh dhe figurash mitike, të cilat janë të lidhura ngushtë me kultet e natyrës shqiptare, ku shfaqen më së miri, detaje dhe argumente të të parëve të tyre, të cilët vijnë prej lashtësisë dhe pësimit të transformimit të tyre në rrjedhën e shekujve ku dallohet edhe fantazia poetike e bazëve popullore.

Për të argumentuar, sa më mirë metamorfozën poetike shqiptare dhe imagjinatën e thellë kolektive të tyre në mjaft materiale të botuaradhe të mbledhura prej nesh zbërthehen natyrshëm mitet dhe besimet e lashta që kanë ardhur të gjalla deri në ditët tona. Në tërë botën e tyre poetike ato përmbajnë marrëdhëniet e njeriut dhe bashkësisë njerëzore në raport me mjedisin ku jetojnë, të cilët shpërfaqen duke bashkëjetuar me njëra-

tjetrën dhe shprehur edhe tipare etnosociale dhe krahinore.

Në mjaft studime evropiane dhe ato shqiptare vihen në dukje se elementët e të jashtëzakonshmes në përrallë, herë –herë barazohen me element fantastikë. Por kohët e fundit studimet folklorike kanë nxjerrë në dritë në disa raste se fantastikja edhe pse njësohet me elementë mitologjikë dhe fetarë, ajo nuk mund të barazohet më të, pasi mjaft subjekte dhe figura mitologjike në përrallën tonë janë kthyer në figura artistike.

Literatura

KAJTAZI, Halil (1972), *Proza popullore e Drenicës*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë 1972.

KURTI, Donat (1942), *Përralla kombtare*, Bleni i parë, Botimi i dytë, Shkodër.

KURTI, Donat O. F. M. (1942), *Prralla kombtare*, mbledhë prej gojës së popullit, Ble

II, Shkodër, Shtyp. "A. Gj. Fishta", 1942.

KURTI, Donat, Palaj Bernardin etj. (redaktorë 1939), *Visaret e kombit*, vëll. i IV, shtëpia botonjëse "Kristo Luarasi", Tiranë.

MBLEDHËS *të hershëm të folklorit shqiptar* (1635-1912), II, Instituti i folklorit, Tiranë, 1961.

MBLEDHËS *të hershëm të folklorit shqiptar* (1961), vëllimi 1, Instituti i folklorit, Tiranë.

MBLEDHËS *të hershëm të folklorit shqiptar* (1962), vëll. i tretë, Tiranë.

MEHMETI, Enver (1996), *Studime në fushën e letërsisë gojore*, Tetovë.

(1966), *Folklor shqiptar I, Praza popullore*, Vëllimi i dytë, Instituti i Folklorit, Tiranë.

(1966), *Folklor shqiptar I, Proza popullore* Vëll. III, Instituti i folklorit, Tiranë, 1966, f. 423-429,

LAMBERTZ, M., Mbi personazhet e përrallave shqiptare (përkthim në AIKP).

Menaxhimi i klasës dhe materialet autentike gjatë mësimit të gjuhës së huaj. Rasti i Gjuhës italiane

ELIONA NAQO

*Universiteti-Ismael Qemali-Valona
Fakulteti i Shkencave Humane
Departamenti i Gjuhëve të Huaja
eliona.naqo@univlora.edu.al*

Abstrakt

Klasa është njësia bazë strukturore e organizimit dhe funksionimit të shkollës. Nëse klasat nuk do të funksiononin, as shkolla nuk do të funksiononte. Në klasë, zhvillohet dhe realizohet procesi mësimor. Ora e mësimit është njësia bazë e procesit mësimor. Në funksion të parimeve, synimeve, qëllimeve dhe objektivave ndërtohen të gjitha veprimtaritë e klasës dhe të shkollës. Nxënësit, mësuesit, drejtuesit, specialistët, punonjësit, prindërit dhe gjithkush që ka ndikim dhe që duhet të përfshihet në jetën shkollë, përbëjnë kapacitetet e burimeve njerëzore. Organizimi, përfshirja dhe menaxhimi i këtyre burimeve njerëzore nuk është dhe aq e lehtë. Në kushtet e një shkolle të hapur menaxhimi merr një rëndësi parësore, ku menaxhimi i klasës është thelbi i tij.

Abstract

The classroom is the basic structural unit of school organization and operation. If the classrooms didn't work, the school wouldn't work either. In the classroom, the learning process is developed and realized. The lesson is the basic unit of the learning process. In function of principles, goals, and objectives, all classroom and school activities are built. Students, teachers, principals, specialists, employees,

parents, and everyone who has influence and should be involved in school life, constitute the capacities of human resources. The organization, involvement, and management of these human resources is not so easy. In the conditions of an open school, management takes a primary importance, where classroom management is, its essence.

Cfarë kuptojmë me menaxhim klase ?

Vendosja e rregullit në klasë për zhvillimin normal të mësimit sipas planifikimit është synim dhe shqetësim për çdo mësues. Në të gjithë jetën historike të shkollës, problem i kontrollit mbi klasë dhe mbi nxënësin ka qenë dhe mbetet problem diskutimi. Në klasë ka nxënës që janë të suksesshëm në aritjet e tyre akademike, ka edhe nxënës që kanë arritje të dobta, ka nxënës që i binden mësuesit dhe nxënës që nuk i binden mësuesit po prishin orën e mësimit apo nuk zbatojnë rregullat e klasës. Mësuesit shpesh përballen me sjellje problematike të nxënësve, ku ndërhyrjet për zgjidhjen e tyre krijojnë edhe konflikte apo përfshirjen edhe të drejtuesve, prindërve apo psikologut. *Jacob Kounin, një psikolog biheviрист, në vitin 1970 kreu një studim në shkolla pikërisht mbi këtë çështje. Në fund të këtij*

studimi ai arriti në përfundimin se në shumicë e rasteve këto situata problematike krijohen nga vetë mësuesi. Ndërhyrjet e mësuesit shpesh nuk janë korrekte dhe në mënyrë profesionale. Nëpërmjet këtij studimi, Kounin na mëson se si kombinohen disiplina dhe të mësuarit në një klasë që funksionon në mënyrë korrekte. Organizimin dhe planifikimin, Kounin i konideronte si çelës për angazhmin e nxënësve në klasë. Mësuesi dëshiron mbarëvajtjen e orës së mësimit prandaj logjika e tij për menaxhimin efektiv të klasës duhet të fokusohet në disiplinën parandaluese të shkeljeve disiplinore. Marrëdhëniet midis menaxhimit efektiv dhe mësimdhënies efektive përbën urën e mbarëvajtjes së orës së mësimit. Në këtë mënyrë, Kounin e zgjeroi kuptimin mbi menaxhimin përtej kontrollit të sjelljes së mësuesit nëpërmjet rregullave shtrënguese. Menaxhimi i nxënësit nuk është qëllim në vetvete, pasi ai është mbi gjithë mjedisin e të nxënësit, kurrikulës dhe vetë mësuesit.

2.1. Qëllimet e menaxhimit të klasës

Një nga qëllimet e menaxhimit të klasës është mbajtja në vazhdimësi e një mjedisi mësimor pozitiv dhe të frytshëm. Të përdorësh teknikat e drejtimit të klasës thjesht për t'i mbajtur nxënësit të rrinë urtë e butë, është joetike. Atëherë, ç'kuptim ka të punosh kaq shumë për të drejtuar klasën?

Ekzistojnë të paktën tri arsye.

- 1- E drejta e pjesmarrjes në procesin mësimor. Çdo veprimtari në klasë ka rregullat e veta për pjesmarrjen e nxënësve në to. Nganjëherë këto rregulla deklarohen qartë nga mësuesi, por shpesh janë të nënkuptuara, jo të deklaruara. Mësuesi dhe nxënësit, madje, mund të mos jenë të vetëdijshëm se janë duke ndjekur rregulla të ndryshme, për veprimtari të ndryshme (Berliner, 1983). Në një grup leximi, për shembull, nxënësit ndoshta duhet të ngrenë dorën për të brë një koment, por, në një grup që bën veprimtari të lirshme në të njëjtën klasë, mjafton që nxënësit të kenë miratimin me sy të mësuesit që të flasin. Rregullat që

përcaktojnë se kush mund të flasë, mbi çfarë duhet të flasë, kur dhe kujt t'i drejtohet, si dhe sa gjatë mund të flasë, shpesh quhen struktura të pjesmarrjes. Për të arritur qëllimin e parë të drejtimit të mirë të klasës duhet t'u japim të gjithë nxënësve mundësi për të mësuar, të sigurohemi që gjithsecili të dijë sesi të marrë pjesë në veprimtaritë e klasës. Element kyç është të qenit në dijeni.

2- Kohë e dedikuar.

Duke i dhënë më shumë kohë procesit të të nxënësit, nuk çon automatikisht në arritje mësimore. Për të qenë e vlefshme, koha duhet të përdoret me shumë efikasitet. Siç e dimë, mënyra sesi nxënësit e përpunojnë informacionin është faktor qëndror për cka ata mësojnë e memorizojnë. Në thelb nxënësit mësojnë atë që ushtrojnë dhe rreth secilës mendojnë. Koha e shpenzuar aktivisht në detyra mësimore specifike shpesh quhet kohë e angazhuar, nganjëherë edhe kohë në punë. Megjithatë edhe koha e angazhuar nuk e siguron apo garanton të nxënësit. Nxënësit mund të rropaten me një material që mund të jetë tepër i vështirë ose përdorin strategji mësimore të gabuara. Kur nxënësit janë duke punuar me një normë të lartë suksesi, duke nxënë e kuptuar vërtet, ne e quajmë kohën e shpenzuar *kohë e të nxënësit mësimor*. Kësisoj, qëllimi i dytë i menaxhimit të klasës është që të rritet koha e të nxënësit mësimor, duke i mbajtur nxënësit të angazhuar aktivisht në veprimtari mësimore të vlefshme dhe të pershtatshme.

3- Menaxhimi i vetdrejtimit.

Qëllimi i tretë i çdo sistemi menaxhimi është t'i ndihmojë nxënësit të bëhen të aftë për të drejtuar veten. Në qoftë se mësuesit fokusohen përgjatë rrugës së tyre në edukimin e nxënësve që t'u nënshtrohen rregullave, ata do të shpenzojnë shumë nga koha e mësimdhënies, të nxënës, duke mbikëqyrur e korrigjuar. Do të vijë një çast që nxënësit do ta shohin qëllimin e shkollës thjesht si zbatim rregullash dhe jo si ndërtim kuptimesh të thella të njohurive

mësimore. Kurse strukturat e të nxënës kompleks si, fjala vjen, të nxënës bashkëveprues ose problemzgjidhës, kërkojnë vetëdëjtimin e nxënës. Bindja ndaj rregullave nuk mjafton për të bërë që këto struktura mësimore të funksionojnë. (McCaslin & Good, 1999). Tom Savazhi (1999) e shpreh thjeshtë : « *Qëllimi më themelor i disiplinës është kultivimi i vetëkontrollit. Njohuritë akademike dhe aftësitë teknologjike do të jenë pa shumë rëndësi, në qoftë se personave që I zotërojnë u mungon vetëkontrolli.* » Përmes vetëkontrollit nxënës shfaqin përgjegjësi.

2.2. Faktorët që ndikojnë në menaxhimin e klasës

Sipas stdimeve të kryera në fushën e menaxhimit, dy janë cilësuar si faktorët më të rëndësishëm:

- ❖ projektimi i orës së mësim, organizimi i saj me të gjithë elementet didaktike
- ❖ qëndrimi i mësuesit.

Të gjitha programet mbi temën mësimore janë të ngjashme sipas kurrikulës së caktuar, por rëndësi ka kush është mësuesi. Ai i jep jetë dhe i bën mësimet e dobishme për nxënësin. Për të menaxhuar klasën me sukses dhe për të drejtuar me efikasitet dhe efektivitet procesin mësimor, mësuesi duhet të planifikojë para se të fillojë viti i ri shkollor. Ndaj është e nevojshme që të familjarizohet me lëndën, mjedisin dhe kolegët, si dhe të jetë i ndërgjegjshëm për stilet e mësimdhënies dhe filozofinë mësimore që do të përdorë. Ky planifikim dhe parashikim i "grackave të mundëshme", e ndihmon mësuesin më afatgjatë. Në këtë mënyrë mësuesi është një hap para, duke paraprirë rreziqe dhe të papritura. Menaxhimi i klasës duhet konceptuar si një kompozim projektesh dhe sfidë për të drejtuar me sukses.

Për këtë mund të ndiqen hapat e mëposhtëm:

- ✓ Identifikohen anët e forta dhe nevojat për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien.
- ✓ Formulohet një vizion i qartë mbi klasën tuaj ideale.
- ✓ Bashkëpunohet me të tjerët për të arritur vizionin.

- ✓ Përgatitet një plan drejtimi dhe organizimi i klasës.
- ✓ Monitorohet plani i menaxhimit të klasës duke përcaktuar ndjekjen e tij, si dhe përshtatet kur është e nevojshme.
- ✓ Vlerësohet niveli i arritjes së planit lidhur me vizionin e dëshiruar.
- ✓ Festohet suksesi me nxënësit.
- ✓ Etj.

Mësuesi do që të jetë i kënaqur nga puna e tij. Kjo kënaqësi të lidhet me efektivitetin e tij në marrëdhënie me nxënësit dhe rezultat e tij të pritshme me klasën. Mirëpo, që mësuesi të jetë efektiv ai duhet të kuptojë se menaxhimi i klasës realizohet nëpërmjet disiplinës parandaluese jo të zgjidhjes apo vënies në kontroll të situatës pasi ka ndodhur problemi. Për t'iu paraprirë situatave të papranueshme *Kounin rekomandon disa ide kyçe në menaxhimin e klasës.*

Ø Efekti i valëzimit

Efekti i ndikimit të ndërhyrjes së mësuesit te një apo disa nxënës në sjelljen e nxënësve të tjerë. Ky efekt ka edhe ndikim negativ dhe ndikim pozitiv. Ndikim negativ ka kur mësuesi ndikon në prishjen e klimës në klasë. Ai qorton një nxënës duke ndikuar tek nxënësit e tjerë. Efekti i valëzimit mund të ndikojë edhe në mënyrë pozitive. E tillë është teknika e tërheqjes së vëmendjes pa e identifikuar nxënësin. Mësuesi lavdëron sjelljen e përshtatshme të nxënësve duke parë nga nxënësit që bëjnë shkeljen. Kjo teknikë ka efekt kryesisht në moshat e reja shkollore.

Ø Withitness (Të jesh me nxënësin)

Kjo ide i referohet vetëdijes së një mësuesi për atë që po ndodh në klasë. Një mësues ka "withnes" nëse mësuesi e di se çfarë po ndodh në klasë gjatë gjithë kohës. Ai ka aftësinë të shikojë "nga shpina", e di në çdo moment se çfarë po bëjnë nxënësit e tij edhe pa praninë e tij.

Ø Përballja me situatat e dyfishta.

Në këtë ide përmbledhet aftësia e mësuesit për t'iu përfshirë njëkohësisht në disa aktivitete. Kur mësuesit në mënyrë efektive mund të priren për dy ose më shumë ngjarje në të njëjtën kohë, ai duhet të ndërhyjë në kohën e duhur në situata të

caktuar që vatra e hapur mos të krijojë situata problematike në klasë.

3. Tipologji të komunikimit në klasë

Veprimtaria ligjërimore në klasë ka pikësnyime të ndryshme dhe merr forma të larmishe. Megjithatë, synimi kryesor është aftësimi i nxënësve për t'u shprehur lirisht në akte ligjërimore autentike, në përshtatje me situatën. Realizimi i një qëllimi të tillë nuk është i lehtë, sepse kërkon para së gjithash zotërim të një bagazhi leksiko-gramatikor të mjaftueshëm për zhvillimin e ligjërimit gojor. Gjatë punës në klasë mund të përdoren dhe të alternohen me njëri-tjetrin katër elemente komunikimi, cituar më poshtë

1. Komunikimi didaktik
2. Komunikimi imituar
3. Komunikimi i simuluar
4. Komunikimi i mirëfilltë (autentik)

Midis këtyre katër tipave të ligjërimit ka dallime të mëdha, por ka edhe lidhje të brendshme dialektike. Kështu, nuk mund të kalohet tek komunikimi i mirëfilltë pa kaluar shkallë-shkallë etapap paraprirësë.

- Ligjërimi didaktik përbën tipin e parë të komunikimit në klasë, i cilin përfshin pyetjet, kërkesat për kuptimin e mësimit, përvetësimin e tij, kontrollin e njohurive të nxënësve, qofshin këto të natyrës leksikore, gramatikore apo të përmbajtjes tematike. Ky tip komunikimi, ku rolin kryesor e luan mësuesi lidhet me organizimin e punës në klasë, duke përfshirë kështu të gjitha manipulimet e gjuhës qoftë letrare apo e disiplinave të tjera shkollë.
- Ligjërimi i limituar (riprodhues) është tipi i dytë i ligjërimit që përdoret në klasë. Ai karakterizohet nga të mësuarit përmëndesh dhe riprodhim i dialogjeve, teksteve, përsëritja e modeleve të dhëna nga mësuesi etj. Ky tip komunikimi synon të familjarizojë nxënësit me gjuhën e përdorur në klasë.
- Ligjërimi i stimuluar kërkon më tepër imagjinatë dhe nismë nga ana e nxënësit, sepse ai duhet të reagojë spontanisht në situata analoge, në debate e diskutime, në

lojëra të krijuara artificialisht e të nxitura nga mësuesi. Në këtë rast rritet pavarësia e nxënësit dhe studentit, megjithëse ajo nuk është e plotë.

- Mësuesi vihet në rolin e regjisorit të orës së mësimit. Organizimin e së cilës ai e ka menduar paraprakisht. Komunikimi i stimuluar krijon kushtet për të kaluar në komunikimin e mirëfilltë (autentik).
- Ligjërimi i mirëfilltë (autentik) është komunikimi i lirë, i pavarur. Nxënësit dhe studentët marrin fjalën me nismën e tyre në fazat e ndryshme të organizimit të punës së grupit Ligjërimi i mirëfilltë përbën shkallën më të lartë të komunikimit, i cili realizohet sidomos në biseda të lira gjatë orës së mësimit ose jashtë saj. Mund të flasim për komunikimin autentik edhe në diskutimet midis anëtarëve të grupit për realizimin e ushtrimeve të ndryshme krijuese, gjatë debateve të punës me grupe për zgjidhjen e detyrës që ka dhënë mësuesi.

3.1 Drejtimi i klasës

Nje numër i madh studjuesish dhe kërkuesish në fushën pedagogjike kanë këmbëngulur në rolin vendimtar që luajnë veprimet e mësuesit në klasë dhe në mënyrën se si e organizon ai mësimin. Një nga pionierët e kësaj rryme pedagogjike është edhe amerikanin *Jacob Kounin (C.M. Charles 1997)*. Duke parë që komentet dhe diskutimet mbi sjelljet e nxënësve nuk janë bindëse, ai mendon se rolin themelor në këtë drejtim e ka menaxhimi i klasës nga mësuesi. Në këtë rast kemi një përmbysje të perspektivës, nuk bëhet më fjalë për ndëshkim të nxënësve që mund të shfaqnin sjellje të qendrimeve të padisiplinuara e të papërshtatshme për arsye psikologjike e sociologjike shkaktohet e të cilave mund të mos kenë fare lidhje me shkollën apo me klasën, por me faktorë jashtë tyre. Rregulli, disiplina apo rrëmuja dhe mungesa e disiplinës do të varehin nga organizimi i punës dhe nga veprimet apo mosveprimet e mësuesit në klasë.

4. Konfliktet. Rregulla që ndihmojnë për të zgjidhur konfliktet në klasë

Jeta e përditshme në shkollën fillore na jep shumë shembuj të situatave konfliktuale.

Shumica e konflikteve bazohen në qëndrimet e përgjithshme të nxënësve ose në paaftësinë e tyre për të përballuar presionin. Shembuj të situatave konfliktuale janë:

- marrje ose fshehje e gjërave të dikujt;
- shtyrje ose prekje pa dashje;
- lojëra nervash me njëri-tjetrin;
- nuk i lë të qetë shokët e tjerë të klasës;
- ngacmime të ndërsjella;
- forma të rënda ngacmimesh si rrahje ose dhunë/abuzim emocional. fizik.

Nxënësit në këtë moshë, për zgjidhjen e konflikteve, përdorin strategji të ndryshme nga ato që përdorin të rriturit. Strategjitë ndryshojnë në varësi të moshës së nxënësve. Më të vegjlit kanë prirjen për të zbatuar strategji të tilla, si:

- reagime fizike (duke goditur etj.),
- reagime agresive, zënka me zë të lartë, duke thirrur një të rritur për ndihmë, duke u larguar nga skena e konfliktit, duke hequr dorë dhe tërhequr, duke bërë sikur nuk ka ndodhur asgjë ose me një gjest simbolik (*një shtrëngim duarsh, një dhuratë etj.*).

Nxënësit më të rritur të shkollave fillore (mosha 10 vjeç e lart) kanë prirjen të përdorin strategji të ndryshme në zgjidhjen e konflikteve të tilla, si:

- duke injoruar konfliktin,
- duke folur me njëri-tjetrin,
- duke kërkuar një zgjidhje në interes të përbashkët që merr parasysh të dyja qëndrimet,
- duke kërkuar kush ka të drejtë, për rrjedhojë kush ka *"fituar, si dhe duke negociuar derisa të gjithë të përfshirët në të, të mbeten të kënaqur me zgjidhjen.*

Ekspertët bëjnë dallimin ndërmjet tre llojeve kryesore të zgjidhjes së konflikteve:

- zgjidhja fizike e konfliktit;
- zgjidhja e njëanshme e konfliktit (duke e bërë një veprim "sikur nuk ka ndodhur", pajtim me gjeste simbolike ose me dhurata);
- zgjidhja konflikteve përmes bashkëpunimit (reflektimi ose aftësia për të parë dy këndvështrime).

Zgjidhja e problemeve do të ndikojë në një grup më të gjerë njerëzish, nëse ato i përkasin

kategorisë së problemeve ose konflikteve të përbashkëta dhe, në të njëjtën mënyrë, zgjidhja e një problemi ose konflikti individual duhet të ndikojë vetëm individin dhe jo në dikë tjetër. Në shkollën fillore, konfliktet si ato të përshkruara më sipër, shpesh mund të lindin për shkak të infrastrukturës (nuk ka hapësirë të mjaftueshme), gjinisë (marrëdhëniet vajzë-djalë), punës së përbashkët (shpejtësi të ndryshme në punë, nivele të ndryshme etj.) ose si pasojë e sjelljes sociale (nuk e lejon dikë të mbarojë së foluri etj.). Kur zhvillohen këto katër mësimet rreth konfliktit, mësuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se trajtimi i gjërave që nuk shkojnë mirë në klasë nuk është e mundur të realizohet në vetëm një mësim. Pavarësisht nga mënyra e formulimit dhe e miratimit të rregullave të klasës ose rregullave të komunikimit, problemet dhe konfliktet mundet të ndodhin përsëri. Prandaj, konfliktet dhe zgjidhja e tyre, si dhe ndërgjegjësimi për problemet që mund të ndodhin në jetën e përditshme shkollore, duhet të trajtohet në vijimësi. Vetëm nëse nxënësit bëhen pjesëmarrës aktivë në diskutimin e krijimit të rregullave, ata do të jenë në gjendje të identifikohen me to.

Përfundime

Arsimi në përgjithësi, por ai shqiptar në veçanti është prej dy dekadash në një proces ndryshimesh të thella dhe komplekse. Ndryshimet në mësimdhënie dhe të nxënin, janë ndër ndryshimet e rëndësishme të këtij procesi. Gjithnjë e më shpesh mësimdhënia ndërvepruese është në qendër të zhvillimeve të sotme në arsim. Ajo i përgjigjet prirjes së sotme botërore për ta shndërruar klasën në një mjedis të gjallë, ku, në vend të dhënies së informacionit, kultivohen shprehjet për gjetjen, kërkimin e pavarur të tij, diskutohen çështje në këndvështrime të ndryshme, analizohen ato, identifikohen problemet dhe punohet bashkërisht për zgjidhjen e tyre.

BIBLIOGRAFIA

1. Musai, Bardhyl (2014). *Metodologji e mësimdhënies, botimi i dytë. Rruga Jordan Misja, Pallatet Gener 2, Tirane: Bardhyl*

- Musai. fq. 329–356. ISBN 978-99927-822-2-6*
2. *Haloçi, Andromaqi (2010). Mardhëniet në klasë. Tiranë: Shtëpia botuese e Librit Universitar. fq. 73–74. ISBN 978-99927-0-546-9.*
 3. *Emmer, E., Evertson, C., Clements, B., & Worsham, M. (1997). Managing problem behaviors. In Classroom management for secondary teachers. Needham Heights, MA: Allyn and Bacon.*
 4. *Edwards, D. and Mercer, N. (1987). Common knowledge: the development of understanding in the classroom London: Methuen*
 5. *Grup autorësh. (1999). Metoda të mësimdhënies: Manual për mësuesit e rinj, AEDP, Toena, Shtypshkronja LAERT, Tiranë.*
 6. *Beauchamp, G., & Kennewell, S. (2008). The influence of ICT on the interactivity of teaching, Education and Information Technologies, Volume 13 Issue 4, f. 305-315.*
 7. *Black, P. J., & Wiliam, D. (1998). Assessment and classroom learning. Assessment in Education: Principles Policy and Practice, 5(1), f. 7-73.*

Momente të ndikimit reciprok dhe të identifikimit të filozofisë me pedagogjinë

Dr. Jak Simoni

Doc.Dr. Ambera Duka

Universiteti "Aleksandër Moisiu"

Durrës

Abstrakt

Të studiosh filozofi, kryesisht etikë, do të thotë të merresh dhe me pedagogji dhe anasjelltas. Bazat e hershme të këtyre dijeve gjenden në Greqinë e Lashtë, gjithashtu dhe shpjegimi etimologjik tek greqishtja e lashtë. Shumë filozofë që në antikitet kanë kontribuar në mënyrë të dyfishtë, duke lenë gjurmë të rëndësishme në historinë e filozofisë dhe të pedagogjisë. Gjithashtu rryma të ndryshme filozofike si racionalizmi, idealizmi, empirizmi, marksizmi, pragmatizmi kanë ndikuar vazhdimisht tek pedagogjia, ku ka pasur momente që këto dije janë shkruar në një, si në rastin e pedagogjisë pragmatiste të J. Dewey. Me pragmatizmin bie mënyra metafizike e te menduarit dhe filozofia e pedagogjia fillojnë e merren me problematika reale të njerëzimit, përfshi dhe efektet negative si tek njeriu, ashtu dhe tek mjedisi, të progresit dhe të zhvillimit të papërmbajtur që shfrytëzon pa kriter pasuritë natyrore dhe burimet njerëzore. Në këto kushte bëhet i domosdoshëm ndërgjegjësimi për këtë shfrytëzim, për ndotjen globale dhe për rëndësinë e edukimit mjedisor. Më pak fjalë ky është skeleti bazë rreth të cilit do të shtjellohet ky artikull.

Fjalë kyç: *pedagogji, filozofi e edukimit, pragmatizëm, J. Dewey, ekologji*

Hyrje

Arritjet njerëzore në fushën e dijes janë zhvilluar në drejtime të ndryshme që prej fillimeve të aktivitetit intelektual njerëzor, por në bazë kanë rrënjë të përbashkëta. Ndonëse njohja njerëzore është shumë më e hershme, një momenti mjaft i rëndësishëm, e për ne më i njohur, është lulëzimi i dijeve në periudhën klasike greke, ku filozofia merr një rëndësi të veçantë. Filozofia, ndonëse origjinën e ka nga kurioziteti për të njohur botën dhe principet

bazë të çdo qenie apo ekzistence në univers dhe u zhvillua nga filozofë që kishin interesa të

gjithanshme si në gjeometri, astronomi etj., shumë shpejt fillon e interesohet që të njohë mënyrën e sjelljes njerëzore, si në rastin e sofistëve që konsideroheshin mësues të virtytit. Në këtë kontekst roli i faktorit edukativ bëhet i rëndësishëm. Njeriu duhej të ishte i aftë për të ndarë të mirën nga e keqja, e cila duhej evituar e në këtë mënyrë formohej virtyti. Formimi i virtytit merr rëndësi me Sokratin, Platonin, Aristotelin, i cili e cilëson si një e mesme e artë ndërmjet dy veseve të kundërt. Trajtimi nga filozofia i veseve dhe virtyteve dhe çështjeve të tjera të etikës e bëjnë të domosdoshëm trajtimin e faktorëve edukativë. Etika zë një pozicion të ndërmjetëm ndërmjet filozofisë dhe shkencës së edukimit, sa që mjaft filozofë që kanë trajtuar çështje të etikës, kanë trajtuar dhe çështje të edukimit. Përhapja e rrymave të ndryshme filozofike gjatë gjithë historisë së saj ka ndikuar pozitivisht tek pedagogjia. Më stoikë virtyti dhe etika merr një rëndësi të veçantë, për arsye se qëndrueshmëria e vetëpërmbajtja që karakterizon stoikët duhej të arriheshin nëpërmjet edukimit. Epikuri nuk bënte kurrfarë dallimi duke përfshirë në shkollën e tij pa përjashtim gratë, fëmijët, të huajt dhe duke krijuar një komunitet miqësor. Një rol të rëndësishëm në aspektin edukativ ka dhënë dhe Seneka. Në mesjetë përgjithësisht filozofia unifikohet me teologjinë dhe edukimi do të jete në funksion të tyre. Tek autorët e mëvonshëm modernë e bashkëkohor kontributi bëhet akoma më i rëndësishëm. Rrymat filozofike si empirizmi, racionalizmi, iluminizmi, romantizmi kanë pasur një ndikim të madh në pedagogji. Padyshim se ndikimi i filozofisë tek pedagogjia është më i madh se anasjelltas, por nuk mohohen momente të ndikimit të pedagogjisë tek filozofia. Pika kulmore e këtij ndikimi është zhvillimi i filozofisë

pragmatiste, kryesisht me Dewey. Në zhvillimet bashkëkohore të këtyre disiplinave një rëndësi të veçantë merr diskutimi mbi pasojat negative të industrializimit dhe të zhvillimit të papërmbytur tek vetë njeriu dhe tek mjedisi, për rrjedhojë ndërgjegjësimi për situatën dhe edukimi mjedisor bëhen të domosdoshëm. Duke u bazuar në literaturë, kryesisht tek manuale të ndryshme si të filozofisë ashtu dhe të pedagogjisë, çështjet e lartpërmendura do të hartohet në mënyrë më të zgjeruar. Një vend të rëndësishëm në këtë artikull do të kenë autorët dhe rrymat me të spikatura filozofike të periudhave të ndryshme, deri tek ajo bashkëkohore, të cilat kanë trajtuar çështjet e lartpërmendura.

1. Origjina e hershme e raportit ndërmjet filozofisë dhe pedagogjisë

Siç u tha në hyrje të këtij artikulli, është e pamundur të studiosh historinë e filozofisë pa gjetur elementë që e ndërthurin me shkenca të tjera, kryesisht me pedagogjinë. Është e vërtetë se: "Nga filozofia janë shpërndarë degëzime të tjera"¹, siç shprehet një studiues italian, Vittorio Savini, në librin e titulluar *Fidarsi della logica*, por raporti me pedagogjinë është më i komplikuar, saqë kjo ndarje nuk ka qenë dhe ndoshta nuk mund të jetë kurrë tërësisht e mundur. Autorë që zënë vend si fillestarë të mendimit filozofik kanë trajtuar dhe çështje që kanë të bëjnë me edukimin. Moment i rëndësishëm i kësaj ndërthurje është momenti, kur filozofet e lashtë fillojnë e ndryshojnë orientimin e tyre nga kozmosi apo nga principet bazë të gjithçkaje në botë tek ekzistenca njerëzore; tek raporti me të tjerët, domethënë tek njeriu si pjesëtar i një qytet-shteti që për të funksionuar sa më mirë kishte nevojë që eksperiencën dhe arritjen e brezave t'ua transmetonte nëpërmjet edukimit brezave të tjerë. Sofisti i shquar Protagora e konsideronte *polisin* si një aparat kompleks edukativ, ku brezat do të trashëgojnë arritjet e tyre pasardhësve. Atëherë ekzistonte një mentalitet ku çdo i rritur kishte si detyrë edukative që eksperiencën e tij ta trashëgoonte tek të tjerët. Kthimi i vështrimit tek njohja e vetë njeriut si anëtar i *polisit* bëhet më i theksuar tek filozofi simbol i filozofisë, Sokrati e kryesisht tek Platoni. Njeriu duhej të parapërgatitej si anëtar i një bashkësie politikisht e organizuar e në këto kushte merrte rëndësi të veçantë procesi edukativ pa të cilin nuk është i mundur mirëfunksionimi i *polisit*. Mendimi edukativ i Platonit është i lidhur ngushtë me konceptimin e tij të *polisit*. Kryesisht tek libri i tij *Republika* konsideronte drejtësinë si virtyt kryesor, e cila

realizohet vetëm me ndarjen e drejtë të punëve, ku secili të kryente funksionin për të cilin është i përshtatshëm dhe për tu arritur kjo kërkohej një edukim i përshtatshëm. Për këtë Platoni ideon një proces mjaft të gjatë edukativ hallkat e të cilit do t'i kalonin një pas një, kryesisht drejtuesit e qytetit që, sipas tij, do i karakterizonte virtyti i dijes. Platonit i rikthehet shumë më vonë një tjetër idealist i shquar, por tashmë në botën gjermane, G. Hegel, në një libër të titulluar jo rastësisht *Platoni*. Natyrisht në qendër të vëmendjes së Hegelit ishte ethosi.. "Komuniteti bazohet mbi ethos, mbi traditën, që përbën shpirtin e individit, është të vepruarit etik të gjithsecilit"². Platoni, sipas Hegelit, do të edukojë këtë ethos. Jeta publike e shtetit ekziston vetëm në sajë të ethosit dhe ethosi ekziston në sajë të institucioneve³. Platoni është filozof i botës së ideve, por ideja më e lartë, sipas tij, është mirësia dhe edukimi do ta orientojë njeriun drejtë saj. Sipas tij, mjeti basë për të ruajtur shtetin është edukimi dhe formimi.

Kurse për Aristotelin qëllimi i edukimit është arritja e një stadi ku dishepulli kërkon të zgjerojë njohjen jashtë çdo interesi praktik. Ai, krahas kontributit të shumë thujse në të gjitha drejtimit e dijes, trajton gjerësisht vertytet. Sipas tij, vertyti etik nuk është i lindur por i fituar në jetë, ai ka të bëjë me zgjedhjen e mjetit të drejtë ndërmjet dy skajesh. Dhe për Aristotelin një vertyt i rëndësishëm është drejtësia. Sipas Aristotelit, çdo kërkim e në të njëjtën mënyrë çdo veprim ka si qëllim një të mirë, d.m.th. një qëllim final⁴. Ashtu si Platoni, që mendonte se ideja më e lartë është mirësia, dhe për Aristotelin qëllimi më i lartë identifikohet me të mirën më të lartë njerëzore, kështu roli i edukimit bëhet mjaft i rëndësishëm. Qëllimi më i lartë mbi të gjithë qëllimet tjera identifikohen me të mirën më të lartë njerëzore⁵. E mira më e lartë është identike si për individin ashtu dhe për qytetin, prandaj kjo e mirë trajtohet në relacion me qytetin, i cili është një i tërë ku individ i bën pjesë⁶.

Dhe rryma të tjera filozofike që lulëzojnë në filozofi si epikurizmi, stoicizmi, konsiderojnë me rëndësi rolin e edukimit. Madje Epikuri themeloi shkollën e tij ku merrnin pjesë pa përjashtim të huaj, skllëvër, gra dhe shkolla do ishte një ambient takimi miqësor. Pasi Greqia bëhet provincë e Romës, këto shkolla vijuan aktivitetin e tyre në Romë, ku në aspektin edukativ një rol të rëndësishëm ka Seneka. Në mesjetë kemi identifikim të filozofisë me teologjinë dhe në këto kushte edukimi duhej të ishte në funksion të tyre. Një moment i rëndësishëm për pedagogjinë do të jetë ndikimi i romantizmit

¹ Savini V. (2021) *Fidarsi della logica* Albatros, Roma 2021 f.47

² Hegel G. (2004) *Platoni*. Shtëpia botuese "Dritan", Tiranë f.311

³ Po aty f.315

⁴ Berti E. (1979) *Profilo di Aristotele*, Edizioni Studium, Roma f. 246

⁵ Po aty f. 247

⁶ Po aty f. 247

pedagogjik. Në fakt romantizmi është një rrymë letrare që lindi në gjermani, por që u përhap më gjerë dhe ndikoi si tek filozofia idealiste gjermane ashtu dhe tek pedagogjia. Duke qenë tërësisht e pamundur që të përmbledhen të gjitha momentet e afrimit apo të ndërthurjes së filozofisë me pedagogjinë, po përmendim vetëm disa autorë që kanë dhënë kontribut në si në filozofi ashtu dhe në pedagogji dhe disa rryma filozofike që kanë ndikuar tek shkenca e edukimit.

2. *Ndikimi i rrymave të ndryshme filozofike e letrare si iluminizmi, empirizmit, idealizmi, marksizmi tek pedagogjia.*

Rryma të ndryshme filozofike e letrare si empirizmi, romantizmi, iluminizmi, idealizmi, pragmatizmi etj., kanë pasur një ndikim të madh tek pedagogjia. Me empirizmin eksperiencia merr një rëndësi të veçantë si në njohjen filozofike ashtu dhe në edukim. Iluminizmi kërkon që të edukohet e të formohet një njeri që ka fatin e tij të lidhur ngushtësisht me shoqërinë, ku vetëm në këtë mënyrë del nga gjendja e mjerimit dhe e injorancës në të cilën ndodhet. Sipas iluministëve, roli i shoqërisë është mjaft i madh. Në këtë periudhë një kontribut të madh jep Rusoi, por mendimi i tij mbetet utopik. Këto rryma kanë ndikuar në çlirimin e pedagogjisë nga metafizika. Këtë çështje e trajtoi gjerësisht studiuesi italian, Franco Cambi, në librin e titulluar *Manuale di filosofia dell'educazione*. Ja si shprehët në këtë libër për këtë çështje: "Pedagogjia, e cila është zhvilluar në simbiozë shekullore me metafizikën, ka arritur ta shkundë nga supet këtë "zgjedhë". Dhe e ka bërë me një proces kompleks, fillimisht me një lidhje të fortë me empirizmin (nëpërmjet J. Lok që ka frymëzuar pedagogjinë e re të sh. XVIII dhe e ka lidhur me procese empirike, dhe të konstruktimit të mendjes e të individit - qytetar, duke e emancipuar me projekte universale e të domosdoshme të botës, të shoqërisë dhe të njeriut), pastaj nëpërmjet iluminizmit (nga Rusoi tek Kanti, duke kaluar për Diderot e për Condillac duke riafirmuar rëndësinë e individit natyror e të etikës sociale, nëpërmjet storicizmit dhe pozitivizmit (që kanë vendosur në qendër shoqërimin e njeriut dhe formimin e tij human social), pastaj pragmatizmi, marksizmi, ekzistencializmi etj., të gjitha filozofi që qëndrojnë matanë dhe kundër modelit metafizik, e anashkalojnë, duke i shënuar pedagogjisë një statut të shkencës empirike nga njëra anë dhe të shkencës historike (e politike) nga ana tjetër"⁷. Kjo frazë përshkruan rrugën e gjatë të zhvillimit të pedagogjisë që i korrespondon dhe emancipimit social të njeriut të ndikuar nga iluminizmi,

pragmatizmi, marksizmi, ekzistencializmi etj. Autori rreshton të gjitha rrymat që kanë ndikuar pozitivisht në çlirimin nga metafizika.

Natyrisht se ka dhe rryma të tjera si idealizmi që nuk ndikon në këtë drejtim, por në të kundërt, gjithësi ja vlen të përmendim mendimin mbi pedagogjinë të përfaqësuesit kryesor të idealizmit, G. F. Hegel. Siç e përmendim kur folëm për trajtimin që Hegeli i bën Platonit, interesi i tij për ethosin dhe për edukimin është mjaft i madh. Në librin *Filozofia e të drejtës* Hegel është shprehur: "Veprimi lind nga një dëshirë ku qëllimi është mirëqenia. Ethosi i familjes flet guhen e këtij uniteti; aty pasqyrohen martesë, prona, edukimi i fëmijëve"⁸. Kurse në mënyrë specifike për pedagogjinë ai është shprehur: "Pedagogjia është arti i të bërit etik të njeriut: ajo konsideron njeriun natyror dhe i tregon rrugën për të rilindur e për të ndryshuar natyrën e tij të parë, në një të dytë, shpirtërore"⁹. Këndvështrimi hegelian i edukimit patjetër që është metafizik dhe do të gjejë oponentë si nga e majta marksiste ashtu dhe nga pragmatizmi etj. Marksi kritikon konceptimin idealist të pedagogjisë i cili, siç u tha, është ndërtuar mbi modele abstrakte. Sipas tij, edukimi ka karakter klasor; është shprehje e kulturës së klasës në fuqi. Modele, në dukje ideologjike, janë veshje të interesave materiale të klasës. Një kritikë rrënjësore ndaj Idealizmit pedagogjik të Hegelit, që konceptonte dhe edukimin si një zhvillim në vetvete, i kanë bërë filozofët pragmatistë, kryesisht J. Dewey. Për këtë çështje do të flasim në paragrafin e mëposhtëm.

3. *Ndikimi i pragmatizmit: identifikimi i filozofisë me pedagogjinë*

Siç u tha, një ndikim mjaft domethënës tek pedagogjia ka filozofia pragmatiste që përbën një ndryshim radikal në historinë e filozofisë me autorë si Peirce, James, Dewey etj. James besonte tek filozofia dhe konsideronte pragmatizmin si një agim të ri. Ja si shprehet ai për filozofinë: "Filozofia është më sublimja e arritjeve njerëzore. Çka përfitohet prej saj nuk është diçka materiale, por shpirti ynë mbushet me kurajë. Dhe sado që njerëzve të zakonshëm shpesh metodat e saj, sfidat, dyshimet, dhe dialektika mund t'ju duket e pakëndshme, asnjëri prej nesh nuk mund të ecë në jetë pa dritën që ajo dërgon në botëkuptimin tonë"¹⁰. Me këtë fazë përfshinë veten në radhën e filozofëve që konsiderojnë filozofinë një fanar ndriçues. Ai vë re gjithashtu një mungesë sinjeraliteti në diskutimet filozofike, ku thotë se baza më e fuqishme nuk përmendet asnjëherë¹¹. Ashtu si Shopenhauer e Niçe dhe James kritikon karakterin romantik të filozofisë:

⁷ Cambi F. (2000) *Manuale di filosofia dell'educazione*. Laterza, Milano f.54

⁸ Gennari, M. (2005) *Filosofia della formazione dell'uomo* Bompiani, Milano f.544

⁹ Po aty f. 547

¹⁰ James W. (2005) *Pragmatizmi*, Plejad f.17

¹¹ Po aty f.18

"Spontanitetit romantik dhe guximit i ka kaluar koha; pamja që shpaloset është materialiste"¹². Sipas tij, njerëzit e shkencës parapëlqejnë t'i kthejnë shpinën metafizikës si një ndërtesë e izoluar që banohet vetëm nga fantazma, kurse njerëzit praktikë e shkundin pluhurin e filozofisë nga rrobat për të ndjekur natyrën¹³. Kjo filozofi e re lë mënjanë metafizikën. Ja si shprehet James: "Unë ofroj diçka me emrin e çuditshëm 'pragmatizëm' si një filozofi që mundet t'i kënaqë të dyja llojet e kërkesave. Pragmatisti mund të mbetet fetar si racionalist, por në të njëjtën kohë, si empirist, mund të ruaj afërsinë më të madhe me faktet. Shpresoj që shumë prej jush të krijojnë një mendim të mirë ashtu siç e kam unë"¹⁴. James mendon një filozofi të re, por kërkon një rrugë të mesme ku feja të vijojë të mbetet akoma e rëndësishme. Sipas James pragmatizmi zgjidh dilemat e filozofisë duke i thjeshtuar tek pasojat praktike: "Metoda pragmatike është, pikë së pari, një metodë për të zgjidhur mosmarrëveshje që nuk mund të zgjidhen ndryshe. Ka një apo shumë botë? Jemi të lirë apo të përcaktuar nga fati, dominon materialja apo shpirtërorja? Këto hapin diskutime pafund. Në këto raste metoda pragmatike përpigjet të interpretojë duke studiuar pasojat praktike"¹⁵.

Pragmatisti tjetër i shquar J. Dewey kritikon konceptimin hegelian si konceptim statik të jetës, sepse ajo që ka rëndësi është vetëm qëllimi final i procesit edukativ konsideruar si i pandryshueshme dhe i përkryer. Një trajtim interesant i mendimit pedagogjik të J. Dewey gjendet tek libri i lartpërmendur *Manuale di filosofia dell'educazione* i autorit italian, Franco Cambi, i cili thekson mënyrën e re të të bërit pedagogji: "Kështu mënyra për të bërë pedagogji – deduktive, mbi historike, e drejtuar për të zhvilluar modele përfundimtare – ka mbetur në hije, duke i lënë hapësirë një tjetër mënyrë të të bërit pedagogji: duke e lidhur me shkencat në mënyrë të veçantë me shkencat humane, nga të cilat merr orientim e mbështetje, që duhet t'i përdorë në mënyrë kritike si "burime" të saj, duke e riorganizuar sipas atij *telosi* që mbështetet në binomin edukim/formim. Dewey, i pari e më mirë se të tjerët, ka dhënë këtë skemë të re të dijës pedagogjike në të cilën çdo mbeturinë metafizike rezulton tërësisht e djegur"¹⁶. Pedagogjia e re që propozojnë pragmatistët duhet të jetë e spastruar nga mbeturinat metafizike, kryesisht ato hegeliane. Studiuesi italian gjithashtu trajton vendin që zë filozofia në raport me shkencat të tjera. Ja si shprehet për këtë çështje: "Pedagogjia është një dije që artikulohet ndërmjet shkencave dhe shoqërisë, lidhet me kërkimin shkencor dhe me etikën dhe

politikën, duke ndërtuar modelet e saj në këtë hapësirë të ndërmjetme, ngushtësisht e lidhur me kohën historike dhe me evoluimin e subjekteve, të dijës dhe të shoqërisë"¹⁷. Pedagogjia gjen vazhdimisht një hapësirë të ndërmjetme ndërmjet shkencave dhe shoqërisë. Franco Cambi thekson, se pas J. Dewey, këto karaktere të dijës pedagogjike janë forcuar si nëpërmjet rrymave të filozofisë empirike të edukimit, ashtu nëpërmjet atyre kritikave (të teorisë kritike të hermeneutikës), ashtu nëpërmjet kërkimeve ndërdisiplinore të zhvilluar rreth pedagogjisë, tashmë thuajse në një rol gati pilot në fushën edukative. Nga gjithë këto drejtime shkëputja nga çdo vokacion metafizik është konsideruar si qendrore dhe e pakthyeshme¹⁸. Shkëputja apo largimi i pedagogjisë nga metafizika nuk d.m.th. largim nga filozofia dhe për faktin se dhe filozofia ka ndryshuar dhe është bërë më pak metafizike. Përkundrazi, arrijtjet e filozofisë dhe të shkencave të tjera, kryesisht të atyre humane, kanë ndikuar tek arrijtjet e pedagogjisë dhe anasjelltas. Madje sipas J. Dewey, marrëdhëniet ndërmjet këtyre dijeve janë aq të ngushta, sa pedagogjia afrohet aq shumë me filozofinë, sa bëhet një filozofi e zbatuar. Por sipas Dewey filozofia e zbatuar, apo pedagogjia, do të ndikojë dhe tek jeta politike; konkretisht tek demokratizimi i shoqërisë. Për këtë filozofi italian, Franco Cambi, në një paragraf të titulluar *Pragmatizmi dhe problematizmi: teori e praktikë* të librit të lartpërmendur shprehet: "Pragmatizmi, në mënyrë të veçantë duke nisur nga Dewey – një pragmatist mjaft *sui generis*, pak i përkulur që të drejtojë mendimin tek veprimi, por i kujdesshëm për të shpëtuar autonominë dhe specifikën e konjektivës; kështu më mirë i përfaqësuar nga pozicioni instrumentalist, ashtu si vetë më vonë përcakton filozofinë e tij -, por akoma më përpara me James, me Peirce, me Mead, me Morris, pastaj me neopragmatistët (Quine, Davidson, Rorty etj.) ka fiksuar një lidhje precize me pedagogjinë, nëpërmjet teorisë së subjektit, interpretimin e mendimit, vizionin e shoqërisë demokratike"¹⁹. Kur bëhet fjalë për teorinë e tij të subjektit autori i referohet pragmatizmit ndërsa kur flet për interpretimin e mendimit, vizionin e shoqërisë demokratike i referohet pedagogjisë. Edukimi do të ushtrojë brezat për një shoqëri demokratike dhe të formojë një individ të gatshëm për bashkëjetesën tolerante e dialoguese.

Sipas J. Dewey, edukimin dhe demokratizimin ishin të lidhur ngushtësisht. Ja si shprehet për këtë: "Unë besoj – shkruante ai - se edukimi është metoda themelore për progresin shoqëror dhe reformimin e

¹² Po aty f.24

¹³ Po aty f.28

¹⁴ Po aty f.34

¹⁵ Po aty f.44

¹⁶ Cambi F. (2000) *Manuale di filosofia dell'educazione*. Laterza, Milano f.54

¹⁷ Po aty f. 55

¹⁸ Po aty f. 55

¹⁹ Po aty f. 70

tij"²⁰. Dhe në veprën tjetër *Demokracia dhe arsimit* J. Dewey pohon se shoqëria demokratike dhe arsimit demokratik janë pjesëmarrëse dhe në zhvillim, jo vetëm përgatitëse. Ai e shihte shkollën si miniaturë të shoqërisë, në të cilën nxënësit mund të mësonin dhe të ushtronin shprehitë dhe mjetet e nevojshme për jetesë demokratike²¹. Me gjithë lidhjet e ngushta të pedagogjisë me filozofinë, kryesisht me etikën dhe politikën, ka pasur momente ku pedagogjia ka kërkuar autonominë e saj. Për këtë do të flitet në paragrafin që vijon.

4. Pedagogjia në kërkim të autonomisë së saj

Kërkimi i lartpërmendur i autonomisë së pedagogjisë ka ndodhur në gjysmën e dytë të viteve nëntëqind. Krahas të tjerëve, këto momente i pikas më se miri studiuesi italian, Franco Fraboni, në librin e titulluar *Introduzione alla pedagogia generale* në të cilin ai shprehet: "në këtë rrugëtim asnjëherë i plotësuar në mënyrë përfundimtare, pedagogjia ka bërë përpara, midis kërkimit të pavarësisë dhe kërkesës për tu ndërthurur me disiplina të tjera. Me fjalë të tjera, ajo ka marrë formë si fushë e dijës e karakterizuar nga përplasja, lidhje dhe gërshetime me fusha të tjera të njohjes"²². Është kërkuar një autonomi nga studiuesit e kësaj fushe, por pa u shkëputur nga disiplina të tjera dhe kërkimi i kësaj autonomie ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin e saj. Autori merr një krahasim nga fusha e gjeografisë për të sqaruar raportin, ndërlidhjen apo ndërthurjen e filozofisë jo vetëm me pedagogjinë, por dhe me shkencat të tjera. "Në këtë kuptim, pedagogjia mund të interpretohet si shkencë kufitare ku koncepti i kufirit nënkuptohet jo si barrierë e ngurtë që kufizon dhe ndan, por, në të kundërt, si zonë kufitare e përbashkët, në të cilën ndërtohen dhe ndahen dijet midis disiplinave shkencore që, nga këndvështrime të ndryshme (dhe me aparate të ndryshme teorike dhe metodologjike), vështrojnë, reflektojnë dhe projektojnë rreth objekteve hulumtuese të përbashkëta"²³. Ndonëse autori nuk kufizohet vetëm tek filozofia dhe pedagogjia, por n. q. s. do të kërkojmë të përbashkëtat e këtyre disiplinave ato janë çështje që kanë të bëjnë me virtytin, moralin, politikën etj., që janë objekt i të dyja disiplinave. Ndërsa etika na tregon se çfarë janë virtytet pedagogjia trajton edukimin me virtyte. Për kërkimin e identitetit të pedagogjisë autori vazhdon: "Kështu, kërkesa për identitet nga ana e pedagogjisë paraqitet si një proces i hapur dhe në zhvillim të

vazhdueshëm, në të cilin pedagogjia përfaqësohet qartë nga një dëshirë për të qenë e ndikuar nga disiplinat tjera shkencore, por në të njëjtën kohë e zënë me përpunimin e pikëpamjeve të veçanta të pavarura. E gjitha kjo, duke përdorur dije deri tani të ardhura nga shkencat jo pedagogjike, por të interpretuara nën dritën e asaj që përbën objektin e kërkimit pedagogjik, ose përbën lidhjen ndërakteve arsim-edukim-formim"²⁴. Pedagogjia do të ketë si qëllim që të interpretojë në dritën e saj dijet që merr nga shkencat të tjera jo pedagogjike. Sipas studiuesit italian, takimi i pedagogjisë me metodën shkencore shfaqet me një ngarkesë progresiste e demokratike të destinuar për të pasur një ndikim të madh në debatin mbi ri përcaktimin e disiplinës pedagogjike²⁵. Për çështjet që kanë të bëjnë me demokratizimin dhe lidhjes së tij me edukimin, siç e përmendëm në paragrafin e lartpërmendur, një kontribut të rëndësishëm kishte dhënë J. Dewey.

Çështjen e autonomisë së pedagogjisë, apo dhe të raportit të saj me shkencat të tjera, kryesisht me filozofinë, e ka trajtuar dhe autori tjetër italian, Franco Cambi, të cilin e përmendëm në dy paragrafët e më sipërm. Ky studiues në librin *Manuale di filosofia dell'educazione* trajton disa autorë dhe bashkëkombës si R. Massa, Banfi etj. Për këtë të fundit shprehet: "Banfi e ka shikuar pedagogjinë si shkencë filozofike, por të ushqyer nga shkencat të ndryshme e të rakorduar me atë që është specifike për të e pikërisht binomi edukim/formim, duke i lënë idesë së formimit një prioritet në të gjitha proceset edukative²⁶. Dhe nga kjo frazë kuptojmë rolin e rëndësishëm të shkencave të tjera për pedagogjinë dhe rëndësinë që ka formimi. Sipas F. Cambi, Banfi na ka lënë një imazh njëkohësisht të dendur dhe të hollë të pedagogjisë, ri menduar – në mënyrë fenomenologjike e kritike - brenda dhe në shërbim të proceseve edukuese, duke i dhënë një farë kuote autonomie, qartësie teoretike, ndërgjegje racionale kritike-dialektike që duhet ta dallojë si dije teorike, kritike e shkencore²⁷.

Tek zhvillimet e mëtejshme të pedagogjisë ndikojnë dhe zhvillime të tjera të filozofisë dhe sociologjisë si kritika frankfurtiane e shoqërisë, sipas të cilës edukimi është tërësisht në funksion të interesave ekonomike. Gjithashtu ndikojnë dhe disa autorë të tjerë që trajtojnë pasojat e progresit si tek qenia njerëzore ashtu dhe në mjedis dhe nevojën e

²⁰ Dewey J. (2003) *Shkolla dhe shoqëria* perkth. Shqip Plejad Tiranë. F.27

²¹ Ornstein A. Hunkins P. (2003) *Kurrikula Baza, Parime dhe probleme* Perkth. Instituti i Studimeve Pedagogjike Tiranë f.67

²² Fraboni F. *Introduzione alla pedagogia generale* Laterza 2003 f.15

²³ Po aty

²⁴ Po aty

²⁵ Po aty f.18

²⁶ Cambi F. (2000) *Manuale di filosofia dell'educazione*. Laterza, Milano f. 72

²⁷ Po aty

ndërgjegjësimi dhe të edukimit ekologjik. Këto çështje do të trajtohen në paragrafin tjetër.

5. *Pasojat e progresit dhe të shoqërisë së konsumit: edukimi i përgjegjësisë dhe kujdesit ndaj mjedisit.*

Filozofia, sociologjia dhe pedagogjia bashkëkohore janë mjaft të ndikuara nga çështje që kanë të bëjnë me pasojat e industrializimit dhe zhvillimit të papërmbytur ekonomik si tek vetë njeriu, ashtu dhe tek mjedisi. Filozofë, sociologë e studiues të pedagogjisë i bëjnë jehonë ndërgjegjësimi ekologjik dhe kërkojnë të zgjojnë ndjenjën e përgjegjësisë ndaj situatës kritike nga ndotja globale. Situata është bërë kritike, sepse në emër të krijimit të kushteve maksimale momentale të njeriut shkatërrohet pa kriter mjedisi. Së fundmi më shumë flitet për pasojat e industrializimit në natyrë, duke lënë gati në harresë pasojat tek njeriu që modifikohet apo deformohet shpesh dhe pa e kuptuar. Duke modifikuar tërësisht mjedisin, njeriu harron se është modifikuar tërësisht dhe vetë. Si për çdo problem dhe për këtë ka pikëpamje të ndryshme, ku ca janë optimiste e ca pesimiste. Një pjesë e intelektualëve, studiuesve, opinionistëve gjithë këtë progres e konsiderojnë si normal pozitiv që rrit mirëqenien e njeriut në tokë dhe zvogëlojnë rrezikun e pasojave. Optimizmi dhe besimi tek shkenca, më mirë të themi papërgjegjshmëria njerëzore, ka shkuar deri në atë pikë që është thënë: po të shkatërrojmë Tokën, do të kolonizojmë Hënën dhe Marsin, ndonëse në Mars është shumë larg zbarkimi i njeriut. Studiues të tjerë mendojnë se pasojat e veprimit njerëzor konsiderohen katastrofike për ambientin dhe kërkohej ndërhyrje. Paraprakisht ndërhyrjes kërkohej ndërgjegjësimi për situatën dhe në planin edukativ edukimi i kujdesit ndaj mjedisit. Për sa i përket rritjes së konsumit të pakufishëm të të mirave materiale deri para ca kohësh filozofë, sociologë e antropologë flisnin për shoqëri konsumi, tani flitet për shoqëri shpërdorimi, madje për një shpërdorim qesharak. Paradoksalisht tregu nuk kufizohet të plotësojë nevojat, por shpik nevoja artificiale dhe pastaj krijohet një garë se kush i plotëson më shumë; një garë shpërdorimi. Për të përmendur vetëm ca: industria e makinave, tekstile, e modës, ushqimore, e lodrave të fëmijëve, madje dhe martesat, varrimet, sporti, etj., janë kthyer tërësisht në funksion të industrisë; madje dhe prodhimi i mjeteve didaktike nuk është në funksion të pedagogjisë por të industrisë. Shpërdorim i tepruar, më shumë për modë dhe për interesat e atyre që përfitojnë, sesa për nevojë. Konsiderohen pastaj "normale" pasojat jo vetëm në mjedis, por dhe kur rezultojnë materiale

kanceroze të përdorura në industri, madje dhe në atë ushqimore dhe tek lodrat e fëmijëve. Imponohet në shoqëri një stil jete që nxit konsumin ose më mirë bën konsumin qëllim në vetvete. Me çështje të kësaj natyre janë marrë disa autorë, ku një prej tyre është ekonomisti kanadezo-amerikan J. Galbraith. Sipas tij, njeriu është një qenie imituese që joshet lehtësisht nga reklamimi, kështu që zëvendësohen nevojat reale me ato artificiale: "Krijimi i borxheve, i rregulluar nga një sistem normash të kodifikuara, drejton fatin e konsumatorit, individualizmi i të cilit nuk e bën atë të lirë, por e vendos përballë një rreziku të dyfishtë: retorikat e reklamës, që e stimulojnë drejtë nevojave gjithnjë e më artificiale e të kushtueshme; dhe imitimi, në vorbullën e të cilit bien, në mënyrë të pavetëdijshme, të varfrit duke imituar ata që janë më të pasur"²⁸.

Veprimtaria njerëzore është tërësisht e kushtëzuar nga faktorë ekonomikë dhe njeriu nuk ka as kohë të reflektojë mbi gjendjen e tij, as të ambientit dhe natyrisht kjo detyrë i mbetet filozofëve, antropologëve dhe sociologëve. Në këtë drejtim janë mjaft interesant përfaqësuesit e Shkollës së Frankfurtit si Adorno, Marcuse, Benjamin, Erich Fromm etj. Kritika e tyre na zgjon ose na nxit për të bërë një reflektim mbi efektet tek njeriu. Erich Fromm, në librin *Psikoanaliza dhe feja*, shprehet si për ndikimin e besimit të verbër, gjithashtu dhe të procesit edukativ që më shumë krijon iluzione sesa formon: "Fëmijët në shkollat e të dielave, mësojnë se ndershmëria, sinqeriteti dhe kujdesi për shpëtimin e shpirtit duhet të jenë parimet udhëheqëse të jetës, në një kohë kur jeta na mëson se, ndjekja e këtyre parimeve i bën njerëzit në rastin më të mirë, ëndërrues, që e humbasin ndjenjën e realitetit."²⁹ Sipas tij, njeriu është shndërruar në instrument për makinën ekonomike: "njeriu nuk e shikon më veten si qëllimin më të lartë të jetës së tij, ai e ka shndërruar veten si instrument për makinën ekonomike të krijuar prej duarve të tij personale. Atë më shumë e intereson produktiviteti i punës, sesa lumturia dhe zhvillimi i shpirtit të tij"³⁰. Duket se ai mësimi i hershëm sokratik: *kuro shpirtin*, është lënë në harresë. Ndërkohë teza marksist e tjetërsimit të njeriut zhvillohet më tej nga përfaqësuesit e Shkollës së Frankfurtit. Sipas tyre: Njeriu është tërësisht i lidhur më punën. Mirëqenia ekonomike, plotësimi i pakufishëm i nevojave materiale kanë zënë vendin e zhvillimit shpirtëror. Sipas E. Fromm, dhe dinjitetin personal e përcakton tregu: "Ndjenja e tij e dinjitetit personal bazohet jo në vlerësimin e aftësive të tij. Ajo varet nga kërkesa në treg, apo nga mendimi i të tjerëve rreth 'joshjes' së tij"³¹.

²⁸ Gennari, M. (2005) *Filosofia della formazione dell'uomo* Bompiani, Milano f. 460

²⁹ Fromm E. *Psychology and religion* (perth. shqip Psikoanaliza dhe feja, Plejad, Tiranë, 2002). fq.10

³⁰ Po aty f.94

³¹ Po aty f.95

Ndërkohë është ngritur çështja e konsumit pa kriter e progresit jo vetëm në planin e ndotjes mjedisore, por dhe në planin e të drejtës, duke shtruar pyetjen se deri në çfarë mase kemi të drejtë të shfrytëzojmë pasuritë e tokës? Po brezat e ardhshëm a kanë të drejtë gjejnë pasuri natyrore? Disa autorë kanë trajtuar këtë çështje, por unë po përmend filozofin gjermano-amerikan, H. Jonas dhe ekonomistin e politikanin e shquar italian G. Tremonti. Për sa i përket konsumimit të shfrenuar dhe shfrytëzimit pa kriter të pasurive natyrore H. Jonas është shprehur: "pasardhësit tanë kanë të drejtë që të jetojnë në një planet të pa grabitur, më shumë se sa të kenë një kujdes të mrekullueshëm"³². Progresi sipas tij nuk merr parasysh mbarimin e pasurive dhe dëmtimin e ambientit natyror. Jonas formulon një tjetër imperativ kategorik: veprimi yt t'i shërbejë jetës në tokë. Ndërsa G. Tremonti është akoma më pesimist dhe ky pesimizëm shprehet kur shkruan: "Po konsumojmë të ardhmen e fëmijëve tanë, dhe po e bëjmë këtë aq shpejt sa që po shohim vetë efektet e veprimeve tona"³³.

Përfundime/Konkluzione

Nga një këndvështrim historik, në këtë artikull u paraqiten disa momente të rëndësishme të marrëdhënieve, apo të ndërthurjes së pedagogjisë me filozofinë. Momente, ku filozofë të shquar janë marrë njëkohësisht me çështje filozofike dhe edukative. Gjithashtu u trajtua ndikimi tek pedagogjia i rrymave të ndryshme filozofike si idealizmi, empirizmi, iluminizmi, pragmatizmit që thuhet se deri në identifikimin e këtyre disiplinave. U përmenden disa momente, ku si rezultat i ndikimit gradual të lartpërmendur, kryesisht të empirizmit, marksizmit dhe të pragmatizmit, u arrit çlirimi i pedagogjisë nga metafizika dhe orientimi i saj drejt problematikave më reale dhe aktuale të njeriut. Ndoshta nga ana historike raporti i pedagogjisë me filozofinë nuk përbën ndonjë risi, ndonëse është mjaft kompleks, por orientimi në periudhën bashkëkohore të filozofisë, sociologjisë dhe pedagogjisë drejt pasojave të pakthyeshme të progresit dhe zhvillimit ekonomik e urban të papërmbajtur, siç janë problematikat akut të ndotjes mjedisore, i përdorimit pa kufi të pasurive natyrore dhe shfrytëzimi i papërmbajtur i burimeve njerëzore, për të cilat nuk flitet, mendoj se përbën një interes të madh. Në fakt, duke masakruar natyrën njeriu masakron veten e tij. Ndërgjegjësimi në këtë drejtim dhe edukimi mjedisor do të sjellin ndoshta dhe kufizimin e shpërdorimit dhe të konsumit pa kriter, që nga ana e tij mund të sjellë ndryshime radikale në ekonomi, përgjithësisht tek të gjitha shoqëritë që janë bazuar tek konsumi pa kriter. Kjo është një çështje jetike për njerëzimin dhe

mendoj se do të zhvillohet gjithnjë e më shumë nga studiues të këtyre fushave dhe jo vetëm.

Bibliografia

- Berti E. (1979) *Profilo di Aristotele*, Edizioni Studium, Roma
- Cambi F. (2000) *Manuale di filosofia dell'educazione*. Laterza, Milano
- Dewey J (2003) *Shkolla dhe shoqëria* perkth. shqip Plejad Tiranë.
- Fromm E. *Psychology and religion* (perkth. shqip Psikoanaliza dhe feja, Plejad, Tiranë, 2002).
- Gennari, M. (2005) *Filosofia della formazione dell'uomo* Bompiani, Milano
- Hegel G. (2004) *Platoni*. Shtëpia botuese "Dritan", Tiranë
- James W. (2005) *Pragmatizmi*, Plejad
- Ornstein A. Hunkins P. (2003) *Kurrikula Baza, Parime dhe probleme* Perkth. Instituti i Studimeve Pedagogjike Tiranë
- Fraboni F. (2003) *Introduzione alla pedagogia generale* Laterza Milano
- Savini V. (2021) *Fidarsi della logica* Albatros, Roma
- Tremonti, G. (2009) *La paura e la speranza*. Mondadori, Milano,

³² Gennari, M. (2005) *Filosofia della formazione dell'uomo* Bompiani, Milano f.500

³³ Tremonti, G. (2009) *La paura e la speranza*. Mondadori, Milano, f.10

Ndikimi i artit të folurit në orë mësimore projektsh e përshtatur me gjuhën standarde shqipe

Joana Lapa

doktoraturë në proces

Universiteti Ismail Qemali, Vlorë

joana.lapa@univlora.edu.al

1. Hyrje

Zotërimi i artit oratorik është një përpjekje argëtuese dhe fantastike. Të folurit e suksesshëm varet nga ndjenja e sinqertë dhe e vetbesimit. Aftësia e të folurit në publik është çështje praktike dhe frika skenike mund të pushtohet.

Pavarësisht nëse e mbani mend apo jo, keni mësuar të notoni, duke notuar- dhe ka të ngjarë të keni pirë shumë gëllënjkë të bezdisshme uji apo dhe të mbushni hundët përpara se të ndjeheshit të sigurtë në një pishinë apo det.

Pra, zotërimi i artit të folurit publik është shumë i ngjashëm me notimin. Mbajtja e fjalimeve është mënyra e vetme për t'u bërë një orator i aftë. Kjo do të thotë të hidhesh në një fund të thellë proverbial. Në fillim, të gjithë jemi të mbushur me shqetësime kur qëndrojmë para një audience. Shumë folës të shkëlqyeshëm si: William Gladstone dhe kleriku amerikan Henry Ward Beecher, kurrë nuk pushuan së vuajturi nga frika e skenës.

2. Mënyrat për të arritur zotërimin e frikës gjatë fjalimit

a. Të shmangët ndjenjat e vetëdijes duke e lënë veten të zhytur në temën e fjalimit tuaj. Nëse jeni të përqëndruar plotësisht në idenë ose mesazhin që po përpiqeni të komunikoni, do të ketë pak hapësirë për shqetësime boshe për pamjen tuaj ose se si audience ju percepton.

b. Ti nënshtrohesh përmbajtjes së fjalës në mënyrë që të evitohen shqetësimet e panevojshme për vetë-prezantim.

c. Të zotërosh një bagazh të caktuar informacioni. Shumë folës dështojnë sepse qasen në auditor të papërgatitur në këtë mënyrë emocionet fillojnë të të mposhtin. Të mësuarit përmendësh të paragrafit të parë do ishte zgjidhje për një hyrje dinjitoze.

d. Të presësh suksesin pasi të përgatiteni për sukses duke ruajtur një përlule të sinqertë, një gadishmëri të përvetshme për t'u përmirësuar.

e. Të praktikosh fjalimet në vazhdimësi dhe së shpejti do të notosh me shpejtësi.

AFTËSITË KOMUNIKUESE TË MËSUESIT

Të folurit, aspekt i rëndësishëm në orën e mësimin

Shumë mësues përdorin një sërë pyetjesh provokuese, me anë të të cilave ata duan të mbajnë të përqëndruar vëmendjen e nxënësve, të zhvillojnë replika edhe kur ta nuk janë në gjendje të përgjigjen

Mësuesit harxhojnë shumë kohë duke folur. Ata shpjegojnë, japin udhëzime, drejtojnë pyetje ose drejtojnë diskutimin e tërë klasës. Prandaj nuk është aspak e çuditshme që **cilësia e bisedës së mësuesit të jetë një nga aspektet më të rëndësishme të efikasitetit të mësimdhënies.** Madje, kjo është cilësia më e rëndësishme e efikasitetit të mësimdhënies.

"Shumë nga të dhënat kërkimore mbështesin kërkesën se qartësia e shpjegimit (shpesh quhet edhe "qartësi e mësuesit") jep një ndihmesë kryesore në arritjet e nxënësve. Qartësia e mësuesit, sigurisht, e shton veprimtarinë bisedore të mësuesit, ndihmon shumë nxënësin të përfshihet në detyrat mësimore", shkruan Bardhyl Musai në Portali Germa.

Paraqitja nga mësuesi (informacioni, përshkrimi dhe shpjegimi) zakonisht ndodh në fillim të mësimin, ndonjëherë në fund, madje dhe gjatë mësimin, si dhe atëherë kur mësuesi ndjen se është e përshtatshme. Në shkollë, jo rrallë herë paraqitja merr formën e një leksioni, i cili kërkon kohë dhe nxënësit e kanë të vështirë t'i kushtojnë vëmendje. Ata përqendrohen vetëm për një interval të shkurtër kohor. Kjo vërtetohet nga të dhënat e psikologjisë, ku koha e përqendrimit pa ndërprerje

varet nga mosha. Sa më e vogël të jetë mosha aq më e vogël është koha e përqendrimit të vazhdueshëm të vëmendjes.

Për të shmangur këtë, **shumë mësues përdorin një sërë pyetjesh provokuese, me anë të të cilave ata duan të mbajnë të përqendruar vëmendjen e nxënësve, të zhvillojnë replika edhe kur ta nuk janë në gjendje të përgjigjen.** Në fakt, pyetjet duhen bërë, por të një karakteri tjetër.

Ndikimi i ushtrimeve të folurit në zhvillimin e menduarit të nxënësve

Mënyra më e mirë për të zhvilluar të folurin tek nxënësit, janë ushtrimet e shumta. Ushtrimet e të folurit duhet të jenë gjithpërfshirës dhe të nxisin të menduarit aktiv të nxënësve...

Mënyra më e mirë për të zhvilluar të folurin tek nxënësit, janë ushtrimet e shumta. Ushtrimet e të folurit duhet të jenë gjithpërfshirës dhe të nxisin të menduarit aktiv të nxënësve. Mësuesi duhet ti drejtojë/orentojë nxënësit në mënyrë që ata të organizojnë dhe të aftësojnë të menduarin. Zhvillimi i të menduarit me anë të ushtrimeve të të folurit, mund të realizohen në mënyra të ndryshme. Mësuesi luan rolin primar në realizimin e këtyre ushtrimeve. Ai duhet të krijojë një mjedis klase, ku nxënësit mund të punojnë në grupe me njëri-tjetrin, ku realizojnë bashkëbisedime, ku zgjidhin ushtrime të niveleve të ndryshme, ku ndihen të lirë të shprehin me gojë atë se çka mendojnë.

Virgini O' Keefe në librin e saj *SPEAKING TO THINK/THINK TO SPEAKING*, thotë që studentët e të gjithave niveleve dhe aftësive të ndryshme, meritojnë të gjithë të kenë një shans për të pasur sukses. Metodat e të folurit dhe të menduarit u mundëson mësuesve, t'i japin çdo nxënësi mundësinë për të përdorur të folurin me të tjerët dhe me veten. Kjo është mënyra kryesore e të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke përjashtuar apo minimizuar bisedat në klasë, sepse mund të pengojmë shumë nxënës.

Virgini O' Keefe argumentoi se ndarja e të mësuarit dhe përpunimi i njohurive dhe aftësive ushtrimore me zë të lartë i ndihmon të gjithë nxënësit të arrijnë më shumë zhvillim intelektual. Libri i saj, tregon vlerën e bisedës në klasë duke treguar sesi funksionon dhe duke ofruar zgjidhje praktike për ta bërë procesin më të suksesshëm.

Ajo orienton disa pika për mësuesit:

- Siguron udhëzime specifike për të inkurajuar përfshirjen totale të nxënësve.
- Përshkruani aktivitete të shumta për të nxitur kreativitetin dhe për të fituar interesin dhe motivimin e nxënësve.
- Demonstroni procesin e grupit të vogël me instruksione hap pas hapi për të realizuar gjithpërfshirjen.

- Jepuni shembuj dhe aktivitete për të aktivizuar nxënësit me gojë.

- Vlerësoni aftësitë për të folurit, por pa nxitur frikën e nxënësve gjatë komunikimit.

Ky libër i ofron mësuesit një repertor të gjerë të mënyrave sesi të menaxhojnë dhe të inkurajojnë pjesëmarrjen e nxënësve në diskutim.

Disa nga aktivitetet për të promovuar të folurin në zhvillimin e menduarit të nxënësve janë:

1. Diskutimi. Një diskutim mund të mbahet për arsye të ndryshme. Nxënësit mund synojnë të arrijnë në një përfundim, të ndajnë ide rreth një ngjarjeje ose të gjejnë zgjidhje në grupet e tyre të diskutimit. Qëllimi i diskutimit është thelbësor dhe përcaktohet nga mësuesi. Mësuesit mund të organizojnë duke formuar grupe me 4-5 nxënës dhe në fund të gjithë grupet paraqesin mendimet e tyre përmes së folurit. Ky aktivitet nxit të menduarit kritik dhe vendimmarrjen e shpejtë. Gjithashtu nxënësit mësojnë si të shprehin dhe të justifikojnë veten në mënyrë të sjellshme, ndërsa janë duke mos u pajtuar me të tjerët.

2. Stuhi mendimi. Kjo metodë i mundëson nxënësve të prodhojnë ide në një kohë të kufizuar. Kjo metodë është efikase se të gjithë kanë mundësinë për të zhvilluar të folurin. Ky aktivitet nuk i kritikon mendimet apo idetë e nxënësve, por thjesht nxënësit janë të hapur për të shprehur mendimet e tyre. Ky është një ushtrim efikas për të nxitur gjithpërfshirjen e të folurit të nxënësve.

3. Tregim historish. Me këtë lloj ushtrimi të të folurit, nxënësit zhvillojnë të menduarit duke përmbledhur shkurtimisht një tregim apo histori që kanë degjuar nga dikush me parë, apo mund të krijojnë një tregim për t'ia treguar shokëve në klasë. Ky ushtrim nxit mendimin krijues, duke patur parasysh formatin fillim, zhvillim, mbarim. Me anë të kësaj metode, mësuesit jo vetëm aftësojnë të folurit, por dhe tërheqin vëmendjen e klasës.

4. Intervista. Nxënësit me anë të këtij aktiviteti kryejnë intervista me temë të zgjedhur dhe me njerëz të ndryshëm. Kjo metodë u jep mundësi nxënësve të ushtrojnë aftësitë e tyre të të folurit, jo vetëm në klasë, por dhe jashtë saj. Më pas shprehin studimet e tyre në klasë, ku nxënësit mund të intervistojnë dhe njëri tjetrin.

5. Paraqitja e figurave. Një lloj tjetër ushtrimi, ku nxënësit me anë të fotove, përdorin figurat duke përshkruar atë që shohin. Ky ushtrim nxit kreativitetin dhe imagjinatën e nxënësve si dhe aftësinë e të folurit në klasë.

Këto ushtrime, përfshijnë secilin nxënës në çdo aktivitet të të folurit, duke zhvilluar dhe të menduarit. Këto metoda, rrisin të folurin, mendimin kritik.

Sipas Goldstein, roli i mësuesit në procesin e të folurit dhe të menduarit do të jetë:

- Mësuesi duhet të tregojë shenja pozitive kur komenton përgjigjen e nxënësit
- Mësuesi nuk duhet t'i korrigjojë shumë gabimet e nxënësit kur flasin, për të mos i shqepur nga fjalimi.
- Mësuesi duhet të ofrojë sa më shumë ushtrime që të nxisin të menduarit dhe të praktikojnë saktë të folurit në gjuhën standarte.

Gjithashtu, një artikulli i Punimeve të Akademisë Kombëtare të Shkencave në ShBA, na tregon se të menduarit dhe sidomos zhvillimi i mendimit kritik, u mundësohet nxënësve me anë të ushtrimeve të të folurit.

Uolf Mishel Roth, gjithashtu ka folur për të folurin dhe të menduarin. Në një artikull ajo është shprehur: *lidhja midis të menduarit dhe të folurit është orientuar nga disa terma. Të folurit shpreh atë se çka subjekti ka menduar ose atë që po mendon për momentin, ndaj të folurit është konsideruar si imitim, kopje e mendimit.* Folja të shpreh, shihet si një metaforë dhe etimologjikisht, vjen nga latinishtja **expressare**.

10 keshilla për nxënësit për të folurit në publik

Të folurit në publik nuk vjen natyrshëm për shumicën e njerëzve, por nëse është diçka me të cilën keni vështirësi, këto këshilla mund t'ju ndihmojnë. Sa më shumë t'i zbatoni këto këshilla gjatë të folurit në publik, aq më rehat do të ndiheni. *Përtej përgatitjes, megjithatë, ka strategji që mund t'i përdorni për të reduktuar stresin dhe ankthin.*

Më poshtë mund të gjeni 10 këshilla për një fjalim në publik sa më të mirë:

1. Flisni për atë që dini

Nëse është e mundur, zgjidhni një temë për të cilën keni informata të shumta. Pasioni juaj për temën do të ndihet nga audienca dhe do të ndiheni më pak të shqetësuar duke ditur se keni shumë përvojë për të nxjerrë kur nxënësit e tjerë ju bëjnë pyetje.

2. Tërhiqni vëmendjen e audiencës

Shumica e shokëve tuaj të klasës do t'ju kushtojnë vëmendje të paktën 20 sekondat e para; tërhiq vëmendjen e tyre gjatë atyre momenteve të hershme. Filloni me një fakt interesant ose një histori që lidhet me temën tuaj.

3. Përqendrohuni në mesazhin tuaj

Kur përqendroheni në prezantim, ankthi ka më pak gjasa të dalë jashtë kontrollit. Përqendrohuni në mesazhin kryesor të fjalimit ose prezantimit tuaj dhe vendosni qëllimin tuaj që t'ua jepni atë mesazh nxënësve të tjerë në klasën tuaj.

4. Tregoni histori

Tregimet tërheqin vëmendjen e nxënësve të tjerë dhe japin një mesazh në një mënyrë më kuptimplote sesa faktet dhe shifrat. Kurdoherë që është e mundur, përdorni një histori për të ilustruar një pikë në fjalimin tuaj.

5. Shmangni fjalët plotësuese

Fjalë të tilla si "edhe", "kështu" dhe "um" nuk i shtojnë asgjë fjalimit tuaj. Praktikoni të heshtni kur ndieni dëshirën të përdorni një nga këto fjalë.

6. Ndryshoni tonin dhe shpejtësinë e të folurit

Folësit e natyrshëm ndryshojnë zërin (i lartë kundrejt i ulët) dhe shpejtësinë (shpejt kundrejt ngadalë) të fjalëve të tyre. Kjo i mban shokët dhe shoqet e klasës të interesuar dhe të angazhuar në atë që thoni.

7. Bëjeni audiencën të qeshë

E qeshura është një mënyrë e shkëlqyeshme për t'u çlodhur si ju, ashtu edhe nxënësit e tjerë në klasën tuaj, dhe të thuash shaka mund të jetë një akullthyes i mrekullueshëm në fillim të një fjalimi. Praktikoni kohën dhe dorëzimin e shakave tuaja paraprakisht dhe kërkonin një mik për komente. Sigurohuni që ato të jenë të përshtatshme për klasën tuaj përpara se të filloni.

8. Vizualizoni suksesin

Është e natyrshme të ndiheni të shqetësuar para se të flisni para një turme, por mendimet negative vetëm sa ju lëndojnë më shumë. Në vend të kësaj, në momentet para se të dilni në skenë, imagjinoni se sa mirë do të ndiheni pasi të mbarojë e gjitha.

9. Përdorni një ndihmë vizuale

Në situatat më formale të të folurit, folësit publikë shpesh përdorin mjete vizuale për të ndihmuar në dhënien e një prezantimi më efektiv. Për shembull, nxjerrja në pah e pikave tuaja kyçe me PowerPoint është një mënyrë e shkëlqyer për të ndihmuar audiencën tuaj t'i kujtojë ato pika. Mjetet ndihmëse vizuale si grafikët, fotot dhe videot janë gjithashtu mënyra të shkëlqyera për t'i shtuar kontekst shtesë informacionit në fjalimin tuaj.

Në situatat më formale të të folurit, folësit publikë shpesh përdorin mjete vizuale për të ndihmuar në dhënien e një prezantimi më efektiv. Për shembull, nxjerrja në pah e pikave tuaja kyçe me PowerPoint është një mënyrë e shkëlqyer për të ndihmuar audiencën tuaj t'i kujtojë ato pika. Mjetet ndihmëse vizuale si grafikët, fotot dhe videot janë gjithashtu mënyra të shkëlqyera për t'i shtuar kontekst shtesë informacionit në fjalimin tuaj.

10. Buzëqeshni

Nëse gjithçka tjetër dështon, buzëqeshni. Shokët tuaj të klasës do t'ju perceptojnë si një folës të ngrohtë dhe do të jenë më të hapur ndaj asaj që keni për të thënë.

Konkluzione:

- Arti i te folurit në arsimin fillor ka rëndësi për të zhvilluar aftësitë krijuese, komunikuese dhe vetbesimin e nxënësve.
- Qëllimi kryesor i te folurit është të zhvillojë aftësitë e të menduarit aktiv të nxënësve në mënyrë të tillë që ata të shprehin lirshëm idetë e tyre në gjuhën standarte shqipe.
- Rëndësia e përshtatjes së gjuhës shqipe me te folurit në fusha të ndryshme është një sfidë e vërtetë për komunitetin shqipfolës.
- Ai rrit ndjeshëm vetëbesimin dhe motivimin e nxënësve për një të ardhme më të ndritur të shoqërisë.
- Të mësuarit nëpërmjet te folurit lirshëm është një metodë efektive për ngulitjen e koncepteve të nxënësve.

Bibliografia

- [1]. Mësimdhënia dhe të nxënësit ndërveprues, Bardhyl Musai, CDE (Qendra për Arsim Demokratik)
- [2]. Modele për zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve. Orë mësimore të suksesshme, CDE (Qendra për Arsim Demokratik)
- [3]. Strategji të mësimdhënies dhe të nxënësit për klasat mendimtare CDE (Qendra për Arsim Demokratik), Botim i projektit "Zhvillimi i të menduarit kritik gjatë të lexuarit dhe të shkruarit", Alan Crawford, Charles Temple, Wendy Saul, Samuel R. Mathews, James Makinster
- [4]. Gazeta "Panorama". Mësimi i bazuar në përshtatje të gjuhës shqipe, një metode efektive për nxënësit e shekullit aktual.
- [5]. Virgini O' Keefe libri *SPEAKING TO THINK/THINK TO SPEAKING*,
- [6]. Portali shkollor, viti shkollor 2018-2019

SHKENCAT INXHINIERIKE DHE MATEMATIKORE

Vlerësimi i karakteristikave të lëvizshmërisë të një anijeje peshkimi nëpërmjet përdorimit të softuerit "Fuqi Anije V 1.0"

Blenard Xhaferaj

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
blenardxhaferaj@yahoo.it

Abstrakti

Vlerësimi i karakteristikave të lëvizshmërisë së anijes është element i rëndësishëm qoftë për sa i përket procesit të projektimit të anijeve të reja qoftë për sa i përket analizave të ndryshme që synojnë optimizmin e efikasitetit energjetic të anijes gjatë fazës së shfrytëzimit të saj. Konkretisht njohja e këtyre karakteristikave mundëson optimizmin e akopjimit të sistemit motor, karene, helikë. Punimi prezanton një metodologji të përdorimit të softuerit "Fuqi Anije V 1.0", i cili është një softuer i zhvilluar nga autori, për vlerësimin e rezistencës, fuqisë dhe karakteristikave propulsive të anijes. Metodologjia kombinon kapacitetet e softuerit "Fuqi Anije V 1.0" me aplikacione të tjera kompjuterike, si dhe të dhënat e serive të helikave. Aplikimi i kësaj metodologjie, në rastin e një anijeje peshkimi, ka mundësuar marrjen e rezultateve të llogaritjeve dhe ndërtimin e diagramave për sa i përket fuqisë dhe komponentëve të rezistencës, si dhe të koeficientëve të bashkëveprimit helikë-karene. Procedura e prezantuar në punim mund të përdoret edhe për tipologji të tjera të anijeve ekzistuese Shqiptare. Gjithashtu procedura mund të përdoret edhe gjatë fazave fillestare të projektimit të anijeve të reja për vlerësimet e rezistencës, fuqisë dhe koeficientëve të bashkëveprimit karene helikë.

Fjalë kyçe: Rezistencë, fuqi, karene, helikë, lëvizshmëri, anije peshkimi.

Abstract

The evaluation of the propulsive characteristics of ships is a crucial element in terms of the design process of new ships and in terms of various analyses that aim at optimizing the

ship's energy efficiency during its operation phase. Particularly, evaluations of these characteristics allows us to optimize the matching of the system, engine, hull, and propeller. The paper presents a methodology of using the software "Ship Power V 1.0", which is a software developed by the author to evaluate resistance, power and propulsive characteristics of ships. The methodology combines the capabilities of the software "Ship Power V 1.0" with other computer applications, as well as data of propeller series. The application of this methodology, in the case of a fishing vessel, has enabled to obtain the results of calculations and the construction of diagrams in terms of power and resistance components, as well as coefficients of propeller hull interaction.

The procedure presented in this study can also be used for other typologies of existing Albanian ships. In addition the procedure can be used during the initial stages of the design of new ships for the evaluations of resistance, power and coefficients of propeller-hull interaction.

Key words: Resistance, power, hull, propeller, propulsion, fishing vessel.

1. Hyrje

Peshkimi është një sektor i rëndësishëm, sepse ai mundëson jo vetëm sigurimin e të mirave në zinxhirin ushqimor, por sektori krijon edhe mundësi të shumta punësimi. Edhe në Shqipëri, si një vend bregdetar, peshkimi konsiderohet një sektor i rëndësishëm i ekonomisë [1]. Referuar të dhënave të INSTAT [1] Flota Shqiptare e anijeve të peshkimit për vitin 2020 numëronte 784 mjete. Kjo flotë në vite ka ardhur duke u rritur. Kështu nëse i referohemi

të dhënave të INSTAT-it [1] për periudhën kohore 2018-2022 konstatohet se flota ka pësuar një rritje me rreth 20%. Pjesa më e madhe e anijeve të peshkimit operojnë në portin e Durrësit 36.7% dhe në portin e Vlorës 34.1% [2]. Në total flota e anijeve të peshkimit ka një fuqi të instaluar prej 91146 KW [2].

Ashtu si edhe sektorë të tjerë të industrisë detare edhe ndaj sektorit të peshkimit ka një presion të shtuar për reduktimin e emetimeve ambientale. Në këtë kuadër Organizata Ndërkombëtare e Detarisë (IMO) ka ndërmarr iniciativë të cilat kanë në fokus reduktimin e emetimeve nga anijet. Këto iniciativë përfshijnë indeksin e projektimit të efikasitetit energjitike (EEDI), planin e menaxhimit të efikasitetit energjitike (SEEMP), indeksin e efikasitetit energjitike të anijeve ekzistuese (EEXI), dhe treguesin e intensitetit të karbonit (CII).

Edhe pse anijet e peshkimit nuk janë pjesë e kërkesave të mësipërme të IMO [3], [4] minimizimi i ndikimit ambiental nga anijet e peshkimit paraqet rëndësi shumë të madh. Kjo është e lidhur ngushtësisht edhe me nivelin e karburantit të konsumuar nga mjetet e peshkimit dhe emetimet atmosferike të tyre. Në vitin 2018, në rang botëror është raportuar se anijet e peshkimit kanë konsumuar rreth 12.86 milion ton karburant duke emetuar rreth 40.7 milion gazra serrë [5]. Këto emetime të gazrave serë nga anijet e peshkimit përbëjnë rreth 4% të emetimeve të transportit detar [5].

Reduktimi i ndikimeve ambientale dhe emetimeve atmosferike të anijeve, lidhet ngushtësisht me konsumin e karburantit, fuqinë motorike dhe karakteristikat e lëvizshmërisë. Në vijë të përgjithshme reduktimi i konsumit të karburantit, në mjetet detare, mund të arrihet nëpërmjet optimizimeve të efikasitetit energjitike dhe të performancave hidrodinamike dhe të projektimit të mjeteve të reja dhe atyre ekzistuese duke synuar në përmirësimin e performancave të sistemit karenë-helikë-motor, reduktimin e peshës totale të mjetit, përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme (era, dielli), përdorimin e karburanteve të cilat karakterizohen nga nivele të ulëta të emetimeve, përdorimin e teknologjive që synojnë reduktimin e emetimeve, optimizimin e operacioneve të shfrytëzimit dhe lundrimit të mjeteve detare, optimizimin e operacioneve portuale [6].

Disponimi i karakteristikave fuqi-shpejtësi, ose rezistencë shpejtësi, si dhe i karakteristikave të tjera të lëvizshmërisë mundësojnë që të gjykohej për ndërmarrjen e masave konkrete për përmirësimin e performancave të sistemit karenë-motor-helikë të anijeve ekzistuese nëpërmjet remonteve, përshtatjeve dhe

riparimeve të ndryshme, të cilat mund të synojnë minimizimin e rezistencës së karenës, maksimizimin e rendimentit të helikës dhe akopjimit motor-helikë, si dhe optimizimit të shpejtësisë. Flota Shqiptare e anijeve të peshkimit karakterizohet nga një mungesë e theksuar e dokumentacionit teknik për sa i përket karakteristikave hidrodinamike të lidhura me karenën dhe helikën. Shumë pak informacion mund të gjendet në bordin e anijeve Shqiptare të peshkimit lidhur me karakteristikën shpejtësi-fuqi, shpejtësi-rezistencë dhe faktorëve të bashkëveprimit helikë-karenë.

Këto karakteristika hidrodinamike, si kurba shpejtësi fuqi, shpejtësi rezistencë, karakteristikat e funksionimit të helikës, si dhe parametrat e bashkëveprimit karenë-helikë mund të përcaktohen nëpërmjet matjeve eksperimentale në vaskat navale me modele karenash dhe helikash; simulimeve numerike të fluidodinamikës (CFD), përdorimit të modeleve të regresionit si dhe diagramave të serive sistematike të karenave dhe helikave [7]. Kryerja e testimeve eksperimentale kërkon burime financiare dhe disponimin e baseneve eksperimentale për kryerjen e testimeve. Gjithashtu këto testime kërkojnë edhe kohë për realizimin dhe përpunimin e të dhënave eksperimentale. Simulimet e fluidodinamikës numerike (CFD) kërkojnë burime financiare për disponimin e softuerëve të avancuar të simulimit. Gjithashtu koha e simulimit për marrjen e rezultateve është e madhe. Modelet e regresionit dhe të dhënat e serive sistematike, të cilat janë një praktikë e konsoliduar në fushën navale mundësojnë një vlerësim të shpejtë të karakteristikave të rezistencës dhe fuqisë së anijes. Në formë konvencionale të karenave të anijeve këto metoda sigurojnë një saktësi të kënaqshme krahasuar me rezultatet e marra nga provat me modele në vaskë, si dhe rezultateve të marra nga simulimet e fluidodinamikës numerike (CFD) [7].

Punimi synon të prezantoj rezultatet e përfitimit të karakteristikave të lëvizshmërisë për një anije peshkimi nëpërmjet përdorimit të softuerit kompjuterik "Fuqi Anije V 1.0" dhe të dhënave të serive të helikave. "Fuqi Anije V 1.0" është një softuer i zhvilluar nga autori [8], [9] për vlerësimin parametrik të rezistencës dhe fuqisë së anijes, nisur nga parametrat kryesorë geometrikë të anijes. Investigimet e kryera nga autori [7] me modele karenash të anijeve të peshkimit kanë treguar saktësi të mirë të parashikimit të rezistencës të softuerit "Fuqi Anije V 1.0", krahasuar me të dhënat eksperimentale.

2. Materiali dhe Metodrat

1.1 Karakteristikat e anijes së peshkimit të marrë në analizë.

Anija e peshkimit e marrë në analizë është një anije shqiptare peshkimi. Dimensionet kryesore të anijes të nxjerra nga dokumentacioni teknik i saj janë:

Gjatësia maksimale $L_{OA} = 24$ m
Gjerësia $B = 6$ m
Lartësia e konstruksionit $D = 3.4$ m
Zhytja konstruktive $T = 2.4$ m

Peshkarexha ka një impiant lëvizës me një helikë. Helika është një helikë me tre lopata, me diametër $D_H = 1.56$ m, raport diskor 0.65 dhe me raport hap/diametër $P/D = 0.95$. Në figurën 1 paraqitet pamja e përgjithshme e kësaj anije peshkimi. Anija është e pajisur edhe me librin e stabilitetit në të cilat janë të pasqyruara karakteristikat gjeometrike dhe hidrostatike të mjetit. Të dhëna të tjera të nxjerra nga dokumentacioni i teknik i bordit të anijes paraqiten në tabelën 1.




Figura 1. Pamja e përgjithshme e anijes së peshkimit

Tabela 1. Të dhëna kryesore të karenes

Koeficienti i plotësisë totale C_B	0.47
Koeficienti i plotësisë prizmatike C_P	0.61
Koeficienti i plotësisë së vijës së ujit C_{WL}	0.84
Koeficienti i plotësisë së brinjës së midelit C_M	0.77

1.2 Seria e helikave B - Wageningen.

Duke qenë se nuk disponoheshin të dhëna më të detajuara në lidhje me gjeometrinë e helikës, për vlerësimin e karakteristikave të lëvizshmërisë u përzgjedh seria B-Wageningen e helikave të anijeve.

Seria e helikave B-Wageningen është një prej serive më të përdorshme në fushën navale. Kjo është një ndër seritë më të plota të helikave dhe ka karakteristika shumë të mira të funksionimit. Seria përmban të dhëna për helika me numër lopatash Z nga 2 – 7, raport diskor 0.3 – 1.05 dhe raport hap/diametër P/D nga 0.5 – 1.4 [10]. Në tabelën 2 dhe tabelën 3 paraqiten disa prej të dhënave kryesore të serisë B-Wageningen [11]. Edhe në rastin e anijeve të peshkimit seria B-Wageningen e helikave është një seri shumë e përdorshme [12].

Tabela 2. Të dhënat e serisë B-Wageningen (për raportin diskor deri në vlerën 0.55 [11].

Numri Lopatave (Z)	Raporti Diskor					
2	0.3					
3		0.35			0.5	
4			0.4			0.55
5				0.45		
6					0.5	
7						0.55

Tabela 3. Të dhënat e serisë B-Wageningen (për raportin diskor 0.55 – 1.05) [11].

Z	Raporti Diskor					
2						
3		0.65		0.8		
4			0.7		0.85	1.00
5	0.6			0.75		1.05
6		0.65		0.8		
7			0.7		0.85	

1.3 Softueri "Fuqi anije 1.0"

Softueri "Fuqi Anije V 1.0" është një softuer i zhvilluar nga autori për vlerësimin parametrik të rezistencës dhe fuqisë për një gamë të gjerë të tipologjive të anijeve. Bllok skema e përgjithshme llogaritëse e softuerit paraqitet në figurën 2.




Figura 2. Bllokskema e përgjithshme e softit "Fuqi Anije V 1.0" [7], [9], [13].

Krahas llogaritjeve të komponentëve të ndryshme të rezistencës, si rezistenca e fërkimit, rezistenca valore, rezistenca e mbetur, rezistenca viskoze, si dhe koeficientëve përkatës të rezistencës softueri mundëson edhe vlerësimin e disa karakteristikave të rëndësishme të bashkëveprimit trup-anije

helikë, si koeficientin e rrymë daljes w , fraksionin e forcës shtytëse t , rendimentin e karenës η_H , rendimentin rrotativ η_R , si dhe forcën shtytëse T_H që duhet të zhvilloj helika për lëvizjen e anijes me një shpejtësi të caktuar V [8], [9].

Vlerat e koeficientëve të rezistencës, faktorëve të karakteristikave të lëvizshmërisë, si dhe forcës shtytëse të kërkuar për helikën llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$C_{XX} = \frac{R_{XX}}{0,5\rho SV^2} \quad (1)$$

$$T_H = \frac{R_T}{(1-t)} \quad (2)$$

$$\eta_H = \frac{(1-t)}{(1-w)} \quad (3)$$

ku:

- R_{XX} dhe C_{XX} - paraqesin respektivisht komponentët e rezistencës dhe koeficientët përkatës të tyre.
- T_H - paraqet forcën shtytëse të kërkuar për helikën.
- w - koeficienti i rrymë daljes
- t - fraksioni i forcës shtytëse.
- η_H - rendimenti i karenës.

1.4 Metodologjia e studimit.

Për qëllimet e studimit fillimisht u hartua metodologjia për realizimin e vlerësimeve të karakteristikave të lëvizshmërisë. Metodologjia parashikon kombinimin e softuerit "Fuqi Anije V 1.0" me të dhënat e serisë B-Wageningen, softeve të modelimit të helikave dhe formulave të përafërta për vlerësimin e karakteristikave të karenës dhe helikës. Në figurën 3 paraqitet bllokskema e metodologjisë së studimit.

Siç mund të konstatohet nga bllok skema e paraqitur në figurën 3, elementët kryesor të saj janë:

- ✓ vlerësimi i karakteristikave kryesore të karenës të nevojshme për ekzekutimin e softuerit "Fuqi Anije V 1.0".
- ✓ zgjedhja e serisë së helikës dhe përcaktimi i të dhënave të nevojshme për ekzekutimin e softuerit "Fuqi Anije V 1.0"
- ✓ hedhja e të dhënave të karenës dhe helikës në softuerin "Fuqi Anije V 1.0".
- ✓ ekzekutimi i softuerit "Fuqi Anije V 1.0" dhe marrja e rezultateve të llogaritjeve të rezistencës, fuqisë dhe karakteristikave të lëvizshmërisë.

2 Rezultate dhe diskutime

Siç tregohet edhe në bllok skemën e paraqitur në figurën 3 hapi i parë i metodologjisë parashikon analizën e të dhënave të disponueshme. Në rastin e anijes së peshkimit të

marrë në shqyrtim, duke qenë se anija është e pajisur me librin e stabilitetit të gjitha të dhënat e karenës për ekzekutimin e softuerit "Fuqi Anije V 1.0" mund të nxirren nga libri i stabilitetit.

Për sa i përket helikës së anijes janë në dispozicion numri i lopatave, raporti diskor dhe raporti hap/diametër. Rendimenti i helikës së izoluar që i korrespondon shpejtësisë nominale të lëvizjes së anijes i nevojshëm si e dhënë input për programin "Fuqi Anije V 1.0" nuk disponohet. Gjithashtu në dokumentacionin që disponohet nuk përcaktohet përkatësia e serisë së helikës. Seria B-Wageningen e helikave u zgjodh për vazhdimin e procesit të llogaritjeve të karakteristikave të rezistencës dhe lëvizshmërisë. Kjo për arsyen se kjo seri është një seri që ka gjetur një përdorim shumë të madh në tipologji të shumta anijesh, përfshirë edhe anijet e peshkimit.




Figura 3. Bllok skema e metodologjisë së studimit.

Në figurën 4 paraqiten pamje të renderuara të helikës së modeluar. Modelimi është realizuar me ndihmën e toolseve kompjuterike CAESES/FRIENDSHIP. Vlera e rendimentit të helikës së izoluar, e nevojshme si e dhënë input për softin "Fuqi Anije V 1.0", vlerësohet nga softi i modelimit të helikës ka rezultuar $\eta_0 \approx 0.544$.




Figura 4. Pamje të renderuara të helikës së modeluar.

Të dhënat e krenës së anijes, të nxjerra nga dokumentacioni teknik i bordit, si gjatësia midis perpendikulareve L_{PP} , gjatësia në vijën e ujit L_{WL} , gjatësia maksimale L_{OA} , zhytja T , koeficientët e plotësisë, si dhe të dhënat e helikës, si diametri, raporti hap/diametër, raporti diskor, u përdorën për ekzekutimin e softuerit "Fuqi Anije V 1.0" dhe marrjen e rezultateve. Llogaritjet në softuerin "Fuqi Anije V 1.0" u realizuan në fushën e shpejtësive $V_s = 1-15$ nyje, me hap 1 nyje, duke marrë një raport të plotë të llogaritjeve lidhur me komponentët e ndryshme të rezistencës, koeficientët e adimensionalizuar të rezistencës, fuqisë efektive dhe karakteristikave të lëvizshmërisë së anijes. Mbi bazën e rezultateve të marra nga raportet e llogaritjeve të softuerit "Fuqi Anije V 1.0" u ndërtuan grafikët e komponentëve të rezistencës, grafiku i forcës shtytëse të kërkuar nga helika në funksion të shpejtësisë së anijes, grafiku i fuqisë efektive, grafiku i faktorëve të propulsionit dhe grafikët e rendimenteve. Këto paraqitje grafike paraqiten përkatësisht në figurat 5, 6, 7, 8, 9.

Për shpejtësinë nominale të lëvizjes së anijes rendimenti propulsiv hirdodinamik i llogaritur nga softueri "Fuqi Anije V 1.0", rezultoi $\eta_D = 0.53$ kurse fuqia e zhvilluar në helikë rezultoi $P_D = 180$ KW.




Figura 5. Grafikët e komponentëve të rezistencës, ndërtuar sipas llogaritjeve të softuerit "Fuqi Anije V 1.0".




Figura 6. Grafiku i forcës shtytëse të kërkuar nga helika, ndërtuar sipas llogaritjeve të softuerit "Fuqi Anije V 1.0".




Figura 7. Grafiku i fuqisë efektive, ndërtuar sipas llogaritjeve të softuerit "Fuqi Anije V 1.0".




Figura 8. Grafiku i faktorëve të propulsionit w, t , ndërtuar sipas llogaritjeve të softuerit "Fuqi Anije V 1.0".




Figura 9. Grafikët e rendimenteve, ndërtuar sipas llogaritjeve të softuerit "Fuqi Anije V 1.0".

Përlllogaritjet e rezistencave të karenës së anijes dhe të koeficientëve të lëvizshmërisë, si dhe diagramat përkatëse të paraqitura në figurat 5, 6, 7, 8 dhe 9 krijojnë mundësinë për analizat e akopjimit motor-karenë-helikë, si dhe përcaktimin e fuqisë motorike referuar shpejtësisë së lëvizjes së anijes. Gjithashtu këto rezultate të llogaritjeve dhe paraqitjet përkatëse grafike mund të përdoren për analizat e ndryshme të përcaktimit të emetimeve të CO₂ referuar shpejtësisë së lëvizjes së anijes. Metodologjia e paraqitur në punim mund të përdoret jo vetëm për anijet ekzistuese, por ajo mund të përdoret edhe për llogaritjet përkatëse që realizohen në fazat fillestare të projektimit të anijeve të reja. Në rastin e anijeve ekzistuese kur nuk disponohen të dhënat e karenës është i nevojshëm modelimi i gjeometrik 3D i karenës së anijes, duke shfrytëzuar softet CAD të modelimeve gjeometrike dhe matjeve në karenën e anijes. Në këtë rast për modelimin 3D CAD të anijes mund të shfrytëzohet metodologjia e paraqitur në studime të mëparshme të autorit si në referencën [7].

4. Konkluzione

Në punim u paraqit një procedurë e plotë e parashikimit të karakteristikave të rezistencës dhe të koeficientëve të propulsionit për rastin e një anijeje peshkimi. Procedura shfrytëzon kapacitetet llogaritëse të softuerit "Fuqi Anije V 1.0" kombinuar me aplikacione të programeve komerciale të llogaritjeve të helikave, ose të dhënat e helikave sipas të dhënave eksperimentale të serive sistematike. Procedura mund të përdoret si në rastin anijeve ekzistuese Shqiptare, që kanë mungesë të këtij dokumentacioni, ashtu edhe në rastin e kryerjes së këtyre llogaritjeve në fazat fillestare të projektimit. Në fazat e avancuara të projekteve të anijeve të reja këto rezultate të llogaritjeve mund të merren ose duke shfrytëzuar matjet eksperimentale në vaskat navale, ose vlerësimet bazuar mbi llogaritjet e fluidodinamikës numerike CFD.

5. Referencat

- [1] INSTAT, (2022). *Statistikat e peshkimit* [2022].
- [2] ILVO MEDELING D/2022/04, (2022). *Fisheries Impact Assessment Albania*. 2022. ISSN 1784-3197.
- [3] Koričan, M., Perčić, M., Vladimir, N., Alujević, N., & Fan, A. (2022). *Alternative power options for improvement of the environmental*

friendliness of fishing trawlers. *Journal of Marine Science and Engineering*, , Vols. 10(12), 1882.

- [4] Szelangiewicz, T., Abramowski, T., Żelazny, K., & Sugalski, K. (2021). *Reduction of resistance, fuel consumption and GHG emission of a small fishing vessel by adding a bulbous bow*. *Energies*, 14(7), 1837.
- [5] Alma-Marís, (2023). *A pathway to decarbonise the EU fisheries sector by 2050. Report produced for Oceana Europe by Alma Marís Consulting*. 96 pp. February 2023.
- [6] IMO, (2009). *Second IMO GHG study*. [Accessed on: 27 July 2023].
- [7] Xhaferaj, B., (2022). *Investigation on some conventional hulls forms of the predictive accuracy of a parametric software for preliminary predictions of resistance and power*. *Brodogradnja*, 2022, Vol. 73/01. pp 1-22. <https://doi.org/10.21278/brod73101>.
- [8] Xhaferaj, B., Dukaj, A. (2012). *A computer program for prediction of resistance and power of ship*. *International Conference on Ship and Shipping Research*, NAV 2012. Napple, Italy 2012.
- [9] *A new procedure of power prediction based on Van Oortmerssen regression*. Xhaferaj, B., Dukaj, A., (2017). *Proceedings of IMAM 2017 - Maritime Transportation and Harvesting of Sea Resources*, 2016, 1, pp. 387–392.
- [10] *Maritime Research Institute of Netherlands. Open waters diagrams*, Wageningen B-Series. 1978.
- [11] Van Lammeren, W. P. A., van Manen, J. V., & Oosterveld, M. W. C. (1969). *The Wageningen B-screw series*. *Transactions S.N.A.M.E.* 77, pp. 269–317.
- [12] Munazid, A., Ariana, I. M., & Utama, I. K. A. P. (2020, August). *Numerical Study of Pre-Duct on Traditional Fishing Vessels as Energy Saving Device (ESD)*. In *IOP Conference Series: Earth and Environmental Science*, Vols. (Vol. 557, No. 1, p. 012049).
- [13] Xhaferaj, B., (2022). *Rast studimor i analizës krahasuese të parashikimeve të rezistencës në lëvizje të softuerit "Fuqi Anije V 1.0" kundrejt të dhënave eksperimentale për një anije çisterne*. *Buletini Shkencor - Universiteti i Vlores "Ismail Qemali"*, Numri 5, Volumi 3, 2022. ISSN 2310-6719.

SISTEMI I TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE PREZANTIMI I MBROJTJES FDIR

Mateo Selfo¹, Aldi Tabaku², Enio Selfo¹

Technische Universität Clausthal¹

Universiteti Ismail Qemali Vlorë²

mateoselfo20@gmail.com

Abstrakt

Hyrje: Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike bën të mundur furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve. Në këtë sistem ndodhin dhe defekte për shkaqe të ndryshme dhe zgjidhja ideale është gjetja dhe rregullimi i defektit sa më shpejtë që konsumatorët të vazhdojnë të furnizohen me energji.[3] Këtë e realizon më së miri mbrojtja FDIR. **Qëllimi:** Në vendin tonë ndërprerjet e energjisë elektrike janë bërë më të shpeshta pasi gjetja e defekteve është bërë më e vështirë dhe reparimi në kohë po ashtu. Vlerësimi i sistemit të mbrojtjes FDIR lehtëson shumë punën dhe kursen kohën gjë që ul nivelin e shqetësimeve nga konsumatorët. **Materiali dhe metoda:** Janë përdorur literatura dhe artikuj të botuar bashkëkohore për të marrë informacion. Gjithashtu janë marrë të dhëna në terren dhe nga institucione përgjegjëse për transmetimin e energjisë elektrike. **Rezultatet:** Mbrojtja FDIR është futur kohët e fundit në përdorim për sistemin e transmetimit elektroenergjitik. Ajo bën të mundur gjetjen, izolimin dhe rregullimin e defektit në kohë shumë të shkurtër gjë që sjell kosto më të ulëta. Automatizimi i shpërndarjes mundëson operacione më fleksibël të kontrollit të rrjetit. Si rezultat, furnizimi me energji elektrike është më i besueshëm, efikas dhe më cilësor. Shpejtësia, kostoja dhe saktësia e proceseve të shumta të shpërndarjes së çelësave mund të përmirësohen me automatizimin e shpërndarjes. **Përfundim:** Teknologjitë e rrjeteve të avancuara bëjnë rrugën e tyre në botën e transmetimit dhe të shpërndarjes për të përmirësuar furnizimin me energji elektrike, duke e bërë shumë të besueshme. Komunikimet e avancuara janë gjithashtu të

nevojshme për rikonfigurimin manual ose automatik të rrjetit në rast se disa komponentë të rrjetit po përjetojnë dështime ose defekte. Burimet e ripërtërishme të energjisë do të vazhdojnë me vendosjen e shpejtë në rrjetin e shpërndarjes. **Rekomandime:** Brezat e shpërndarës duhet të bëhen pjesë e procesit të përditshëm të planifikimit, të projektimit dhe të proceseve operacionale dhe praktikave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë Sistemeve të Shpërndarjes, Nënstacioneve dhe Integritetit të Prodhimit të Shpërndarës.

Fjalë kyç: FDIR, automatizimi i shpërndarjes, nënstacion, rrjeti smart, transmetimi i energjisë elektrike

Abstract

Introduction: The electricity transmission system makes it possible to use electricity from consumers. In this system, defects occur for several different reasons and the ideal solution is to find and fix the defect as soon as possible so that consumers can continue to be supplied with energy.[3] This is best achieved by the FDIR protection. **Purpose:** In our country, power outages have become more frequent as finding defects has become more difficult and repairing them in time as well. The evaluation of the FDIR protection system greatly facilitates the work and saves time, which reduces the level of concerns from consumers. **Material and method:** Contemporary published literature and articles were used to obtain information. Also, data were obtained in the field and from an institution responsible for the transmission of electricity. **Results:** The FDIR protection has recently been

put into use for the electrical transmission system. It makes it possible to find, isolate and fix the defect in a very short time, which brings lower costs. Distribution automation enables more flexible network control operations. As a result, the electricity supply is more reliable, efficient and of better quality. The speed, cost and accuracy of many key distribution processes can be improved with distribution automation. **Conclusion:** Advanced grid technologies make their way into the world of transmission and distribution to improve the supply of electricity, making it highly reliable. Advanced communications are also needed for manual or automatic reconfiguration of the network in case some network components are experiencing failures or malfunctions. Renewable energy sources will continue to be rapidly deployed in the distribution network.

Recommendations: Distributed generation should become part of the daily planning process, design and operational processes and practices, paying special attention to Distribution Systems, Substations and Distributed Generation Integration.

Keywords: *FDIR, distribution automation, substation, smart grid, electricity transmission*

Hyrje []

Nga instalimi i rrjetit të parë elektrik më 4 shtator 1882, në Manhattan, shumë aspekte të energjisë elektrike kanë ndryshuar[1]. Këto përfshijnë rregullimin e tregut të energjisë, ndryshimet në matje, ndryshimet në prodhimin e energjisë, decentralizimin e energjisë së shpërndarë dhe rritjen e mikro-gjenerimit dhe mikro-rrjeteve të izoluara, duke përfshirë dhe burimet e rinovueshme të energjisë. Kompleksiteti i rrjetit aktual po rritet, së bashku me numrin e konsumatorëve dhe ngarkesave[2]. Për të menaxhuar në mënyrë efektive këtë rrjet jashtëzakonisht kompleks të energjisë, është prezantuar ideja e Rrjetit Inteligent. Ky rrjet përkufizohet si "një rrjet i modernizuar që mundëson rrjedhje energjie disa-drejtimshme dhe përdor aftësi komunikimi dhe kontrolli të dyanshme që do të çojnë në një sërë funksionalitetesh dhe aplikimesh të reja"[3]. Elektronika industriale, inxhinieria e komunikimit dhe përparimet e shkencës materiale kanë kontribuar të gjitha në zhvillimin e Rrjetit inteligjent. Gjenerimi i shpërndarë (DG) ose gjenerimi i decentralizuar nuk është një koncept i ri i industrisë. Në 1882, Thomas Edison ndërtoi fabrikën e tij të parë komerciale elektrike - "Pearl

Street"[4]. Stacioni Pearl Street ofroi energji elektrike me rrymë direkte 110 V (DC) për 59 klientë në Manhattanin e poshtëm. Deri në vitin 1887, kishte 121 termocentrale Edison në Shtetet e Bashkuara që jepnin energji elektrike DC për klientët. Këto termocentrale të hershme punonin me qymyr ose ujë[5]. Prodhimi i centralizuar i energjisë u bë i mundur kur u kuptua se energjia elektrike me rrymë alternative (AC) mund të transportohej me kosto relativisht të ulëta me humbje të reduktuara të energjisë në distanca të mëdha duke përfutur nga aftësia për të rritur tensionin në stacionin e prodhimit dhe për të ulur tensionin pranë klientit. ngarkesat. Përveç kësaj, konceptet e përmirësimit të performancës së sistemit (stabiliteti i sistemit) dhe përdorimi më efektiv i aseteve të gjenerimit siguruan një platformë për integrimin e rrjetit në një zonë të gjerë. Kohët e fundit, ka pasur një interes në rritje të shpejtë për vendosjen e gjerë të gjenerimit të shpërndarë, që është energjia elektrike e shpërndarë në rrjet nga një sërë vendndodhjesh të decentralizuara[10]. Teknologjitë e disponueshme komerciale për gjenerimin e shpërndarë bazohen në turbinat me erë, motorët me djegie, turbinat mikro dhe mini-gaz, qelizat e karburantit, instalimet fotovoltaike (solare), njësitë hidro me kokë të ulët dhe sistemet gjeotermale. [2]

Çrregullimi i industrisë së shërbimeve elektrike, shqetësimet mjedisore të lidhura me termocentralet tradicionale të prodhimit të lëndëve djegëse fosile, paqëndrueshmëria e kostove të energjisë elektrike, mbështetja rregullatore federale dhe shtetërore për energjinë "e gjelbër" dhe zhvillimet e shpejta teknologjike mbështesin përhapjen e gjenerimit të shpërndarë në sistemet e shërbimeve elektrike. [11]. Shkalla në rritje e vendosjes së DP sugjeron gjithashtu se zgjidhjet alternative të bazuara në energji do të luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në rrjetin inteligjent dhe shërbimet moderne. [13]

Zbatimi në shkallë të gjerë i gjenerimit të shpërndarë mund të çojë në evoluimin e rrjetit të shpërndarjes nga një sistem "pasiv" (automatizimi, monitorimi dhe kontrolli lokal/i kufizuar) në një sistem "aktiv" (global/integruar, vetë-monitorues, gjysmë i automatizuar) që i përgjigjet automatikisht dinamikave të ndryshme të rrjetit elektrik, duke rezultuar në efikasitet më të lartë, menaxhim më të mirë të ngarkesës dhe më pak ndërprerje.[14] Megjithatë, gjenerimi i

shpërndarë gjithashtu paraqet një sfidë për projektimin, funksionimin dhe menaxhimin e rrjetit të energjisë, sepse rrjeti nuk sillet më si dikur. Rrjedhimisht, planifikimi dhe funksionimi i sistemeve të reja duhet të trajtohen ndryshe, me një vëmendje më të madhe ndaj sfidave të një sistemi të automatizuar global.

Kërkesat e mëposhtme duhet të plotësohen nga dizajnimi, zbatimi dhe funksionimi i rrjetit modern të automatizuar:

- Shpërndarja dhe transmetimi i energjisë duhet të jetë me kosto efektive. [3]
- Kostoja e energjisë elektrike për konsumatorët duhet të jetë më e ulët.
- Siguria e sistemit duhet të garantohet.
- Në rast të një defekti, restaurimi i shërbimit duhet të jetë i shpejtë. [15]
- Duke lidhur më shumë Burime të Energjisë së Rinovueshme (BRE) në rrjet, impaktet mjedisore duhet të monitorohen siç duhet.
- Menaxhimi dhe integrimi i BRE-ve duhet të përmirësohet. [16]

Rrjeti konvencional ndryshon nga një rrjet smart në shumë mënyra. Në krahasim me një infrastrukturë si rrjeti smart, rrjeti konvencional ka më pak sensorë. Këta sensorë janë përgjegjës për sigurimin e të dhënave në kohë reale të rrjetit për monitorimin dhe kontrollin e sistemit. Rrjeti i komunikimit të rrjetit smart duhet të krijohet për komunikim të dyanshëm midis klientëve dhe qendrave të kontrollit. Për më tepër, prezantimi i Infrastrukturës së Matjes së Avancuar (AMI) varet nga kjo lidhje dykahëse.[17] Një metodë standarde e matjes elektro-mekanike të një rrjeti elektrik përjashton përdorimin e transferimit të të dhënave në kohë reale në këtë konfigurim. Rrjedhimisht, një sistem matës dixhital është një domosdoshmëri thelbësore për rrjetin smart në mënyrë që të miratojë zgjidhje automatizimi si Leximi Automatik i Matjeve (AMR) ose AMI. [18] Mbledhja e të dhënave të matësve të energjisë dhe transmetimi i sigurt në stacionin e kontrollit për faturimin, zgjidhjen e problemeve dhe analizën janë detyrat e AMR ose AMI. [9] Rrjeti smart përbëhet nga fusha të ndryshme ose njësi operationale. Funksionaliteti i çdo njësie varet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga çdo njësi tjetër në rrjet. [19] Së bashku me strategjitë e zbulimit dhe izolimit të defekteve, restaurimi i shërbimit përbën një nga tiparet kryesore të automatizimit të shpërndarjes. [3] Shumica e artikujve të

mëparshëm të rishikimit fokusohen në strategjitë individuale në vend që të paraqesin problemet dhe zgjidhjet e FDIR si një strategji e vetme.

Parimet e automatizimit të shpërndarjes diskutohen në këtë punim, së bashku me avantazhet dhe sfidat shoqëruese. Infrastruktura e komunikimit e nevojshme për të zbatuar strategji të ndryshme të automatizimit të shpërndarjes është diskutuar gjithashtu. Shpjegimi i koncepteve të FDIR dhe puna e tyre kërkimore në sfond është paraqitur në vijim pjesë e këtij punimi. Diskutohen aspekte të ndryshme të problemit të FDIR, si dhe qasje të centralizuara dhe të decentralizuara për zgjidhjen e tyre. Është trajtuar evolucioni i algoritmeve të ndryshme të restaurimit të shërbimeve, së bashku me përfitimet dhe disavantazhet e tyre.

Automatizimi i Shpërndarjes

Çdo proces automatik përkufizohet si një proces që kryen një detyrë në një mënyrë të automatizuar për të arritur një shpejtësi më të shpejtë të funksionimit.[20] Koncepti i automatizimit të shpërndarjes u propozua për herë të parë në vitet 1970 , kur qëllimi ishte rritja e performancës operative të sistemit të shpërndarjes së energjisë. Megjithatë, për shkak të kostove të larta të zbatimit dhe teknologjisë së papjekur të komunikimit, koncepti nuk u miratua plotësisht nga ndërmarrjet elektrike.[21] Vitet e fundit, me avancimin e teknologjisë së komunikimit, sistemeve të marrjes së të dhënave, mjeteve të analizës së të dhënave dhe elektronikës së energjisë, automatizimi i shpërndarjes po bëhet sërish fokusi i kërkimit dhe përmirësimit. Instituti i Inxhinierëve Elektrikë dhe Elektronikë (IEEE) ka përcaktuar Sistemet e Automatizimit të Shpërndarjes (DAS) si sisteme që mundësojnë një ndërmarrje elektrike të monitorojë, koordinojë dhe operojë komponentët e shpërndarjes në kohë reale nga vende të largëta.[22] Automatizimi i shpërndarjes mundëson operatione më fleksibël të kontrollit të rrjetit. Si rezultat, furnizimi me energji elektrike është më i besueshëm, efikas dhe më cilësor. Shpejtësia, kostoja dhe saktësia e proceseve të shumta të shpërndarjes së çelësave mund të përmirësohen me automatizimin e shpërndarjes.[7] Këto përfshijnë zbulimin e dështimit, ndërrimin e furnizuesit, menaxhimin e ndërprerjeve, monitorimin dhe kontrollin e tensionit, menaxhimin e energjisë reaktive,

mirëmbajtjen e pajisjeve të linjës ushqyese dhe integrimin në rrjet të burimeve të energjisë së shpërndarë.

Përfitimet e Automatizimit të Shpërndarjes

Ka disa përfitime të zbatimit të strategjive të automatizimit të shpërndarjes.

- Përfitimet operative dhe të mirëmbajtjes komponentëve
- Përfitimet financiare

Kuptimi i mbrojtjes FDIR

Mbrojtja FDIR është një koncept që lidhet me sistemet e kontrollit të avionëve.[22] Sigla FDIR vjen nga terminet Fault Detection, Isolation, and Recovery, që në shqip mund të përkthehet si Zbulimi i Gabimeve, Izolimi dhe Rikuperimi.

Mbrojtja FDIR përdoret në sistemet e avionëve për të zbuluar, identifikuar dhe trajtuar gabime ose defekte të mundshme në pajisjet dhe në sistemet e avionit.[23] Për të kuptuar si funksionon mbrojtja FDIR, le të shpjegojmë çdo pjesë të saj:

- Zbulimi i gabimeve (Fault Detection): Kjo pjesë e mbrojtjes FDIR përdoret për të identifikuar gabime ose defekte në sistemet e avionit.
- Izolimi (Isolation): Pas zbulimit të një gabimi, sistemi duhet të identifikojë burimin e gabimit dhe ta izolojë atë. Kjo është procesi i identifikimit të komponentit ose sistemit të caktuar që ka shkaktuar gabimin.
- Rikuperimi (Recovery): Pas izolimit të gabimit, sistemi mund të kalojë në fazën e rikuperimit, duke marrë masa për të zëvendësuar ose rregulluar komponentin e gabuar. [24]

Aplikimi në fushën e transmetimit të energjisë elektrike

Për të mbajtur konsumatorët në një treg të çrregulluar, ofruesit e energjisë duhet të rrisin cilësinë e shërbimit të tyre. Si rezultat, disa ndërmarrje elektrike kanë prezantuar DAS si një metodë inteligjente për të përmirësuar besueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit të shpërndarjes.[25] FDIR konsiderohet si më i rëndësishmi nga të gjitha funksionet e automatizimit të shpërndarjes. Qëllimi i FDIR është të minimizojë kohën e restaurimit të shërbimit për një ngjarje defekti të përhershëm të furnizuesve të shpërndarjes nga një mesatare prej 58 minutash në më pak se 5 minuta. Kur ndodh një defekt në anën e shpërndarjes, komponentë të


ndryshëm inteligjentë të tillë si IED-të që janë të lidhura nëpërmjet një rrjeti komunikimi transmetojnë informacionin e defektit përgjatë segmentit të rrjetit të prekur.[26] Përveç mbrojtjes, IED kryejnë funksione të tilla si kontrolli, matja, regjistrimi i shqetësimeve dhe monitorimi i gjendjes. Shpejtësia e transferimit të të dhënave përmes IED-ve është shumë më e shpejtë sesa me metodat konvencionale. Kur këto IED janë të lidhura në rrjet, ato mund të ofrojnë pothuajse të gjithë informacionin e nevojshëm për operatorët e sistemit. Në rast defekti, IED-të e lidhura me ndërprerësit dërgojnë mesazhe kontrolli tek IED-të e tjera të rrjetit. Bazuar në këtë shkëmbim informacioni, ndërmerren hapat e nevojshëm për të hequr defektin dhe për të rivendosur energjinë sa më shpejt të jetë e mundur.[27]

Rrjeti i komunikimit luan një rol kritik në identifikimin e defektit dhe rivendosjen e fuqisë. Protokollet e nënstacionit si IEC61850 mund të përdoren në sistemet moderne të energjisë për të shkëmbyer informacion. Ardhja e standardit IEC61850 mundëson një sërë aftësish dhe përfitimesh mbrojtjeje dhe kontrolli, duke përfshirë komunikimin nga kolegët përmes mesazheve Generic Object Oriented Substation Event (GOOSE)[28] Komunikimi pa tel GOOSE mund të përdoret për të përmirësimit i aplikacioneve aktuale të automatizimit të nënstacioneve të tensionit të mesëm (MV). GOOSE mundëson monitorim më të gjerë të sistemit. Të gjitha lidhjet GOOSE kontrollohen vazhdimisht dhe nëse konstatohen anomali, ato i raportohen operatorit. Transferimi i shpejtë dhe i besueshëm i të dhënave është thelbësor për zbatimin e strategjisë FDIR.[29]

Në strategjitë FDIR, hapat e mëposhtëm zbatohen në mënyrë sekuenciale:

- Zbulimi i defekteve:
- Izolimi i defektit:
- Klasifikimi i gabimeve:
- Vlerësimi i kapacitetit:
- Rivendosja e shërbimit:

Fig 1: Skemat e kontrollit për FDIR



Faktorët që ndikojnë në sigurinë e skemës

Siguria e një skeme të automatizuar FDIR (Fault Detection, Isolation, and Recovery) është një aspekt kritik që duhet të merret parasysh gjatë zhvillimit dhe përdorimit të saj.[30] Këtu janë disa faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në sigurinë e një skeme të automatizuar FDIR:

- Induktanca: Përdorimi i komponentëve të induktancës është një mënyrë për të rritur sigurinë e skemës FDIR. Duke përdorur komponentë të dyfishtë ose më shumë për të zëvendësuar njëri-tjetrin në rastin e një gabimi, rritet rezistenca e sistemit ndaj defekteve. [31]
- Verifikimi dhe validimi: Skema FDIR duhet të verifikohet dhe të validohet së bashku me sistemet e tjera të kontrollit për të garantuar performancën dhe sigurinë e saj. Kjo përfshin testimin dhe simulimin e situatave të gabimeve për të vlerësuar se si skema FDIR reagon dhe për të identifikuar çdo kufizim ose mungesë të sigurisë.[32]
- Qasja e të dhënave: Skema FDIR bazohet në të dhënat dhe sinjalet e sensorëve për të zbuluar dhe identifikuar gabimet. Siguria e sistemit duhet të mbrohet nga ndikimet e të dhënave të paautorizuara ose të korruptuara që mund të ndikojnë në rezultatet e skemës FDIR.[33] Përdorimi i metodave të sigurisë së të dhënave, përfshirë verifikimin dhe autentifikimin e tyre, mund të ndihmojë në parandalimin e ndikimeve të jashtme të papëlqyera. [34]
- Mekanizma të rezistencës: Skemat FDIR duhet të jenë të pajisura me mekanizma të rezistencës për të parandaluar dëmtime të mëtejshme nga gabimet ose defektet. Kjo përfshin ndërprerjen e pjesëve të sistemit të prekur për të minimizuar përhapjen e gabimit dhe për të ruajtur funksionimin e pjesëve të tjera të sistemit.[35]

- Monitorimi dhe diagnostifikimi i skemës: Siguria e skemës FDIR varet nga aftësia e monitorimit dhe diagnostifikimit të vetë skemës. Aftësia për të identifikuar gabimet dhe për të siguruar izolimin dhe rikuperimin e tyre në mënyrë të saktë dhe efikase është kritike për sigurinë e sistemit. [36]

Për të rritur sigurinë e një skeme të automatizuar FDIR, është gjithashtu e rëndësishme të respektohen standardet e sigurisë dhe praktikrat e mira të industrisë për zhvillimin dhe implementimin e sistemeve të automatizuara.[37]

Drejtime të ardhshme dhe rekomandime

Sistemet e sotme të shpërndarjes po bëhen gjithnjë e më të komplikuar. Metodrat e reja të prodhimit dhe ruajtjes së energjisë elektrike si PV, qelizat e karburantit dhe sistemet e ruajtjes së baterive dhe metodat e reja të konsumimit të energjisë elektrike, siç janë aparatet e avancuar dhe automjetet elektrike plug-in janë duke u lidhur me rrjetin e shpërndarjes.[] Shumë ndërmarrje po përballen me këto sfida sot në fushat gjithnjë e më të mëdha të rrjetit të shpërndarjes.[38] Shumë zhvillues po ndërtojnë komunitete të reja të gjelbra që përmbajnë brez dhe ruajtje të mjaftueshme për të mbajtur ngarkesën e komunitetit gjatë një ndërprerjeje. Funksioni i rrjetit të energjisë do të integrojë më tej të gjitha sistemet e shpërndarjes për të ruajtur një rrjet shpërndarjeje të sigurt, të besueshme dhe të efektshme.[39] Kjo do të ketë efektin e zvogëlimit të kostove dhe rritjen e përfitimeve të përgjithshme të këtyre teknologjive, duke ruajtur një cilësi dhe besueshmëri të përmirësuar të energjisë elektrike të ofruar konsumatorëve në sistemin e shpërndarjes. Ky justifikim më i fuqishëm ekonomik do të ndikojë në avancimin e këtyre teknologjive të reja duke shkaktuar një ndikim të rëndësishëm në çështjet dhe elementet e dizajnit të sistemit të shpërndarjes dhe sistemeve të automatizimit të ndërlidhura.[40]Këto zhvillime të mëdha që po ndodhin në industrinë e energjisë duke ndryshuar tërë botën e transmetimit dhe shpërndarjes duke përfshirë nënstacionet. [41]

Këtu përmendim:

- Avancimet në komunikim nënkuptojnë komunikim të drejtpërdrejtë në mes të konsumatorit, rrjetit dhe stacionit të gjenerimit në

kohë reale, kështu që shërbimi mund të balancojë kërkesën e ngarkesës në të dy drejtimet. Komunikimet e avancuara janë gjithashtu të nevojshme për rikonfigurimin manual ose automatik të rrjetit në rast se disa komponentë të rrjetit po përjetojnë dështime ose defekte.[42]

- Reletë mbrojtëse të përparuar dhe pajisje të tjera të kontrollit me komunikim të zgjeruar dhe aftësi algoritme për të zbuluar, izoluar dhe rikonfiguruar automatikisht rrjetin për të ruajtur furnizimin me energji të pandërprerë.[43]

- Burimet e ripërtërishme të energjisë do të vazhdojnë me vendosjen e shpejtë në rrjetin e shpërndarjes.[40]Fuqia e erës, energjia diellore, njësitë e hidrocentraleve do të rrisin kapacitetin dhe prodhimin e tyre; sistemet e magazinimit të energjisë do të vendosen për të ndihmuar sistemin për të përmbushur kërkesën e pikut dhe gjeneratorëve të sistemit.[44] Microgrids do të sigurojë konsumatorët me energji të besueshme dhe me cilësi të lartë kur lidhja me një sistem transmetimi n është humbur ose në rast të një komuniteti të izoluar.[45]




Fig 2: Skema e funksionimit te Microgrids

Një numër gjithnjë e më i madh i ndërmarrjeve elektrike në mbarë botën po kërkojnë mënyra për të ofruar shërbime të shkëlqyera të energjisë duke u bërë më të fokusuar në konsumatorë, konkurrues, eficient, inovativ dhe përgjegjës për mjedisin.[46] Brezat e shpërndarë duhet të bëhen pjesë e procesit të përditshëm të planifikimit, të projektimit dhe të proceseve operacionale dhe praktikave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë: Sistemet e Shpërndarjes, Nënstacionet dhe Integrimi i Prodhimit të Shpërndarë

- Dizajnet e nënstacioneve të transmetimit dhe shpërndarjes

- Kufijtë e vlerësimit të pajisjeve për rritjen e nivelit të defekteve (për shkak të gjenerimit të shtuar të shtuar) [47]

- Reletë dhe rregullimet mbrojtëse që mund të sigurojnë funksionimin e besueshëm dhe të sigurt të sistemit me shpërndarje të ndërlidhur gjenerata (mund të përballojë burime të shumëfishta, rryma të kundërt, nivele të ndryshueshme të defekteve etj.)[48]

- Praktikat e restaurimit të shërbimit që zvogëlojnë mundësinë e ndërhyrjes së gjenerimit të shpërndarë në proces dhe madje të përfitojnë nga gjenerata e shpërndarë për të rritur besueshmërinë aty ku është e mundur[49]

- Praktikat dhe mjetet e tokëzimit për të kontrolluar mbtensionet e shpërndara të gjeneruara nga gjenerimi. [50]

Referencat:

1. I.Srivastava, S.Bhat ,B. V. S. Vardhan and N. Dhanraj Bokde, *Fault Detection, Isolation and Service Restoration in Modern Power Distribution Systems: A Review*
2. Arnold, G.W.; Wollman, D.A.; FitzPatrick, G.; Prochaska, D.; Holmberg, D.; Su, D.H.; Hefner, A.R., Jr.; Golmie, N.T.; Brewer, T.L.; Bello, M.; et al. *NIST Framework and Roadmap for Smart Grid Interoperability Standards, Release 1.0; NIST Special Publication; National Institute of Standards and Technology: Gaithersburg, MD, USA, 2010; p. 145. [Google Scholar] [CrossRef]*
3. Nafi, N.S.; Ahmed, K.; Gregory, M.A.; Datta, M. A Survey of Smart Grid Architectures, Applications, Benefits and Standardization. *J. Netw. Comput. Appl.* **2016**, *76*, 23–36. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
4. Latore, N.A.; Bhat, S.S.; Srivastava, I. Literature Review of Service Restoration in Distribution System. In *Proceedings of the 2017 Second International Conference on Electrical, Computer and Communication Technologies (ICECCT), Coimbatore, India, 22–24 February 2017; pp. 1–6. [Google Scholar] [CrossRef]*
5. Gururajapathy, S.S.; Mokhlis, H.; Illias, H.A. Fault Location and Detection Techniques in Power Distribution Systems with Distributed Generation: A Review. *Renew. Sustain. Energy Rev.* **2017**, *74*, 949–958. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
6. Mwfuniyi, R.J.; Kissaka, M.M.; Mvungi, N.H. Distributed Approach in Fault Localisation and Service Restoration: State-of-the-Art and Future Direction. *Cogent Eng.* **2019**, *6*, 1628424. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)

7. Jiang, Y.; Liu, C.-C.; Xu, Y. Smart Distribution Systems. *Energies* **2016**, *9*, 297. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)] [[Green Version](#)]
8. Pahwa, A. Planning and Analysis Tools to Evaluate Distribution Automation Implementation and Benefits. *IEEE Power Eng. Soc. Gen. Meet.* **2005**, *3*, 2622–2623. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
9. Gruenemeyer, D. Distribution Automation: How Should It Be Evaluated? In *Proceedings of the 1991 Rural Electric Power Conference, the 35th Annual Conference, Dearborn, MI, USA, 28–30 April 1991*; pp. C3/1–C310. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
10. Sanchez, J.; Caire, R.; Hadjsaid, N. ICT and Power Distribution Modeling Using Complex Networks. In *Proceedings of the 2013 IEEE Grenoble Conference, Grenoble, France, 16–20 June 2013*; pp. 1–6. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
11. Elattar, E.E.; Shaheen, A.M.; El-Sayed, A.M.; El-Sehiemy, R.A.; Ginidi, A.R. Optimal Operation of Automated Distribution Networks Based-MRFO Algorithm. *IEEE Access* **2021**, *9*, 19586–19601. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
12. Shaheen, A.; Elsayed, A.; Ginidi, A.; El-Sehiemy, R.; Elattar, E. Improved Heap-Based Optimizer for DG Allocation in Reconfigured Radial Feeder Distribution Systems. *IEEE Syst. J.* **2022**, 1–10. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
13. Shaheen, A.M.; Elsayed, A.M.; Ginidi, A.R.; El-Sehiemy, R.A.; Elattar, E. A Heap-Based Algorithm with Deeper Exploitative Feature for Optimal Allocations of Distributed Generations with Feeder Reconfiguration in Power Distribution Networks. *Knowl. Based Syst.* **2022**, *241*, 108269. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
14. Lin, C.-H.; Chuang, H.-J.; Chen, C.-S.; Li, C.-S.; Ho, C.-Y. Fault Detection, Isolation and Restoration Using a Multiagent-Based Distribution Automation System. In *Proceedings of the 2009 4th IEEE Conference on Industrial Electronics and Applications, Xi'an, China, 25–27 May 2009*; pp. 2528–2533. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
15. Apostolov, A.; Vandiver, B. IEC 61850 GOOSE Applications to Distribution Protection Schemes. In *Proceedings of the 2011 64th Annual Conference for Protective Relay Engineers, College Station, TX, USA, 4–7 April 2016*; pp. 178–184. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
16. Milioudis, A.N.; Andreou, G.T.; Labridis, D.P. Enhanced Protection Scheme for Smart Grids Using Power Line Communications Techniques—Part I: Detection of High Impedance Fault Occurrence. *IEEE Trans. Smart Grid* **2012**, *3*, 1621–1630. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
17. Li, J.; Ma, X.-Y.; Liu, C.-C.; Schneider, K.P. Distribution System Restoration With Microgrids Using Spanning Tree Search. *IEEE Trans. Power Syst.* **2014**, *29*, 3021–3029. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
18. Zidan, A.; El-Saadany, E.F. A Cooperative Multiagent Framework for Self-Healing Mechanisms in Distribution Systems. *IEEE Trans. Smart Grid* **2012**, *3*, 1525–1539. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
19. Shahin, M.A. Smart Grid Self-Healing Implementation for Underground Distribution Networks. In *Proceedings of the 2013 IEEE Innovative Smart Grid Technologies-Asia (ISGT Asia), Bangalore, India, 10–13 November 2013*; pp. 1–5. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
20. Zidan, A.; Khairalla, M.; Abdrabou, A.M.; Khalifa, T.; Shaban, K.; Abdrabou, A.; El Shatshat, R.; Gaouda, A.M. Fault Detection, Isolation, and Service Restoration in Distribution Systems: State-of-the-Art and Future Trends. *IEEE Trans. Smart Grid* **2017**, *8*, 2170–2185. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
21. Shahidehpour, M.; Wang, Y. *Communication and Control in Electric Power Systems: Applications of Parallel and Distributed Processing*; IEEE Press Series on Power Engineering; IEEE Press: Piscataway, NJ, USA; Wiley-Interscience: Hoboken, NJ, USA, 2003. [[Google Scholar](#)]
22. Arefifar, S.A.; Mohamed, Y.A.-R.I.; EL-Fouly, T.H.M. Comprehensive Operational Planning Framework for Self-Healing Control Actions in Smart Distribution Grids. *IEEE Trans. Power Syst.* **2013**, *28*, 4192–4200. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
23. Craig, D.; Spare, J. Benefits of Automatic Fault Detection, Isolation and Service Restoration on Power Distribution Circuits. In *Proceedings of the PES T&D 2012, Orlando, FL, USA, 7–10 May 2012*; pp. 1–4. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
24. Tanenbaum, A.S.; Van Steen, M. *Distributed Systems: Principles and Paradigms*; Prentice-Hall: Upper Saddle River, NJ, USA, 2007. [[Google Scholar](#)]
25. Mohagheghi, S.; Stoupis, J.; Wang, Z. Communication Protocols and Networks for Power Systems—Current Status and Future Trends. In *Proceedings of the 2009 IEEE/PES Power Systems Conference and Exposition, Seattle, WA, USA, 15–18 March 2009*; pp. 1–9. [[Google Scholar](#)] [[CrossRef](#)]
26. Mekic, F.; Alloway, K.; Angelo, C.; Goodin, R. Fault Detection Isolation and Restoration on the Feeder (FDIR): Pick Your Technology. In *Proceedings of the CIRED, 21ST International*

- Conference on Electricity Distribution, Frankfurt, Germany, 6–9 June 2011; pp. 6–9. [\[Google Scholar\]](#)
27. Jenkins, R.; Dolezilek, D. Case Study: Using IEC 61850 Methods for RTU Replacement and Distributed Automation. In Proceedings of the 10th Annual Western Power Delivery Automation Conference, Spokane, WA, USA; 2008. [\[Google Scholar\]](#)
28. Wernsing, R.; Hubertus, J.; Duffy, M.; Hataway, G.; Conner, D.; Nelson, E. Implementation of an Innovative Advanced Loop Scheme to Provide Distribution Reliability Improvement. In Proceedings of the 2010 IEEE Rural Electric Power Conference (REPC), Orlando, FL, USA, 16–19 May 2010; pp. B2–B2-8. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
29. Nagata, T.; Tao, Y.; Sasaki, H.; Fujita, H. A Multiagent Approach to Distribution System Restoration. In Proceedings of the 2003 IEEE Power Engineering Society General Meeting (IEEE Cat. No.03CH37491), Toronto, ON, Canada, 13–17 July 2003; pp. 655–660. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
30. Chen, X.; Kong, B.; Liu, F.; Gong, X.; Shen, X. System Service Restoration of Distribution Network Based on Multi-Agent Technology. In Proceedings of the 2013 Fourth International Conference on Digital Manufacturing & Automation; IEEE: Qingdao, China, 2013; pp. 1371–1374. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
31. Lo, Y.L.; Wang, C.H.; Lu, C.N. A Multi-Agent Based Service Restoration in Distribution Network with Distributed Generations. In Proceedings of the 2009 15th International Conference on Intelligent System Applications to Power Systems, Curitiba, Brazil, 8–12 November 2009; pp. 1–5. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
32. Khamphanchai, W.; Pipattanasomporn, M.; Rahman, S. A Multi-Agent System for Restoration of an Electric Power Distribution Network with Local Generation. In Proceedings of the 2012 IEEE Power and Energy Society General Meeting, San Diego, CA, USA, 22–26 July 2012; pp. 1–8. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
33. Elmitwally, A.; Elsaid, M.; Elgamel, M.; Chen, Z. A Fuzzy-Multiagent Service Restoration Scheme for Distribution System With Distributed Generation. *IEEE Trans. Sustain. Energy* **2015**, *6*, 810–821. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
34. Ghorbani, M.J.; Choudhry, M.A.; Feliachi, A. A Multiagent Design for Power Distribution Systems Automation. *IEEE Trans. Smart Grid* **2016**, *7*, 329–339. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#) [\[Green Version\]](#)
35. Sharma, A.; Srinivasan, D.; Trivedi, A. A Decentralized Multiagent System Approach for Service Restoration Using DG Islanding. *IEEE Trans. Smart Grid* **2015**, *6*, 2784–2793. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
36. Dong, Z.; Lin, L.; Guan, L.; Chen, H.; Liang, Q. A Service Restoration Strategy for Active Distribution Network Based on Multiagent System. In Proceedings of the 2018 IEEE Innovative Smart Grid Technologies—Asia (ISGT Asia), Singapore, 22–25 May 2018; pp. 384–389. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
37. Habib, H.F.; Youssef, T.; Cintuglu, M.H.; Mohammed, O.A. Multi-Agent-Based Technique for Fault Location, Isolation, and Service Restoration. *IEEE Trans. Ind. Applicat.* **2017**, *53*, 1841–1851. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
38. Prabawa, P.; Choi, D.-H. Multi-Agent Framework for Service Restoration in Distribution Systems With Distributed Generators and Static/Mobile Energy Storage Systems. *IEEE Access* **2020**, *8*, 51736–51752. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
39. Nguyen, C.P.; Flueck, A.J. Agent Based Restoration With Distributed Energy Storage Support in Smart Grids. *IEEE Trans. Smart Grid* **2012**, *3*, 1029–1038. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
40. Estebsari, A.; Patti, E.; Barbierato, L. Fault Detection, Isolation and Restoration Test Platform Based on Smart Grid Architecture Model Using Internet-of-Things Approaches. In Proceedings of the 2018 IEEE International Conference on Environment and Electrical Engineering and 2018 IEEE Industrial and Commercial Power Systems Europe (EEEIC / I&CPS Europe), Palermo, Italy, 12–15 June 2018; pp. 1–5. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
41. Hussain, S.M.S.; Nadeem, F.; Aftab, M.A.; Ali, I.; Ustun, T.S. The Emerging Energy Internet: Architecture, Benefits, Challenges, and Future Prospects. *Electronics* **2019**, *8*, 1037. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#) [\[Green Version\]](#)
42. Gundu, V.; Simon, S.P. A Novel Energy Routing Technique with Hybrid Energy Storage for Residential Electricity Cost Minimization in a Smart Distribution Network. *Energy Sources Part A Recovery Util. Environ. Eff.* **2020**, 1–18. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
43. Shewale, A.; Mokhade, A.; Funde, N.; Bokde, N.D. An Overview of Demand Response in Smart Grid and Optimization Techniques for Efficient Residential Appliance Scheduling Problem. *Energies* **2020**, *13*, 4266. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
44. Shewale, A.; Mokhade, A.; Funde, N.; Bokde, N.D. A Survey of Efficient Demand-Side Management Techniques for the Residential

- Appliance Scheduling Problem in Smart Homes. Energies* **2022**, 15, 2863. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
45. Kabalci, Y.; Kabalci, E.; Padmanaban, S.; Holm-Nielsen, J.B.; Blaabjerg, F. Internet of Things Applications as Energy Internet in Smart Grids and Smart Environments. *Electronics* **2019**, 8, 972. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
46. Mets, K.; Ojea, J.A.; Develder, C. Combining Power and Communication Network Simulation for Cost-Effective Smart Grid Analysis. *IEEE Commun. Surv. Tutor.* **2014**, 16, 1771–1796. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
47. Avancini, D.B.; Rodrigues, J.J.P.C.; Rabêlo, R.A.L.; Das, A.K.; Kozlov, S.; Solic, P. A New IoT-based Smart Energy Meter for Smart Grids. *Int. J. Energy Res.* **2021**, 45, 189–202. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
48. Li, X.; Liang, X.; Lu, R.; Shen, X.; Lin, X.; Zhu, H. Securing Smart Grid: Cyber Attacks, Countermeasures, and Challenges. *IEEE Commun. Mag.* **2012**, 50, 38–45. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)
49. Ni, K.; Ramanathan, N.; Chehade, M.N.H.; Balzano, L.; Nair, S.; Zahedi, S.; Kohler, E.; Pottie, G.; Hansen, M.; Srivastava, M. Sensor Network Data Fault Types. *ACM Trans. Sen. Netw.* **2009**, 5, 1–29. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#) [\[Green Version\]](#)
50. Zou, Z.; Bao, Y.; Li, H.; Spencer, B.F.; Ou, J. Embedding Compressive Sensing-Based Data Loss Recovery Algorithm Into Wireless Smart Sensors for Structural Health Monitoring. *IEEE Sens. J.* **2015**, 15, 797–808. [\[Google Scholar\]](#) [\[CrossRef\]](#)

Rrjeti rrugor dhe nevoja për transport të qëndrueshëm në qytetin e Vlorës

Dr. Ing. Pëllumb Cacaj¹

¹Universiteti i Vlorës "I. Qemali"

Fakulteti i Shkencave dhe natyrës

Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare

pellumb.cacaj@univlora.edu.al, pellumb_cacaj@yahoo.it

Prof.Asoc. Shpëtim Cami²

²Universiteti Ndërkombëtar Strugë

Maqedoni e Veriut

Fakulteti i Shkencave Politike

sh.cami@eust.edu.mk, shpetimcami@gmail.com

Abstrakt

Qyteti i Vlorës, me ndryshimin e sistemit politik, pësoi një zhvillim të madh në fushën e transportit. Numri i automjeteve u rrit me ritme të shpejta dhe ishin automjete të llojeve dhe kapacitetetve të ndryshme. Ky zhvillim nuk u shoqërua me të njëjtin hap në zhvillimin e infrastrukturës rrugore. Vlora ka një perspektivë të qartë zhvillimi. Pritshmëritë janë që numri i popullsisë do të rritet së bashku me numrin e automjeteve si rezultat i zhvillimit të qytetit.

Për t'i paraprirë zhvillimit të qytetit dhe për të rritur lehtësinë e lëvizjes së mjeteve në rrugë, janë të nevojshme studimet inxhinierike.

Ky studim analizon kufizimet e sistemit rrugor të qytetit të Vlorës duke vënë përballë dy skenarë. Në të parin do të vlerësohen flukset e trafikut për vitin 2030 mbi këtë sistem rrugor. Skenari i dytë do të vlerësojë të njëjtin sistem rrugor kur qyteti do të ketë zhvillim si qytet evropian, ku tre banorë kanë një mjet. Nga ballafaqimi i këtyre skenarëve do të nxirren edhe konkluzionet përkatëse. Modelimi i flukseve të trafikut dhe modelimi i nivelit të shërbimit të rrugëve të qytetit të Vlorës do të bëhen me modelin klasik të transportit dhe me softuerin TransCAD.

Fjalë kyç: trafik, nivel, shërbim, rrugë, Vlorë

Abstrakt

The city of Vlorë, as a result of the changes at the political system, underwent a significant development in the transport sector. The number of vehicles increased rapidly and in various types and capacities. This development was not at the same rate as the development of the road infrastructure. Vlorë has a clear development perspective. The number of the population is increased along with the number of vehicles as a result of the development of the city.

In order to forestall the development of the city and to improve the movement of vehicles on the road, engineering studies are necessary.

Hereby are illustrated the limits of the road system of the city of Vlorë by facing two scenarios. In the first situation is evaluated the traffic flows on the actual road system for the 2030. The second situation is evaluated the same road system considering the development of the city like a European city where three inhabitants have one vehicle. By this evaluation is possible to draw relevant conclusions. The modeling of traffic flows and the modeling of the level of service of the roads of the city of Vlorë is structured by the classic transport model and the TransCAD software.

Keywords: *traffic, level, service, road, Vlora*

Hyrje

Zhvillimi i një vendi apo rajoni të caktuar është i lidhur me zhvillimin e transportit dhe gjithë sistemeve që lidhen me transportin. Shqipëria dhe Vlora, zhvillimin më të madh e kanë marrë me zhvillimin e transportit dhe veçanërisht me zhvillimin e transportit rrugor.

Zhvillimi i rrjeteve rrugore në zonat urbane, si pjesë e sistemit të transportit, është i një rëndësie të madhe. Zhvillimi i kësaj infrastrukture duhet të jetë bazë për zhvillimin urban të qytetit të Vlorës [10].

Infrastruktura e trashëguar në qytet nuk i plotëson kushtet për të përballuar flukset gjithnjë në rritje të mjeteve në vitet e para të demokracisë. Me kalimin e viteve sistemi rrugor është mirëmbajtur dhe disa pjesë të tij janë ndërtuar të reja [10].

Rrugët kryesore të qytetit gjatë periudhave të pikut të trafikut apo gjatë sezonit turistik të verës bllokohen [10].

Rrugët periferike janë të mirëmbajtura por shfaqin të njëjtin problem me rrugët kryesore të qytetit. Akset kryesore të qytetit shërbejnë edhe si rrugë nacionale, nëpërmjet të cilit kalohet për në zonën e Orikumit, Himarës dhe Sarandës duke rritur trafikun [10].

Në periudhën e verës numri i mjeteve rritet për shkak të rritjes së numrit të turistëve, duke vështirësuar lëvizjen.

Prespektiva e qytetit paraqitet optimiste për shkak të zhvillimeve të pritshme ekonomike, sociale dhe demografike dhe parashikohet që popullsia të pësojë rritje dhe si pasojë edhe numri i mjeteve në qarkullim do të rritet [6].

Kjo rritje e numrit të mjeteve duhet të merret parasysh për të marrë masat që situata e trafikut dhe flukset mbi rrjetin rrugor të mos shkaktojnë problem dhe bllokime [9, 10].

Në Shqipëri raporti midis numrit të banorëve dhe të makinave aktive është një automjet për shtatë banorë, ndërsa në vendet europiane raporti është një automjet për tre banorë [8]. Shqipëria dhe Vlora si pjesë e saj, është një vend në zhvillim dhe mbas disa viteve do të arrijë standartin europian edhe për numrin e makinave. Mjafton të konsiderojmë se në Bashkinë e Vlorës, në fund të vitit 2022, ishin rregjistruar 39555 automjete [6]

Nëse raporti europian i mjeteve do të ishte i njëjtë edhe në qytetin e Vlorës, si do të ishin flukset e trafikut mbi rrjetin rrugor të qytetit dhe a do të mundet rrjeti rrugor të përballojë këtë trafik të automjeteve?

Për këtë, do të jetë e nevojshme që të llogariten flukset e trafikut për situatën në të cilën ka një mjet për çdo tre banorë dhe nivelin e shërbimit të këtyre rrugëve, për të parë nëse kapacitetet janë plotësuar ose jo.

Është bërë studimi inxhinierik për përcaktimin e flukseve të trafikut mbi rrjetin aktual rrugor të qytetit dhe mbi rezultatet janë bërë edhe parashikimet për rritjen e këtyre flukseve për të ardhmen dhe konkretisht për vitin 2030.

Nëse janë pëllogaritur dhe njihen flukset e trafikut, duke njohur edhe kapacitetet përkatëse të rrugëve, mund të përcaktohet niveli i shërbimit të rrugëve ose LOS (Level of Service).

Niveli i shërbimit LOS tregon cilësinë dhe lehtësinë e lëvizjes si dhe kushtet mbi të cilat duhet të ndërhyhet për të përmirësuar atë [2, 3].

Rezultatet e mara do të jenë baza për nxjerrjen edhe të konkluzioneve përkatëse për flukset e pritshme të trafikut mbi rrjetin rrugor dhe do të bëhet edhe vlerësimi i kapacitetetve të tyre.

Niveli i shërbimit të sistemit rrugor jep një pamje të qartë se çfarë ndërhyrjesh të mundshme duhet të bëhen për zgjerimin e rrugëve, përmirësimin e cilësisë së tyre, ndërtimin e rrugëve të reja, organizimin më të mirë të trafikut, planifikim më të mirë të territorit, duke ruajtur një raport të caktuar të numurit të banesave me numrin e mjeteve.

Për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e tyre grafike kemi përdorur software-in TransCAD.

Për qytetin e Vlorës nuk ka ndonjë studim inxhinierik të mirëfillt për sistemin e transportit, pra për rrugët dhe lëvizjen e mjeteve, përveç një punimi të bërë në vitin 2001 nga Bashkia Vlorë dhe Instituti Transportit, i cili nuk jepte asnjë zgjidhje për çfarë pritej të ndodhte në vitet në vazhdim me trafikun dhe sistemin rrugor të qytetit, përveç drejtimeve të lëvizjes së automjeteve [7].

Studimi i mëposhtëm është një ndihmë për institucionet që merren me menaxhimin dhe planifikimin e hapsirës urbane të qytetit të Vlorës për të kuptuar më mirë pasojat e zhvillimit të vrullshëm urban në fushën e transportit.

Ky studim gjithashtu është një referencë për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm për Bashkinë Vlorë,

Materiali dhe metodat

Studimi është bërë për zonën urbane të qytetit të Vlorës me një model inxhinierik, me anen e të cilit janë bërë llogaritjet e flukseve të mjeteve mbi rrjetin rrugor si dhe parashikimet për të ardhmen. I njëjti model inxhinierik është përdorur për të bërë edhe llogaritjet e nivelit të shërbimit të sistemit rrugor të qytetit të Vlorës.

Modeli duhet të ndërtohet me një strukturë sa më të thjeshtë dhe të jap një paraqitje të thjeshtuar të realitetit. Thjeshtimi fillon me përcaktimin e zonave, sistemit rrugor dhe kodifikimin e një zone urbane, mbledhjen e të dhënave, kalibrimin dhe vlerësimin e tyre [1].

Këto të dhëna mund të jenë mbi baza vjetore për çdo zonë të hapsirës urbane, për nivele të ndryshme të detajimit për popullsinë, nivelin ekonomik, aktivitetet që lidhen me punësimin, hapsirat tregtare, qendrat social-kulturore, etj [1].

Një ndër modelet më të përdorshëm është modeli klasik i transportit. Si fillim, duhet të përkufizohet zona e studimit dhe të ndahet nga pjesa tjetër. Për zonën që meret në studim duhet të mblidhen një numër i madh të dhënash, në varësi të të cilave përcaktohet edhe saktësia e rezultatëve të modelit. Gjithashtu, rëndësi të madhe për saktësinë e modelit kanë edhe matjet e trafikut mbi rrjetin rrugor [1].

Modeli inxhinierik klasik i transportit mbështetet mbi teorinë e grafeve [1, 5]. Një graf është i përbërë nga një çift kordinatash të bashkësisë G , e cila përbëhet nga elementët N të nyjave dhe nga elementët L të harqeve që lidhin nyjat: $G = (N, L)$.

Nyjet N mund të identifikojnë pikat e një territorit fizik apo aktivitetet e ndryshme të një sistemi. Një hark L tregon egzistencën e një marrëdhënie të çfarëdoshme midis një palë nyjesh që ai përshkon [1, 5].

Paraqitja më e shpejtë e një grafi është metoda grafike në të cilën nyjet janë identifikuar me një rreth dhe një numur dhe harqet nga segmente që lidhin çiftet e nyjeve që formojnë bashkësinë L . Çdo hark i drejtuar ka një shigjetë që tregon drejtimin e orientimit [1, 5].

Skematikisht modeli klasik i transportit paraqitet si mëposhtë:




Fig. 1. Ndërtimi skematik i modelit klasik të transportit

Paraqitja numerike e një grafi mund të jetë edhe në formë matrice ose vektoriale.

Mënyra klasike e mbledhjes së të dhënave për studimin e flukseve të trafikut në hapsirën urbane është mbledhja manuale e tyre. Një mënyrë moderne është edhe mbledhja e të dhënave me anën e paisjeve elektronike, siç janë përdorimi i njësive GPS dhe paisjeve elektronike të matjes së trafikut, etj. Megjithatë, pavarësisht metodës së përdorur, gjithmonë egziston mundësia e gabimeve [1, 5].

Për të mundësuar shmangien e gabimeve përdoren metoda statistikore, nëpërmjet të cilave interpretohen dhe analizohen të dhënat në mënyrë që të merret maksimumi i sasisë së informacionit të përdorur. Nga të dhënat e grumbulluara duhet të nxirren konkluzione sa më të sakta [5].

Është bërë modeli i sistemit të transportit duke bërë shpërndarjen e udhëtimeve mbi rrjetin rrugor të hapsirës së studimit duke ndërtuar matricën e udhëtimeve Origjinë-Destinacion. Në vazhdim bëhet modeli i zgjedhjes të mënyrës së udhëtimit dhe në fund nëpërmjet modelimit kalohet në paraqitjen grafike të flukseve të trafikut mbi rrjetin rrugor [1].

Gjatë modelimit të sistemit të transportit është e nevojshme që numri total i udhëtimeve të dalë nga origjina e zonës (origjina O_i) të jetë i njëjtë me numrin total të udhëtimeve të tërhequra në zonë (destinacioni D_j), e cila japet me shprehjen e mëposhtme [1]:

$$\sum_i O_i = \sum_j D_j \quad (1)$$

E gjithë hapsira e studimit konsiderohet e izoluar dhe të gjitha udhëtimet që gjenerohen nga një zonë do të tërhiqen nga tjetra dhe anasjelltas të gjitha udhëtimet e tërhequra nga një zonë janë gjeneruar nga një zonë tjetër, pra në total shuma e udhëtimeve të gjeneruara është e barabartë me totalin e shumës së udhëtimeve të tërhequra.

Për të bërë parashikimet e flukseve të trafikut për të ardhmen, një nga teknikat më të përdorura është ajo e "Faktortit të Rritjes", e cila mund të aplikohet në parashikimin e numrit të udhëtimeve në të ardhmen nga secila prej kategorive të përmendura më lartë. Ekuacioni bazë i tij është [1, 5]:

$$T_i = F_i t_i \quad (2)$$

ku T_i dhe t_i janë respektivisht parashikimet e udhëtimeve për të ardhmen dhe të udhëtimeve aktuale në zonën i , dhe F_i është faktori i rritjes.

Është përdorur e njëjta procedurë si më lartë, duke modeluar edhe një herë flukset e trafikut për kushtet e pritshme për të ardhmen, duke marrë në konsideratë faktorët e ndryshëm që do të ndikojnë në hapsirën urbane të qytetit të Vlorës [1, 5].

Kjo paraqitje e re e bërë për të ardhmen është e nevojshme për të vlerësuar ndikimin që kanë mbi sistemin e transportit elementët e veçantë të tij.

Ngarkimi i flukseve të trafikut mbi rrjetin rrugor është hipoteza e një udhëtimi racional, dmth, zgjedhje e një rrugë e cila ofron koston individuale më minimale të perceptuar.

Një numër faktorësh influencojnë në zgjedhjen e rrugës kur udhëton midis dy pikash. Këta faktor përfshijnë kohën e udhëtimit, distancën, koston monetare, bllokimet dhe radhët e trafikut, llojet e manovrave të kërkuara, tipin e rrugës, reabilitimin e kohës së udhëtimit [1].

Në fund të modelimit raportohen vlerat e përlllogaritura të fluksevetë trafikut mbi çdo aks rrugor si dhe kapacitetet përkatëse të tyre dhe mund tëpërlllogaritet niveli i shërbimit të rrugëve ose LOS. Niveli i shërbimit të rrugëve përdoret për të përkufizuar cilësinë dhe lehtësinë e lëvizjes në kushte të trafikut të ndryshueshëm si dhe kushtet e kontrollit të tij [2].

Vlerat e nivelit të shërbimit janë të lidhur ngushtësisht me kapacitetin e rrugëve. Nëse kapaciteti jep një vlerë sasiore të trafikut, niveli i shërbimit jep një masë cilësore të tij. Për të përshkruar këto kushte, përdoret shkallëzimi me gërma nga A në F [2].

Niveli i shërbimit të rrugëve LOS mund të paraqitet sipas niveleve:

- Niveli i shërbimit **A** përfaqëson kushtet e fluksit të lirë.
- Niveli i shërbimit **B** përfaqëson kushtet e fluksit me ndonjë kufizim.
- Niveli i shërbimit **C** përfaqëson kushtet stabël të fluksit në të cilin për të mbajtur shpejtësinë e dëshiruar, duhet të ndërrohet korsia ose të realizohen parakalime që kërkojnë vëmendje nga ana e drejtuesit të mjetit.
- Niveli i shërbimit **D** karakterizohet nga një fluks automjeteve i stabilizuar, por mundësia e manovrimit është shumë e kufizuar.
- Niveli i shërbimit **E** karakterizohet nga një nivel i ulët i shërbimit dhe korespondon me kapacitetin e rrugës.
- Niveli i shërbimit **F** përfaqëson kushtet e qarkullimit me ndërpreje dhe bllokime të shpeshta të tipit ndalo dhe ec [2].

Drejtuesi i një mjeti mund të udhëtojë në një rrugë nën kushte të ndryshme të lëvizjes dhe volumit të trafikut. Faktorët që influencojnë nivelin e shërbimit mund të listohen si shpejtësia dhe koha e udhëtimit, ndërprerjet e trafikut ose kufizimet e tij, liria në udhëtim me shpejtësinë e dëshiruar, udhëtimi konfort dhe me kosto sa më të ulët. Drejtuesi i mjetit është tjetër faktor, pra sjellja e tij është shumë e rëndësishme pasi ndikon në kushtet e trafikut [2, 11].

Kapacitetet e rrugëve për një zonë urbane mesatarisht janë 1000 deri 1800 automjete për një orë, mbi një kors, kur ka një trafik të moderuar [3, 11].

Për një rrugë kryesore urbane, në të cilën kalon trafiku kryesor, kapaciteti i rrugës për një kors mund të jetë nga 1500 në 2500 automjete në një kors për një orë [3, 11].

Ndërsa për autostrada kapaciteti për një kors mund të jetë nga 1800 deri në 2200 automjete në një kors për një orë.

Këto kapacitetet janë përlllogaritur për kushte ideale të trafikut dhe të rrugëve. Në çdo rast duhet të merren parasysh faktorët qëpërmenden

mësipër për përllogaritjen e kapacitetit të një rruge [3, 11].

Raporti Volum trafiku/Kapacitetet e rrugës, jep nivelin e shërbimit të rrugëve. Vlera e këtij raporti mund të variojë nga 0 në 1 [2, 11].

Rezultatet

Modelimi i zonës së studimit, është paraqitur si një graf. Grafi i hapsirës urbane të qytetit të Vlorës është ndarë në 20 zona të brendëshme dhe 5 zona të jashtme. Çdo zonë në mënyrë konvencionale do të paraqitet me centroidën e zonës dhe një numur ID [1, 4]. Të dhënat e pesë zonave të jashtme janë marrë nga "Plani Kombëtar i Transportit" [8].

Modelimi është bërë për kushtet e pritshme të trafikut, duke marrë në konsideratë ndryshimet demografike, të numrit të mjeteve dhe ato social ekonomike, për vitin 2030 [4].

Etapat e modelimit në modelin klasik të transportit janë zbatuar dhe rezultati janë vlerat e flukseve të trafikut mbi rrjetin rrugor dhe paraqitja e tyre grafikisht mbi akset rrugore të qytetit të Vlorës [4].

Nivelit i shërbimit është përllogaritur duke bërë raportin e flukseve të trafikut me kapacitetet përkatëse të rrugëve. Rezultati është niveli i shërbimit të rrugës. [2].

Paraqitja grafike e rrjetit rrugor kryesor të qytetit të Vlorës me zonat e ndara dhe me centroidat jepet në grafet e mëposhtëm:




Fig. 2 Paraqitja grafike e sistemit rrugor të qytetit të Vlorës [4]




Fig. 3. Paraqitja e grafit të hapsirës urbane të qytetit të Vlorës [4].

Faktor tjetër i rëndësishëm në përcaktimin e nivelit të shërbimit është shpejtësia mesatare e lëvizjes. Bazuar në përcaktimet e "Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", shpejtësia maksimale e lëvizjes së mjeteve në një zonë urbane është 40 km/orë. Nga përllogaritjet e bëra del që shpejtësia mesatare e lëvizjes është e ulët dhe arrin maksimumin në 25 km/orë [4].

Grafikisht janë paraqitur volume i flukseve të pritshme të trafikut mbi rrjetin rrugor aktual të qytetit të Vlorës si dhe për një pamje me të qartë të ngarkesës së trafikut edhe nivelet e shërbimit të këtyre rrugëve [4].

Nga grafikët e flukseve të trafikut vërehet që qyteti do të ketë ngarkesë të madhe veçanërisht mbi dy akset kryesore që janë Bulevardi "Ismael Qemali" dhe "Gjergj Kastrioti" ndërsa rrugët me më pak volum trafiku janë rrugët periferike. Duhet të shikohet mundësia për një shpërndarje më të drejtë të volumit të trafikut mbi rrjetin rrugor të qytetit, sidomos mbi rrugët periferike. Bulevardet janë edhe zonat me dendësinë më të madhe të

popullsisë duke bërë që efekti mbi trafik të jetë i madh [4].




Fig 4. Paraqitje grafike e flukseve të trafikut për vitin 2030 [4].

Paraqitja grafike e niveleve të shërbimit të rrugëve LOS është paraqitur me ngjyra, ku me ngjyrë jeshile jepen rrugët me nivelin A dhe me të kuqe ato me nivel shërbimi F. Ngjyrat e tjera përfaqësojnë nivelet e tjera të ndërmjetme. Referuar rrugëve me ngjyrë të kuqe, mund të dallojmë që shumë akse rrugore do të janë të bllokuara nga trafiku, pra volumni i flukseve do të jetë më i madh nga kapaciteti i rrugës [4].

Nga pamja e grafikut të nivelit të shërbimit vërehet që akset me ngjyrë të kuqe, pra akset në të cilat volumet e trafikut janë më të mëdha nga kapacitetet përkatëse të rrugëve, pra niveli E dhe F, janë akset që kalojnë në qendrën e qytetit dhe në Bulevardet kryesore të tij, ndërsa akset me volume trafiku më të ulëta, pra niveli A dhe B, dhe që paraqiten me ngjyrë jeshile, janë akset periferike [4].

Trafiku i mjeteve duhet të zhvendoset në rrugët periferike dhe këtu sugjerohet të kalojnë mjetet e mëdha, kamionë dhe autobuzë, duke ditur që efekti i tyre në trafik është sa 3-4 autovetura. Edhe mjetet që kalojnë tranzit në qytet për në Orikum ose Himarë, duhet të kalojnë në periferi.




Fig 5. Paraqitje grafike e nivelit të shërbimit të rrugëve për vitin 2030 [4].

Për të kuptuar me qartë atë që do të ndodhë, merren në referim flukset e trafikut mbi Bulevardin “Gjergj Kastrioti”, një nga rrugët kryesore të lëvizjes së mjeteve në qytetin e Vlorës. Ky aks rrugor lidh qytetin me autostradën.

Flukset e trafikut të përlogaritura në njërën nga segmentet më të ngarkuar të Bulevardit do të kenë vlerën 8194 automjete për orë, ndërkohë që kapaciteti i këtij segmenti rrugor është pranuar mesatarisht 8000 automjete në një orë [3].

Pra, nga sa vërehet, flukset e trafikut mbi këtë aks rrugor, janë shumë të mëdha dhe e ka kaluar kapacitetetin e saj.

Në grafikun e niveleve tëshërbimit shumë pjesë të këtij bulevardi janë me ngjyrë të kuqe ose afrojnë me të kuqen, që do të thotë që kapacitetet e

të jetë me këto rritme apo edhe më të shpejta, një fluks i tillë, në këtë territor dhe me këtë sistem rrugor do të jetë i papërballueshëm.

4. Nga paraqitja grafike e flukseve të trafikut dhe nivelit të shërbimit për zhvillim evropian të qytetit, vërehet që pothuajse i gjithë sistemi rrugor i qytetit është i bllokuar, duke arritur nivelin E dhe F. Pothuajse të gjitha rrugët janë të bllokuara, duke përfshirë edhe rrugët periferike. Vlerat e flukseve të trafikut janë shumë me të mëdha se kapacitetet e rrjetit rrugor aktual.

5. Rritja e përgjegjësisë publike të politikëbërësve të qytetit dhe qeverisë për të marrë masa për hartimin e planeve rregulluese të zgjerimit të qytetit duke respektuar normativat dhe kushtet urbanistike që lidhen me shfrytëzimin e hapsirës urbane, do përshpejtonte zvogëlimin e rrezikut nga bllokimet e trafikut të cilat prodhojnë njëkohësisht jo vetëm humbje kohe, por edhe pasoja të tjera në të gjitha fushat.

Rekomandime

1 Përsheptimi i masave për riplanifikimin e territorit është një hapat e parë që duhet të bëhet. Aktualisht në qytetin e Vlorës, ka një plan të zhvillimit të tij. Qyteti Vlorës ka një dëndësi të madhe të popullsisë e cila vazhdon të rritet nga dita në ditë, dhe bashkë me to edhe numri i mjeteve. Plani zhvillues i qytetit duhet të konsiderojë detyrimisht mundësinë e zgjerimit të territorit të qytetit të Vlorës me qëllim që të mos rritet më dëndësia e popullsisë dhe numri i mjeteve për njësi të territorit.

Në bazë të këtyre planeve të zhvillimit, duhet të jenë edhe planet e zhvillimit të trafikut.

Nga ana tjetër, kapacitetet e rrugëve janë të kufizuara dhe në pjesën më të madhe të rrugëve kryesore, nuk ka mundësi për të zgjeruar dhe për të rritur kapacitetetin e tyre.

2. Në kushtet aktuale, për zona të caktuara të qytetit, ku dëndësia e mjeteve dhe e popullsisë është e madhe, janë të nevojshme ndërtimi i parkingjeve nëntokësore dhe mbitokësore për automjetet.

Këto mund të jenë në hapsira publike dhe private, në katet nëntokësore të pallateve apo duke ndërtuar godina mbi tokë për parkime.

Duke parë dëndësinë e madhe të popullsisë, Bashkia sugjerohet që lejet për ndërtimin e apartamentëve të reja t'i japi në zonat preferike të qytetit si dhe me parkingje në katet nëntokësore.

3. Rritja e sinjalistikës për sistemin rrugor të qytetit është një detyrim.

4. Organizimi më i mirë i trafikut duke shtuar rrugët me një drejtim për të rritur shpejtësinë e lëvizjes.

5. Nxitja dhe financimi i organizatave të shoqërisë civile me anëtarësi, me fokus rritjen e kulturës qytetare mbi sigurinë e lëvizjes dhe respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor.

6. Hapja e programeve që përgatisin specialistë në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të transportit në mënyrë që institucionet e njësive vendore edhe në zbatim të ligjit të bëjnë studimet e trafikut dhe t'i përditësojnë ato sipas planeve dhe prioriteteve të shpallura nga pushteti lokal apo edhe ai qëndror.

Literatura

1. Willumsen L, Ortuzar J. (2011). *Modelling Transport*. 4th edition 10-60
2. John R. McLean: *Highway Traffic Operations: Theory and Practice* 98-140
3. *Traffic Capacity Of Urban Roads*, TA 79/99 Incorporating Amendment No 1 dated May 1999
4. Msc.Ing. Pëllumb Cacaj *Disertacion: Modelimi i flukseve të trafikut të rrjetit rrugor në qytetin e Vlorës me Software TransCAD*
5. Ennio Cascetta: *Transportation Systems Engineering: Theory and Methods* 207-256
6. DPSHTRR, *Shërbime-online/open-data-statistika-raporte*
7. *Bashkia Vlorë dhe Instituti i Transportit, Plani i trafikut i Bashkisë Vlorë, viti 2001*
8. *Instituti i Transportit, Plani Kombëtar i Transportit, viti 2018*
9. *Bashkia Vlorë, Dokumenti i Rishikimit të PPV Vlorë, vendim nr. 4 datë 17.05.2019*
10. *Bashkia Vlorë, Rregullore e planit PPV Vlorë, nr. 64, datë 31.08.2017*
11. *Autoriteti Rrugor Shqiptar, Udhëzime të përgjithshme, "Kushtetektike të projektimit të rrugëve automobilistike"*